



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 17 NËNTOR 2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
17. NOVEMBRA 2011. GODINE**

**NËNTOR – NOVEMBAR
2011**

E enjte, 17.11. 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Fillojmë me pikën e parë.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Diskutimet në emër të grupit parlamentar zgjasin deri në 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta, replika nuk ka.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e marrin fjalën. Po e nisim me deputeten Nazane Breca.

NAZANE BRECA: Faleminderit, kryetar!

I nderuari kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Kosova në vazhdimësi ka probleme me kuadrot. Në të kaluarën niveli i arsimimit të popullatës, e dimë të gjithë se si dhe sa ka qenë.

Në vitet '80 fillon ngritja e arsimimit dhe krijimit të kuadrove aq të nevojshme për ne si komb dhe komunitet.

Në dhjetëvjeçarin e fundit, e dimë gjithashtu, se ky nivel filloi të ngritet dhe në fakt na gëzonte të gjithëve, duke mos dashur të hyjë shumë në nivelin e cilësisë, i cili gjithmonë është çështje për diskutim, në kohën kur edhe me strategji dhe me ligj mundoheshim të ngrisnim numrin e punëtorëve shëndetësorë, e në veçanti të mjekëve për numër të banorëve.

Ngritja e këtyre kuadrove i kushton shtetit dhe familjes, kuptohet edhe individit. Të gjithë jemi të njoftuar se Fakulteti i Mjekësisë zgjatë 5 dhe 6 vite, varësisht nga vendi se ku studiojnë, ku shumica bëjnë edhe më shumë për të diplomuar. Më pastaj, ky kuadër duhet të punojë të paktën edhe dy vite për të mund të marrë specializimin, i cili gjithashtu zgjatë nga 3 deri në 6 vite dhe këtu nuk përfundojnë peripecitë dhe telashet e kuadrove të reja.

Është fati ai që do ta gëzonte këtë specialistë në qoftë se gjen një vend pune për të filluar punën dhe jetën familjare. Për ata që nuk e kanë këtë fat, si mund ta quajmë, sigurisht se mendojnë në opsione tjera, të lënë atdheun dhe të gjejnë një vend pune në një vend tjetër. Pse? Sigurisht se për këtë duhet pyetur Qeverinë dhe shtetin. Çka ajo bëri e bën që këto kuadro t'i ndalë e t'i stimulojë në vendin tonë, e në anën tjetër çdo ditë dëgjojmë refrene se si ta kthejmë trurin nga shtetet e tjera. A nuk tingëllon cinike kjo?

Derisa ne diskutojmë me ... ndonjëherë për çështje të tilla, të cilat më shumë tingëllojnë si premtime të fushatave elektorale, realiteti është krejt tjetër, është krejt ndryshe. Sot, deshëm të pranojmë apo jo, një numër shumë i madh i mjekëve po na ikin çdo ditë. Kjo

sigurisht që i kushton familjes së individit, por të jemi të bindur se më së shumti do t'i kushtojë Kosovës, apo ndoshta po brengosemi shumë dhe së koti, meqë premtimet e Qeverisë janë të kota dhe i ngjajnë fushatës elektorale që zgjasin një muaj.

Të nderuar qeveritarë,

Para se të bëhet vonë për ne si shtet dhe të biem në krizë intelektuale, e në veçanti në mungesë të mjekëve, do të duhej të mendojmë më seriozisht në këtë drejtim, jo duke ju ndaluar njerëzve që të lëshojnë vendin, ngase secili do të gjejë mënyrën të ikë.

Sigurisht, vendet që kërkojnë mjekë janë përfitues të dyfishtë, njëra se nuk kanë investuar asnjë centë për t'i shkolluar këto kuadro, e në anën tjetër marrin punëtor të rinj, si kuadro që do t'i shfrytëzojnë gjatë dhe do të jenë edhe taksapagues të gjatë.

Të nderuar qeveritarë,

Është koha të mendoni në këtë drejtim. Dritat e rrezikut po na lajmërojnë seriozisht. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REXHEPI: Poštovani predsjedniče,

Predstavnici vlade,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

Za ovom govornicom u Parlamentu Kosova želim da istaknem jedan veliki problem koji muči Bošnjačko stanovništvo u Prizrenu, odnosno regionu Župe i Podgore, gde se unazad godinu dana vrši privatizacija društvenih Lirijinih objekata od strane Agencije za privatizaciju, koji su strateški bitna mesta za izgradnju infrastrukturnih objekata za planiranu buduću opštinu, pa bih apelovala na direktora da se taj proces privatizacije privremeno obustavi dok se ne regulišu imovinsko - pravna pitanja u tom regionu.

Posedujem dokaze da je zemljište vlasništvo privatnih lica koje mogu dostaviti na uvid posedovne listove, kao i stare tapije koje su građanima bile privatno oduzete pre 1999. godine.

Takođe, želim istaći jako bitan problem, odnosno sistem privatizacije od strane agencije, njenih menadžera i njihovom nepristrasnom ponašanju tokom dodeljivanja tendera, gde bi lokalno stanovništvo imalo prednost, naravno uz poštovanje svih adekvatnih kriterijuma od strane agencije, da se ne bi desio problem dodele Lirijinog objekata u Rečane nekom stranom licu protiv koje se sada vrši peticija Bošnačkog stanovništva koje živi u tom regionu. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,
Të nderuar dhe të respektuar deputetë,
Unë kam një pjesë të fjalës sime që e kam përgatitur për veriun, kur ka qenë rendi i ditës,
do të flas, do të lexoj vetëm një pjesë të saj dhe pjesën tjetër do ta dorëzoj në sekretari.

Do të lusja dhe do të përgjëroja të gjithë ata që janë të preokupuar me të drejtë për fatin tonë tragjik dhe për fatin e etnisë tonë të copëtuar, me theks të veçantë kur flasim, kur shkruajmë, kur sugjerojmë zgjidhje për Preshevën, Bujanovcin dhe për ato vendbanime të banuara me shqiptarë në Medvegje, që duhet të jemi shumë të kujdesshëm.

Këto vise duhet dhe do t'i bashkohen Kosovës, jo si rezultat i këmbimeve territoriale, sepse sipas dëshmimeve të literaturës historike, të botuar në Serbi, që një pjesë e saj e kam cituar dhe kam shfletuar edhe në këtë parlament, do dëshmojnë bindshëm se Serbia me qeveritë e saj shoviniste ka aneksuar kaq shumë territore tona dhe ka shkombëtarizuar etninë tonë deri në Luginë të Preshevës e të Bujanovcit, duke shkaktuar vrasje, djegie të përmasave çnjerëzore, që edhe sot gjatë leximit të kaplon trishtimi.

Ndërsa, kjo gjeneratë e jona sot, kur i kujtojmë përjetimet e luftës së fundit, përmasat e pësimeve dhe shkallën e përjetimeve vijmë në një konkluzion se paça në mes të Kosovës e Serbisë dhe pajtimi historik i joni dhe i Serbisë mund të vijë jo vetëm me një kërkim falje për të gjitha këto, por doemos dhe gjithsesi pa tjetër do të vijë si ekuivalencë e gjithë kësaj përplasjeje historike që bëhet kthimi i Preshevës e Bujanovcit dhe i atyre vendbanimeve me shqiptarë në rrethinën e Medvegjës, që historikisht kanë qenë shqiptare në kuadër të Kosovës, dhe nuk guxo të mendojë askush, i shtyrë nga instinkti i xhambazit me asnjë kodër sa do të vogël në veri të Kosovës, si këmbim.

Këto kohët e fundit janë deklaruar subjekte politike, formime akademike, me shkëlqim në krijimtarinë e tyre të admirueshme letrare dhe shkencore, figura piemonte në këto krijimtari, të cilat me sugjerime dashamirëse, secili me teori për zgjedhje të problemit të këtyre viseve tona martire e kanë lënduar këtë çështje, duke kontestuar njohjet e 85 shteteve, një pjesë e këtyre është më me ndikim në rruzullin tokësor, të cilët na njohin të drejtën tonë në këtë tërësi territoriale, duke u shprehur kështu siç ka ndodhur me disa paraqitje të ndryshme. Kontestohet edhe vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë se Kosova ka të drejtë dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të vet ka folur.

Mirë, faleminderit, e dorëzon me shkrim! E lexova dhe e thashë, deputetët që lajmërohen në emër të grupit, le të lajmërohen që janë në emër të grupit. Me opozitën po bëj përjashtime, me pozitën jo!

Deputeti Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, poštovani predsedniče!

Poštovani poslanici,

Drage kolege,

Posebna je čast i zadovoljstvo biti poslanik koga su na slobodnim izborima izabrali građani, ali ta čast nosi veliku odgovornost koju moramo pokazati i opravdati ukazano poverenje kako radom u parlamentu, tako van njega.

Ovo sve govorim iz razloga što Poslanička grupa SLS ima tu odgovornost i poslanici moraju izneti probleme svojih birača iz svoje zajednice.

U prethodnom periodu, kao i sada, sela u opštini Gračanica izložena su, moram se tako izraziti, torturi ili samovolji kompanije za distribuciju i prodaju struje, KEK-u. Pa i ako su građani platili i izmirili svoje obaveze, po zvaničnoj statistici preko 80%, oni su kategorisani u grupu C, u kojoj se nalaze potrošači koji nisu platili i ispunili svoju kvotu i naplate.

Moram napomenuti da u grupi C potrošači imaju 3 sata struju, 3 bez struje.

Ovim putem moram iskazati svoje nezadovoljstvo i nezadovoljstvo svoje zajednice i u ovom domu skupštine i da zamolim relevantne faktore kako u KEK-u, tako i u Vladi da jednom za svagda odvoji dobro od lošeg, tojest da potrošačima koji su izmirili svoje obaveze omogući slobodno snabdevanje električnom energijom i da ih ne izjednačava sa potrošačima koji ne plaćaju utrošenu električnu energiju. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Kabinet qeveritar,

Jemi mësuar të flasim gjithmonë për veriun edhe atë pasi që të kemi incidente dhe probleme serioze atje, edhe më herët. Edhe kolegu im nga Grupi i PDK-së tash e përmendi.

Sjellja jonë gjithmonë karshi problemeve dhe mundësisë së zgjidhjes së problemeve, me frikë po e qet politikën e Kosovës në defanzivë edhe kohën kur kemi propozime opsionale prej Serbisë, edhe në kohën kur kemi probleme serioze me bllokimin e rrugëve dhe jetës atje, edhe me probleme për menaxhimin edhe shtrirjen e sovranitetit, e në fund ka dalë edhe ideja më e re që kufijtë duhet të bashkë menaxhohen.

Atëherë, nëse ata nuk donë të jetojnë në Kosovë dhe nëse ata nuk i kanë takuar Kosovës një kohë të gjatë, është problem që duhet lënë ata ta zgjidhin, por ne nuk mund t'i detyrojmë njerëzit të jetojnë me zor. Problemin tash po zhvendosin lindje, aty ku është problemi, aty ku s'flitet kurrë, sepse e deshëm ose s'deshëm, në lindje të Kosovë edhe lufta është bërë vetë, është ndarë, dhe të drejtat politike edhe civile të garantuara nuk janë realizuar. Atëherë 74-shi nuk po funksionon as për Serbinë, as për Kosovën, duhet gjetur një model tjetër, i cili i kënaq palët, e ndal këtë dialog teknik të rrejshëm, kalon në një dialog politik, i cili ridefinon kufijtë dhe këta kufij të 56-ës i zgjidhin problemet etnike dhe territoriale në mes popujve, sepse tendenca e Serbisë është për ta parandaluar, ka qenë për ta parandaluar Republikën e Kosovës, por kjo ka dështuar dhe tash ne duhet ta

parandalojmë tendencën e tyre për ta ndarë Kosovën brenda ose për ta ndarë Kosovën territorialisht, sepse ata nuk dëshirojnë të bisedojnë më për Lindje të Kosovës, ata bisedojnë vetëm për Veri, vetëm për të drejtat territoriale dhe politike të serbëve në veri dhe këto probleme vazhdojnë.

Ne e dimë krejt që hekurudha e vjetër është një kufi historik, i cili i ka ndarë shqiptarët si etni në atë kohë prej serbëve, sado që thellë i duket dikujt, nuk është thellë, sepse aty njerëzit jetojnë edhe sot dhe zgjidhja e problemeve politike dhe territoriale njëherë e përgjithmonë me Serbinë do ta qetësonte regjionin dhe do të krijonte mundësi krejt tjera, në mënyrë që procesi të ecën përpara.

Atje ka shumë njerëz, shumë shqiptarë që jetojnë edhe sot dhe nuk mendojnë për t'u larguar, përkundër presionit të madh, atje ka edhe më tutje kërkesa politike që presin për t'u realizuar, por askush prej neve nuk merret.

Procesi i fundit i Vjenës e ka ndaluar Kosovën për të vendosur reciprocitet politik, në mënyrë që të realizohen ato të drejta, me kushtëzimin që statusi i Kosovës rrezikohet të mos zgjidhet.

Atëherë, Grupi i Unitetit në atë kohë i ka ikur kërcënimit serioz për mos zgjidhjen e statusit, ndoshta është dashur të zgjidhet njëherë problemi i madh e mandej të merren me probleme sekondare dhe me probleme tjera. Unë jam ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

E njëjta gjë ka qenë, por Haliti dhe Luta ia morën temën “Vetëvendosjes”.

Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë, zëvendëskryeministra, ministra,

Kolegë deputetë,

Shpresoj se këtë temë s'e ka marrë askush. Dola këtu vetëm të informoj që Komisioni për amendamentimin e Kushtetutës ka hyrë në fazën finale. Ne e kemi përfunduar fazën e debatit publik dhe në këtë fazë, nga data 20 e këtij muaji deri më datën 5 dhjetor është konsulta përfundimtare me partitë politike. Gjithashtu Komisioni është brenda afateve dhe mandati i këtij Komisioni përfundon më datën 20 janar, po për shkak të punës që e kemi bërë intensive edhe gjatë verës, Komisioni ka vendosur që projekt-amendamentet kushtetuese t'i dorëzojë një muaj para kohe, do të thotë është orientimi që deri kah data 20 dhjetor pakoja e amendamenteve t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës, në mënyrë që në pajtim me Rezolutën e Kuvendit të Kosovës të krijohen kushtet për implementimin e plotë të rezolutës.

Për shkak të diskutimeve të këtyre ditëve, dola të sqaroj se sa i përket Komisionit, Komisioni nuk do të kërkojë asnjë ditë shtesë për ta përfunduar mandatin, përkundrazi

simbolikisht ne do ta dorëzojmë pakon e amendamenteve para kohe për të hapur rrugën drejt implementimit të obligimeve që dalin nga rezoluta.

Aspekti i dytë, siç e thashë, nga data 20 deri më datën 5 dhjetor, komplet grupet parlamentare dhe partitë politike duhet të përfshihen në këtë debat për t'i dhënë vërejtjet përfundimtare, sepse më datën 14 dhe 15 dhjetor është edhe mbledhja e fundit të komisionit, kur këto do të miratohen.

Dhe, segmenti i tretë, Komisioni po funksionon plotësisht brenda mandatit legal që kemi. Pra, ne jemi duke u marrë kryesisht me aspektin e zgjedhjes së drejtpërdrejtë të Presidentit dhe çështjet që ndërlidhen me këtë proces dhe nuk ka ende asnjë ide në Komision që të merrem me çështjet e kompetencave, sepse një gjë e tillë nuk është në mandatin e Komisionit. Mirëpo, Komisioni ka vlerësuar gjatë punës se në qoftë se Parlamenti vlerëson që Komisioni duhet të merret edhe me çështjet e kompetencave, atëherë është në parlamentin të vlerësojë se a do ta autorizojë Komisionin për një mandat të tillë.

Por, vetë fakti që amendamentet do të dorëzohen me kohë dhe Parlamenti do t'i miratojë, hapet rruga që rezoluta të implementohet plotësisht në kohë dhe miratimi i amendamenteve dhe Ligjit për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit e krijon infrastrukturën e nevojshme kushtetuese dhe ligjore që vendi të shkojë në zgjedhjet e Presidentit sipas dinamikës së përcaktuar me Rezolutën e Kuvendit të Kosovës dhe me memorandumit, i cili është pranuar në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: faleminderit!
Fjalën e ka deputeti, Vesimir Saviq.

VESIMIR SAVIĆ: Hvala, predsjedniče Skupštine!
Dame i gospodo narodni poslanici,
Želim ovom prilikom da iskoristim svoja prava koja predviđa Poslovnik o radu Skupštine Kosova, poglavlje VI, član 20. tačka 2, gde poslanici mogu na osnovu svojih političkih ideja i stavova biti članovi nekih parlamentarnih grupa, a da iz tih grupa isto mogu izaći pismenim zahtevom.

Ja sam 11.7.2011. godine uputio jedan pismeni zahtev predsjedniku Skupštine da ja, poslanik Vesimir Savić, napuštam Poslanički klub SLS-a. U više navrata sam kontaktirao tehničko osoblje Parlamenta Kosova, gde se moje ime i prezime drži još na sajtu Poslaničkog kluba Samostalne liberalne stranke.

Samostalna liberalna stranka nema 12 poslanika u svom Poslaničkom klubu, ima mnogo manje, jer su još i drugi poslanici izašli iz tog Poslaničkog kluba i tražim da se moje ime i ime tih poslanika ne zloupotrebljava na sajtozima Skupštine Kosova. Tražim da se moje ime po hitnom postupku, kako se to uradilo skidanje iz Komisije, uradi i skidanje mog imena i prezimena sa Poslaničkog kluba Samostalne liberalne stranke na sajtu Skupštine Kosova. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Dhe, deputetja e fundit që është lajmëruar, është deputetja Xhevahire Izmaçu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe njëherë brenda pak muajsh jam e detyruar të paraqes një problem të madh që po përballen qytetarët e komunës së Vushtrrisë, mungesën e madhe të energjisë elektrike.

Komuna e Vushtrrisë, qytetarët e saj po përballen me një terr të pambarim nga një keqmenaxhim i Korporatës Energjetike të Kosovës.

Ditëve të fundit, KEK-u përmes Zyrës së Informacionit ka dalë edhe me deklarata të pavërteta, ku po i bën të papërgjegjshëm të gjithë qytetarët e Vushtrrisë, duke i qitur si keqpërdorues të mëdhenj të një energjie që ata realisht edhe e kanë shumë pakë këto ditë.

Si deputete dhe qytetare e kësaj komune jam e obliguar të shpreh revoltën time për metodën e dëmtimit kolektiv, pra për veprimet që KEK-u i bën ndaj qytetarëve të Vushtrrisë, duke i shkyçur vazhdimisht në mënyrë kolektive.

Qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë u është bërë një jetë e padurueshme me këtë gjendje. Posaçërisht këtë gjendje po e vuajnë fëmijët, pleqtë, çerdhet dhe gjithë të tjerët qytetarë. Andaj, ftoj menaxhmentin e KEK-ut që të ketë një përgjegjësi më të madhe dhe të ketë një transparencë edhe lidhur me pagesat dhe faturimet të cilat sipas informacioneve të fundit janë rritje në komunën e Vushtrrisë, ndërsa paraqiten krejt ndryshe nga menaxhmenti i kësaj korporate.

Gjithashtu, kërkoj nga menaxhmenti i KEK-ut që nëse assesi nuk ka mundësi që të bëhet një furnizim më i mirë me energji elektrike, atëherë së paku le të ketë një lajmërim edhe mos të bëhen shkëputje dhe ndërprerje të energjisë elektrike pa kurrfarë lajmërimi, së paku të kenë një përgatitje ekonomitë familjare, por edhe mos të kenë kolaps të gjitha bizneset në komunën e Vushtrrisë.

Dhe, e fundit, ata si korporatë energjetike kanë obligim që të bëjnë një menaxhim më të mirë dhe të marrin mësim nga menaxhimi i korporatave të tjera se si t'i inkasojnë borxhet e tyre, jo të dalin me deklarata dhe të fajësojnë të gjithë qytetarët pa dallim, edhe ata që janë të përgjegjshëm, edhe disa prej tyre që mund të jenë të pa përgjegjshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zotërinj ministra dhe zëvendësministra,

Dialogu Kosovë – Serbi për çështje teknike në mënyrë që të lehtësohet jeta e qytetarëve, që është pak a shumë definimi fillestar dhe ende qëndron i këtij dialogu, ka filluar kah

mot, mandej ka ngecje dhe tash ditët e fundit kemi një aktivizim të diskutimit rreth këtij dialogu.

Janë disa përfundime të cilat nuk janë bërë vepër. Unë mendoj që është koha që kur flitet për këtë dialog, të rridefinohet përkufizimi i tij fillestar, sepse kam bindjen që ka rrëshqitur nga ky përfundim edhe përkufizim, aq më tepër në rast se ky përkufizim fillestar krahasohet me një rezolutë të nxjerrë në Kuvendin tonë dhe, edhe një hap më tej, aq më tepër që nuk ka pasur një komunikim institucional për zhvillimet e këtij dialogu.

Tash, ditët e fundit doli edhe një propozim që po shëtit ndërmjet komunikimeve të përfaqësuesve të dialogut në Kosovë dhe në Serbi, i cili po më duket që pa të drejtë po bëhet një tip i diskutimit pa përgjegjësi, një diskutim akademik, çka është menaxhimi i përbashkët i kufijve dhe ç'është kufiri. Me qenë se ne nuk kemi një diskutim institucional për këto probleme, që janë fundamentale në raportet Kosovë – Serbi, mendoj që është koha, është domosdoshmëri që të krijohet një transparencë aq sa është e mundshme dhe e domosdoshme ndërmjet ekipit të bisedave, të dialogut dhe institucioneve të Kosovës, në këtë rast Kuvendit.

Dhe, po rezymoj: është koha dhe më vjen mirë që kryetarja e dialogut ose udhëheqja e dialogut, zëvendëskryeministrja Edita Tahiri është këtu, që sot ta japë një deklaratë para Kuvendit se çka është duke ndodhur, sepse mendoj që nuk kemi nevojë t'i bëjmë shpejt e shpejt dhuratë Serbisë për këtë pjesë të këtij muaji që ka mbetur, për ta bërë bashkëpunëtorë të jashtëzakonshme në dialog, kur asgjë, asgjë deri tash nga ky dialog nuk është bërë vepër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Dhe, me këtë diskutim, pika e rendit të ditës - Deklarimet jashtë rendit të ditës, përfundoi.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45.1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashtrojnë më së shumti dy pyetje.

Ne sot kemi 4 pyetje të deputetëve. Prej 4 pyetjeve, 3 ministrat që ju drejtohen pyetjet nuk janë këtu. Është vetëm ministri Bedri Hamza. Nëse donë deputetët t'i lexojnë pyetjet unë mund t'i thirr me emër.

Pyetjen e parë për sot e ka bërë deputeti Shaip Muja, për ministrin Ferid Agani. Deputet, a do ta lexosh pyetjen.

SHAIP MUJA: I nderuar kryetar, jo, sepse janë edhe dy pyetje paraprake të cilat lidhen me këtë pyetje, që përbëjnë tërësinë e kuptimit të orientimeve të mia që i kam shtruar.

Mministri i Ambientit, po ashtu nuk është përgjigjur, as ministri i Drejtësisë dhe nuk ka kuptim, në mungesë të ministrit të Shëndetësisë nuk kompletohet kuptimi pse i kam shtruar pyetjet. Faleminderit! Kur të jenë këta prezent, do t'i shtroj tri pyetjet.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Sali Morina, pyetje për ministren Mimoza Kusari – Lila, ministrja nuk është këtu. A do ta bësh pyetjen, deputet? Faleminderit!

Deputeti Agim Kuleta, pyetje për ministrin Bedri Hamza. Deputet, e ke fjalën! Regjia, fjalën deputetit Kuleta!

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryetar!

Neni 26 i Ligjit 03/L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar e përcakton normën standarde të TVSH-së prej 16%. I njëjti nen e ka paraparë mundësinë që ministria përkatëse, me një vendim të Qeverisë, pas aprovimit nga Kuvendi të nxjerr akt nënligjor për futjen në përdorim të normës së ulur deri në masën 5% për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të caktuara.

Aplikimi i kësaj mundësie të paraparë edhe me ligj për uljen e TVSH-së për produkte bujqësore dhe ta ndihmonte në mënyrë të drejtpërdrejtë sektorin e bujqësisë, si sektor shumë i rëndësishëm në të cilin llogarit zhvillimi ekonomik i vendit.

Sipas të njëjtës procedurë, nëse paraqitet e nevojshme, si masë mbrojtëse mund të nxirret vendimi për ngritjen e normës së TVSH-së deri në masën prej 21% për disa produkte të veçanta, siç janë: duhani, pijet alkoolike me përqindje alkooli mbi 8%, parfumet dhe automjetet e pasagjerëve me çmim mbi 25 mijë euro.

Sot, kur dihet që pjesa më e madhe e produkteve bujqësore për t'iu shmangur pagimit dhe TVSH-së tregtohen në mënyrë jo të rregullt dhe në këtë mënyrë shkaktojnë rritjen e evazionit fiskal, nxjerrja e një vendimi të tillë nga ana e Qeverisë do të ndikonte fuqishëm në drejtim të kundërt me këtë trend negativ. Përveç kësaj, pra uljes së evazionit fiskal, kjo masë do të ndikonte gjithashtu edhe në rritjen e fuqisë blerëse të konsumatorëve.

Atëherë, zoti ministër, pse nuk ka ndodhur ulja e TVSH-së për produkte bujqësore deri më tani dhe a ka Qeveria në plan që një gjë të tillë ta bëjë në të ardhmen? Nëse po, kur? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuari zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Deputetë të nderuar,

I nderuari deputet Kuleta, faleminderit për pyetjen!

Qeveria e Kosovës është në vazhden e reformave, sidomos te politika fiskale. Dihet se në të kaluarën është shtuar norma e tatimit në fitim të korporatave në 10%, norma e tatimit në fitim të ardhurave individuale është progresive që fillon 04, 8 e 10% dhe këto reforma

janë duke vazhduar. Edhe para sa dite kanë ndodhur disa ndryshime në favor të krijimit të kushteve dhe të klimës më të mirë për biznesin, siç është ulja e normave të kamatave të cilat Administrata Tatimore i aplikon ndaj bizneseve të cilat kanë vonesë në pagesën e tatimeve, thjeshtësimi i dokumenteve të cilat nevojiten me rastin e importimit dhe eksportimit të produkteve të caktuara në Kosovë nga 9 dokumente në 3, dhe një prej masave që parashikohet është edhe lirimi i lëndëve të para dhe lirimi i disa pajisjeve nga dogana, me qëllim që të favorizohet sidomos prodhimi vendor.

Sa i përket çështjes së TVSH-së, dihet se edhe shumë vende të tjera të regjionit, po edhe në Evropë kanë TVSH-në e përshkallëzuar, domethënë ku është norma e ulët dhe norma e lartë. Ne kemi aktualisht normën 0 dhe normën standarde 16%.

Për të gjitha reformat të cilat jemi duke i zhvilluar, sa i përket politikave fiskale ne jemi në bashkëpunim të ngushtë edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Ky është një prioritet i yni, ne e kemi qitur në tavolinën e bisedimeve, jemi duke diskutuar edhe në momentin kur ne e harmonizojmë dhe normalisht kur kemi edhe ngritje të performancës të institucioneve që merren me administrimin e këtyre tatimeve, ne do të vendosim për uljen dhe për shkallëzimin e normës së TVSH-së. Mirëpo, jemi duke investuar në ngritjen e performancës të institucioneve që merrem me administrimin e TVSH-së.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputet, ke pyetje shtesë!

AGIM KULTETA: Unë veç rreth pjesës së dytë të pyetjes, do të thotë, nëse po, siç thatë ju, po, atëherë a ka ndonjë farë afati përafërsisht kur mund të ndodhë kjo, të përafërt.

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Fillimisht jemi duke investuar në ngritjen e performancës, të kapaciteteve të Administratës Tatimore. Në momentin kur Fondi Monetar Ndërkombëtar vlerëson dhe Ministria e Financave vlerëson që ky institucion i ka mbërrirë kapacitetet e nevojshme që të mund të merret edhe me menaxhimin e TVSH-së të përshkallëzuar, sigurisht se do të ndodhë. Ne i kemi të gjitha analizat. Ndërsa, sa i përket çështjes së implikimeve në buxhet, ne nuk e shohim ndonjë rrezik të madh, sepse ka mundësi që norma standarde të lëvizet për një përqindje, ndërsa të riedukohet norma e ulët për disa produkte që janë më etike për qytetarët e Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Dhe, pyetja e fundit, deputetja Sala Berisha – Shala, pyetje për ministrin Besim Beqaj, ministri s'është këtu. Do ta lexoni pyetjen?
Regjia, fjala për deputeten Sala Berisha –Shala.

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit, kryetar!
Me qenë se ministri nuk është këtu, pyetja ime ka pasur të bëjë me monitorimin e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale dhe besoj që në seancën e ardhshme ministri do të vjen të na tregojë se sa janë përfillë rekomandimet që kanë dalë nga ai monitorim.

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 8 nëntor 2011,

Pyes, nëse keni vërejtje në Procesverbal? Si duket, nuk ka vërejtje. Konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 8 nëntor 2011.

Prezentë kemi 79 deputetë.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim, në parim.

Ftoj kryeministrin, zotin Hashim Thaçi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fillimisht, më lejoni që në kuadër të këtyre angazhimeve që i kemi, por edhe të miratimit të buxhetit të Kosovës për vitin 2012, të ndalem edhe në dy çështje që janë të rëndësishme, po ashtu, për qytetarët e vendit, për shtetin tonë, për respektimin e Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës.

I nderuari kryetar,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Miq ndërkombëtarë,

Jemi dëshmitarë të përkushtimeve të mëdha të institucioneve të Republikës së Kosovës në një partneritet shumë të ngushtë me të gjitha autoritetet ndërkombëtare, KFOR-in, EULEX-in, Bashkimin Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të bërë zbatimin e plotë të kushtetutshmërisë dhe ligjeve në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Befasisht, ditëve të fundit kemi deklarime të personaliteteve publike të partive të ndryshme politike, që mënyrën e zgjidhjes së problemit të veriut të Mitrovicës e shohin si option me dhënien e atij territori të Republikës së Kosovës, Serbisë, apo me ndryshimin e kufijve apo këmbimin e territoreve.

Natyrish, unë shpreh edhe shqetësimin e Qeverisë për këto ide befasuese, që janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës dhe, gjithashtu, prezantoj edhe shqetësimin e gjithë miqve ndërkombëtarë për këto ide që janë në kundërshtim me qëndrimet e Kuvendit të Kosovës, Qeverisë, të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës, në kundërshtim me vullnetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, në kundërshtim me dokumente ndërkombëtare për Kosovën. Dhe, ritheksoj, Kosova është e njohur nga 86 shtete me integritetin territorial të respektuar, të garantuar dhe të njohur ndërkombëtarisht.

Prandaj, edhe njëherë shpreh shqetësimin tim në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjithashtu prezantoj edhe shqetësimin e miqve ndërkombëtarë, që kanë prezantuar këtë shqetësim në Qeveri të Kosovës për këto ide të individëve të ndryshëm të skenës politike të Kosovës.

Dhe, pyetja ime në këtë drejtim, edhe si Qeveri e Kosovës, është që a është edhe qëndrim i partive të caktuara politike, apo janë vetëm qëndrime individuale?

Jam në favor të mendimit të lirë, jam në favor të ideve të reja, në favor të opinioneve të lira, por në të njëjtën kohë, mendoj se këtyre çështjeve të ngritura ditë më herët apo edhe ditëve të fundit, është mirë t'u jepet përgjigje nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Qeveria e Kosovës do të vazhdojë të respektojë në plotëni Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, për respektimin e plotë të integritetit territorial të Republikës së Kosovës dhe, natyrish, asnjë cep i territorit të Republikës së Kosovës të mos i jepet Serbisë.

Dy, është ngritur, gjithashtu ndërlidhet edhe me buxhet krejt, bile më tepër se buxheti kjo është - ndarja e territorit të Kosovës dhe çdo ide e tillë është shumë e rrezikshme.

Dhe, çështja e dytë, është ajo për menaxhimin e integruar të kontrollit të kufirit shtetëror.

Ideja e Qeverisë së Republikës së Kosovës për menaxhimin e integruar dhe kontrollit të kufirit shtetëror është në përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës, në përputhshmëri me ligjet e Kosovës, dhe ju kisha ftuar të gjithëve me dashamirësinë më të madhe, si kolegë, ta lexoni mirë, sepse është model evropian, model që e kemi aprovuar vetë dhe unë dëshiroj të theksoj vetëm atë që të mos përzihet menaxhimi i integruar i kufirit me çështjen e kufijve!

Dhe, menaxhimi i integruar i kufijve është ky, pra ky ligj zbatohet pa paragjykim ndaj mandatit organizatave ndërkombëtare, ashtu siç parashihet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Tjetër, menaxhimi i integruar i kufirit nënkupton bashkërendim dhe bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtar, ndërmjet të gjitha autoriteteve përkatëse,,

KRYETARI: Edhe Qeveria e ka të drejtën të flasë jashtë rendit të ditës.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: ...për vendosjen e sistemeve të efektshme dhe me rendiment të menaxhimit të integruar të kufirit, me qëllim arritjen e objektivave të kufijve të hapur, por të mirëkontrolluar dhe të sigurt.

Vazhdojmë, bëjeni dallimin edhe me demarkacion, që nënkupton vijën kufitare ndërmjet dy shteteve fqinje.

Qëllimin e menaxhimit të integruar dhe kontrollit të kufirit, gjithashtu mund t'ua prezantoj, që është në përputhshmëri, që është ligji ynë që e kemi miratuar ne.

Vazhdojmë me buxhetin. Faleminderit!

(Reagime)

KRYETARI: Kur ta kryej fjalën, ju kërkoni replikë!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari kryetar i Kuvendit,
Kabinet qeveritar,
Kabinet qeveritar
Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot është një ditë e rëndësishme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, edhe për të gjithë ne, pasi që sot do të miratojmë buxhetin e Kosovës për vitin 2012.

Buxheti të cilën do ta miratojmë sot është shumë domethënëse për shumë arsye. Ky buxhet i sukseseve tona, është buxhet i premtimeve të mbajtura, dhe mbi të gjitha buxhet i dinjitetit të shtetit tonë demokratik dhe qytetarëve tanë.

Ky buxhet është dëshmia më e qartë se kjo qeveri është në shërbim të plotë të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe të interesave të tyre.

Miratimi i buxhetit për vitin 2012 vjen si rezultat i punës dhe përpjekjeve të palodhshme të institucioneve tona për të ndërtuar një buxhet që garanton zhvillimin ekonomik të vendit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies së qytetarëve tanë.

Ky buxhet është dëshmi e përpjekjeve tona që përmes zhvillimit ekonomik të punojmë për të çuar përpara kohezionin dhe përfshirjen sociale dhe për të rritur mirëqenien qytetare sociale të qytetarëve tanë, financimet e parapara në Buxhetin 2012, janë dëshmia më e mirë që kjo Qeveri është e përkushtuar të punojë në dobi të të gjithë qytetarëve tanë, pa dallime etnike, fetare, regjionale dhe në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Ky buxhet është i bazuar në Projeksione realiste të të hyrave dhe shpenzimeve në këtë kohë kur kriza ka kapluar shumë vende të Evropës, të cilat garantojnë jo vetëm plotësimin e nevojave të qytetarëve tanë, por njëkohësisht garantojnë rritje të zhvillimit ekonomik.

Një veçori tjetër e këtij buxheti është se reflekton plotësisht politika prioritare të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Pra, buxheti është ndërtuar duke u bazuar në politika mirë qeverisëse dhe sidomos në planin dhe vizionin për zhvillimin ekonomik të vendit, i cili reflekton më së miri angazhimin tonë për të ecur përpara në gjithë sektorët strategjikë, të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm për investime të huaja direkte.

Të nderuar deputetë,

Ky buxhet reflekton rritjen e financimeve për sektorin e bujqësisë, përqendrohet në financimin e projekteve kapitale, duke përfshirë këtu edhe projektin më madhor, rrugën Morinë-Merdarë, si dhe investimet e tjera kapitale në fushën e infrastrukturës, të arsimit, shëndetësisë, telekomunikacionit, energjetikës.

Buxheti i vitit 2012, është dëshmi e përkushtimit tonë të fuqishëm për të ruajtur qëndrueshmërinë fiskale dhe për të siguruar financim të plotë për të gjitha shërbimet publike që janë në dobi të qytetarëve tanë, në këtë periudhë të vështirësive ekonomike, nëpër të cilën po kalon jo vetëm Kosova dhe vendet e rajonit, por edhe vendet tjera të zhvilluara të Evropës.

Në fakt, mund të themi me krenari që përderisa shumë vende të Evropës janë ballafaquar me stagnim në zhvillimi të tyre, Kosova jo vetëm që nuk ka përjetuar ngecje e regres, por në vazhdimësi ka arritur të ruaj rritjen ekonomike stabile, e cila do të jetë e pranishme edhe në vitet në vijim. Për këtë vit, rritja ekonomike do të jetë 5%. Kjo është dëshmi e politikave tona të matura dhe realiste, por është edhe refleksion i vitalitetit dhe aftësive të pamohueshme të qytetarëve tanë për t'u përballur me vështirësitë, duke pasur gjithmonë vizion për të ardhmen.

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Para se të përfundoj fjalën time, më lejoni të përmend edhe një fakt shumë me rëndësi. Ky buxhet është ndërtuar në bashkëpunim të plotë me miqtë tanë ndërkombëtarë. Ky buxhet është harmonizuar gjithashtu me Fondin Monetar Ndërkombëtar, që është një dëshmi e fuqishme të partneritetit tonë me këtë organizatë financiare ndërkombëtare, por edhe dëshmi që Kosova është në gjendje të jetë anëtare e barabartë dhe e përgjegjshme e institucioneve ndërkombëtare.

Në fund, të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Dua të theksoj se ky buxhet është buxheti i zhvillimit ekonomik, i mirëqenies sociale, i reformave demokratike, forcimit të rendit dhe ligjit, i integriteteve evropiane.

Unë dëshiroj, të nderuar deputetë, përfaqësues të të gjitha partive politike, që t'ju falënderoj për bashkëpunimin që keni treguar në dëgjimin, në procesin e sqarimit nga ministri i Financave, zoti Hamza, që ju i keni bërë këtij buxheti.

Ju falënderoj për gjitha kritikën, vërejtjet, sugjerimet, por edhe për mbështetjen tuaj. Ju ftoj që ta miratojmë këtë buxhet, të kemi një debat dobiprurës në shërbim të shtetit dhe interesave të të gjithë qytetarëve. Ky buxhet do të jetë në interes të shtetit, në interesin e të gjithëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Replikë, kërkuat Sabri! A e do fjalën? Urdhëro, e ke fjalën.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër,

Ministra dhe kolegë deputetë,

Sot është dita kur diskutohet në të gjitha shtetet normale evropiane, qysh po kemi qejf të themi, ligji themelor i vitit, prandaj kam menduar që nuk është dita kur duhet të lëshojmë slogane të natyrave të përditshme politike e jo politike, por të bisedojmë për këtë ligj dhe unë mendoj që duhet të koncentrohemi me tërë fuqinë, dijen në diskutimin e këtij ligji. Por, meqë ashiqare ne kemi probleme akute të cilat lëvizin, politike dhe janë edhe të ditës, edhe të muajit, edhe të vitit, askush nuk na ndalon që qysh nesër të kthehemi në Kuvend dhe të bisedojmë për këto çështje që janë shumë të mëdha. Dhe, ajo që unë fola në fillim sot, ishte një thirrje implicite për këtë mënyrë të diskutimit, kështu që çështjet shumë të mëdha nuk ka nevojë të ndërhyjnë në çështje tjera të mëdha, të cilat i kemi në rend dite.

Prandaj, po thërras që sot të bisedojmë për buxhetin në këtë Kuvend dhe Qeverinë dhe kryeministrin dhe ne të gjithëve nuk na ndalon askush që nesër të bisedojmë për probleme tjera të mëdha që i ka Kosova. Edhe në atë dialog për të cilin po flitet me kaq kujdes, panatyrshëm, nëse problemet ekzistojnë, ato duhet të diskutohen edhe në Qeveri, edhe në Kuvend. Pra, kohën e kemi, por jo sot dhe nuk është mirë të shfrytëzojmë bisedën për buxhetin, që është themelore, për një reflektim të shpejtë të një teme tjetër. Ky ishte reagimi im. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Urdhëro, Kryeministër, kundër replikë!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar zoti Hamiti,

Unë vetëm ngrita shqetësimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për deklarin e zyrtarëve të partive të ndryshme politike, që e shohin si mundësi dhënien e territorit të veriut të Mitrovicës Serbisë për zgjidhje të problemit. Prandaj, ky është shqetësim i Qeverisë së Kosovës, sidomos për mos reagimin e partive politike përkatëse ndaj këtyre qëndrimeve dhe, në anën tjetër shpreh edhe shqetësimin e pyetjeve që miqtë ndërkombëtarë i kanë bërë Qeverisë së Kosovës, kryeministrit të Kosovës për këto deklarime. Unë nuk dëshiroj askënd në kuptimin të prejudikoj, as të polemizoj me askënd, por vetëm ngrita shqetësimin e Qeverisë dhe të miqve ndërkombëtarë.

Sa i përket menaxhimit të integruar dhe kontrollit të kufirit, i nderuari Hamiti, përsëri ju ftoj ta lexoni ligjin mirë.

(Reagim)

Nëse nuk e ke lexuar, unë përsëri marr mundimin që ta lexoj dhe ta keni të qartë.

(Reagim)

Jo, po flas unë për integrim, se po thoni që po bëhet një hap për ta integruar Kosovën kah Serbia. Ky është një hap për ta forcuar dhe konsoliduar shtetin e Kosovës dhe, për vëmendjen tuaj, ju ftoj që ta dëgjoni se çka nënkupton dhe cili është qëllimi i menaxhimit të integruar dhe të kontrollit të kufirit.

Menaxhimi i integruar dhe kontrolli i kufirit shtetëror bëhet me qëllim të, po e lexoj edhe për ju dhe, para së gjithash, për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Pra, e para, Sigurimit të pacenueshmërisë së kufirit shtetëror, është Ligji ynë kjo që po e lexoj, mbrojtjes së jetës dhe të shëndetit të njerëzve, parandalimit dhe zbulimit të veprave penale dhe kundërvajtësve, zbulimit dhe arrestimit të kryerësve të tyre; Parandalimit, zbulimit dhe ndalimit të migrimit të kundërligjshëm; Ofrimit të sigurisë së njerëzve dhe pronës së tyre, si dhe mbrojtjen e ambientit në territorin e Republikës së Kosovës; Parandalimit, zbulimit dhe hetimit të krimit ndërkufitar, në partneritet me agjencitë tjera shtetërore për zbatimin e ligjit; Parandalimi dhe zbulimi i të gjitha kërcënimeve tjera për sigurinë dhe rendin publik...

KRYETARI: Zoti kryeministër, e kemi në rend dite Ligjin për buxhetin.

KRYEMINISTRI: Edhe pak, ju lutem!

Parandalimi i lëvizjes së kundërligjshme të mallrave, pasurive të tundshme për të siguruar që të hyrat e akcizës doganore, tatimet të paguhen në mënyrë të duhur siç parashihet në ligj.

Pra, edhe një herë, Qeveria e Kosovës vetëm po zbaton Ligjin që e ka nxjerrë ky Kuvend, po e respekton Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Ju lutem, nëse doni të bisedoni për këtë çështje, dihen procedurat se si hyjnë në rend dite kërkesat. Unë nuk do t'ia jap fjalën askujt, do të vazhdojmë me pikën e rendit të dietës.

(Reagime na salla)

Ani, kush po e do fjalën prej juve të LDK-së? Mirë. Sabri Hamiti, kundër-replikë.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Është rregull universale e këtij Parlamenti dhe i gjithave, që kur i përmendet emri dhe i adresohet diçka dikujt, i jepet fjala dhe nuk është mirë ta licitojmë këtë problem, se është universal.

Unë e falënderoj Kryeministrin që i lexoi do renda rreth një ligji dhe besoj që ka qenë instruktiv për, ndoshta për deputetët e vet ose për qytetarëve, është problem i tij. Mua nuk ka nevojë, ti mos i ikë problemit. Nëse janë këto probleme që duhet të shqyrtohen, unë ju thashë, ne do të thërrasim mbledhje nesër dhe pajtohem, nuk do t'i ikim ne problemit themelor - ligjit që e kemi sot dhe kot e keni, se ne jemi serioz, në këtë pikë do të bisedojmë sot, nën një.

Nën dy, nëse ka perceptime individuale të ndryshme rreth zgjedhjes së një problemi, qoftë i dialogut, ju e dini që jetojmë në shoqëri demokratike dhe nëse ju kërkon përgjegjësi, shefave të partive për perceptimet individuale të partive...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit!
Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë desha vetëm të them, i nderuari zoti Hamiti, unë vetëm e lexova ligjin që e keni aprovuar ju, ligji është i Kosovës, kaq. Ju faleminderit shumë.

(Reagime)

KRYETARI: Ju lutem, edhe një herë po them, nëse jeni të disponuar për të futur këtë çështje në rend dite, dihen procedurat se si vjen një temë në rend të ditës dhe shfrytëzohen!

(Reagime)

Po, sot jo, por dihen procedurat, për nesër, javën tjetër. I bëni nënshkrimet dhe me 40 nënshkrime mund ta kërkon edhe kohën, edhe datën dhe ditën për të diskutuar një çështje. Vazhdojmë.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi,
I nderuari zoti kryeministër,
Zëvendëskryeministra, ministra,
Deputetë të nderuar
Të nderuar përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar,
Përfaqësues të Mediave,
Qytetarë të dashur të Kosovës,

Fillimisht, më lejoni që t'i falënderoj të gjitha grupet parlamentare, ato grupe parlamentare të cilat ma kanë dhënë mundësinë që si ministër i Financave të shkoj dhe ta diskutoj me ta Projektbuxhetin për vitin 2011.

Projektbuxheti për vitin 2011, është Projektligj në harmoni të plotë me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, neni 20 dhe 21, është Projektbuxhet i cili i reflekton prioritetet e Qeverisë të Republikës së Kosovës dhe është projektbuxhet i cili është diskutuar gjatë dhe është harmonizuar edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Projektbuxheti është një rezultat i një pune integrale të të gjitha organizatave buxhetore, duke përfshirë edhe nivelin lokal dhe qendror dhe ka ardhur si një dokument integral dhe është paraqitur sot para jush.

Fillimisht, më lejoni që të jap ecurinë e disa indikatorëve makro-ekonomik për vitin 2011. Ministria e Financave, qysh në fillim të vitit ka projektuar që rritja ekonomike për vitin 2011, për Kosovën do të jetë 5.3%. Këtë vlerësim të Ministrisë së Financave sot e konfirmojnë edhe institucionet më kredibile të kësaj fushe, siç është Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Kjo tregon se njerëzit e Ministrisë së Financave, Ministria e Financave dhe Qeveria është treguar e pjekur dhe mjaft profesionale me rastin e parashikimeve të ecurive ekonomike dhe indikatorëve makro-ekonomik për vitin 2011. Këtu me vete, për t'i ikur subjektivizmit, e kam edhe raportin e publikuar nga Banka Botërore, ku e jep vlerësimin për rritjen ekonomike për Evropën juglindore dhe për vitin 2011, Shqipëria vlerësohet që do të ketë rritje ekonomike 3%, Bosnja e Hercegovina 2%, Kosova 5.3%, Maqedonia 3%, Mali i Zi 2.9% dhe Serbia 2%, që Kosova e ka lartë rritjen ekonomike më të mëdha se sa vendet e regjionit. Ne jemi të vetëdijshëm që edhe rritja ekonomike prej 5.3% nuk është ajo të cilën ne e synojmë, i cili është objektiv i joni, i cili mundëson që në mënyrë të konsiderueshme të ulët papunësia e varfëria, por është një bazë e mirë që ne në periudhën e ardhshme makro-fiskale të arrijmë te rritja ekonomike edhe më e lartë.

Performanca e të hyrave gjatë vitit 2011 ka qenë jashtëzakonisht e mirë. Kemi pasur një performancë jashtëzakonisht të fuqishme të të hyrave. E di që me rastin e aprovimit të buxhetit për vitin 2011, ka plasur shqetësime, ka pasur diskutime se a është një plan real sa i përket të hyrave. Të hyrat në këtë vit, jo që presim që do të inkasohen 100% në harmoni me planin e aprovuar, me buxhetin e aprovuar për vitin 2011, mirëpo ne presim që do të kemi një tejkalim të këtij plani. Këto të hyra të cilat janë grumbulluar deri në këtë periudhë, neve na garantojnë që deri në fund të vitit doganat e Kosovës do të arrijnë që të kemi 18%, më së paku 18% të hyra më shumë se periudha e njëjtë paraprak, njëjtë Administrata Tatimore.

Performanca a e mirë e të hyrave gjatë këtij viti, ka mundësuar që ne t'i mbulojmë shpenzimet e parapara me buxhetin për vitin 2011. Kjo performancë e të hyrave, që ne vlerësojmë se do të jetë diku 200 milionë më tepër, në krahasim me vitin paraprak, ka mundësuar që të mbulohet rritja e pagave, kur dihet që kemi pasur një rritje signifikante të pagave, ku të gjithë punëtorët që realizojnë paga përmes buxhetit, kanë përfituar nga

ngritja e pagave. Do të mundësojë mbulimin e pagave për kategoritë e dala nga lufta, familjet e dëshmorëve, invalid të luftës, do të mundësojë që ne t'i mbulojmë me sukses shpenzimet për investimet kapitale dhe, mbi të gjitha, që ka qenë top – prioritet i yni, është ruajtja e qëndrueshmërisë makro-fiskale dhe stabilitetit makro-fiskal. Prapë po i referohem raportit të publikuar nga Banka Botërore, e cila flet për deficitin buxhetor, deficitin fiskal, ku Kosova gjatë gjithë periudhës së kaluar marko-fiskale, po edhe gjatë periudhës të ardhshme planifikon që deficitin të jetë brenda parametrave të lejuar.

Deficitin për vitin 2010, Shqipëria ka pasur 3, Bosnja 4.2, Kosova 2.7, Maqedonia 2.5, Mali i Zi 4.9, Serbia 4.6, do të thotë jemi brenda parametrave të lejuar sa i përket çështjes së deficitit dhe jemi të sigurt në qëndrueshmërinë makro-fiskale të vendit tonë dhe kjo neve na garanton që pavarësisht ecurive në procesin e privatizimit, Kosova t'i kryejë të gjitha obligimet për të gjitha kategoritë ekonomike dhe në fund të vitit të ketë bilanc bankar që janë në tabelat e buxhetit, është i prezantuar, që do të jetë minimumi 120 milionë, por vlerësimet tona janë se do të jetë edhe më i lartë se kaq.

Deputetë të nderuar,

Në vazhdim, më lejoni që t'i jap indikatorët makro-ekonomikë sa i përket Projektbuxhetit për vitin 2012 dhe periudhës së ardhshme makro-fiskale. Rritja ekonomike vlerësohet se do të jetë 5%. Ne kemi qenë shumë të kujdesshëm sa i përket vlerësimit të rritjes ekonomike për periudhën e ardhshme. Arsyeja është, kemi marrë në konsideratë edhe rekomandimet e institucioneve shumë kredibile në këtë fushë, siç është Fondi Monetar Ndërkombëtar, kemi marrë parasysh ecuritë që priten të ndodhin në euro-zonë, ku realisht nuk janë shumë pesimistike zhvillimi i ecurive që pritet të ndodhë në euro zonë gjatë vitit të ardhshëm dhe kjo mund të ketë impakt edhe në zhvillimet në Kosovë. Mund të ndikohen remitencat, mund të ndikohen eksportet dhe mund të vijë deri te lëvizja e çmimeve, sidomos të artikujve të cilët marrin pjesë në përqindje bukur të lartë në mbushjen e buxhetit, siç është nafta dhe derivatet e saj.

Qëllimi ynë ka qenë që Kosova ka nevoja, ka shumë prioritete, mirëpo mbi të gjitha qëllimi ynë ka qenë që ne ta ruajmë top prioritetin tonë, që është stabiliteti makro-fiskal dhe kur është në pyetje stabiliteti makro fiskal, ne jemi harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe kemi projektuar deficitin buxhetor brenda parametrave që është diku rreth 3%. Sa i përket të hyrave, vazhdon trendi pozitiv i të hyrave, vazhdon rritja e të hyrave edhe në Doganë, edhe në Administratë Tatimore dhe të hyrat e planifikuara për vitin e ardhshëm janë në lartësi prej 1 miliard e 361 milionë. 860 milion euro janë të parapara që të mblidhen nga doganat e Kosovës, 285 milionë janë nga Administrata Tatimore e Kosovës, 168 milionë janë të hyra vetanake të nivelit qendror dhe nivelit komunal, janë pjesë e të hyrave 35 milionë euro nga dividendat e PTK-së, janë pjesë e të hyrave rreth 30 milionë euro grante nga Banka Botërore, që gjithsej kur i mbledhim, vinë në 1 miliardë e 361 milionë.

Sa u përket të dalave buxhetore, niveli i agave është në 407 milion, kemi një rritjeje prej 5.4%. Kjo rritje nuk është rezultat i rrezitjes së pagave, po është rezultat i plotësimit dhe rritjes së kapaciteteve të institucioneve të brenda Qeverisë së Kosovës, siç është arritja e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Agjencionit Kosovar të

Inteligjencës, rritja e numrit në Policinë e Kosovës, pastaj Agjencioni për Mbrojtjen e të dhënave dhe institucionet tjera.

Sa u përket mallrave dhe shërbimeve, janë në lartësi prej 198 milionë dhe i kemi marrë për bazë të dhënat historike dhe konsiderojmë që kjo shumë e buxhetuar për mallra dhe shërbime është e mjaftueshme që me një menaxhim të mirë të sigurohet funksionaliteti dhe mundësia e kryerjes së aktiviteteve për të gjitha organizatat buxhetore. Subvencionet dhe transferet janë në lartësi prej 284 milionë euro dhe pjesë e subvencioneve të transfereve është edhe kostoja për Ligjin e pensioneve, gjithashtu është edhe shuma e paraparë për mbulimin e koston për Ligjin e pensionimit të ish trupave mbrojtëse të Kosovës që shërbejnë në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Kemi një rritje të transfereve sociale, ndërsa kemi një zvogëlim të subvencioneve për ndërmarrjet publike. Kur janë subvencionet për ndërmarrjet publike, Korporatës energjetike të Kosovës në vitin e ardhshëm planifikohet që t'i ndahen 7 milionë euro më pak për importin e energjisë elektrike, planifikohet dhe është planifikuar fondi për subvencionimin e Radiotelevizionit të Kosovës dhe është ndarë një fond 3 milionë euro për subvencionet për ngrohtoren "Termokos". Janë ndarë 3 milionë euro sepse ne kemi marrë obligim me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes për projektin e kogjenerimit, i cili është rreth 25 milionë euro, që ne deri në momentin e finalizimit të këtij projekti, që pritet të ndodhë në fund të vitit 2013, komercialisht këtë ndërmarrje ta mbajmë të qëndrueshme në treg.

Inflacioni gjatë periudhës së ardhshme makro fiskale vlerësohet se do të jetë 2.3%. Sa i përket pozicionit tjetër mjaft të rëndësishëm, ku fokusi ynë ka qenë kryesisht në këtë pozicion, janë investimet kapitale. Ne kemi arritur që ta ruajmë nivelin e investimeve kapitale me 40% të buxhetit dhe kjo është më e larta në gjithë vendet e regjionit. Pra, po i referohem raportit të Bankës Botërore për këtë çështje ...

(Ndërprerje nga regjia)

Drejtimin e seancës e merr zoti Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit

KRYESUESI: Vazhdojani, regjia!

MINISTRI BEDRI HAMZA: ... që investimet kapitale sa i përket pjesëmarrjes së tyre në totalin e buxhetit, Shqipëria i ka 17%, Bosnja i ka 9.4%, Kosova 39.5%, ndërsa Maqedonia 12.7%. Projekti më kapital sa i përket investimeve kapitale është projekti i autostradës. Për këtë projekt janë ndarë 296 milionë euro, 240 milionë euro janë për ndërtimin e autostradës, 56 milionë euro janë për shpronësim. Investimet kapitale, në raport me vitin 2011, rriten për 15%. 320 milionë euro mbesin investimet kapitale për projektet tjera. Këto fonde të ndara për investimet kapitale mundësojnë përfundimin e dhjetëra shkollave, përfundimin e dhjetëra palestrave sportive, mundësojnë vazhdimin e zgjerimit të rrjeteve të ujësjellësit, mundësojnë investime në sektorin e shëndetësisë.

Sa i përket raportit të ndarjeve ndërqeveritare, 300 milionë euro nga granti qendror shkojnë për komunat dhe 61 milionë, rreth 60 milionë euro janë të hyra vetanake të komunave, që totali i buxhetit të komunave vjen diku në 360 milionë.

Të gjitha këto janë arritur duke ruajtur borxhin publik në nivel mjaftë të ultë. Kosova e ka borxhin publik më të ulët në regjion dhe është diku te 5.6% të GDP-së. Qëllim ynë ka qenë që ne para juve sot ta prezantojmë një projektbuxhet të qëndrueshëm, të bazuar në burimet e qëndrueshme të financimit, ta ruajmë nivelin e lartë të pjesëmarrjeve të investimeve kapitale në totalin e buxhetit, t'i marrim në konsideratë çështjet sociale, ta ruajmë deficitin primar buxhetor brenda parametrave të lejuar dhe ky buxhet është në harmoni të plotë dhe në marrëveshje të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Më lejoni që me pak fjalë që shpjegoj edhe disa pozicione tjera që janë pjesë e tabelave të buxhetit. Për herë të parë, në Kosovë planifikohet që të kemi një ... të brendshëm prej 74 milionë. Ne presim, është kryer infrastruktura legale, janë siguruar sopverët e nevojshëm dhe presim që për këtë qëllim ne të fillojmë diku në fillim të vitit të ardhshëm, pjesën e parë të vitit të ardhshëm.

Një pozicion tjetër i cili mund të diskutohet, është çështja e dividendës së PTK-së prej 35 milionë. Ne kemi biseduar me Bordin e PTK-së, kemi biseduar me menaxhmentin e PTK-së, kemi studiuar bilancet e kësaj kompanie dhe të gjitha analizat çojnë që 35 milionë dividendë për buxhetin e Kosovës nga kjo kompani është shumë e realizueshme, pa e rrezikuar afarizmin e kësaj ndërmarrjeje. Dhe, një çështje tjetër që është 300 milion euro të hyra nga financimi i njëhershëm.

Me Fondin Monetar Ndërkombëtar kemi diskutuar, jemi pajtuar dhe sigurisht ne do ta bisedojmë këtë çështje edhe gjatë misionit të tij, që të pritet të jetë në shkurt. Privatizimi apo mos privatizimi i PTK-së nuk e rrezikon qëndrueshmërinë e buxhetit. Dallimi është se me privatizimin e PTK-së do të kemi bilanc bankar të nivelit më të lartë. Pa privatizimin e PTK-së, do të kemi bilanc bankar të nivelit më të ulët, mirëpo nuk rrezikohet qëndrueshmëria makro-fiskale, nuk rrezikohet likuiditeti i shtetit. Ne jemi përcaktuar për reforma strukturore, ne jemi përcaktuar për ekonominë e lirë të tregut, ne nuk themi se shitja e aksioneve të një kompanie publike duhet të bëhet për mbajtjen e buxhetit. Edhe në të kaluarën është diskutuar se po shitet posta për t'u paguar rrogat, po shitet posta për t'u bërë autostradat. Posta nuk u shitë, pagat u paguan, autostrada po vazhdon. Jemi përcaktuar që bartës i zhvillimit ekonomik të jetë sektori privat, ndërsa sektori shtetëror, Qeveria të jetë krijuese e parakushteve për zhvillimin e sektorit privat përmes ligjeve të mira, përmes infrastrukturës së mirë fizike.

Unë, duke ju falënderuar për vëmendje, ne me kujdesin më të madh i presim diskutimet e juaja, e presim kontributin e juaj, i mirëpresim kritikën e juaja konstruktive, do t'i evidencojmë të gjitha dhe gjatë punës tonë të përbashkët edhe në komisionet funksionale të Kuvendit do t'i marrim në konsideratë dhe do t'i shqyrtojmë. Duke ju falënderuar për vëmendjen juaj, duke ju falënderuar edhe një herë grupeve parlamentar për mundësinë

që ta bisedojmë këtë Projektbuxhet, unë ju falënderoj edhe pas diskutimeve ju lus që ta votoni të njëjtin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju Faleminderit, zoti ministër!

Pas prezantimit të Projektligjit, hapi debatin për diskutim, në parim. Fjalën e ka kryetarja e komisionit funksional, respektivisht përfaqësuesja Hasime Krasniqi

HASIME KRASNIQI: I nderuari zoti nënkryetar i Kuvendit,
Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Projektbuxheti i vitit 2012, është diskutuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 9 nëntor, ku e ka shqyrtuar në parim Projektbuxhetin për vitin 2012 dhe me shumicë votash i ka rekomanduar Kuvendit ta miratojë në parim dhe t'i krijojë mundësinë Komisionit të bëjë përmirësimet e mundshme në fazat e procedimit të mëtejshme të buxhetit.

Projektbuxheti për vitin 2012, është një dokument i përgatitur mirë në aspektin përmbajtësor dhe teknik. Janë të përfshirë treguesit makro ekonomikë që i paraprijnë hartimit të buxhetit. Pjesa tekstuale e Projektligjit të buxhetit, sipas të cilës bëhet ndarja e mjeteve dhe rrjedhja e menaxhimit të tyre, si dhe pjesa tabelore. Në përgjithësi, kemi një material të mjaftueshëm të detajizuar mirë, që i krijon mundësi secilit deputetë të bëjë analizat e nevojshme.

Projektbuxheti i vitit 2012 është në harmoni të plotë me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, si dhe është i bazuar në prioritetet e Qeverisë, në veçanti në ruajtjen e qëndrueshmërisë makro-fiskale dhe, mbi të gjitha, është i harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Sipas indikatorëve makro-ekonomikë, ekonomia e Kosovës është vlerësuar të ketë një rritje 5% në vitin 2012, rritje kjo e ndikuar kryesisht nga rritja e konsumit, investimeve dhe eksporteve.

Në pjesën tekstuale është rregulluar mënyra e ndarjes dhe e menaxhimit të mjeteve. Në pjesën tabelore vërehet se janë rritur të hyrat, kurse ka një shpërndarje më të mirë të fondeve aty ku përfitojnë qytetarët. Është bërë rritja e të hyrave në 1 miliard e 361 milionë euro, që do të thotë se do të ketë rritje për 4% në krahasim me vitin 2011. Të hyrat kryesisht sigurohen nga doganat të cilat kanë rritje për 4%, në krahasim me këtë vit, dhe nga ATK-ja, që kanë rritje për 9%, në krahasim me vitin 2011. Fondet janë orientuar për politikën që janë shpallur si prioritet me programin e Qeverisë. Shpenzimet janë rritur edhe për vitin 2012 për 7.6% , për paga dhe mëditje 5.4% më shumë se në këtë vit. Për mallra dhe shërbime janë 5.9% më të larta se në vitin 2011, kurse për subvencione dhe transfere 4.4% më shumë se në vitin 2011.

Mjetet janë përqendruar në projektet e rëndësishme kapitale në infrastrukturë, arsim, shëndetësi, në bujqësi dhe në sektorët e tjerë që reflektojnë zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e mirëqenies sociale në shoqëri.

Në përgjithësi, struktura e shpenzimeve buxhetore dominohet nga shpenzimet kapitale me 40.5%. Për këtë kategori të shpenzimeve janë paraparë edhe një ngritje prej 15% më shumë për investimet në përgjithësi, kur $\frac{1}{4}$ e buxhetit u ndahet komunave sipas formulës së përcaktuar me ligj për grantet qeveritare, afër 80% e shpenzimeve komunale mbulohen nga granti qeveritar.

Të nderuar deputetë,

Në komision ka pasur debat konstruktiv, deputetët e kanë vlerësuar buxhetin, por edhe kanë shprehur vërejtjet e tyre që besoj shumë se disa prej këtyre vërejtjeve mund të inkorporohen në buxhet gjatë amendamentimit. Po ashtu, disa deputetë kanë shprehur hezitimin e tyre se burimet financiare që mbushim buxhetin, sipas parashikimeve të Qeverisë, nuk janë shumë të sigurt për garantimin e qëndrueshmërisë financiare. Po ashtu, ka pasur vërejtje se rritja ekonomike që vjen nga investimet publike nuk ka efekte multiplikuese.

Për Komisionin për Buxhet dhe Financa ende mbetet problem buxhetimi i agjencioneve të pavarura dhe rregullatorëve ekonomikë që i raportojnë Kuvendit, si dhe buxheti i RTK-së, probleme këto që përcillen nga viti në vit në mungesë të legjislacionit të duhur për këto agjencione. Janë mbi 30 agjencione rregullatorë, borde ekzekutive, këshilldhënëse që i raportojnë Kuvendit, e për caktimin e pagave dhe të mëditjeve nuk ka rregullativë ligjore. Kështu, tek pagat dhe mëditjet e këtyre institucioneve ka laramani të madhe në disa agjencione. Pagat kanë qenë të rregulluara me ligjet që janë shfuqizuar, si për shembull, paga e Avokatit të Popullit, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, kurse me ligjet në fuqi të këtyre institucioneve, pagat e bordeve rregullohen me Ligjin mbi pagat e zyrtarëve të lartë, i cili nuk është miratuar ende.

Nga shumica e këtyre agjencioneve kemi marrë kërkesa të cilat Komisioni për Buxhet dhe Financa, gjatë shqyrtimit dhe amendamentit të Projektbuxhetit do të gjejë forma dhe mundësi për plotësimin e kërkesave të arsyeshme, që të ruhet pavarësia buxhetore e këtyre institucioneve të pavarura. Për financimin e RTK-së është mirë që të gjenden format e financimit të qëndrueshëm dhe ky medium të mos jetë barrë e buxhetit të Kosovës dhe të mundësohet funksionimi i mirëfilltë i këtij mediumi publik.

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka miratuar Projektbuxhetin dhe iu rekomandon deputetëve të miratojnë në parim Projektligjin dhe t'i krijojnë mundësi Komisionit të bëjë amendamentimet e mundshme.

KRYESUESI: Tani është radha të flitet në emër të grupeve parlamentare ose të përfaqësuesve të grupeve. Në emër të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Ju faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Sot kemi para vetes dokumentin më të rëndësishëm të shtetit që përcakton edhe zhvillimin ekonomik dhe perspektivën e Kosovës për vitin 2012.

Duke pasur parasysh rëndësinë, duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë që ka ky dokument për vendin tonë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar me vëmendje dhe kujdes të veçantë këtë dokument, ka sjell, po ashtu, rrjedhat prej ditës së parë dhe deri sa ka arritur në Parlamentin e Kosovës dhe si Grup vijmë në përfundim dhe i përshëndesim në mënyrë të veçantë përpjekjet e ministrit të Financave që t'i harmonizojë të gjitha qëndrimet, të diskutojë pa ngarkesa me të gjitha grupet parlamentare të Kuvendit të Kosovës, krejt kjo me qëllim të harmonizimit të gjitha kërkesave dhe që ky buxhet të dalë sa më i qartë dhe i kompletuar.

Duke pasur parasysh mundësitë tona buxhetore, por gjithsesi edhe nevojat tona, ne kemi ardhur në përfundim se ky buxhet është në përputhje me nevojat e vendit tonë.

Kjo që ndodh me këtë planifikim të drejtë të buxhetit, që e bën Qeveria e Republikës së Kosovës, është në përputhje me mundësitë tona buxhetore dhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e vlerëson këtë buxhet si buxhet për zhvillim ekonomik të vendit.

Kosova është shteti i vetëm në rajon i cili ka projektuar 40% të buxhetit të tërësishëm, të jetë në investime kapitale, që është një dëshmi e mirë se ky buxhet është buxhet për zhvillim ekonomik të vendit.

Brenda vitit të ardhshëm Kosova do të ketë rritje prej 15% në investime kapitale, të cilat siç thamë, do të marrin 40% të buxhetit të tërësishëm.

Në fillim dëshiroj t'i potencoj disa nga elementet më të rëndësishme të këtij buxheti, të cilat janë vlerësuar dhe përkrahur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe organizmat tjerë financiar ndërkombëtar, të cilat janë:

Kosova ka kontroll të plotë ndaj buxhetit publik të trashëguar. Kosova ka vetëm 5.4 të borxhit publik, i cili aktualisht është më i vogli në regjion. Ky buxhet shihet se është i harmonizuar plotësisht me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Është buxhet i planifikuar për zhvillim, është një stabilitet i plotë makro-fiskal dhe mbi të gjitha dhe më e rëndësishmja e këtij buxheti është se ka rritje buxhetore në buxhetin e shtetit.

Kosova për vitin 2012 do të ketë buxhet prej 1 miliard e 520 milionë euro, prej të cilave 612 milionë do të jenë të ndara për investime kapitale, 296 milionë apo rreth 50% janë të ndara për vazhdimin e mëtutjeshëm të punimeve në autostradën Vërmicë-Merdar, që është projekti më kapital i vendit dhe që po jep vërtet një kuptim shtetit të vendit tonë, ndërsa pjesa tjetër është ndarë për projekte me prioritet sipas ministrive dhe komunave, e që është 320 milionë apo 11% më tepër, krahasuar me vitin 2011. Kosova, sipas këtij buxheti tregon se është përcaktuar për reformë strukturore. Nga ky buxhet shihet se ndarja është bërë sipas objektivave dhe prioriteteve të parapara.

Mos privatizimi i Postës nuk e rrezikon aspak buxhetin, vetëm ndryshon bilancin bankar dhe krejt kjo thuhet sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Të nderuar deputetë,

Hartimi i këtij buxheti dhe raportimi i Fondit Monetar Ndërkombëtar na bën të ndihemi vërtet mirë. Fondi Monetar Ndërkombëtar ka raportuar që Kosova ka bërë përpjekje të dukshme dhe priten marrëveshje të reja. Një Delegacion i Fondit Monetar që vizitoi vendin tonë nga data 2 deri me datën 11 nëntor, kanë vlerësuar pozitivisht qëndrueshmërinë makro-fiskale.

Fondi Monetar Ndërkombëtar thekson se Kosova ka shmangur çrregullimet serioze të krizës që po e godasin euro-zonën. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, ekonomia e Kosovës parashihet të ketë një rritje prej 5.3% gjatë vitit 2012. Vlerësohet lartë se sistemi bankar ka mbetur i qëndrueshëm me likuiditet të shëndoshë dhe mbulesë të kapitalit. Fondi Monetar Ndërkombëtar po ashtu ka vlerësuar lartë se Kosova ka bërë hapa vendimtarë drejt qëndrueshmërisë fiskale në menaxhim të fortë dhe ekzekutim të buxhetit.

Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, politika makro-ekonomike dhe financiare janë në rrugë të drejtë dhe ky menaxhim i fortë i buxhetit hap rrugë për ndihmë financiare dhe mundëson marrjen e donacioneve tjera për vitin 2012.

Të gjitha këto fakte janë në harmoni me synimet tona për një zhvillim të shëndoshë dhe perspektivë zhvillimore për vendin tonë.

Sa i përket granteve, sipas Projektbuxhetit të vitit 2012 ato nuk janë zvogëluar aspak, por vetëm janë harmonizuar sipas numrit të banorëve nëpër komuna, të dala nga regjistrimi i fundit i popullsisë. Të gjitha ministrat dhe të gjitha komunat do të jenë përfitues të këtij buxheti, duke pasur parasysh se është një ndarje e drejtë e kategorive buxhetore mbi bazën e prioriteteve dhe projekteve.

Të nderuar deputetë,

Qytetarët e Kosovës sot presin maturi institucionale dhe me padurim presin miratimin e këtij buxheti, që nuk është shumë të përsëritet se vërtet është buxhet i zhvillimit ekonomik.

Miratimi i këtij buxheti sot tregon pjekurinë institucionale dhe lë anash interesat grupore politike të pozitës dhe opozitës. Jam i bindur se nëse ky buxhet është i shikuar profesionalisht, atëherë miratimi i tij do të jetë unanim, sepse ky buxhet po përkrahet edhe nga mekanizmat tjerë financiarë ndërkombëtarë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës mbështet rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe i fton të gjitha grupet parlamentare që ta përkrahin buxhetin për vitin 2012. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputeti Naser Osmani!

NASER OSMANI: I nderuari kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I nderuar ministër i Financave,

LDK-ja ka analizuar me kujdes Projektbuxhetin e vitit 2012 dhe konsiderojmë që edhe ky buxhet, sikur edhe ai i këtij viti, është ndërtuar mbi bazën e paqëndrueshmërisë së të hyrave dhe janë planifikuar shpenzime që nuk reflektojnë nevojat e qytetarëve të Kosovës. Këto shpenzime nuk do të zvogëlojnë varfërinë dhe nuk do të krijojnë vende të punës.

Projektbuxheti nuk merr parasysh vërejtjet e shumë institucioneve ndërkombëtare dhe nuk tregon si do të përmirësohet pozita financiare dhe ekonomike e Kosovës. Raporti i Progresit, Raporti i OKB-së dhe raportet tjera japin indikacione të qarta për keqmenaxhimin ekonomik dhe fiskal të Kosovës.

Në mars të këtij viti, LDK-ja paraqiti vërejtjet e saja për buxhetin e vitit 2011. U vërtetuan se ato ishin shumë të sakta. Qeveria duhet të pranojë se po vegjeton në bazë të rezervave buxhetore të grumbulluara nga vitet e mëparshme dhe duke mos paguar shumë obligime, duke bartur projektet prej vitit në vit dhe duke u munduar të fshihet pas manipulimeve me numra, ndryshe ajo do të falimentonte tërësisht.

Ky buxhet është peng i politikave dhe premtimeve të gabuara elektorale e jo buxhet i zhvillimit ekonomik. Ai nuk është ndërtuar mbi o objektivat zhvillimore. Korniza afatmesme e shpenzimeve 2012 – 2014 mbetet dokument i pavlerë, për arsye se asgjë nga ai dokument nuk reflektohet në buxhet. Asnjë nga objektivat e strategjisë zhvillimore të hartuar në Bullgari nuk janë në buxhetin e vitit 2012. Qeveria vetë hoqi dorë nga iluzionet për rritje ekonomike prej 7 deri 8% dhe për zvogëlim të papunësisë prej 8 deri 10%. Deficiti buxhetor prej 3.5 të GDP është mbi nivelin e lejuar të kriterëve të Bashkimit Evropian. Buxheti për mallra dhe shpenzime nuk është në linjën me investime kapitale. Investimet në shkolla, objekte shëndetësore, rrugë e tjera, nuk përcillen me personel, me pajisje, me materiale të nevojshme për mirëmbajtje.

Të nderuar kolegë,

Të hyrat e planifikuara të grumbulluara në kufi prej 831 milionë euro tregon më së mirë se ne po eksportojmë para, sepse këto të hyra parash, së paku $\frac{1}{4}$ e parave ne po i paguajmë për importe të lloj-lloj mallrave, duke nënvlerësuar prodhimet vendore.

Buxheti për paga duket se është rritur për 20 milionë. Ky buxhet shtesë shkon për paga të institucioneve të reja të krijuara në Qeverinë megalomane dhe jo për të rritur apo për të ruajtur fuqinë blerëse të pagave të tanishme.

Shërbyesit civilë duhet të dinë se pagat e tyre sipas këtij buxheti dhe sipas kornizës afatmesme nominalisht do të mbesin të pandryshuara për tri vitet e ardhshme, kurse realisht do të zvogëlohen ashtu si rritet inflacioni.

Edhe transferet sociale, sidomos pensionet bazike, asistenca sociale, por edhe buxheti për mallra dhe shërbime parashihen të rriten shumë më ngadalë se sa norma e inflacionit.

Investimet kapitale prej 616 milionë nuk pritet të krijojnë efekte multiplikuese. Qeveria po bën shpërndarjen politike të buxhetit duke ndërtuar rrugë e shkolla aty ku nuk ka arsyeshmëri investive, por vetëm qejfe të militantëve. Dhjetëra rrugë dhe shkolla po barten nga viti në vit që nga 2010.

Autostrada gëlltitë gjysmën e investimeve kapitale dhe rezulton se kilometri i saj xhepave të varfër të qytetarëve të Kosovës po iu kushton rreth 9 milionë euro për një kilometër katror. LDK-ja dhe presidenti Ibrahim Rugova ishin nismëtarë të këtij Projekti, por kjo nuk do të thotë se ne nuk duhet të jemi përgjegjës për koston e saj dhe të kërkojmë që kostoja të jetë transparente dhe racionale.

Nga projektligji rezulton një ndarje e ulët buxhetore për bujqësi, për investimet kapitale në tregti dhe industri, si dhe për promovimin e vendeve të reja të punës dhe për përmirësimin e mjedisit. Këto janë fusha të nën-vlerësuara në krahasim jo vetëm me nevojat tona, por edhe me vendet tjera në rajon.

Të nderuar deputetë,

Në fushën e arsimit investohen 24.3 milionë apo 3.9% të investimeve kapitale, por vetëm 2.5 milionë janë projekte të reja. Të tjerat janë projekte të bartura nga viti 2010.

Është e padrejtë shpërndarja e investimeve kapitale në arsim nëpër komuna. Është e padrejtë dhe jashtë ligjit që MASH-i të merret me investime në komuna. Kjo është përgjegjësi e komunave. Qëllimi po shihet. Komunat e qeverisura nga LDK-ja kanë rreth 40% të popullsisë së Kosovës, ndërsa marrin vetëm 19% të buxhetit për ndërtimin e shkollave. Prishtina ka 55 mijë nxënës në shkollat fillore dhe të mesme, apo rreth 15% të numrit total të nxënësve në nivelin e Kosovës, ndërsa merr 4% për ndërtimin e shkollave.

Në infrastrukturë projekte të reja, përveç autostradës, pothuaj se nuk ka fare. Nga 26 milionë sa mbesin pas investimeve për autostradën, shumica janë projekte të bartura që nga viti 2010. Kjo flet se Qeveria Thaçi fillon shumë projekte për destinim fushate, kurse tani ato i prolongon nga viti në vit.

Të nderuar deputetë,

LDK-ja ka zhvilluar dhe ofron alternativë, alternativën e saj për buxhetin e vitit 2012.

Ne konsiderojmë se buxheti i Kosovës duhet të ndërtohet në burime të qëndrueshme të të hyrave dhe shpenzimeve që bazohen në objektivat zhvillimore.

Të hyrat dhe shpenzimet duhet të sillen në kufijtë e pritshëm si nga tatimet, ashtu edhe nga të hyrat e njehershme.

Deficiti buxhetor nuk duhet të kalojë 3% të GDP.

Shpenzimet për paga, mallra dhe transfere sociale duhet të mbajnë fuqinë reale blerëse. Krahasuar me normën e inflacionit, shpenzimet kapitale duhet të prodhojnë efekte maksimale për ekonominë vendore dhe përfitimet të janë të barabarta për të gjithë qytetarët.

Duhet të ekzistojë pariteti ose barazia në mes të shpenzimeve kapitale dhe shpenzimeve për mallra dhe shpenzimeve për të siguruar se investimet kapitale në rrugë, shkolla dhe projekte të tjera të mund të mirëmbahen në mënyrë adekuate.

Për shkak të rrethanave në tregjet ndërkombëtare dhe të krizës së euros, privatizimi i PTK-së do të shtyhet për vitin 2013. Kjo do të kursente disa qindra milionë euro humbje nga çmimi i ulët i privatizimit në kushtet e krizës. Alternativa jonë buxhetore i merr parasysh vlerësimet e Komisionit Evropian të paraqitura në Raportin e Progresit të këtij viti, si dhe vlerësimet e vazhdueshme të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Në alternativën buxhetore të LDK-së janë adresuar sugjerimet për secilin zë buxhetor. Këtë vit pritet të rriten të hyrat totale prej 12%, krahasuar me vitin 2010, ndërsa parashikimet e Ministrisë së Financave për vitin 2012 është për një rritje prej vetëm 4%.

LDK-ja mendon se ka ende hapësirë për rritjen e të hyrave, si nga doganat, ashtu edhe nga të hyrat tatimore vendore.

Duke aplikuar projektin e arkave fiskale dhe disiplinën fiskale, ne vlerësojmë reale rritjen e të hyrave në vitin 2012 prej së paku 6%, në krahasim me këtë vit. Kjo do të mundësonte që të hyrat totale të jenë 1 miliard e 416 milionë, në krahasim me 1 miliard e 361 milionë, të parapara nga Ministria e Financave.

Po ashtu, ne kemi paraparë që të hyrat nga dividendat e Postës për vitin 2012 të jenë 60 milionë euro.

Ne propozojmë që pagat të rriten për aq sa rritet inflacioni dhe ta ruajmë vlerën reale të pagës. Me një presupozim të inflacionit prej 7% në vit, rritja e pagave do të ishte për 26 milionë euro. Një sistem i tillë do të aplikohet edhe për mallrat dhe shërbimet, si dhe për transferet sociale.

Ne vlerësojmë se subvencionet për ndërmarrjet publike për vitin 2012 duhet të mbesin në nivelin e njëjtë të vitit 2011...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, zgjatja kohën, edhe një faqe e ka, meqenëse po flet në emër të grupit!

NASER OSMANI: Ne vlerësojmë që duhet bërë një korigjim të brendshëm, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i shërbimeve vitale për qytetarët.

Të nderuar deputetë,

Alternativa që ne e ofrojmë për buxhetin parasheh rritje të të hyrave për 55 milionë dhe rritje të shpenzimeve për 34 milionë. Bilanci primar do të bie në minus 134 milionë ose 2.7% të GDP-isë, ndërsa bilanci i përgjithshëm bie në 147 milionë ose 2.9% të GDP-isë. Të dyja këto vlera janë 3% të GDP-isë, që janë brenda kritereve të Bashkimit Evropian.

Ne vlerësojmë se privatizimi i Postës duhet të shtyhet së paku deri në vitin 2013. Mos privatizimi i PTK-së do të sillte të hyra nga dividenda në vlerë prej së paku 60 milionë euro, por mund të sigurohen edhe më shumë me një qeverisje më të mirë kooperative. Pa shitje të PTK-së do të sigurohet që bilanci bankar në fund të vitit të jetë 137 milionë, që është për 12% më i lartë se i këtij viti.

Shpërndarja e shpenzimeve kapitale prej 616 milionë euro duhet të reflektojë pozitivitetin zhvillimor që ka Kosova. Duhet të theksojmë se edhe në këtë aspekt ne kemi qenë peng e kontratave që Qeveria e tashme i ka nënshkruar dhe kjo nuk na ka lejuar neve që të reflektojmë në të gjitha prioritetet zhvillimore.

Propozojmë që për projektin e autostradës për vitin 2012 të mos shpenzohen 240 milionë, por vetëm 180 milionë, kurse pjesa e mbetur prej 60 milionëve të investohen në projektet infrastrukturore që kanë mbetur përgjysmë tash e sa vite dhe gjithashtu të orientohen në projekte tjera kapitale që gjenerojnë punësim dhe zhvillim.

Propozimi i LDK-së për shpërndarjen e 60 milionëve është:

- Buxheti për bujqësi të shtohet për 20 milionë në projekt zhvillimor të sistemit të ujitjes, subvencione dhe programe mbështetëse për bujqësi dhe agro-biznes.
- Buxheti për infrastrukturë të rritet për 15 milionë, për rrugë dhe infrastrukturë përcjellëse kryesisht në zonat rurale në përputhje me prioritetet e komunave.
- Të dedikohen 5 milionë për agjenci të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për ndërtimin e inkubatorëve të biznesit, skemave të garantimit të kredive dhe mbështetjes së bizneseve.
- Për sektorin e arsimit të ndahen edhe 10 milionë, ku duhet të implementohen projekte për përmirësimin e cilësisë së arsimit në institucionet publike dhe private të arsimit.

Investimet në objekte shkollore do të mundësonin implementimin e arsimit të obliguar në arsimin e mesëm e të lartë.

Duhet gjithashtu të investohet në informatizimin e shkollave....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Le t'i vazhdohet, deri sa ta kryej!

NASER OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues, nuk po e zgjas!

Të nderuar deputetë,

LDK-ja mund të përkrah vetëm një buxhet i cili merr parasysh këto alternativa që ne i propozuam. Për ndryshe, ky projektbuxhet i njëjtë me atë të vitit të kaluar, vetëm sa do ta degradojë zhvillimin e vendit, duke e renditur Kosovën edhe më poshtë në të gjitha raportet ndërkombëtare. Buxheti i cili do të varfërojë më tutje të varfrit, buxhet i cili na largon nga Evropa.

Zoti kryesues,

Të gjitha këto, të cilat unë vetëm sipërfaqësisht i përmenda, por edhe të dhënat e tjera të cilat nuk janë në fjalimin tim, shefi i Grupit Parlamentar do ta dorëzojë te ju si dokument i Lidhjes Demokratike që të merren parasysh të gjitha ato sugjerimet të cilat i ka dhënë LDK-ja lidhur me buxhetin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë do të dëshiroja që të di se kush do të flas në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje"? Visar Ymeri! Në emër të AAK-së po dihet. Në rregull! Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar, deputeti Visar Ymeri!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Për vetë faktin që kryeministri tash nuk është këtu për ta diskutuar buxhetin, tregon që ai në fillim të seancës erdhi vetëm sa për t'i shprehur disa brengat për atë se çka po thonë tjerët dhe përgjithësisht foli për veriun, në njëfarë mënyre të çuditshme, duke u buzëqeshur. Unë s'di çka ka zbavitëse a qesharake me atë që po ndodh në veri, po ndoshta kryeministri e di. Po këtu po flasim për Projektligjin për buxhetin për vitin 2012, Projektligj ky të cilin shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së e vlerësoi si dokumentin më të rëndësishëm për Kosovën, pra ndoshta më i rëndësishëm edhe se Kushtetuta.

Po ky dokument më së miri ose më mirë se cilido ligj tjetër, e reflekton konceptin qeverisës të kësaj qeverie. Ose, më saktësisht, në këtë rast do të kishte qenë, ta them, mungesa absolute e konceptit për qeverisje që e ka kjo qeveria jonë.

Për më tepër, ky buxhet po ashtu flet zëshëm për nivelin e njohjes dhe të kuptimit që kjo qeveri ka për interesat ekonomike e shoqërore të vendit. Dhe prapë, më saktësisht, për këtë rast duhet ta them mungesën e njohjes dhe kuptimit që kjo qeveri ka në përgjithësi. Por ky buxhet vërtet e tregon ekselencën që kjo qeveri e ka në një aspekt fare të ngushtë: tregon se si kjo qeveri i njeh shumë mirë interesat partikulare personale të njerëzve në të dhe rreth saj dhe se si pafytyrësisht i vendos ato përmbi interesat kolektive të popullit të Kosovës.

Ende pa hyrë në pjesën e tabelave të të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2012, vet teksti i projektligjit ka shumë të meta dhe paqartësi të cilat, ende pa i parë numrat, e bëjnë

projektligjin të çuditshëm dhe të rrezikshëm. Për shembull, neni 11 ia mundëson ministrit, qeverisë ose organizatave buxhetore të manipulojë me mjete, duke ua lejuar paradhënien deri në 15% të vlerës së përgjithshme të kontratës për ato kontrata që e tejkalojnë shumën prej 10 mijë eurosh. Ndërkohë që Qeverisë ia lejon të aprovojë pagesa të paradhënies deri në 30% të vlerës së kontratës, madje 100% për mallra dhe shërbime me vetëm miratimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Neni 14 i të njëjtit ligj, paraqet mendësinë e keqplanifikimit që po na përcjellë në secilin buxhet të viteve të fundit. Ky praktikisht ia lejon lirinë e pafund qeverisë që t'i ndryshojë projektet kapitale ashtu si të dojë gjatë ekzekutimit të buxhetit, që e bën votimin e këtij buxheti në Kuvend vetëm sa për sy e faqe.

Ky nen e lejon lëvizjen e lirë të parave të buxhetuara nga një zë në tjetrin deri në 25%, si dhe me miratimin e Kuvendit përmbi 25%. Pra nënkupton se Qeveria nuk është e sigurt se çfarë do të bëjë as brenda një viti, e lëre më për periudha më afatgjate.

Nuk kanë kaluar as një vit që prej se kjo qeveri e proklamoi me pompozitet planin e saj strategjik për zhvillimin ekonomik të vendit, i cili pa dashje, domethënë pa dashjen e Qeverisë e mori emërtimin “Plani Banjsko”.

Dhe që në momentin e parë që e pati rastin ta fillojë zbatimin e këtij plani, pra me buxhetin e vitit 2012, meqenëse buxheti për vitin 2011 atëbotë ishte miratuar, kjo qeveri e pranoi se ai plan nuk do të ketë kurrfarë ndikimi në politikat buxhetore të shtetit. E pa këtë ndikim, ai bëhet i parealizueshëm, natyrisht.

Me këtë nuk dua ta lavdëroj planin, por ta dëshmoj se kjo qeveri nuk e ka idenë e planifikimit dhe se të gjitha ato që i thotë, faktikisht i bën vetëm sa për të thënë diçka. E pa një plan strategjik, natyrisht se obligohet që përherë të improvizojnë. Por improvizimet na e betonojnë dhe ruajnë status quon. Me to nuk ka zhvillim ekonomik. Zhvillimi ekonomik është çështje serioze dhe për ta arritur një shkallë të duhur të qëndrueshmërisë ekonomike, duhet strategji afatgjate e cila zbatohet. Pa të, natyrisht se e humbim rrugën me t'u nisur, ashtu sikur që e ka humbur rrugën faktikisht Qeveria.

Si është e mundur që në prill të këtij viti, të na thuhet se do të kemi rritje ekonomike prej 7 deri në 8 %, e në nëntor ta planifikojmë buxhetin duke supozuar rritje prej vetëm 5%.

Si mund të gabohet kaq shumë në projekte? Madje rritja e projektuar për vitin 2012, në të cilën supozohen projektimet e buxhetit të cilin e kemi përpara, është në kundërshtim edhe me Kornizën afatmesme të shpenzimeve, e cila u miratua në këtë Kuvend jo më larg se 5 muaj më parë. Madje me të dy skenarët të cilët ishin paraqitur aty, njëri prej të cilëve, ai i Qeverisë, i bazuar në “Planin Banjsko”, parashihte rritje ekonomike për 6.6% për vitin 2012, 7.8% në vitin 2013, si dhe 7.4% në vitin 2014.

Ndërkohë që skenari tjetër, apo skenari bazik, siç quhej aty, parashihte rritje ekonomike prej 5.1%, 5.4% dhe 6% për vitet respektive. Ndërkohë që buxheti i po kësaj qeverie parasheh, siç thashë, rritje ekonomike prej 5%.

Për më tepër, para 5 muajve, përmes Kornizës afatmesme të shpenzimeve, po kjo qeveri u zotua se për vitet 2012, 2013, dhe 2014 do ta mbajë deficitin e përgjithshëm buxhetor përbrenda 2% të bruto produktit vendor.

Tash me buxhet po na thotë se as ky planifikim nuk doli të jetë ashtu dhe se ky deficit në fakt projektohet të jetë mbi 3%, diku te 3.2%.

Po ashtu, në të njëjtin dokument të para 5 muajve na është thënë se, ta zëmë, buxheti për bujqësi do të rritet deri në 3% të Buxhetit të shtetit, ndërkohë që në Projektligjin për buxhet ai nuk arrin as 1.5%. Pra, do të kishte qenë mirë të kërkojmë nga qeveria që të mos planifikojë më, sepse me plane të tilla që ia fusin kot, po rrezikojmë më shumë se sa pa plan fare.

Por, fatkeqësisht, mungesa e aftësisë planifikuese nuk përfundon me kaq. Në dokumentet përcjellëse për buxhetin Qeveria parashikon një rritje vjetore të bruto produktit vjetor prej 5%, dhe thotë se burimi kryesor i kësaj rritjeje është rritja e investimeve kapitale në sektorin publik, të cilat planifikohen të rriten për 2012 për 15.1%.

Ndërkaq, sipas tyre, në tri vitet në vijim mesatarisht investimet kapitale do rriten me një temp prej 5.5%, që në fakt i bie se rritje te investimeve do ketë vetëm në vitin 2012, meqenëse se aty do të jenë 15%, në ndërkohë që për vitet tjera nuk do të ketë.

Këtu e kemi një problem tjetër domethënës. Edhe pse në vitet 2013 dhe 2014 Qeveria nuk parasheh rritje të investimeve publike, megjithatë rritja ekonomike vazhdon të projektohet te 5%. Kjo nënkupton se ose investimet publike nuk qenkan fare me rëndësi për promovimin e zhvillimit ekonomik, gjë që natyrisht nuk është e vërtetë, ose se mënyra se si dhe ku i investon Qeveria paratë publike, janë krejtësisht të parëndësishme për zhvillimin ekonomik. Pra, vetë qeveria po e thotë se investimet e saj nuk gjenerojnë zhvillim, që nënkupton që nuk janë në interes të popullit të Kosovës. Atëherë, natyrisht, pyetja natyrale që është këtu, në interes të kujt janë?

Për vitin 2012, Qeveria parasheh një rritje te investimeve private prej 8.7%. Në të njëjtën kohë thuhet se gjatë këtij viti do të ketë më pak remitenca nga jashtë, që nënkupton më pak fuqi blerëse të konsumatorit dhe me pak kërkesë për prodhime konsumi. Po ashtu, duke e pasur parasysh krizën financiare, parashihet një ngushtim i hapësirave për kredimarrje brenda Kosovës. Në të njëjtën kohë, Banka Botërore dëshmon se ka ardhur deri të përkeqësimi i mundësive të të bërit biznes në Kosovë.

Tash është shumë e paqartë se si mund të rriten investimet private me 8.7% në një mjedis ku ka më pak kërkesë për mallra, ka më pak kredi dhe është më vështirë të bëhet biznes, njësoj siç është e paqartë se si mund të rritet e ardhura kombëtare në një mjedis të tillë. Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh rrethanat e njëjta, Qeveria prapë planifikon rritje të ndjeshme të konsumit privat.

Dhe të njëjtin problem e kemi edhe më të hyrat. Përveç se Qeveria planifikon që edhe në vitet në vijim, përfshirë vitin 2012, afërsisht 75% të të hyrave të financohen nga doganat, gjë që nënkupton se nuk planifikohet fare rritja e prodhimit të brendshëm dhe se prapë do të vazhdojmë t'i importojmë ato që kemi nevojë t'i konsumojmë, edhe të këto planifikime ka paqartësi.

Të hyrat nga doganat planifikojnë të rriten për 3.7%, ku një pjesë e kësaj rritjeje i atribuohet rritjes së konsumit dhe pjesa tjetër i atribuohet rritjes së importit. Por, rritja e konsumit për të hyrat nga dogana ka relevancë për to vetëm nëse rritet konsumi i mallrave të importuara, gjë që bie që rritja faktikisht i atribuohet vetëm kategorisë së dytë, që e përmenda, rritjes së importit.

Për më tepër, Qeveria na thotë se rritja e të hyrave nga dogana do të shkaktohet edhe nga rritja e investimeve, kur në të njëjtën kohë na thotë se i ka hequr të gjitha barrierat tatimore për importimin e makinerisë dhe lëndës së parë.

Shtoja tërë kësaj parashikimet për ulje të çmimeve të artikujve të konsumit dhe të naftës globalisht, gjë që do të nënkuptonte ulje të vlerës së importeve, dhe e kemi një pasqyrë jashtëzakonisht të turbullt. Sepse, sipas të gjitha këtyre parametrave të dhëna nga Qeveria, i bie se qytetarët e Kosovës me më pak remitenca, me më pak qasje në kredi dhe me më shumë vështirësi për të bërë biznes, do të importojnë më shumë dhe konsumojnë më shumë. Kjo është një almet teori ekonomike! Pra, është zbulësë, të cilën duhet ta patentojmë!

Situata është njëjtë kaotike edhe kur i shikojmë shpenzimet buxhetore. Në bazë të të dhënave të prezantuara nga Qeveria, e cila pretendon se është duke e zvogëluar varfërinë me shumë sukses, dhe e cila po premton se do përkujdeset fuqishëm për kategoritë e dala nga lufta, del se transferet qeveritare për kategori sociale do të rriten vetëm me normën e inflacionit. Thënë shkurt, i bie se edhe nëse numri i përfituesve të skemave sociale mbetet i pandryshueshëm, mirëqenia e tyre në rastin më optimist vetëm do të stagnonte, meqë nuk ka as rritje reale të mjeteve të ndara për transfere.

Qeveria po ashtu deklaroi se do ketë një rritje prej 5% të fondit të pagave për vitin 2012, si dhe thuhet se kjo rritje do të shkojë për akomodimin e punësimeve të reja nëpër ministri dhe për zbatimin e plotë të Marrëveshjes për rritjen e pagave për vitin 2011. Çka do të thotë kjo? Se marrëveshja për paga, nuk qenka zbatuar, dhe po u dashka të finalizohet në vitin 2012, apo se Qeveria edhe më tepër do ta keqpërdorë pushtetin për ta rritur punësimin në sektorin publik duke akomoduar, siç jemi mësuar, militantë partiak të saj!

Por për një Qeveri e cila arriti që të gabojë në 30% të të hyrave të planifikuara për vitin 2011, të financimit për buxhetin e vitit 2011, çdo gjë është e mundshme. Dhe madje është e mundshme ta vazhdojnë avazin e njëjtë të planifikimit edhe për vitin 2012. Pra, një pjesë e konsiderueshme e financimit është e bazuar në burime në të cilat ne nuk kemi ndikim: FMN, Banka Botërore, Komisioni Evropian, apo në të hyra të cilat na detyrojmë të shesim pasurinë tonë publike. Ky është shantazh për qytetarët e Kosovës. Por kjo i bie

kështu: nëse doni paga nga sektori publik, nëse doni arsim, shëndetësi e shërbime publike, duhet të hiqni dorë ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, zgjatjani kohën deri sa ta përfundojë, në emër të grupit!

VISAR YMERI: Pra, përfundimisht, ky buxhet është i keqplanifikuar, në shumë raste i pavërtetë, dhe tejet dëmtues për ekonominë e vendit dhe mirëqenien e qytetarit. Dhe, për më tepër, është buxhet i cili nuk paraqet kurrfarë koncepti zhvillimor, i cili as nuk e di prej nga niset, e as nuk e di se kah do të shkojë. E si i tillë, nuk mund dhe nuk bën të jetë i pranueshëm për ne. Prandaj, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk do ta votojë këtë buxhet të paraqitur nga Qeveria. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Që fillimisht duhet të themi se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës mendon se ky buxhet është buxhet në rrjedhën e buxheteve që janë votuar në Kuvendin e Kosovës në katër vitet e fundit, e që ka sjellë në varfërim të vazhdueshëm të shtetit të Kosovës, në futjen borxh të shtetit të Kosovës dhe një jetë gjithmonë e më të pasigurt për qytetarët e Kosovës.

Sidoqoftë, fillimisht duhet të them se me ndarjen e Ministrisë së Financave nga ajo e Ekonomisë, Qeveria Ministrinë e Financave e ka shndërruar në shërbim të kontabilitetit dhe ky shndërrim në pjesë – në kontabilitet të Qeverisë ka bërë që të paktën të kemi kontabilitet më të mirë dhe mund të them se të paktën balancimi i buxhetit është më i mirë, për shkak se ministrit paraprak herë i mungonin 262 milionë, një herë tjetër nuk i gjente ku i ka 140 tjera. Domethënë, kemi pasur raste kur nuk e ka ditur ku i ka mjetet. Tash të paktën e dimë ku janë mjetet dhe e dimë se sa mjete po na mungojnë dhe ku i kemi, dhe pa asnjë dromë cinizmi duhet përshëndetur vullnetin e ministrit për të biseduar me Kuvendin për këto çështje.

Sidoqoftë, ajo që do të them, do të jetë krejt diçka tjetër, për shkak se nëse shifrat janë në rregull, ekonomia është as përafërsisht ajo e cila duhet të jetë ose ajo për të cilën flitet këtu.

Si fillim, ministri tha që borxhi publik i Kosovës do të shkojë 5.6% të GDP-së, që i bie diku rreth 300 milionë euro. Ademi e gaboi, tha 5.4, domethënë ky 0.2% nuk është aq i vogël! Merruni vesh mes veti dhe kallëzona a është 5.6 a 5.4, domethënë, se nuk është aq i vogël ky ndryshim dhe ka të bëjë me njëfarë forme të manipulimit, të zvogëlimit gradual të shifrave, që nuk janë të mira për Kosovën.

Tani, nëse e shohim atë që u tha këtu, sidomos nga përfaqësuesi i partisë në pushtet, zoti Grabovci, mund të them që vendet si Greqia, si Italia, si Spanja e disa vende tjera, mos t'i përmend, lirisht mund ta thërrasin Qeverinë e Kosovës t'u kallëzojë qysh t'i menaxhojnë financat publike, në mënyrë që t'i shpëtojnë vendet. Domethënë, aq të mirë janë këta, aq mirë i dinë punët e veta, aq mirë janë duke e menaxhuar buxhetin e Kosovës dhe ekonominë e Kosovës, sa lirisht mund të shkojnë e t'u dhënë ligjërata, t'u mbajnë ligjërata atyre në Evropë, se ata nuk po dinë!

Duke pasur parasysh që parashihet 5% rritje ekonomike për vitin e ardhshëm, në të njëjtën kohë parashihet 5% rritje e të hyrave buxhetore, shihet se Qeveria e ka lënë Kosovën të ecën vetë. Domethënë, nuk ka kurrfarë masash tjera për t'i rritur të hyrat vetjake, sepse 5% rritje ekonomike, që ndodhë vetvetiu për shkak të remitencave dhe 5% rritje të buxhetit, do të thotë: lëre vetë, fike Qeverinë krejt se ndodh vetë, edhe pa Qeveri hiq. Nuk ka nevojë të kemi qeveri.

Me këtë që e ka bërë, me 5% rritje të barazuar, domethënë që Qeveria ka hequr dorë prej luftimit të evazionit fiskal. Do të kthehen arkat fiskale pak më vonë. Nuk ka nevojë, domethënë Qeveria ka hequr dorë prej punës në luftimin e evazionit fiskal, se sikur ta luftonte evazionin fiskal, me siguri të hyrat kishin për t'u rritur pakëz më shumë, ndoshta, se që parashihen. Ka heq dorë prej luftimit të korrupsionit, definitivisht, domethënë se nëse kishte për të pasur politika të qarta për luftimin e korrupsionit, me siguri se edhe kishte për t'u reflektuar te projektimi i të hyrave.

Ka hequr dorë prej krijimit të kushteve për investime të huaja. Vetë ministrat e Qeverisë së Kosovës, këta të katërt që bëjnë për ekonomi, jo ky i Financave, thonë që në Kosovë është vërtet zor të bëhet biznes. Por, ministrat që janë të ngarkuar për të krijuar kushte për të bërë biznes në Kosovë, dalin e thonë: "goxha zor është të bëhet biznes në Kosovë". Paramendoni ju, çfarë kulture e punës, çfarë përgjegjësie për të udhëhequr me shtetin, dominon.

Kjo Qeveri ka hequr dorë për të parashikuar ulje të papunësisë, domethënë rritje të vendeve të punës për shkak se nëse shkon e barazuar me rritje prej 5%, numri absolut, po edhe relativ i të papunëve në Kosovë do të rritet. Kjo do të thotë që jo vetëm përqindja, por edhe numri total i të pa punëve në Kosovë do të rritet, ose edhe vice versa.

Në këtë buxhet shihet se përkundër faktit që thuhet se do të jenë diku nja 300 e diçka milionë euro, përpos autostradës, investime kapitale, nëse i shihni tabelat, më shumë se gjysma e atyre projekteve janë bartje prej vitit të kaluar, që u tha prej dy parafolësve. Do të thotë, në vitin e kaluar nuk janë realizuar projektet që i janë premtuar popullit të Kosovës dhe barten, dhe neve na paraqitet si kumulativ kinse për çdo vit janë shpenzuar ato mjete.

Në fund të fundit, duhet të shihni se nuk janë shpenzuar. Nuk është ky kumulativ, e projektet që barten prej këtij viti në vitin 2012, janë më të mëdha se projektet të cilat fillohen në vitin 2012. Do të thotë, në vitin 2012 nuk fillon kurrgjë.

Tani, duhet pyetur Qeverinë e Kosovës – a për kesi performanca keni shkuar në Banjsko, a? Çka keni bërë atje?

Totali është se ky buxhet e parasheh Qeveria e Kosovës pajtohet me situatën në të cilën gjendet Kosova. Domethënë, është një pajtim që nuk mund ta nxjerrin Kosovën prej kësaj situatë, duhet vazhduar kështu, të shpenzojnë sa më shumë që të munden, të shpenzojnë sa më joracionalisht që munden dhe të del ku të del.

Po ju tregoj, është gati mantra. Njerëzit që e mohojnë realitetin, nuk munden ta ndryshojnë atë realitet. Dhe këta që po e mohojnë realitetin për të cilin po flasim ne, po flet shoqëria civile, po flet gjithë bota, kush e mohon realitetin, nuk mundet kurrë ta ndërrojë, se i infektojnë edhe njerëzit, edhe aparachikët që i kanë nëpër komuna, që i kanë nëpër ministri. Ata mendojnë se është mirë kështu çka janë duke bërë. Nuk munden të mobilizojnë njerëz për ta ndryshuar realitetin, ata që e mohojnë realitetin.

Ky buxhet tregon se Qeveria as nuk e ka ndërmend të provojë ta zhvillojë vendin. Ky buxhet prapë, po them, tregon se Qeveria është e zonja të shpenzojë jo racionalist, por jo të krijojë. Do të kthehem prapë, këtu.

Pak retrospektivë për t'ju dëshmuar që është e vërtetë kjo që po them unë, dhe Qeveria dhe ministrat dhe të gjithë ju i keni shifrat, në shumë burime të shifrave të sakta. Të hyrat buxhetore në fund të vitit 2004 kanë qenë 450.000.000 euro, në fund të vitit 2007 kanë qenë 930.000.000 euro, të hyrat vetanake të Republikës së Kosovës, me atë Qeverinë që shumë prej jush i keni thënë - e keqe. Thotë, për më pak se tri vjet është dyfishuar vlera e të hyrave që kanë hyrë në buxhetin e Kosovës, vetanake, për tri vjet më shumë se 100%. Përderisa, për katër vitet, të cilat jemi duke i parë në këtë qeverisje, kemi mbërri prej 930.000.000 eurove, të hyra vetanake reale, në pak më shumë së 1.1 miliard, dom të tregojmë vërtet cilat jonë të hyra vetanake, po flasim pa shitur, domethënë i bie që ka pasur rritje diku prej 4-5% në vit, ose kumulativin 3 : 3, po ta llogarisim, del diku 17%. Domethënë, ajo Qeveria e keqe e ka dyfishuar, kjo nuk po mund kurrqysh të shkojë përmbi 5%. Domethënë, dallimi është ky 100% për 3 vjet, kundrejt 17% për 4 vjet, si dhe mos ta harrojmë pjesën tjetër 500.000.000 euro rezerva në fund të vitit 2007, që i kanë trashëguar këta dhe 5.6% borxh publik. Tash, domethënë, diferenca është që dikur kemi pasur rezerva dhe 0 borxh publik, 500.000.000 rezerva, tash i kemi diku nga 300.000.000 euro borxh publik. Domethënë, përkundër buxheteve që janë shpenzuar, përkundër dividendëve që janë marrë, diku nga 800.000.000 euro ju del dallimi për katër vjet edhe do të kthehen te vlera e parasë së shpenzuar shumë shpejt.

Ligji për buxhetin e kaluar është votuar- privatizimi i PTK-së. Ai ka qenë ligj, është futur në ligj, bile është quajtur - shndërrimi i aseteve publike në asete private, diçka... një farë fjalie, kështu e komplikuar ka qenë, por ka qenë fjala për shitjen e PTK-së, e nuk është shitur. Në njëfarë forme është thyer ligji dhe pa marrë parasysh kanë shkuar në Banjsko e kanë shkelur ligjin, se e kanë pasur në ligj që ta privatizojnë. Edhe, ajo vlera 300.000.000 e PTK-së po na del që është vlera e borxhit publik, se na borxh kemi hyrë. Tash, atë vlerë të shitjes borxh e kemi edhe kur të shitet duhet diqysh të lahet. Kjo Qeveri i ka 5 ministra, që merren me ekonomi edhe po e ka komplikuar jetën më shumë,

krejt Kosovës ia ka ... për shkak se duhen dy njerëz të vendosin për një temë. Edhe, është ligj i administratës, ministri e din më mirë se unë, që kur dy njerëzve iu jep një punë të cilën mund ta kryejë një njeri, puna s'kryhet hiç, komplikohet. Edhe, këta e kanë komplikuar, për të bërë pazare politike, e kanë komplikuar punën.

Arkat fiskale, po kthehem, diku nja 9.000 janë instaluar, me pompozitet. Janë shitur më së shtrenjti në rajon, kemi folur këtu për arkat fiskale. Përderisa te bizneset tjera nuk po instalohen, çka domethënë kjo? Qeveria merr vendime, të cilat nuk aplikohen njëjtë për të gjithë njerëzit, që, domethënë, dikush është i dënuar të paguajë, kushtimisht i dënuar, dikush tjetër s'pagan hiç dhe ndodhë që dy biznese të mesme ose të vogla, veprojnë karshi-karshi dhe njëri pagan, tjetri s'pagan. Kush fiton më shumë, ai që pagan taksa, apo ai që s'pagan taksa? Kjo domethënë që Qeveria e Kosovës, po lejon që të ndershmit të dënohen, e të pandershmit të përfitojnë. Në të njëjtën kohë, po krijon mundësi që bizneset e mëdha, të cilat duhen të kenë arka fiskale, se i kanë dënimet shumë të mëdha, duhet të shkojnë duke degraduar, ndërsa bizneset, të cilat bën vaki edhe i mbajnë vetë, nuk kanë nevojë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe 2 minuta, Ardianit!

ARDIAN GJINI: Sa ta kryej, sikur të tjerëve.

KRYESUESI: Si të tjerëve, po tjerët e patën të shkruar, Ardian...

ARDIAN GJINI: S' ka lidhje....

KRYESUESI: Pra, ka lidhje.

ARDIAN GJINI: Çështja tjetër është me këtë politikë të arkave fiskale, domethënë, po provohet, që duke i shkatërruar të mëdhenjtë, t'i forcojmë të vegjlit dhe kjo është politikë e cila ka filluar dhe ka përfunduar me Bashkimin Sovjetik, prej saj ka hequr dorë edhe Kina.

Tani çështja e arkave fiskale është një trend, të cilin e keni instaluar për të bërë biznes dikush edhe e ka përfunduar me këtë trend edhe nuk po ia shohim kurrkund rezultatin. Po, është çështja tjetër, të cilën duhet ta përmend gjithsesi, është vlera e parasë së investuar në katër vjetët e fundit, se duhet parë trendin dhe duhet parë edhe çka po ndodhë tash? Paraja e investuar nuk është as barabarësish e vlefshme me atë që sot kemi. Çka domethënë kjo? Kjo, domethënë që nëse e ndërtojmë një shtëpi në një vend pa rrugë, më shtrenjtë na kushton ndërtimi se vlera e shtëpisë, menjëherë pasi është ndërtuar. Qysh mund të ndodhë kjo në shtet? Kjo ndodhë kur ndërtohet shkolla për 5 nxënës, ose kur ndërtohet një rrugë për 5 vetura brenda ditës edhe lidhet me një rrugë, në të cilën nuk mund të kalosh fare, ose, kur kompanive të papërgjegjshme u jepet kontrata edhe ato nuk dinë ta ndërtojnë objektin edhe duhet ta meremetojnë, 6 muaj mbasi të lëshohet në punë, ose duhet asfaltuar rrugët tri herë për tri vjet, ose kur merret talli

20%, e atëherë kompanitë duhet rrudhur dorën në cement, në hekur, në bitumin edhe prapë rrugët edhe objektet shkatërrohen brenda një viti. Domethënë, nëse merret talli 100%-shi i vlerës po humbet. Po humbet 100%-shi, për shkak se po duhet ndërtuar krejt për së pari. Kjo është çka ka bërë Qeveria e Kosovës për këto vitet e fundit. Edhe, ju tregova pse ndodhë kështu.

Ky buxhet është krejt e njëjta, mos të flas për çështjen e solidaritetit në mes njerëzve, që po ju themi që disa herë që po e shkatërrohi duke i favorizuar regjionet e caktuara. Në lexim të dytë, a din çka doni të bëni, keni për t'ia hequr një projekt Skenderajt e ta qitni në Gjilan, se jonë ankuar. Po, kjo nuk është logjika e buxhetit, kjo nuk duhet të jetë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Kush po do replikë? Dy replika i paskemi!
Hajde zoti Grabovci, replikë.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryeses!

Unë parafolësit vetëm i kisha bërë një herë, të paktën një herë, vetëm një herë, le të ndalet edhe le t'i vlerësojë të arriturat pozitive dhe perspektivën e këtij vendit që shënon nga viti 2007, me ardhjen në pushtet të Partisë Demokratike të Kosovës. Por, edhe nëse ky tenton që mos t'i vlerësojë, qytetarët e Kosovës, i vlerësojnë drejtë, sepse ato projekte kapitale, këtë ndryshim pozitiv të vendit, po e shijojnë të gjithë qytetarët e vendit. Unë nuk u thirra fare në buxhet, por u thirra në raportet e organizmave ndërkombëtarë, financiar, të cilët kanë vlerësime pozitive për buxhetin dhe të arriturat e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Megjithatë, unë e kuptoj shqetësimin e tij, por me këto deklarime i kisha bërë thirrje të vazhdojë edhe më tutje, se do të na mundësojë jetëgjatësinë e qëndrimit tonë në pushtet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Kundër replikë, zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Definitivisht, nuk është kurrfarë befasie. Unë e thashë një fjali, këta njerëz që e mohojnë realitetin, nuk mund ta ndryshojnë realitetin. Sikur këta të kishin qenë mirë, raportet ndërkombëtare do të ishin ndryshe. Po unë nuk e di ku po i lexon. Edhe fjalimet tona nuk e mbajnë në pushtet zotin Grabovci, por vjedhja banale e votave, se s'kishte me qenë kurrë në pushtet.

KRYESUESI: Zoti Grabovci e ka edhe një minutë.

ADEM GRABOVCI: Unë i bëj thirrje zotit Gjini, vetëm le të ndalet në komunën e vet, në Gjakovën e tij, rreth shtëpisë së tij dhe i sheh, i shijon dhe i përjeton ndryshimet që ka bërë Qeveria e Republikës së Kosovës, se kur ke qenë ti në pushtetin qendror dhe atë lokal, Gjakova ka qenë në një pozitë të mjerë. Ndërsa, me ardhjen e Qeverisë së Partisë Demokratike në pushtet, ndarja ka qenë shumë e drejtë. Dhe, kemi dëshmuar shumë qartë se nuk udhëhiqemi nga mendësia regjionale, por vërtet ia duam të mirën çdo vendi dhe

çdo pëllëmbë të këtij vendi dhe të kësaj toke, e trajtojmë si të barabartë, tonën dhe të paprekshme.

Prandaj, vetëm, po të bëj thirrje, nisu nga Gjakova jote, ku e ke lënë kur ke qenë ti dhe në çfarë gjendje është sot dhe sa milionë ka fituar me qeverisjen e Partisë Demokratike të Kosovës, në krye? Dhe, vlerësoj edhe vlerësimet ndërkombëtare, që i bëhen sot Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për ministrat,

Përshëndetje për deputetët,

Duke marrë parasysh se sot në seancën plenare, shqyrtohet Projektligji për buxhetin për vitin 2012, atëherë e drejtë demokratike e secilit deputet është që të shprehë mendimin e vet, duke shprehur mendimin e vet duke ditur se të gjitha paratë, të cilat sot janë pasqyruar në Projektbuxhetin 2012, janë para të qytetarëve të Kosovës. Dhe, çdo sugjerim i mirë në këtë projektbuxhet, është në të mirë edhe të vetë ministrit Hamza, i cili edhe gjatë raportimit nëpër grupe parlamentare është shprehur në mënyrë shumë të sinqertë, që mund të jetë ndoshta edhe një sugjerim i mirë edhe prej deputetëve, që mund të dalë prej seancës, që t'i drejtohet Komisionit Parlamentar, për arsye se ndarja buxhetore bëhet për qytetarët e Kosovës. Në këtë seancë është edhe përfaqësuesi i Fondit Monetar Ndërkombëtar, atëherë, do të shkojë një përshëndetje për të. Thuhet se të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë obligim, që të mendojnë se si ndahet projektbuxheti dhe menaxhohet projektbuxheti për qytetarët e saj.

Qeveria e Kosovës gjatë projektimit të buxhetit 2012, ka parashikuar një rritje buxhetore, ndërkohë që dëgjuam se kjo rritje duhet të quhet sukses, duke pasur parasysh gjithë ambientin, që na rrethon dhe gjithë ambientin biznesor, apo më mirë të themi krizën në të cilën ndodhet e gjithë Evropa. Por, si ia ka dalë që ky projektbuxhet të jetë racional dhe të krijojë atë që është më e rëndësishme për Qeverinë dhe qytetarët, që të ndryshojë në të mirë jetën e tyre dhe mirëqenien e tyre, do të mbetet në realizimin e projektbuxhetit.

Nëse analizojmë pasqyrat e Projektbuxhetit 2012, shihet qartë se është vazhdimësi e projekteve të Qeverisë së kaluar, PDK – LDK. Mirëpo, e gjithë parashikimi për rritje ekonomike deri në 5% ose 5.3% për vitin 2012, të cilën e ka deklaruar edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, nuk jep shpresë shumë të madhe, që vetëm me projektbuxhet, apo më mirë të themi me para të qytetarëve të shkojmë në investime kapitale.

Kisha kërkuar pak qetësi prej deputetëve, në rast se është seancë, në rast se është kafe, atëherë të dalim krejt në kafe.

Dihet mjaft mirë se kjo Qeveri duhet t'i hapë rrugën investitorëve dhe nëpërmes investimeve private mund të zhvillohet edhe buxheti, po edhe jeta më e mirë e qytetarëve.

Të gjithë deputetët e kanë pasqyrën e të hyrave të shpenzimeve të Qeverisë, po unë nuk do të potencoj shifra, mirëpo kërkoj nga Qeveria, në këtë rast, edhe pse jam pjesë e koalicionit, mirëpo unë jam deputete brenda Kuvendit të Kosovës, kërkoj që çështja e menaxhimit të parasë publike të bëhet në mënyrë shumë të drejtë dhe transparente. Kosova ka mjete të saja edhe jashtë vendit tonë, siç është çështja e Trustit, siç është çështja e Agjencionit Kosovar të Privatizimit dhe me një projektim dhe analizim shumë të mirë në të ardhmen, Kosova mund të arrijë rezultate shumë të mira dhe të përmirësohet jeta e qytetarëve të saj. Njëkohësisht, kërkoj nga Qeveria, se është në projektbuxhet shuma prej 300.000.000 euro për privatizimin e PTK-së, që të jetë një privatizim shumë transparent në të mirë të qytetarëve të Kosovës. Siç po shihet, Komiteti drejtues, ka marrë një vendim tjetër për privatizimin e Postë -Telekomit të Kosovës, dhe presim që në një seancë të radhës të diskutohet edhe kjo çështje, çështja e privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit dhe çështja e ndërtimit të “Kosovës së Re”. Edhe një herë në këtë seancë, shtroj dilemën time shumë të madhe, që privatizimi i Distribucionit dhe Furnizimit të mos bëhet në planin të cilin e ka bërë shteti fqinj Shqipëria, për arsye se ne do të jemi prapë subvencionues të KEK-ut. Dhe, dal te subvencioni i ndërmarrjeve publike. Edhe dje në grup parlamentar, që e kemi pasur ministrin edhe sot në këtë seancë, kërkoj që të hollat të cilat jepen subvencione edhe për KEK-un edhe për shumë ndërmarrje tjera, mos t’i potencojë me emër, që të lypet një llogari nga ata, se si po shkojnë këto të holla në shfrytëzim, se janë të hollat e qytetarëve të Kosovës?

Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahje buxhetit dhe do që në këtë projektbuxhet 2012, të ketë hapësirë edhe për përfaqësuesit në Qeveri të AKR-së, të PD-së, që investimet në të ardhmen të jenë pjesë e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe jo investimet kapitale, që nisen nga projektbuxheti i Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Millosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poštovani ministri i uvažene kolege,

Samostalna liberalna stranka je razmatrala Nacrt budžeta za 2012.godinu, i mi smo svesni činjenice da je budžet mali i da je njime razvoj ograničen. Ipak, imamo nekoliko osnovnih primedbi na njega. I pored preporuke Evropske komisije, budžet Ministarstva za zajednice i povratak nije povećan. U budžetu Ministarstva zdravlja nisu predviđene kapitalne investicije za izgradnju bolnica u srpskim sredinama. Bolnice u Gračanici i Štrpcu počele su da se grade 2010.godine. Sredstva za završetak ovih projekata nisu predviđena ovim Nacrtom budžeta. Izgradnja kapitalnih objekata, kao što su sportski objekti ili škole, nisu predviđene u nijednoj srpskoj sredini. U izveštaju o napretku piše da su sva ministarstva dužna da 5% svog budžeta odvoje za realizaciju projekata manjina. Smatramo da je u tom smislu budžet neuravnotežen i ne omogućava ravnomerniji razvoj.

Mi ćemo podržati ovaj Nacrt budžeta u načelu i pozivamo predlagачe da pre drugog čitanja otklone ove nedostatke, a mi ćemo daljim radom pokušati da dodemo do kvalitetnijih rešenja. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputetja Balje!

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Moja grupa “6+” je kroz rad u kompetentnoj komisiji i iscrpnoj analizi zaključila da je dokument koji je ispred nas potpun i kvalitetan i da vodi državu u daljem ekonomskom razvoju, da stvara dobro tle za dalje ekonomske uspehe i eliminisanje postojećih ekonomskih negativnosti. Dokument koji se nalazi ispred nas govori o očekivanom ekonomskom rastu od 5%, koji je obećavajući za poboljšanje trenutnog stanja u delu za smanjivanje nezaposlenosti i siromaštva. Top prioritet odgovornih ekonomskih aktera naše države je makrofiskalna stabilnost, što je od velike važnosti. Dokument daje primat infrastrukturnim ulaganjima, obrazovanju, zdravstvu, telekomunikaciji. Ovaj dokument predstavlja finansijski pokazatelj svih aktivnosti u narednoj godini, sve što je planirano i svi evidentirani interesi, njihovo finansiranje i ispunjavanje.

Znamo da se blizu nas države u okruženju suočavaju sa velikom finansijskom krizom, koje stvaraju čitav kolaps u državi. Učeni time, trebamo imati na umu jednu određenu finansijsku disciplinu, koju nam ovaj budžet navodi. Čestitam gospodinu Bedri Hamzi i kažemo da ima potpunu podršku moje grupe. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani vazhdojmë me diskutimet e deputetëve, ose nëse doni t’i marrim 10 minuta pauzë.

(Ndërhyrje)

Zoti Bedri Hamza e ka kërkuar fjalën.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Faleminderit, të gjithë deputetëve që diskutuan dhe morën pjesë dhe kontribuan me diskutimet e tyre, por e pash për obligim që t’i sqaroj disa çështje.

U kontestua qëndrueshmëria e të hyrave. Nuk ka mundësi që të kontestohet qëndrueshmëria e të hyrave, për shkak se ne në planifikimet tona kemi qenë mjaft të kujdesshëm. Nuk ka mundësi që të kontestohet qëndrueshmëria e buxhetit, kur ky buxhet sa i përket deficitit është brenda parametrave të lejuar, ku deficit i projektuar është 3.2%. Ndërsa, në realitet mund të jetë edhe më pak, sepse nuk ka pasur deri tash dhe nuk pres që edhe në vitin e ardhshëm do të ketë ekzekutim 100% të buxhetit. Mirëpo, duke dëgjuar në vazhdim diskutimin e pash që ata që po e kritikojnë qëndrueshmërinë buxhetore, jo që po projektojnë të hyra më të vogla e që janë më të kujdesshëm në projektimin e të hyrave, në planifikimin e të hyrave, por kanë të hyra edhe më të mëdha. Dhe, nuk shkon në të njëjtën kohë edhe për të thënë buxheti është i paqëndrueshëm, veç unë po planifikoj të hyra më të mëdha se këto.

Shpenzim jo të drejtë. Sa i përket komunave, grantet dhe formulat mbi bazën e të cilave ndahen grantet janë vendosë në vitin 2000-2001. Ne nuk kemi e kemi ndryshuar

formulat. Sikur të kishim aplikuar ndryshimin, që ka ndodhë me rastin e regjistrimit të popullsisë, sigurisht se disa komuna kanë me pas buxhet më të vogël.

U përmendën raportet. Kur përmenden raportet e institucioneve ndërkombëtare, është mirë të mos jemi selektiv. T'i referohemi edhe atyre raporteve të Bankës Botërore, që janë shumë të reja, veç sa janë të vjetra, dhe raporteve të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Mua më vjen që asnjëri, dhe bëri mirë që nuk e kontestoi se rritja ekonomike vlerësohet të jetë 5.3%. U ndjeva tepër mirë kur asnjëri nuk e vlerësoi, që në këtë vit kemi krizë buxhetore, vendi po bankroton, se gjatë gjithë vitit u diskutua që u rritën pagat, u bë autostrada, vendi po bankroton dhe kjo s'ndodhi. Më erdhi mirë që të gjithë u pajtuan, që pavarësisht shitjes apo mos shitjes së PTK-së, të gjitha obligimet po kryhen në kohë.

Buxhet nga rezervat. Jo më nuk është buxhet nga rezervat. Është buxhet nga të hyrat. Vetëm në këtë vit të hyrat rriten 18% më shumë se sa në vitet paraprake. Dhe ne duhet të ndjehemi mirë që institucionet e Kosovës në nivel lokal dhe qendror kanë arrit në një situatë kur të kemi buxhetim më shumëvjeçar, kur projektet janë më shumëvjeçare, jo të planifikojmë vetëm në baza vjetore.

U quajt gabim elektorale, që unë kisha thënë nuk është gabim elektorale, por që është prioritet, janë prioritetet të Qeverisë rritja e pagave, rritja e investimeve kapitale... Jo më nuk është gabim elektorale me ua rritë pagat atyre që e meritojnë. Është mirë që ka ndodhë rritja e pagave, është mirë që po ka mundësi me u pague në kohë edhe është mirë që po ruhet stabiliteti makrofiskal.

U përmend lidhja e buxhetit me planin e vizionit për zhvillim ekonomik. Është e vërtetë që për vitin 2011 ne e kemi vlerësuar rritjen ekonomike 5.3%. Ne e kemi vlerësuar për vitin 2012 - 5% , ndërsa në planin për vizion ekonomik, rritja ekonomike është e vlerësuar prej 7 – 8%. Po është në periudhën e ardhshme makrofiskale dhe është nën supozimin se duhet të ndodhin investimet në energjetikë, rruga 6, Brezovica dhe projekte tjera të mëdha.

Deficiti buxhetor, nuk e pash të ju them të drejtën, ndonjë dallim të madh në mes asaj se çka propozojnë të tjerët de deficiti buxhetor, çka propozojmë ne. Ndoshta jemi shumë afër, për mos me thënë, pothuajse identik.

Çështja e inflacionit nuk mund të amortizojë rritjen e pagave. Për periudhën e ardhshme makrofiskale, vlerësohet se inflacioni do të jetë vetëm 2.3%.

Dhe, u tha që ka shpërndarje politike, që nuk qëndron. Nëse i referohemi autostradës, është një projekt kapital të cilin kanë me e shfrytëzua të gjithë qytetarët e Kosovës. Ai nuk ka mundur me e ndërrua drejtimin, përveç andej kah është.

Projekte tjera në Ministrinë e Infrastrukturës, vazhdon investimet në rrugën Prishtinë-Pejë, Prishtinë-Mitrovicë, ka projekte që janë në komunën e Prishtinës, ka projekte që janë në komunën e Podujevës, ka projekte që janë në komunat ku nuk qeveris PDK-ja.

Sa i përket Ministrisë së Arsimit. Ju lutem shikoni shkollat. Janë të shpërndara në të gjithë territorin e Kosovës.

U përmend buxheti alternativ. Unë i vlerësoj alternativat, janë të mirëseardhura, mirëpo për të ndodhur qysh u propozua këtu, fillimisht ai buxhet duhet që të diskutohet, duhet të kalojë nëpër procedurë të rregullt, duhet të diskutohet me të gjitha organizatat buxhetore dhe duhet të harmonizohet me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Edhe ne kemi pasur projeksion më të madh të hyrave se sa këtë që e kemi paraqitur këtu, mirëpo nuk kemi arritur që të harmonizohemi me Fondin Monetar Ndërkombëtar për të hyra më të mëdha se sa këto që janë paraqitur këtu. Dhe, kjo ka qenë marrëveshja. Dhe, të planifikosh të hyra 1.416.000.000 dhe të thuash se do të jenë në harmoni me rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, unë po ju garantoj që nuk shkon.

U përmend që një prej alternativave është edhe zvogëlimi i fondeve për autostradën ekzistuese dhe shpërndarja e këtyre fondeve nëpër prioritetet tjera. Mund të dallojnë prioritetet, dikush ka prioritet shëndetësinë, dikush arsimin, dikush infrastrukturën, mirëpo ne, jo që po mendojmë për t' i zvogëlojmë fondet për autostradë, ne jemi duke punuar intensivisht, që ky projekt të kryhet brenda kontratës, që ky projekt të finalizohet në vitin 2013. I kemi ndarë fondet e mjaftueshme, ju e keni parë që 38 kilometrat e para të këtij projekti janë lëshuar, por jemi duke punuar shumë intensivisht, jo për ta shtyrë e prolonguar këtë projekt, por që ta startojmë projektin e ri, rrugën 6, që është Prishtinë – Shkup. Dhe, ne jemi shumë optimistë që në pjesën e parë të vitit të ardhshëm do të përfundojë studimi i fizibilitetit, studimet teknike dhe pjesa e dytë e viti do të shërbejë për përgatitjet e fillimit të këtij projekti.

U përmendën disa nene në Ligjin e buxhetit, që mundësojnë paradhënie, gjithashtu edhe ridestinimin e mjeteve. Por, i kisha lutur deputetët, që kur e lexojnë Ligjin e buxhetit, le të kuptojnë se në segmente të caktuara ky ligj i referohet ligjeve organike të fushës së caktuar. I referohet Ligjit për menaxhimin e financave publike, Ligjit të prokurimit dhe transferet deri në këto përqindje janë të lejuara dhe janë pjesë e Ligjit për menaxhimin e financave publike, gjithashtu edhe pagesa e paradhënies.

Buxheti i reflekton prioritetet e Qeverisë. Prioritet i Qeverisë ka qenë dhe është ruajtja e stabilitetit makrofiskal. Është pjesë e planit për vizion të zhvillimit ekonomik, apo planit Banjsko, që ka qejf dikush t' i thotë. Dhe, këtu është reflektuar ruajtja e stabilitetit makroekonomik. Është përmendur dhe është pjesë e planit, rritja e fondeve për bujqësinë, 56 për qind ky sektor ka rritje në raport me vitin 2011 dhe rritja deri në 3% apo pjesëmarrja e këtij sektori deri në 3%, është pjesë e projeksioneve afatmesme. Rritja 7-8% arrihet duke investuar në projektet, që janë pjesë e atij plani. Rritja prej 5,3% në këtë vit është bazë e mirë, që brenda periudhës së ardhshme makrofiskale, sigurisht se do të mbërrihet dhe është shumë realiste se do të mbërrihet rritja deri në 7%. Dhe, kur jemi te projeksionet, projeksionet më të rëndësishme financiare ndërkombëtare i ndryshojnë nganjëherë projeksionet e tyre dhe brenda vitit i rishikojnë ecuritë e indikatorëve makroekonomik.

U përmend çështja e deficitit, do të thotë ne 2% e kemi projektuar deficitin, mirëpo realisht presim që të jetë nën 3%.

U përmend sektori bankar. Referojuni të dhënave të publikuara, që kemi pasur rritje edhe të depozitave edhe të kredive dhe ky sektor ka mbetur mjaft stabil.

Rritja e punësimit në sektorin publik nuk ka ndodhur. Ka ndodhur plotësimi i kapaciteteve në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Rritja prej 120 apo pak më tepër e pjesëtarëve në Policinë e Kosovës, në Agjencionin Kosovar të Dhënave dhe shikoni dallimet e të punësuarve në mes Projektligjit për vitin 2011 dhe 2012 dhe shihet sa është.

Ishte një dallim këtu mes prezantimit tim për borxhin publik edhe të Ademit, zotit Grabovci. Unë po them që zoti Grabovci ka pasur të drejtë. Dallimet janë shumë të vogla, por prej momentit që unë e thashë 5.6% ai 5.4%, ndoshta kemi bërë ndonjë pagesë të ndonjë kësti dhe kemi ardhur aty.

(Ndërhyrje)

Po, e ka ditur ai më mirë!

Bartja e projekteve. Kosova ka hyrë në fazën e projekteve më shumëvjeçare. Është mirë dhe janë këshillat dhe rekomandimet e atyre që kanë përvojë më të gjatë në financat publike, që të kalohet në projekte më shumëvjeçare. Nuk pata dëshirë t'ju lodhë pak me krahasime dhe me do gjëra tjera, por vetë deputeti më nxiti dhe më tha t'ju them këto. Këtu i kam të dhënat e krahasimit prej vitit 2007 deri në vitin 2011. Nuk po shkoj më herët se janë shumë të vjetra, mirëpo, u përmend që dhe dua ta sqaroj, që në vitin 2007 të hyrat në nëntëmujorin e 2007-ës kanë qenë 672.000.000, sot janë 933.

Ecim tutje! Investimet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Hamza, ju e keni të drejtën në fund të sqaroni gjithçka, megjithatë vazhdoni edhe një minutë!

BEDRI HAMZA: Investimet kapitale në 2007-ën kanë qenë 62.000.000 euro, sot janë 324. Besoj që nganjëherë një grafikoni flet më shumë se shumë fjalë. Prandaj, projektbuxheti është buxhet i qëndrueshëm, është i analizuar, është i punuar me kujdes, është i harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe garanton stabilitet makrofiskal, garanton pjesëmarrjen e investimeve kapitale 40% të totalit të buxhetit, garanton rritjen e subvencioneve dhe transfereve dhe garanton zhvillimin ekonomik dhe përmes zhvillimit ekonomik dhe investimeve ndikon normalisht edhe në punësim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mjetet buxhetore, përkatësisht projektbuxheti që duhet ta aprovojë ky Kuvend është tepër i rëndësishëm për Kosovën, që të fillojë me financimin publik normal. Ky projektbuxhet paraqet, njëherësh dokumentin më të rëndësishëm të Qeverisë, përmes të cilit shprehet impenjimi i Qeverisë për financimin e projekteve mbi bazën e prioriteteve dhe në funksion të qëndrueshmërisë së financimit publik, të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale.

Projektbuxheti për shpenzime të rregullta për vitin 2012 është në vlerë prej 1.520.000.000 eurove, që paraqitet në rritje prej rreth 7.6% krahasuar me buxhetin e projektuar për vitin 2011. Projektbuxheti për vitin 2012 bazohet në vlerësimet afatmesme të indikatorëve kryesorë ekonomik dhe me vlerësime të rritjes së performancës së institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave, siç janë doganat dhe Administrata Tatimore e Kosovës dhe është i harmonizuar me FMN-në. Të hyrat e rregullta buxhetore për vitin 2012, janë parashikuar të jenë në vlerë prej 1.361.000.000 eurove, apo 4% më të larta se të hyrat e rregullta të buxhetit 2011.

Nga këto të hyra doganat e Kosovës pritet të grumbullojnë 860. 00.000. Të hyrat nga tatimet vendore pritet të arrijnë vlerën 285.000.000 euro, kurse të hyrat tjera nga niveli qendror dhe lokal 186.000.000 euro si dhe nga dividendat e PTK-së 35.000.000, siç e tha edhe ministri.

Pritet që të trashëgojmë një bilanc pozitiv bankar prej mbi 120.000.000 euro nga ky vit, çka do të përdoret si burim shtesë i financimit. Në këtë kuadër shpreh bindjet se projektbuxheti 2012, është realist dhe këtë bindje e mbështes në performimin e kënaqshëm të vitit 2011 bërë nga institucionet relevante për mbledhjen e tatimeve, Administrata Tatimore dhe Shërbimit doganor, kryesisht si rezultat i rritjes së vazhdueshme të efikasitetit të tyre dhe se besojmë se gjatë realizimit të buxhetit të vitit 2012-ës, performanca e tyre do të rritet akoma më tepër.

Të nderuar deputetë, në dimensionin e shpenzimeve kapitale, projektbuxheti në pjesën më të madhe të tij është produkt i projeksioneve dhe politikave të filluara në vitet e mëparshme, një ngritje prej 15% në krahasim me realizimin e shpenzimeve për vitin 2011.

Shpenzimet kapitale parashihet të jenë 616.000.000 euro ose 40.5% e shpenzimeve të përgjithshme, ndërsa shpenzimet tjera përfshijnë pagat 407.000.000 euro, që paraqet një ngritje prej 5.4% në krahasim me vitin 2011.

Shpenzimet për subvencione dhe transfero, 284.000.000 euro dhe shpenzimet për mallra dhe shërbime janë paraparë të jenë 198.000.000 euro ose 5.9% më të larta në krahasim

me vitin paraprak. Kjo ngritje e theksuar në kategori të shpenzimeve përfshin vazhdimin e projektit të autostradës, e cila përfshin shumën prej 296.000.000 euro, ose 50% të kategorisë së shpenzimeve kapitale. Në 320.000.000 euro për projekte tjera kapitale, që janë 11% më shumë krahasuar me buxhetin 2011.

Ngritja e shpenzimeve kapitale reflekton kryesisht implementimin e projektit të autostradës, projekt ky i cili do të shkaktojë presione fiskale për Kosovën edhe për dy vjetët e ardhshëm, por që padyshim do të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe integrujes të Kosovës.

Shpenzimet publike të Kosovës nga viti në vit janë rritur, sepse janë rritur funksionet shtetërore të Kosovës, përkatësisht nevojat publike të saj. Sikurse në të gjitha shtetet tjera edhe në rastin e Kosovës, rritja e shpenzimeve publike ka qenë dhe është indikator presioni mbi institucionet përgjegjëse, që gjejnë burime për financimin e shpenzimeve. Në këtë kuadër, mendoj që Ministria e Financave dhe Qeveria nën konsulencën e FMN-së gjatë përpilimit të Projektbuxhetit të vitit 2012, me rastin e përcaktimit të prioriteteve buxhetore janë udhëhequr kryesisht nga dy kriterë, nga kriteri i nevojës së financimit të një shpenzimi publik dhe kriterit të dobësisë financiare të një shpenzimi publik.

Në fund, mendoj se Projektbuxheti i Qeverisë për vitin 2012 duhet aprovuar, sepse:

- a) Do të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës, duke bërë të mundur që përmes shpenzimeve kapitale, të ndikohet në rritje ekonomike,
- b) Do të jetë në funksion të stabilitetit financiar, duke bërë të mundur financim publik të qëndrueshëm të shpenzimeve shtetërore dhe
- c) Do të jetë në funksion të zhvillimit social, duke bërë të mundur financimin e nevojave sociale të shtresave të caktuara të popullsisë, për aq sa mjetet buxhetore në dispozicion e mundësojnë këtë.

Krejt në fund dua të theksoj se është për t'u përshëndetur puna dhe masat e marra nga Qeveria rreth financimit buxhetor, punë kjo të cilën e thekson edhe komunikata e FMN-së, sipas të cilës citoj: "Qeveria e Kosovës ka bërë hapa vendimtarë drejt qëndrueshmërisë fiskale dhe menaxhimit më të fortë në ekzekutimin e buxhetit". Menaxhimi i shëndoshë fiskal mund të hapë rrugë për ndihmën financiare nga FMN-ja, në vitin 2012 dhe për të lehtësuar vazhdimin e mbështetjes së donacioneve. Në komunikatë, tutje thuhet se politikat makroekonomike dhe financiare në Kosovë janë plotësisht në rrugën e duhur.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, ju ftoj që njëzëri ta përkrahim Projektbuxhetin për vitin 2012. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryesues,
Zoti kryeministër,

Unë do të flas për buxhetin, për kulturën dhe për një çështje të dytë. Për të folur për buxhetin dhe për t'u bërë më i besueshëm dhe më analitik, është mirë që të krahasohen secilën herë shumat që janë dhënë në këtë vit buxhetor, domethënë më 2011, me atë që propozohet për vitin 2012.

Për këtë vit, në buxhet kanë qenë paraparë investime kapitale për kulturë e trashëgimi kulturore 1.651.000 euro, përafërsisht, mundet që shifrat e dhjetëshet e fundit të mos jenë krejt të sigurta. Mirëpo, çfarë ka ndodhur? Asnjë nga këto të holla nuk janë investuar. Domethënë, investime kapitale ka pasur 0, bile me një vendim qeverie, që është i shtatorit, 27 shtator 2011, me kërkesë të Ministrisë për Financa, të gjitha këto të holla janë marrë dhe kanë hyrë në investime të tjera, nuk specifikohet kjo, po dihet se diku kanë shkuar. Domethënë, investimet e planifikuara kapitale për kulturë dhe trashëgiminë kulturore, të tërat kanë shkuar me kërkesën e Ministrisë të investimet tjera.

Unë po them, pse është keq? Është keq se edhe kështu këto investime janë kaq të vogla dhe në këtë mënyrë kaq shpejt, kaq të papritur, të fshihen, është punë që duhet të diskutohet. Subvencione për institucione të kulturës kanë qenë 1.083.000, këto janë shfrytëzuar, natyrisht, dhe s'kanë pasur si të mos shfrytëzohen, se të gjitha analizat e kërkesave dhe të shpërndarjeve tregojnë që kërkesat kanë qenë së paku të gjitha këtyre institucioneve, 3 herë më të mëdha, përafërsisht. Këtu kemi të bëjmë me QKK-në, domethënë Qendrën Kinematografike, Teatrin Kombëtar, Filarmoninë, Galerinë, Baletin, "Shotën" etj.

Çështja është që këto normalisht janë shfrytëzuar të gjithat, sepse mungojnë paratë në këtë lami, problemi është që nuk ka kurrfarë politikash të ndarjes së tyre, kështu që duke mos pasur politikat e deklaruara, kjo i mbetet gjithmonë asaj që quhet dëshirë ose arbitraritet i atij që vendos, në këtë rast, sigurisht që kreu është ministri dhe ata që janë pranë tij. Dhe, mendoj që meqë këto subvencione për institucione janë planifikuar tash për vitin 2012, me një shtesë prej 700.000 euro, mirë që është planifikuar një shtesë, të krijohen dhe të deklarohen politikat e harxhimeve nëpër institucione, sepse nëse s'ka politika të deklaruara, atëherë ne prapë mund të kemi të bëjmë me këtë që unë po e quaj arbitraritet, pa e specifikuar, të ndarjeve të këtyre të hollave nëpër institucione dhe kjo nuk është mirë të ndodhë kështu.

Me këtë planifikim sot për sot unë, meqë e njoh lëmin mirë, jam përpjekur të shoh kush çka merr, nuk dihet, domethënë nuk është e qartë. Kërkoj që gjatë këtij muaji apo sa diskutohet ky buxhet, me njerëzit e interesuar të lëmive të ndryshme, unë pres që do të diskutohet në këtë formë, të precizohen këto. Në anën tjetër, në investimet kapitale për kulturë në këtë vit, pra vitin që po vjen, kemi një zvogëlim për 150.000 euro. Tash, ju thoni, po, po, normalisht që zvogëlohen, se nëse krejt çka ka pasur i ka marrë, logjikisht që i zvogëlon për 150.000 për vitin tjetër dhe këtu është absurd i madh, a? Ato që janë deklaruar për këtë vit, nuk harxhohen, për vitin e ardhshëm zvogëlohen, domethënë këtu kemi të bëjmë me një problem të politikave kulturore në Kosovë dhe unë mendoj që kjo publikisht duhet të diskutohet shumë. Pse them kështu? Për shkak se kjo është një lëmi që financohet kaq pak te ne dhe me politika të gabuara, se është financim për mbijetesë, e kultura nuk krijohet me mbijetesë, sidomos niveli kulturor i kulturës përfaqësuese dhe

identitare, që i thonë elitare, sepse qeveritë kurrkund nuk kanë hesap dhe nuk duhet të financojnë kultura masive, po kultura të rëndësishë së veçantë dhe kur këto financohen, duhet të studiohen dhe të financohen dhe të deklarohen.

Gjithnjë duke u lidhur me këtë, unë mendoj që duhet institucionet nacionale të kenë përparësi të buxhetit dhe pavarësi, po të kenë mbikëqyrje nga Ministria, po kjo që të rregullohet, duhet të rishikohet Ligji për institucionet e kulturës, në mënyrë që programet artistike të krijohen nga profesionistët dhe të korrigjohen ose të mbikëqyren në kuptimin financiar nga Qeveria, për shkak se nëse nuk ndodh kjo, atëherë çdo qeveri që ndërrohet, kjo është veprimtari që nuk është për një vjet, nuk është për dy vjet, që lidhet me trashëgiminë dhe të ardhmen, është specifike.

Politikat e ministrave që vijnë dhe shkojnë, nëse intervenojmë me furtuna ndërrimesh, në emër të përkatësive politike apo çka po di unë, sepse ne kemi dëgjuar këto, thonë: “po bëjmë spastrime se ka pasur përfaqësime politike”. Kjo i bie që, meqë erdhëm ne, ata s’ishin si ne, ne po i heqim! Po e njëjta gjë ndodh mbas 2 vjetësh, 3 vjetësh, vjen tjetri dhe thotë: “ngadalë, se këta nuk janë si ne, po i heqim”. Kjo logjikë s’bën hiq, kjo është e gabueshme totalisht, sepse vlerat kulminante nuk përcaktohen në kulturë me filiacione politike apo me çka po di unë, sensibilitete politike, ato janë probleme individuale.

Kreativiteti dhe profesionalizmi nuk matet dhe nuk guxon të matet me kësi kriteresh. Sa më shumë që të largohen këto kritere, është më mirë për kulturën. Në mënyrë specifike unë duhet t’ju tregoj çka po mendoj, kulturë identitare, që do të duhej shteti ta financojë, s’e financojnë edhe në shtetet që kanë kulturë dhe veprimtari shumë më të forta.

Këtu kemi një çështje që quhet investim kapital dhe sillet nëpër programet e ministrive të kulturës që disa vjet. Është çështja e Shtëpisë së Operës dhe Baletit “Ibrahim Rugova”. Unë ju lus, këtë Qeveri tash edhe atë përpara, le të harrohen spektaklet se s’kanë kuptim! Ju e dini që bashkërisht kemi bërë një spektakël të hatashëm, të gjithë bashkarish, me kryetar shteti, me kryeministër edhe kemi shkuar për ta “rrëmih” që thonë, gurin e parë për ta qitur themelin. Kurr gjë nuk është bërë dhe shans nuk ka të bëhet, nëse prej vitit në vit qitet 1 milion strikt për atë shtëpi, dhe në fund, diku në gjysmë të vitit hiqet ai milion, qysh është shti sivjet, se normalisht që hiqet, se me 1 milion shans nuk ka të bëhet gjë në një investim të tillë.

Pra, të bëhemi konkret, a ka fuqi, a ka plan, a ka mjete dhe qysh e planifikon Qeveria që ta ndërtojë atë shtëpi kulturore ose heq dorë prej saj? Konsideroj që ky 1 milion është qesharak, qysh është dhënë, aq më tepër kur u mor ai 1 milion në shtator.

E dyta, është problemi i financimit të botimeve, të librave. Ajo qysh e bën Ministria deri tash, jo vetëm kjo në këtë vit, por edhe disa vite, është financim qesharak. Me 30.000 euro, Qeveria e Kosovës financon librat kapital, prej atyre shkencor e deri atyre kulturor, kjo s’ka kuptim, kjo s’thotë kurr gjë. Se me sheqerka, me 200-300 euro s’ka financim librash edhe ato financime që llogariten për shtyp, kompensohen me 100 kopje ose 150, që është i detyruar botuesi e autorit t’ia japë Ministrisë. Për më keq, shumica e këtyre

botimeve janë në bodrume, nuk janë në biblioteka dhe shkoni shihni! Edhe njëherë po them, s'ka të bëjë veç me këtë ministër, kjo ka të bëjë me ministrat që kanë qarkulluar aty. Domethënë, nuk ka të bëjë me Krasniqin, që është sot, po e keqja është që sistemi po vazhdon. Për botime kapitale duhet të bëhen politikat e botimeve kapitale dhe të investohen dhe shteti, bën vaki dhe është e sigurt që ka nevojë të bëjë botime kapitale dhe ato të shkojnë te gjithsecili interes, i gjithsecilës shtresë të lexuesve, prej universitetit deri në fillore.

Edhe, e treta, ka të bëjë me kinematografinë, është art i shtrenjtë ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, 2 minuta, lë ta përfundojë!

SABRI HAMITI: ... Puna e kinematografisë, me 400.000 euro s'ka kinematografi në Kosovë, se treg kinematografik nuk ka në Kosovë dhe kjo punë duhet të shqyrtohet mirë. Nuk ka, s'ka mundësi, nuk ndodh kjo.

Sa i përket, edhe një çështje e kisha, problemet që janë ndarë paratë me një rregull të atyre që quhen grante, sa i përket kategorive, mallrave dhe shërbimeve, unë duhet t'ju lexoj shpejt një listë për disa komuna për të parë që ka paragjykimet, sepse nën këtë kategori ju tregoj qysh ndodhet.

Më së liri, domethënë mesatarja e shpenzimit për një punëtor janë këto: Podujeva, Gjilani, Ferizaj, Vushtrria, Peja, Gjakova, Suhareka, Gllogoci, Skenderaj, Rahoveci, Graçanica, më së miri është Graçanica, që është 3 herë më shumë se Podujeva, që është më e ulëta, me 432, Peja është dyfish, 868, Graçanica është trefish 1141, mbasandej e dyta për kah niveli më i ulët i mesatares së shpenzimeve për një punëtor është Skenderaj.

E tash, le të mendohet realisht çka po ndodh? Më së keqi është Podujeva, e dyta Skenderaj, a? Se është bërë zakon që thuhet, po flas për kategorinë shërbime e mallra, buxheti 2012. Skenderajn, më duket, e udhëheq partia e zotit Thaçi, Podujevën e udhëheq partia e zotit Isa Mustafa, domethënë janë më së keqi, e studioni pse ndodh kjo? Graçanicën e udhëheq partia e SLS-së, është trefish dhe Pejën, Aleanca, që është dyfish. Faleminderit! Studioni pak shifrat.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Unë sot tek diskutimi i Projektbuxhetit për vitin 2012, do të përqendrohem tek investimet kapitale që parashihen me këtë projektbuxhet, e ku Qeveria flet për rritjen prej 5% dhe përpiket ta bazojë këtë në investimet kapitale në sektorin publik, që po nënkupton se zhvillimi vjen nga këto investime.

Trajtimi i këtij projektbuxheti, detyrimisht sjell në konkluzën se investimet kapitale sipas këtij projektbuxheti, nuk mund të sjellin zhvillim ekonomik, apo mund të sjellin të themi zhvillim ekonomik të ndonjë kompanie apo të dikujt personalisht, por jo të Kosovës. Këto investime nuk janë në funksion të zhvillimit ekonomik. Kur flasim për zhvillimin ekonomik, duhet ta kemi të qartë se infrastruktura është vetëm bartëse e zhvillimit ekonomik e posaçërisht kur kjo përqendrohet vetëm në një projekt, siç është autostrada.

Dhe, tek shpenzimet kapitale 240 milionë, nga 660 të parapara, shkojnë në autostradën Morinë-Merdare, për të cilën edhe shpenzimet madje janë tejet jo transparente. Nuk pati palë të tretë mbikëqyrëse në segmentin që posa u hap, pra paratë u paguan pa verifikim të sasisë së punës së kryer dhe në buxhet tek Raporti i shpenzimeve, janar-shator 2011, figuron vetëm si shpenzime për autostradë dhe edhe në Projektbuxhetin për 2012, milionat figurojnë vetëm si shpenzime për autostradë, pa detale shtesë.

Ne, pra, në njëfarë mënyre po paguajmë çëçe bllanko për punën që nuk pati kush ta verifikonte. Do të doja të them se që nga hapja e autostradës, unë personalisht isha dy herë në Tiranë, nëpër autostradën, pra, të qytetarëve e cila u pagua shumë shtrenjtë nga vetë paratë e qytetarëve të Kosovës.

Kjo autostradë në fillim u tha se do kushtonte 700 milionë dhe tani pas një viti e gjysmë, në projektimin për të ardhmen, parashihet të kushtojë 880 milionë dhe me këtë trend mund të ketë edhe rritje akoma. Pra, bëhet fjalë për 84 km, që i bie mbi 10 milionë euro për km. Do të duhej, ndoshta, kjo shifër, ky raport, të krahasohej me autostradën në Shqipëri, duke i pasur parasysh terrenin, tunelet dhe duke e krahasuar me terrenin që është në Kosovë.

Kur bëhet fjalë për investime në energji, ta marrim si shembull, rrjetin energjetik, ku nevojiten rreth 250 milionë dhe investim ky që do të sillte jashtëzakonisht përfitime, Qeveria shpeshherë për këtë është arsyetuar se nuk do të mund t'i gjente paratë, ndërsa kur bëhet fjalë për milionat për autostradën, e cila pakrahasimisht sjell më pak zhvillime, për këtë gjenden, natyrisht. Potencialet fitimprurëse si duket këtu nuk shihen si mundësi, ato madje planifikohen edhe të shiten dhe kur bëhet fjalë për PTK-n e që është shumë më pak sjell fitime, do të mund të sillte se sa rrjeti energjetik, parashihet të shitet Telekom, që është fitimprurës dhe jo Posta, e cila punon me humbje. Kjo nuk është logjikë e zhvillimit ekonomik.

Që të mund të themi se investimet kapitale janë në funksion të zhvillimit ekonomik, do të duhet të shohim se si janë shpërndarë këto investime dhe në çfarë fusha? Tek arsimi, ta zëmë shpenzimet kapitale janë të orientuara kah ndërtimi i shkollave dhe atë këto projekte barten vit pas viti, nga viti 2011 dhe nga viti 2010. Dhe, nuk parashihet, pra ndonjë investim tjetër dhe duke qenë pra shumë të vetëdijshëm nga ajo që shohim deri tash, bie se ndërtimi i shkollave nuk e ka dëshmuar rritjen e cilësisë në arsim. Ngjashëm, pothuaj në gjitha projektet kapitale të ministrive të tjera, janë orientimet kah ndërtimi, pra orientimi i investimeve kapitale është kryesisht në ndërtim.

Kjo tregon se mungon vizioni i zhvillimit real të vendit e që zhvillim real do të nënkuptonim prodhim dhe të ardhura nga prodhimi dhe investime për hapje të vendeve të reja të punës, ndërsa kjo logjikë kështu më lehtë do të dyshojë, madje se kur bëhet fjalë për ndërtimin, është ideja gjithmonë që aty është më lehtë të ketë korrupsion.

Një dukuri tjetër që vërejmë tek shpenzimet kapitale është bartja e projekteve që vijnë nga viti në vit dhe ajo më e keqja është bartja e parave nga viti në vit. Paratë barten nga viti në vit dhe kur i bëjmë një analizë raportit të shpenzimeve për muajin janar-shtator të këtij viti, pra raportit 9 mujor, shohim se diku janë 64% të parave të shpenzuara. Nëse kësaj ia heqim autostradën, pasi autostrada deri në shtator ka realizuar 85%, i bie se 47% të parave të shpenzuara janë shpenzuar nga mjetet e alokuara, pra vetëm 47% deri në shtator.

Dhe, nëse e shohim se ky trend do të mund të vazhdojë kështu deri në fund të vitit, mund të mbërrijë eventualisht deri në 62 a 65%. E pjesa tjetër, çka ndodh, bartet në buxhetin e vitit 2012? Ngjashëm ka ndodhur edhe më herët në vitet tjera. Kur t'i bëjmë analizë tash kësaj se çka është shpenzuar e çka jo, i bie që paratë e alokuara për ndërtim, shpenzohen shumë më tepër se sa paratë e alokuara në sferat tjera. Çdo vit kemi bartje të parave në sfera të rëndësishme, por që nuk janë në ndërtim dhe ato nuk shpenzohen, nuk arrijnë të shpenzohen dhe kur bëhet fjalë për ndërtim, atëherë ato arrijnë të shpenzohen skajshmërisht dhe vitin tjetër shtohen të tjera.

Zotërinj, nuk ka zhvillim vetëm me ndërtim, vetëm me asfalt e beton nuk vjen zhvillimi. Më konkretisht, kur shikojmë me radhë dhe i trajtojmë veç e veç, arrijmë të vërejmë, p.sh. tek Zyra e Kryeministrit shpenzimet kapitale për Agjencionin e Ushqimit dhe të Veterinës, janë shpenzuar vetëm 11% dhe këto mjete tash sigurisht barten në vitin 2012, meqë parashihet prapë që të ketë mjete për AUVK-n që është. Pra, u investua dhe nuk u punua që të zhvillohet ky agjencion, e ky agjencion është ai i cili duhet ta kontrollojë mishin e importuar nga Brazili dhe ushqimet e ndryshme që futen në vendin tonë e që cilësia dhe prejdardhja e tyre është tejet e dyshimtë dhe kështu kjo bartje vazhdon vit pas viti. Kur shohim tek Ministria e Financave e kemi një realizim prej 90% dhe këtë realizim prej 90% e keni për shkak se në kuadër të Ministrisë së Financave, është projekti për autostradën një pjesë që ia ka arritur të realizohet 99% dhe kur e heqim këtë 99% në këtë projekt nga buxheti i Ministrisë së Financave, arrin komplet shpenzimet nga kjo ministri deri në 53%, jo më tepër.

Tek Ministria e Bujqësisë, që është tejet me rëndësi, janë shpenzuar vetëm 28%. Tek projekti i ujitjes, projekt ky që është tejet i rëndësishëm për zhvillimin e vendit, janë vetëm 30%. E kur bëhet fjalë për projektin e pyllëzimit, paratë e shpenzuara në vitin 2011 janë 0 % dhe ky projekt bartet nga viti në vit, në ndërkohë që shpyllëzimi i vendit, shpyllëzimi është në gjendje tejet alarmante, natyra po degradohet, druri pritët, shitet pa kontroll dhe nuk ka fare proces të pyllëzimit. Po të ishin pyjet nga betoni, sigurisht se do të kishim përparime në këtë aspekt. Dhe, kur flasim për Ministrinë e Infrastrukturës, natyrisht që kemi realizime të mëdha, këtu i kemi 84% deri në shtator. Dhe të mos harrojmë se 1/15 e këtij buxheti shkon në rrugët tjera, përpos projektit të autostradës dhe kjo po i bankroton ndërmarrjet vendore të ndërtimit.

I tërë buxheti orientohet në ndërtim dhe nga ana tjetër po na bankrotojnë ndërmarrjet e ndërtimit. Kjo ndodh për shkak se ndërmarrjet tona të ndërtimit janë vetëm spektatore në punë ndërtimore që bëhen në Kosovë.

Te Ministria e Arsimit dhe e Shëndetësisë, një pjesë e madhe e shpenzimeve kapitale janë në fakt shpenzime të bartura nga viti 2011, ku te shëndetësia shpenzimet nga investimet kapitale janë shpenzuar 55% dhe kur bëhet fjalë për Ministrinë e Arsimit, këtu janë 65%, natyrisht, sepse këtu kemi më shumë ndërtime.

Te Ministria e Kulturës kemi një dukuri interesante. Edhe në buxhetin e vitit 2011 edhe po në këtë projektbuxhet, raporti i mjeteve të ndara në lëmin e sportit dhe atë të kulturës, është raport 5:2, në favor të sportit. Pra, këtë vit për kulturën janë ndarë 2 milionë 900 mijë euro dhe për sportin 7.5 milionë, kur pas një analize të thjeshtë, ne mund ta vërejmë se tek sporti, kryesisht kemi të bëjmë me ndërtimin e palestrave, pra prapë kemi të bëjmë me ndërtime.

Dhe, kur e shikon se sa janë shpenzuar paratë, prapë e kupton që në aspektin e sportit janë shpenzuar mbi 60% dhe kur vjen fjala te kultura që janë dhënë në start para më pak, ato para nuk shpenzohen as 40% dhe çka ndodh, në vitin tjetër këto prapë përsëriten dhe barten në buxhetin e vitit tjetër dhe ato figurojnë në projektbuxhet?

Tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kemi realizim vetëm 21% deri në shtator, e ndërsa tek Ministria e Mjedisit, cilido mund të mendojë se tani kemi rritje jashtëzakonisht të madhe, pasi që kemi tani 58 milion e 768 mijë vetëm për projektin e këtij viti, pa i marrë parasysh projektet e vitit të kaluar, që në këtë aspekt kur e krahason me buxhetin e vitit të kaluar e kemi 4 milionë e 300 mijë dhe kur e shohim më mirë i bie që 56 milionë nga këto, nga ky buxhet, kanë të bëjnë me shpronësimin e që në fakt për mjedisin i bie që për këtë vit si investime kapitale janë paraparë vetëm 2 milionë e 765 mijë si projekte të reja, pa i marrë parasysh ato, pa i shtuar projektet që vijnë nga viti i kaluar. Pra, edhe më tej shohim se nuk ka përkujdesje për ambientin, përderisa eksploatimi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Le t'i japë ndonjë koleg yti 2 minuta huazim, regjia!

LIBURN ALIU: Dhe, kur e vështrojmë pasqyrën e shpenzimeve, tash te mjedisi e shohim se kur bëhet fjalë për krijimin e rrjetit të kontrollimit të cilësisë së ajrit, shpenzimet janë 0%. Po ashtu, edhe tek digjitalizimi i kadastrës shpenzimet janë 0 dhe ngjashëm shkon edhe nëpër të gjitha ministritë e komunat tjera, të cilat kryesisht diku më shumë e diku më pak, në mesatare nuk arrijnë të kalojnë 50%.

Në qendër të këtij projektbuxheti, në fakt ...politikës buxhetore të deritanishme, nuk është zhvillimi ekonomik, nuk është në fakt qytetari, por është më shumë degradimi ekonomik dhe është më tepër varfërimi dhe shitja. Por, sa i përket buxhetit alternativ nga

LDK-ja, do të doja vetëm, nuk do të dua të paragjykoj, do të donim shumë që ta kishim, ta lexonim që të mund të jepnim edhe komentet, pra kishim dashur që para një jave të jetë ai projektbuxhet që të mund të flasim. Mirëpo e kam një vërejtje, meqenëse dje nëpërmes mediave dëgjua, që një ndër idetë është zvogëlimi apo ngadalësimi i punëve në autostradë, do të doja ta keni parasysh se çka nënshkruan Qeveria, çfarë kontratash nënshkruan Qeveria dhe si mund ato nënshkrime të Qeverisë ta pasojnë dhe ta afektojnë buxhetin, meqenëse kur bëhet fjalë për autostradën nuk mund të ngadalësohet dhe as nuk mund të shtyhet, sepse e vetmja mundësi për ndërprerje të kontratës është kur ajo tejkalohet 120% për segmentin e caktuar paraprak?

Pra, po që se e ngadalëson, pasojnë penalltitë me kontratë. Prandaj, ju kisha lutur para se të dilni me qëndrim të tillë, shikojeni fillimisht kontratën dhe e shihni që është një gjë e tillë e pamundshme dhe duhet të jemi të gjithë të vetëdijshëm për pasojat dhe atë anën e tmerrshme të nënshkrimit të kësaj kontrate. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Kryeministri e ka kërkuar fjalën, për një sqarim, pas tij është pauza deri në orën 14: 30.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit!

I nderuari kryesues,

Desha të ndërlidhem me diskutimet këtu që u ngritën, në veçanti sa i përket dy qasjeve për autostradë, duke e falënderuar secilin prej juve për diskutimet tuaja korrekte dhe të përgjegjshme dhe në të njëjtën kohë të respektimit të opinioneve prej kujtdo që u paraqitën.

Ne të gjithë ishim dëshmitarë të përmbylljes së punimeve të 38 km të parë, javën e kaluar, të autostradës Vërmicë në drejtim të Merdares. Tani kemi opinionin për ngadalësimin e punimeve në autostradë dhe opinionin tjetër të ndërprerjes së punimeve. Unë dëshiroj të theksoj se nuk do të ndodhë as njëra e as tjetra, as ngadalësimi e as ndërprerja e punimeve me arsyetimin se me ndërtim nuk ka zhvillim dhe me pretendimin tjetër se duhet të shpërndahen mjetet në drejtime tjera ndërtuese dhe zhvilluese.

Pra, Qeveria e Kosovës ka menduar, mendon dhe është e vendosur në respektimin dhe implementimin e vendimeve të veta që janë në shërbim dhe interesin, por dhe vullnetin e gjithë qytetarëve të vendit. Ne besojmë fuqishëm se autostrada është: shpresë, optimizëm, besim, zhvillim, humanizëm i natyrës, por edhe emancipim i shtetit dhe qytetarëve të Kosovës, projekti i munguar i qytetarëve, prandaj e theksoj fuqishëm se vazhdimi me intensitetin e planifikuar të ndërtimit të Autostradës “Ibrahim Rugova” është zhvillim dhe unë e theksoj se vetëm duke ndërtuar, nuk është problemi këtu i betonit apo i asfaltit apo i pllakave, apo i kulmeve, apo i gurëthemeleve, por thjesht vetëm me ndërtimin e autostradave, Kosova do të ketë zhvillim të projekteve tilla moderne, flas.

Ne jemi në fazën finale të shqyrtimit të gjitha modeleve për financimin e autostradës tjetër Prishtinë-Ferizaj-Kaçanik-Hani i Elezit, prandaj do të vazhdojmë me intensitetin e planifikuar të ndërtimit të autostradës Vërmicë-Prizren-Suharekë në drejtim të Orllatit, Prishtinës dhe Merdarit. E theksoj edhe njëherë se nëse dikush mendon se nuk ka

zhvillim me ndërtimin e autostradave, unë potencoj se edhe me logjikën e shtigjeve të dhive nuk ka zhvillim Republika e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Hamza, 2 minuta.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryesues!

Kam qëllimin që t'i jap sqarimet për dy çështje që u ngritën, e para që ka të bëjë me ndarjen e mallrave, shërbimeve nëpër komuna. Unë e theksova edhe më herët që formulat për ndarjen e granteve janë formula të cilat janë vendosur në vitin 2001. I kemi 3 grante: grantin e përgjithshëm, grantin specifik të arsimit dhe grantin specifik të shëndetësisë dhe si kriter i formulave kemi: numrin e popullsisë, territorin, nxënësit etj. nuk është kriter numri i të punësuarve në një organizatë buxhetore për ndarjen e buxhetit.

Ne në këtë vit kemi reflektuar fleksibilitet dhe ju kemi dhënë fleksibilitet më të madh komunave sa i përket strukturën e buxhetit. Jemi tu diskutuar dhe tu punuar që në të ardhmen sidomos sa i përket të hyrave vetjake të secilës komunë, komunat e kanë autoritetin e vendosjes për shfrytëzimin e buxhetit të tyre edhe për strukturën e buxhetit sa i përket të hyrës vetjake, a vendosin ata për të shpenzuar për mallra, shërbime më shumë, për investime kapitale, për rini, për sport e kulturë është e drejtë e tyre.

Dhe, çështja tjetër që u ngrit, Kosova ka arritur ditëve të fundit që buxhetin ta ekzekutojë në masë mbi 90%. Ligji për buxhetin nuk lejon bartjen e mjeteve buxhetore nga viti në vitin vijues, në përjashtim të hyrave vetjake të komunave dhe deri në këtë vit të hyrës vetjake të nivelit qendror. Prandaj, nuk ka mundësi që të barten projektet dhe shumat e projekteve nga këtë vit në vitin e ardhshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Replikë, Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Unë nuk mbaj përgjegjësi për imagjinatën e kryeministrit që kufizohet tek figura e dhisë, por për sa i përket autostradës edhe infrastruktura në përgjithësi është bartëse e zhvillimit ekonomik. Këtë e them shumë qartë, natyrisht se përmes saj vjen edhe zhvillimi, por investimet kapitale mund të sjellin zhvillim kur ato orientohen drejt në pikat të cilat hapin vende pune dhe vijnë të sjellin fitime të drejtpërdrejta.

Ne, aso mundësi në Kosovë kemi jashtëzakonisht shumë dhe mendoj se buxheti i Kosovës, me orientim, ka shumë pika që mund të sjellin vende të lira pune, fitim dhe prodhim, është shumë ma i leverdishëm dhe shumë më tepër sjell zhvillimin se sa orientimi vetëm në autostradë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Kryeministri, kundër replikë.

HASHIM THAÇI: Unë desha vetëm një sqarim për ju Liburn. Të lutem, tash është edhe aspekti profesional i diskutimeve për autostradë të cilat edhe ju edhe unë kemi nevojë

t'i dëgjojmë më tepër ekspertët se sa vetëm qëndrime politike, por unë ju pyes juve personalisht- cili projekt ka hapur më shumë vende pune se sa projekti i autostradës në Kosovën prej pas luftës? 2700 punëtorë lokalë kanë punuar, 3800 të gjithë. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Pauzë! Deri në orën 15:00.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë, po vazhdojmë me seancën! Të lajmëruar për diskutim i kemi 53 deputetë!

Nëse përpiqeni t'i reduktoni ju vetë, jo unë, atëherë përpiquni pak më shumë t'i shkurtoni sa të mundeni debatet. Atëherë, po vazhdojmë! Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Si edhe herëve tjera, Projektbuxheti i hartuar nuk korrespondon me nxitje të zhvillimit ekonomik. Në tabelat buxhetore më shumë se 660 milionë euro janë ndarë për shpenzime kapitale, ku gati gjysma e kësaj shume do të shkojë për qëllim të vazhimit të ndërtimit të autostradës Vërmicë-Merdare.

Hartimi i Projektbuxhetit në këtë mënyrë, si dokument legal nga më të rëndësishmit për një shtet, mund të ndikojë shumë negativisht në stabilitetin ekonomik dhe mund të ketë pasoja jashtëzakonisht të mëdha për vitet në vazhdim.

Shpenzimet e këtij projektbuxheti nuk garantojnë as zhvillim e as mirëqenie sociale pasi që indeksi i rritjes së çmimeve është më i lartë se sa rritja nominale.

Jemi të pakënaqur edhe me shpërndarjen e investimeve kapitale nëpër sektorë të ndryshëm dhe komuna, shpërndarje në nivelin qendror dhe lokal.

Prapë, përkundër rritjes së buxhetit për shëndetësi, kjo rritje për 8 milionë nuk është e mjaftueshme për nxjerrjen e shëndetësisë prej kolapsit ku është. Nga kjo rritje nuk janë llogaritur edhe 10 milionë që nevojiten për implementimin e Ligjit të shëndetësisë dhe Ligjit të sigurimeve shëndetësore, ligje këto që po sillen nëpër Qeveri e ende s'janë sjellë në Kuvend, edhe pse në planin legjislativ është dashur të vijë për amendamentim qysh në qershor. Atëherë, ku ka rritje të këtij buxheti të shëndetësisë, nëse vlera prej 10 milionë shkon për këto dy projektligje.

Ky sektor, përpos buxhetit të vogël, po ballafaqohet edhe me keqmenaxhim të këtij buxheti, që po ndikon direkt në mirëqenien sociale e shëndetësore të qytetarëve të Kosovës.

Edhe pse për barna nga lista esenciale ndahen rreth 20 milionë, kjo shumë e madhe e parave, prapë institucionet shëndetësore nuk janë të furnizuara me barna dhe qytetarët janë të detyruar që këto barna t'i blejnë vetë, përkundër kushteve të rënda ekonomike.

Tjetër dukuri, është se ka mospërputhje nga lista e kërkesës për barna nga institucionet dhe lista e furnizimit nga Ministria e Shëndetësisë. Në gjithë botën, secila kompani farmaceutike, kur barnave iu ofrohet afati i skadencës në 6 muaj këto barna jepen si donacion nëpër institucione shëndetësore, ndërsa tek ne këto barna blihen nga Ministria e Shëndetësisë dhe si pasojë kemi grumbullimin e 200 tonë barnave me afat të skaduar. Kjo i kushton buxhetit të Ministrisë, sepse për këto barna paguhet shtrenjtë depoja ku qëndrojnë. Dhe tash kontraktimi i kompanisë për eliminimin e barnave me afat të skaduar është shpenzim shtesë dhe shumë i panevojshëm. Nëse do të ishte bërë menaxhimi i mirë i barnave ekzistuese, duke përcjellë afatin e skadencës dhe shpërndarjen nëpër njësi pa iu skaduar afati.

Për shkak të kësaj dukurie korruptive dhe keqmenaxhuese në Qendrën Klinike Universitare nga inspektorët farmaceutikë dhe shëndetësorë gjenden me afat të skaduar filma për incizim të CT-së dhe stenda për intervenime kardio-kirurgjike, intervenime këto që kushtojnë mjaft. E kush po pëson nga këto parregullsi? Qytetari i Kosovës, sepse askush nuk po ndëshkohet për veprime të cilat Kosovës po i kushtojnë me miliona.

Projektbuxhetin e vitit 2012 e quajmë buxhet të varfërisë, shpenzues dhe jo krijues. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!
Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli!

AURORA BAKALLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,

Si duket, iu paska ardhur radha diskutimeve për shëndetësi. Edhe unë në diskutimin tim do të përqendrohem për buxhetin që është ndarë për Ministrinë e Shëndetësisë dhe në fakt Ministria e Shëndetësisë këtë vit do të përfitojë rreth 9,5 milionë më shumë se sa në vitin që po e përfundojmë nga buxheti i gjithmbarshëm i Qeverisë së Kosovës.

Në vitin 2011 janë ndarë 5.5% nga buxheti i gjithmbarshëm për shëndetësinë, ndërkaq shuma e vitit që do të vjen, nëse shndërrohet në përqindje është 5.8% për Ministrinë e Shëndetësisë.

Kësaj përqindjeje, edhe nëse i shtohen grantet komunale për shëndetësi, vazhdon prapë të jetë më e vogla në rajon, jo vetëm për nga sasia që është e pa diskutueshme, por gjithashtu edhe për nga përqindja.

Vendet e rajonit, siç janë Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia ndajnë rreth 14% nga buxheti i tyre i gjithmbarshëm për shëndetësinë dhe këtë bazuar në

statistikat botërore të shëndetësisë për vitin 2011, dokument ky që lëshohet për çdo vit nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Në debatin e kaluar që kemi pasur për buxhetin e vitit 2011, ne si opozitë deklaruar se shuma e ndarë për sektorin e shëndetësisë është e vogël për të siguruar një shëndetësi cilësore, sidomos në sektorin publik. Ndërkaq, Ministri i Shëndetësisë ndër të tjera na pati thënë, po citoj: “Tani është koha e të menduarit ndryshe, pra koha e të menduarit për një shëndetësi moderne e cila do të bazohet në parimet e ekonomisë së tregut e jo në modele të centralizuara të financimit nga buxheti qendror”.

Ndërkaq, duke u referuar serish në statistikat botërore të shëndetësisë 2011, dëshiroj t’ju prezantoj disa shifra që demonstrojnë se sa investojnë në shëndetësi qeveritë e disa nga vendet më të zhvilluara të botës, domethënë që ndjekin parimin e ekonomisë së tregut.

Kështu, për shembull, Qeveria e Zvicrës ndanë 19.9% nga buxheti i gjithmbarshëm për shëndetësinë, ajo e SHBA-ve 18.7%, e Gjermanisë 18%, Japonisë 17.9%, Kanadasë 17.2%, Australisë 17.1% e kështu me radhë. Pra, derisa edhe Qeveria jonë nuk e trajton shëndetësinë me seriozitet, nuk mendoj se duhet të kemi ndonjë iluzion ne si punëtorë shëndetësorë apo edhe popullata se mund të synojmë për një shëndetësi moderne.

Duke i përcjellë rezultatet në sektorin e shëndetësisë gjatë këtyre tetë muajve të fundit, e në veçanti mungesën e madhe të barërave dhe materialit shpenzues nga listat esenciale, në sektorin publik të shëndetësisë shihet qartë se kjo ministri nuk ka arritur të bëjë një menaxhim të duhur të buxhetit që ka pasur apo mbase ka qenë i pamjaftueshëm.

Nëse analizohen zërat buxhetorë për sektorin e shëndetësisë në Projektbuxhetin e vitit 2012, nuk vërehet ndonjë ndryshim nga ndarjet e mëhershme. Investime diçka më të mëdha shihen në shpenzimet kapitale, por edhe këto janë më të vogla se sa ato që janë paraparë me Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2012-2014.

Kjo ndarje buxhetore na le të kuptojmë se edhe për vitin që po vjen nuk ka hapësirë për shpresë në sektorin e shëndetësisë.

T’ju rikujtoj se edhe Komisioni Evropian në Raportin e Progresit ka shpreh shqetësimin se sasia e vogël e buxhetit, e ndarë për shëndetësinë, është e pamjaftueshme për t’i arritur apo për t’i adresuar sfidat e shumta në këtë sektor dhe për ta zhvilluar atë. Për shembull, këtu theksohet se nuk investohet asgjë për ruajtjen e shëndetit të nënës dhe fëmijës.

Duke pasur për bazë gjendjen shumë të rëndë në sektorin e shëndetësisë dhe duke mos harruar faktin se rreth 15% të popullatës sonë jetojnë në varfëri të skajshme, konsiderojmë se Qeveria e vendit tonë dhe Ministria e Shëndetësisë në veçanti duhet të angazhohen seriozisht për mëkëmbjen e sistemit publik shëndetësor.

Për më tepër, vetëm një sistem i mirëfilltë publik shëndetësor do të ishte i denjë për të hyrë në konkurrencën e ekonomisë së tregut, përndryshe sistemi publik do të shkojë drejt rrënimit të rëndësishëm.

Ne si Lëvizje për Bashkim i rekomandojmë Qeverisë që të ndjekë të paktën shembujt e vendeve në rajon, nëse jo të vendeve të zhvilluara të cilat i përmenda më herët dhe të investojë minimumin prej 10% nga buxheti i gjithmbarshëm për Ministrinë e Shëndetësisë. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Kurtan Kajtazi!

KURTAN KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Projektbuxheti për vitin 2012, për të cilin po diskutojmë sot, karakterizohet me disa elemente kryesore. Në diskutimin tim do të fokusohem në disa prej tyre.

Në radhë të parë, Qeveria e ka respektuar në tërësi procedurën dhe afatet ligjore, duke dorëzuar atë me kohë në Parlament. Gjithashtu, procesi përgatitor për përgatitjen e Projektbuxhetit për vitin 2012 është zhvilluar në harmoni, ashtu siç parashihet edhe në nenin 20 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.

Janë zhvilluar dëgjime të rregullta buxhetore dhe janë bashkërenditur kërkesat e të gjitha organizatave buxhetore në përputhje me prioritetet zhvillimore.

Në këtë drejtim Projektbuxheti që po e diskutojmë sot iu përgjigjet saktësisht kërkesave të përcaktuara me nenin 21 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike.

Mendoj se organi më i lartë legjislativ duhet t'i vlerësojë këto dy aspekte dhe në këtë drejtim të përgëzojë ministrin e Financave për punën e mbarë që e ka bërë.

Në planin e përgjithshëm të konstatoj se politika, përkatësisht buxheti është në përputhje me Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2012-2014, si dhe me planin ekonomik të Qeverisë së Kosovës dhe në këtë drejtim ai reflekton dhe adreson prioritetet kryesore të Qeverisë për vitin fiskal 2012, të shprehur edhe në dokumente tjera të Qeverisë.

Nga analiza që mund t'i bëhet dokumentit vërehet qartë se posaçërisht i është kushtuar kujdes i veçantë, në njërën anë, ruajtjes së qëndrueshmërisë makro-fiskale dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, në anën tjetër.

Krahas këtyre dy orientimeve bazike, Projektbuxheti përfshin edhe adresimin dhe plotësimin e nevojave sociale për kategori më të rrezikuara të shoqërisë.

Dëshiroj që ta theksoj edhe një cilësi tjetër të buxhetit, i cili e bën atë real, e kjo ka të bëjë me planifikimin e matur të shpenzimeve për vitin 2012 në raport me të hyrat e parashikuara, si dhe shpërndarjen efikase të hyrave nëpër kategori të caktuara buxhetore. Ky është kusht i domosdoshëm për secilin buxhet që pretendon të merret me sfidat e përgjithshme të vendit.

Konsideroj se është e arritur shumë e madhe që hartimi i buxhetit është harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar sepse, siç dihet, gjatë kohëve të fundit ka pasur shumë zëra që kanë thënë se marrëdhëniet e Kosovës me FMN-në kanë marrë fund. Vetë ky fakt, po edhe komunikata e fundit e misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, që sapo ka përfunduar vizitën në Kosovë, e cila përmendet taksativisht për përmbushjen e marrëveshjes nga ana e Kosovës, tregon se udhëheqja e politikave makro-ekonomike në vend është në drejtim të duhur. Ky fakt hap rrugën edhe drejt marrëveshjes së re e cila ka të bëjë me Fondin Monetar Ndërkombëtar në vitin 2012.

Është me rëndësi që të përmenden edhe kategoritë kryesore buxhetore të cilat shihen se kanë shënuar rritje kualitative në krahasim me vitin 2011. Kështu, Projektbuxheti i rregullt për vitin 2012 në total paraqet një rritje prej rreth 7.6% krahasuar me buxhetin e projektuar për vitin 2011 dhe ky është një trend shumë inkurajues, sidomos duke marrë parasysh rrethanat ekonomike e financiare globale.

Të hyrat buxhetore për vitin 2012 planifikohen që të arrijnë në 1 miliard e 361 milionë dhe kjo paraqet rreth 4% më shumë se të hyrat për vitin 2011. Nga kjo, doganat pritet që të arkëtojnë rreth 86 milionë, ndërsa të hyrat nga administrata tatimore pritet të jenë mbi 285 milionë euro. Që të dy këta indikatorë tregojnë se kemi të bëjmë me një rritje të punës edhe te organet e rëndësishme shtetërore, që në mënyrë direkte tregon edhe për luftën e evazionit fiskal dhe të informalitetit në ekonomi.

Sa u përket shpenzimeve, ka rritje në të gjitha kategoritë buxhetore. Kështu, shpenzimet kapitale janë paraparë të jenë rreth 616 milionë, shumë që paraqet një ngritje prej 15% në krahasim me vitin 2011. Shpenzimet për paga dhe mëditje janë planifikuar në 407 milionë euro dhe kjo paraqet një ngritje prej 5.5% në krahasim me vitin 2011 dhe shpenzimet buxhetore të parapara për subvencione e transfere arrijnë shumën 284 milionë, shumë kjo më e lartë se në vitin 2011 për 4.4%. Edhe shpenzimet për mallra e shërbime në vitin 2012 janë planifikuar që të jenë më të larta se ato në vitin 2012.

Duke pasur parasysh këto fakte, deputetë të nderuar, konsideroj se ky projektbuxhet për vitin 2012 është në funksion të plotë të zhvillimit të gjithmbarshëm të vendit dhe si të tillë ju ftoj që ta votojmë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Duhet ta nis fjalimin tim nga përshkrimi dhe prezantimi se si u bë buxheti i Kosovës nga ana e Qeverisë.

Sot ministri e krahasoi rritjen ekonomike me vendet e rajonit dhe u mundua të na e mbush mendjen që ne jemi më së miri në rajon. Edhe ne arritjen ekonomike prej 5.3 nuk e kemi kontestuar asnjëherë. Ne kemi thënë që rritja ekonomike po na vjen kryesisht prej sektorit publik, por ministri për të qenë i saktë duhet të tregojë se çfarë bruto produkti

vendor kanë, çfarë baze do të thotë vendet me të cilat na krahason, sepse nuk krahasohet. Ne e kemi një bazë shumë të ulët. Dhe, edhe nëse rriten për 5% 100 euro, është 5 euro. E nëse rriten 2% 1.000 euro, është 20 euro, kështu që nuk ia vlen të lavdërohet.

Mirëpo, për ta kompletuar krejt këtë filozofinë e krahasimit me vendet e rajonit, ministri harroi të thotë edhe diçka, se Kosova e zë vendin e parë në rajon edhe për korrupsion, edhe për biznesin më të pafavorshëm, edhe për mungesën e lirisë së mediave, edhe jemi vendi i tretë në botë për nga numri i azil-kërkuesve. Të gjitha këto kanë lidhje me buxhetin sepse, nëse nuk kemi biznes të favorshëm, normalisht se kemi një zhvillim ekonomik të ulët. Perceptioni për korrupsionin është i madh dhe kjo po ndikon shumë negativisht, sidomos në tërheqjen e investimeve të huaja. Liria e mediave është e lidhur me mungesën e transparencës me shpenzimin e parasë publike. Numri azil-kërkuesve të Kosovës, që e zë vendin e tretë, tregon se sa i mirë është kualiteti i jetës në Kosovë.

Ministri, gjithashtu, mu duktë që u nxitua duke e komentuar alternativën buxhetore që e ka dhënë Lidhja Demokratike e Kosovës, sepse nuk ia vlen të shikohen vetëm të hyrat dhe të dalat dhe të komentohen ato. Normalisht, ne nuk kemi qenë në institucione dhe ka qenë e pamundshme për t'i ndjekur të gjitha procedurat që i ka pasur Ministria. Gjithashtu, ne nuk e dimë çfarë marrëveshje të re ka Ministria me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe kështu nuk e kemi pasur shansin të harmonizohemi. Bile, ky harmonizimi me Fondin Monetar Ndërkombëtar aq shumë u përmend, sa që nganjëherë kisha përshtypjen që qytetarët kur ta dëgjojnë në televizion, do të mendojnë që ky qenka buxhet i FMN-së e jo buxhet i Ministrisë së Financave.

Në seancën e marsit të po këtij viti, LDK-ja e ka ngritur zërin dhe ka thënë që buxheti i vitit 2011 nuk do të mund të realizojë 167 milionë prej Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore, Komisionit Evropian dhe 300 milionë nga shitja e PTK-së. Të gjitha këto ndodhën. Dhe, Ministria në vend që të nxjerrë mësim nga kjo, ajo po lavdërohet që - unë edhe i humba paratë, edhe nuk e shita PTK-në, mirëpo nuk po falimentoj. Mirëpo, çka po harron t'u tregojë qytetarëve? Po harron t'iu thotë se i kam shkurtuar shpenzimet kapitale, kam 32 milionë fatura të pa paguara në sirtarë, po bëj shumë lojëra me numra, po fshihem pas numrave, po barti me dhjetëra projekte që është dashur të kryhen, po e përmendi, jo projekte në vazhdim, por projekte të bartura të cilat fazën e fundi e kanë pasur që të implementohen qoftë në vitin 2010, qoftë vitin 2011 dhe tash i kemi të buxhetuara në vitin 2012 dhe e kam një listë të projekteve të tilla.

Aq shumë ka pasur shpërputhje buxheti i vitit 2011, domethënë buxheti faktik që e kemi tani, me buxhetin e aprovuar, në mars që e kemi aprovuar, sa që ligjet e buxhetit, epiteti buxhet i ka humbur kaheerë. Kjo mund të shihet duke parë tabelën 1 të buxhetit dhe të krahasohen të dhënat e projektuara me të dhënat faktike të buxhetit 2011, dhe këtë mund ta shohin të gjithë. Kjo na ka sjellë në një situatë, ku shumica e projekteve në këtë vit janë projekte të bartura. E theksojmë, projekte të bartura, jo projekte në vazhdim. Këto projekte është dashur të kryhen qoftë në vitin 2010, qoftë në vitin 2011, sepse e kemi analizuar me kujdes edhe buxhetin e vitit 2010, edhe buxhetin e vitit 2011.

Ne vlerësojmë në këtë vit se edhe ky buxhet i ka të njëjtat probleme strukturore. E ka deficitin 3.5%. Prapë ka të buxhetuara 300 milionë nga shitja e PTK-së pa ndonjë beneficion ekonomik, mirëpo do ta rrisë rezervën. Po e shet PTK-në, po humb 60 milionë dividendë dhe paratë thotë - dua t'i mbaj në rezervë, për ta rritur rezervën buxhetore.

Ky buxhet për shumë arsye është, do të thotë, peng i politikave dhe vendimeve e premtimeve të pa baza dhe të gabuara elektorale. Nuk kemi qenë asnjëherë kundër rritjes së pagave, mirëpo e kemi ditur se me rritjen e pagave do të vjen deri te prishja e marrëdhënies me FMN-në. Edhe vitin e kaluar e kemi dëgjuar shumë herë, në fakt jo vitin e kaluar por gjatë këtij viti, se në mars e kemi aprovuar buxhetin e vitit 2011, që nuk do të prishet marrëdhënia me FMN-në, marrëveshja e re është më e mirë se e kaluara, mirëpo të gjithë jemi bindur për këtë.

Qeveria nuk ka plan dhe buxheti e reflekton atë në çdo cent të distribuimit të tij. Nuk e merr për bazë kornizën afatmesme të shpenzimeve, nuk e merr për bazë planin e Bullgarisë. Gjithashtu, investimet kapitale nuk po krijojnë efekte multiplikuese. 49% prej tyre do të thotë shkojnë në projektin e autostradës.

Edhe këtu duhet t'i themi ministrit se nuk jemi kundër autostradës, e thamë edhe më herët, kjo është nisma dhe ideja e LDK-së, pavarësisht asaj që po doni ta merrni privatizimin e kësaj. Mirëpo, kryeministri e ka për detyrë të mendojë për 35% të popullsisë së Kosovës, të cilët kanë më pak se 1 euro, të cilët veç një herë kanë shkuar në Shqipëri, atëherë kur aparatura e Millosheviqit i ka çuar në këmbë atje, në vitin 1999. E sot, ata nuk kanë shans, se nuk kanë rrymë dhe nuk kanë as televizion në shtëpitë e tyre për ta parë segmentin 38 kilometërsh as në televizion. Duhet menduar edhe për ta. E pikërisht për këtë po e ngrisim zërin, sepse nuk jemi kundër autostradës. Nëse ka të holla, le ta fillojë edhe autostradën Shkup-Prishtinë.

Qeveria në bazë të kufizimeve që i ka me marrëveshjen e FMN-së, Qeveria nuk mund të procedojë më asnjë ligj në 2012 i cili ka implikime financiare. Ministri i Financave është dëshmitar i kësaj. Neve veç na u kanë kthyer, do të thotë, prej Bankës Botërore të gjitha amendamentet që i ka bërë komisioni profesional në lidhje me Ligjin për veteranët e luftës.

Nuk mund të shkojë ligji në versionin të cilin e dëshirojnë deputetët, sepse nuk ka të holla. Pagat i ka rritur për 20 milionë, por kjo nuk është rritje e pagave, është vetëm si rritje e agjencioneve dhe e Ministrisë së Diasporës, mallrat dhe shërbimet janë rritur me 5.8%, transferet me 3.6%, derisa norma e inflacionit është 7%.

Edhe pse gjatë vitit 2011 ishte paraparë rritja e pensioneve, ne e dimë që ka qenë e buxhetuar në buxhetin e vitit 2011 rritja e pensioneve. Mirëpo, kjo nuk ka ndodhur sepse ligji nuk është proceduar asnjëherë në Kuvend dhe kjo është bërë me qëllim që këto para të kontribuojnë për ta mbuluar deficitin buxhetor të Qeverisë.

Te shpenzimet kapitale janë rritur 15%, mirëpo duhet të theksojmë se kemi pasur 37% shkurtime të shpenzimeve kapitale me kërkesën e Fondit Monetar Ndërkombëtar, e cila

ka dashur që Qeveria ta ketë një rezervë prej 60 milionëve dhe Qeveria është dashur të bëjë shkurtime prej 37 milionëve, do të thotë investimet kapitale të vitit 2011 nuk janë 535 milionë, qysh janë të paraqitur, por janë minus këto dhe minus të gjitha projektet që Qeveria ka dështuar t'i implementojë dhe përfundojë në vitin 2011.

Kemi shpërndarje politike. U përmend që nuk ka shpërndarje politike, sepse ekziston formula e granteve në bazë të iks kriterëve. Normalisht që formula nuk ndryshon, mirëpo Qeveria po bën shpërndarje politike duke ndërtuar rrugët dhe shkollat atje ku ka militantët e saj. Ne e kemi përmendur edhe më herët. Skenderaj ka tri herë më shumë buxhet për shkolla se sa Prishtina. Në Prishtinë shkollat punojnë me nga tri ndërrime, kemi klasa që kanë mbi 50 nxënës dhe kjo duhet të shikohet dhe kjo nuk ka qysh të kuptohet ndryshe vetëm se shpërndarje politike.

Në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë kemi vetëm 215.000 euro projekte të reja. Në Ministrinë e Punës, në divizionin e punësimit, kemi vetëm 445.000 euro që barten nga ky vit. Në fakt, Qeveria nuk e di as sa është norma e papunësisë, sepse ne ende punojmë me të dhënat e 2009. Nuk është implementuar as anketa.

Merreni me mend, si do të zvogëlohet norma e papunësisë kur Qeveria nuk e di se sa është norma e papunësisë.

Ne kemi dhënë alternativë buxhetore dhe kemi dhënë gjithherë alternativa, por nga pozita jemi kritikuar që vetëm po kritikojmë, jemi jo konstruktivë dhe nuk po japim alternativa. Urdhëroni, i keni alternativat, që doni të merrni prej tyre diçka, merrni, përndryshe nëse këto nuk merren parasysh, atëherë ne nuk e votojmë.

Parimet e përgjithshme mbi të cilat ne kemi ndërtuar buxhetin alternativ është se duke marrë parasysh se Qeveria ka rritur të hyrat në vitin 2011 me 12% në krahasim me vitin 2010, ne kemi shkuar në një rritje 6%. Edhe ministri e tha që këto...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

(Ndërhyrje)

Po, ia japim edhe dy minuta! Mirë, urdhëro, vazhdo edhe 2 minuta!

HYKMETE BAJRAMI: Ne e kemi bazuar këtë. Qeveria ka dështuar me implementimin e arkave fiskale. Ne kemi menduar me luftimin e informalitetit, në implementimin e arkave fiskale prej 105.000 bizneseve sa janë, ne kemi të dhëna se vetëm 9.000 prej tyre kanë arka fiskale. Nëse do të instaloheshin arkat fiskale në të gjitha bizneset, atëherë normal se do të mund të rriteshin të hyrat. Burimet e financimit i kemi të njëjta. Dallojmë në atë se PTK-në nuk do ta shisnim për shkak të konjunkturës ekonomike, do të thotë krizës ekonomike financiare e cila është në rajon. Në këtë mënyrë ne do të kursenim

qindra miliona euro, duke përfituar nga një çmim më i lartë në situatën kur gjithë situata ekonomike stabilizohet.

Ne kemi preferuar që pagat, mallrat dhe shërbimet, transferet dhe subvencionet të rriten në normat e inflacionit, sepse njerëzit po mund të blejnë më pak me paratë e njëjta, do të thotë për shkak të inflacionit që ka ndodhur.

Të gjitha këto, në qoftë se nuk merren parasysh, kurse unë kam edhe shumë gjëra, do t'ia dorëzoj Sekretarisë me shkrim. Mirëpo, projektbuxheti i prezantuar nga Qeveria është po i njëjti me atë të këtij viti, e cila do të thotë i varfëron më shumë të varfrit dhe na largon nga Evropa sepse nuk i përmbahet kriterëve të Evropës. Ne në buxhetin tonë alternativ i përmbahemi deficitit buxhetor dhe kemi deficitin primar me 2.7% dhe deficitin sekondar me 2.95%.

Me këtë buxhet, çfarë e kemi ne, nuk do të përmirësohet jeta e qytetarëve të Kosovës, nuk do të ketë vende të reja të punës, nuk do të ketë më shumë rrymë, studentët në pamundësi për të gjetur punë kur e kryejnë fakultetin i regjistrojnë studimet master, e kur e kryejnë masterin shikojnë se si të emigrojnë.

Si rezultat i gjithë kësaj, po rriten dukuritë negative...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Bedri Hamza!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

E nderuara deputete Bajrami,

Kur të dëgjoja duke diskutuar, sinqerisht u ndala dhe po i bëj pyetje veti, qysh kemi arritur ta bindim Fondin Monetar Ndërkombëtar të pajtohet me këtë buxhet? Dhe, është mirë që tash po thua, nuk e ke kundërshtuar vlerësimin për rritjen ekonomike se gjatë gjithë vitit e ke kundërshtuar. S'ka rritje ekonomike, nuk realizohen të hyrat, ka për të bankrotuar shteti, nuk mund të rriten pagat, nuk bëhen investimet kapitale por, sidoqoftë, të gjitha këto kanë ndodhur, po e sheh që s'po bankroton shteti.

Unë e vlerësoj alternativën, sinqerisht e vlerësoj. Sigurisht se ka sende të mira aty që mund të merren. Mirëpo, prioritetet i vendos Qeveria e cila ka marrë votën. A e vazhdon Qeveria autostradën, vendos Qeveria. Dhe e thashë edhe më herët, se ne jo vetëm që nuk mendojmë për t'i shkurtuar investimet për autostradë, por ne jemi duke punuar intensivisht për t'iu përmbajtur kontratës, ta kryejmë këtë projekt dhe të startojmë me projektin e ri.

Çështja e shitjes së PTK-së, procesi është zhvilluar, nuk është përfunduar, nuk u humb pasuria. Posta është këtu.

Faturat e pa paguara. Të lutem, kur përmend shifra, të jemi korrektë! Referoju deklaratës së fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, që thotë se është një vlerë shumë e vogël,

është simbolike, e unë po ta them që është 2 milionë në krejt buxhetin e Kosovës, duke përfshirë nivelin lokal dhe qendror.

Çështjet tjera. Projekte të bartura. Është mirë që Kosova ka hyrë në projekte me vlera më të mëdha. Është kërkesë dhe është rekomandim edhe i Komisionit Evropian dhe i të gjithë tjerëve që të shkojmë në buxhete më shumëvjeçare. Nuk mundet një projekt i kushtueshëm edhe fizikisht të ekzekutohet brenda një viti, mirëpo të gjitha këto janë investime të reja dhe ky buxhet i propozuar mundëson përfundimin e dhjetëra shkollave, shumë palestrave sportive, shumë projekteve me vlera të mëdha e të kushtueshme.

Deficiti buxhetor, jemi shumë afër dhe në fund të vitit, po them, që ka për të qenë aty ku po thoni ju, te 2.7 ose 2.95. A është 3, a është 2.7, a 2.95 me precizitetin sot më të madh s'mund të flasim asnjëri, por jemi aty.

Çështja e rritjes së pagave dhe prishja e marrëdhënieve me FMN-në. Unë e di që neve i kemi relacionet dhe kemi partneritet me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Është bërë mirë që janë rritur pagat, dhe unë e di që tash nuk del kundër rritjes së pagave.

Lidhja e buxhetit me KASH-in. Merre, të lutem, shikoje buxhetin e 2012 në Kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetin e propozuar. Nuk janë identikë, po janë brenda parametrave të lejuar, që ndoshta janë diku te 90%-shi të njëjtë.

Tabela numër 1. Është buxhet i ndërtuar mbi bazën e prioriteteve të Qeverisë. Është buxhet që i reflekton prioritetet e Qeverisë edhe mbi planin e vizionit të zhvillimit ekonomik. Kemi premtuar ruajtjen e stabilitetit makro-fiskal, kemi premtuar infrastrukturë, kemi premtuar investime në arsim, kemi premtuar rritje të buxhetit për bujqësi. Të gjitha këto i reflekton ky buxhet i propozuar. Unë e di që ka nevojë më shumë.

Procedimi i ligjeve. Është i kostuar Ligji për pensionet, është i kostuar Ligji për pensionimin e ish trupave mbrojtëse të Kosovës që shërbejnë në FSK. Nuk është problem kostoja e ligjeve të shëndetësisë 10 milionë. Në momentin kur këto ligje harmonizohen me rekomandimet që i jep Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, 10 milionë absolut nuk është problem për sigurimin dhe për mbulimin e këtyre kostove të ligjeve.

E përmende edhe një ligj, që nuk është mirë të bëhet politikë me atë ligj, se je e fundit, zonja Bajrami, që merresh me kujdesin për atë kategori, dhe shumë tjerë janë marrë dhe përkujdesur me atë kategori. Ai ligj e njeh statusin e veteranëve, ai ligj i njeh beneficionet e veteranëve. Për t'u caktuar beneficionet e veteranëve, kërkohet që të caktohen kriteret, metodologjia, numri dhe askush, asnjë prej neve këtu, duke i përfshirë të gjitha grupet parlamentare nuk janë kundër që ai ligj të aprovet. Po, mos e merr rolin e avokatit dhe të bajraktarit në këtë punë se s'mundesh ta kesh.

(Ndërhyrje)

Jo, s'po ia ndaloj, por s'mund ta ketë, bajraktar. Nejse, nëse mundet, mirë!

Inflacioni. Kur e krahasojmë inflacionin, ne s'mund t'i parashikojmë ecuritë për periudhën e ardhshme e të flasim për inflacionin e vitit 2011. Nëse flasim për periudhën e ardhshme, për të gjithë parametrat tjerë, atëherë themi që edhe inflacioni është 2.3 dhe shpenzimet kapitale 616 milionë, të investohen. Çdo cent pavarësisht se a është projekt i vazhdueshëm, a është projekt i ri, është investim i ri. Dhe, sigurisht se ka ndikim në rritjen dhe zhvillimin ekonomik.

Shpërndarja politike. Të lutem shumë, merre Ministrinë e Arsimit. Shpërndarja e shkollave është në të gjitha komunat e Kosovës. Nuk është e vërtetë që në Skenderaj ka më shumë shkolla. Në Skenderaj i ke maksimum dy ose tri shkolla. Dhe, po t'i them me emra, që do. Në Podujevë, i ke njëjtë. Ke në Fushë-Kosovë, ke në Prishtinë. Sigurisht se ka nevojë për më shumë.

Dhe, çështja e 105.000 bizneseve, biznese aktive të cilat janë të pajisur me numër fiskal, nuk janë as 70.000. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Replikë, deputetja Hykmete Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, ministër!

Të gjitha këto që i the, kenë të pritshme. Është shumë e vërtetë, asnjëherë s'e kemi kontestuar rritjen ekonomike. S'e kemi kontestuar rritjen e pagave, se ajo ka ndodh me një vendim të Qeverisë.

Çka është për t'u kontestuar, ju në këtë Kuvend keni thënë që ne po hyjmë në një marrëdhënie më të mirë me Fondin Monetar Ndërkombëtar se sa kemi qenë. Keni thënë, këtu janë dëshmitarët, po këta deputetë që i ke sot prezentë, kanë qenë edhe atëherë. Jeni munduar tërë kohën të na bindni.

Se jeni harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ne nuk e dimë, sepse nuk ka marrëveshje të re. Ende nuk jeni kthyer në statusin e përfituesit. Do të thotë, ende jemi duke u monitoruar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Ju e dini shumë mirë që Fondi Monetar Ndërkombëtar ua ka nxjerrë shpirtin, ju ka shtyrë t'i bëni të gjitha ato diskutime pikërisht për të mos ju lënë të shkoni deri te bankrotimi, sepse Fondi Monetar Ndërkombëtar nuk është i interesuar që Kosova të falimentojë dhe bankrotojë. Dhe, nuk keni bankrotuar falë rezervave që i keni pasur dhe këtë duhet ta thoni.

Dhe, ka pasur inflacion. Nëse inflacioni këtë vit ka qenë 7%, normalisht që fuqia blerëse e të hollave tona që i marrim ka rënë për 7% dhe ajo duhet të ngritet. Të gjitha këto i kemi thënë.

Nuk kemi kontestuar asgjë. Domethënë, këto që i kemi kontestuar, kanë ndodhë të gjitha. Kemi thënë 167 milionë nuk vijnë sot në buxhetin. Nuk kam folur për shpërputhjet me buxhetin e aprovuar dhe buxhetin faktik të vitit 2011. Aty folëm! E ke tabelën. Zero i ke nga shitja e PTK-së, zero i ke nga Fondi Monetar, zero i ke nga Komisioni Evropian. Ato i ke. Ato janë fakte.

I kemi kontestuar, ku janë tash? Pse nuk i bisedoni? Pse nuk thoni që e zëmë vendin e parë në rajon për korrupsion. Pse nuk thoni që i çojmë investimet aty ku është më së lehti për të përfituar me tendera? Po thoni, na e kemi rritjen më të madhe ekonomike në rajon, krahasuar me Serbinë, me Maqedoninë, me Shqipërinë e me tjera. Ju lutem shumë, edhe ju duhet të jeni korrekt!

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Mua po më vjen mirë që deputetja po thotë se s'kemi kontestuar asgjë. Domethënë, po pajtohem.

Po, është mirë që s'ka kontestuar asgjë dhe jemi pajtuar dhe është mirë që ne duhet të krahasohemi me vendet e regjionit. Me Amerikën tybe s'mund të krahasohemi.

E sa i përket relacionit me Fondin Monetar Ndërkombëtar, unë po them që kemi relacione korrekte. Nuk është lehtë, do të thotë për t'u menaxhuar këto situata. Lodhur pak jemi, shpirtin s'ma kanë nxjerrë. Në këmbë jam, mirë jam!

Mirë jam dhe sa i përket çështjes së PTK-së, të gjitha procedurat janë zhvilluar. Tregu është ai që e vlerëson. Është ardhur deri te një moment kur ka mbetur një ofertues dhe, normalisht, vendimi i Kuvendit ka qenë i qartë, me një procedurë të hapur e transparente është ndërprerë ky proces dhe do të rifillojë.

Prapë po e ritheksoj, ky proces duhet të zhvillohet dhe do të zhvillohet në mënyrë më transparente, brenda ligjeve me qëllim të maksimalizimit të fitimit për shtetin. Nëse s'ka prapë ofertues, kurrkush s'mund të garantojë përfundimin e këtij suksesi.

Sa i përket fondeve, të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, unë jam shumë optimist që qysh në këtë vit Banka Botërore në dhjetor do të fillojë për t'i derdhur donacionet e premtuara si përkrahje buxhetore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar është pajtuar që për vitin e ardhshëm të jenë 92 milionë euro si pjesë e tabelave të buxhetit. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministër, e kërkoje fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë nuk do të shtoja shumë, zoti kryetar nga ajo që tha edhe ministri i Financave, por më shqetëson neuroza e zonjës Bajrami dhe frustrimi i saj, sidomos sa i përket autostradës. Unë kam besuar se sot do të jesh më optimiste, më me besim, më me guxim, më me shpresë dhe optimizëm për zhvillimin dhe ndërtimin e Kosovës, gjithashtu edhe qëndrimi juaj kundër, sepse ky buxhet është për vazhdimin e rritjes së pagave dhe pagesës së rritjes që e kemi bërë edhe për mësuesit 50% dhe ju e dini, e nderuara zonja Bajrami, për punëtorët shëndetësorë 30%, për gjithë pjesëtarët e FSK-ës 30%, për gjithë policët 40%, për shërbyesit civilë 30%, për invalidët e luftës 50%, për familjet e dëshmorëve gjithashtu 50%, zjarrfikësit 50% dhe të gjitha bëjnë diku

rreth 85 milionë euro nga buxheti i Republikës së Kosovës, kështu që kjo duhet t'ju gëzojë, jo t'ju bëjë agresive dhe ta ngritni tonin sepse, tek e fundit, ju jeni aq sa e di unë edhe pretenduese akademike, prandaj së paku të jemi në nivel të komunikimit.

Por, shqetësimi edhe më i madh tjetër është që edhe partia juaj me gjasë dhe besoj se nuk pajtohet me tonet thjeshtë të racizmit social, që dëgjova në këtë rast prej juve, sidomos kur e përmendni një zonë të caktuar. Unë nuk dua të flas si lokalist në asnjë rrethanë. Secili nga ne e ka një vendlindje. Për mua vendlindje e ime është Kosova dhe jam krenar dhe do të investoj në çdo cep të territorit të Republikës së Kosovës.

Por, është shumë shqetësuese gjithë ajo ankesë, ai frustrim, ai agresivitet, ajo nervozë pse po investohet në këtë komunë apo në atë komunë dhe përmendni konkretisht Drenicën.

Ejani secili dhe bëjmë krahasime për secilën komunë veç e veç dhe investimet që i kemi bërë. Prandaj, këto tone janë të tejkaluara, por dëshiroj të theksoj se ne do të vazhdojmë të investojmë njëjtë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

A mos është autostrada në Drenicë? Është në komunën e zotit Kryeziu! Në komunën e pjesëtarëve të deputetëve të Therandës. Mos deshët tash, thjeshtë, që vendlindjen time Brojën t'ma qitni autostradën e të thoni po i bie afër autostrada fshatit tuaj. Jo, prandaj dëshiroj të theksoj se ai mentalitet lokalist duhet sinqerisht të tejkalohet. Ka kaluar koha kur ndaj një zone apo ai mentalitet apo ai paragjykim i drejtimit të baterisë së topave ndaj një zone në Kosovë të kohës së komunistëve, të vëllazërim-bashkimit të vitit 1945 të Shaban Polluzhës dhe Mehmet Gradicës kanë kaluar njëherë e përgjithmonë, dhe pastaj e kohës së izolimit, diskriminimit dhe mos zhvillimit.

Do të investojmë në çdo cep të territorit të Republikës së Kosovës, edhe në fshatin dhe vendlindjen tuaj.

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër! Fjalën e ka deputeti Blerim Shala!

(Ndërhyrje)

Po, replikë! Mirë, më fal. Blerim, ka replikë, e ka fjalën deputetja Hykmete Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, shumë!

Unë kështu e kam natyrën e të folurit! Neuroza ime nuk bën të të shqetësojë, po unë kisha rekomanduar që ju duhet të jeni nervoz, sepse keni vota të shumë qytetarëve që sot jetojnë në mjerim në Kosovë.

Përndryshe, pagat dhe autostrada, ministër, t'u kisha lutur shumë, janë amortizuar, bre. Nëse kishe mundur, domethënë, pak ta ndërrosh këtë fjalorin, të na flasësh me argumente tjera, sepse na çka do që po flasim, pagat - autostrada, pagat - autostrada, nuk ke argument tjetër dhe u bë, besomë që u bë bajat kjo shumë. Përndryshe, edhe një fjalë tjetër, këtë ende nuk e kuptova, që më the pretendon për në staf akademik. Unë jam në

radhën e akademikëve, nëse nuk ke informacion, do të thotë jam. Ky toni im s'ka kurrjë të bëjë me atë dhe nuk e besoj se ka në mesin tuaj dhe të partisë tuaj më të kulturuar ose me tone, ose me sjellje më të mira se të miat. Absolut, për atë nuk mundesh...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë nuk besoj që është akademik zëri juaj i lartë. Me rëndësi është që të mos shqetësoheni fort për autostradën dhe rritjen e pagave. Kjo do të vazhdojë, edhe autostrada dhe rritja e pagave.

Ndërsa, sidomos për çështje lokaliste, si akademike duhet të jesh shumë e shqetësuar për mentalitetin tuaj shumë të së kaluarës!

KRYETARI: Faleminderit! Ju përkujtoj që në debat e kemi buxhetin për vitin 2012. Fjalën e ka deputeti Blerim Shala!

BLERIM SHALA: I nderuari kryetar,

Kabinet i Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2012, kështu si është propozuar prej Qeverisë së Kosovës, nuk është buxhet që siguron zhvillimin ekonomik të Kosovës, uljen e papunësisë, përmirësimin e gjendjes sociale, mirëqenien e qytetarëve.

Ky është buxhet që synon të garantojë mbijetesën e kësaj qeverie dhe asgjë më tepër.

T'i shohim faktet. A bën të dëgjohemi, më falni, ju të kulturuarit e LDK-së!? Po më doket që s'po ju duket boll që Qeveria po do për të dhënë goxha një shumë të madhe për ndërtimin e autostradës, po doni për t'i dhënë nja 100 milionë shtesë, sipas propozimeve që i keni ofruar dje.

Po, t'i shohim faktet. Në letrën që Qeveria e Kosovës, më 20 qershor të këtij viti ia ka dërguar Fondit Monetar Ndërkombëtar, Qeveria është zotuar që në fund të këtij viti në Bankën Qendrore të Kosovës do t'i ketë së paku 305 milionë euro, në vend të 355 milionë eurove sa ishte zotimi i Qeverisë së Kosovës në kuadër të stand-by aranzhmanit të nënshkruar në korrik të vitit 2010.

Sipas propozim-buxhetit të Qeverisë së Kosovës, në fund të këtij viti në arkën e shtetit do të jenë 123 milionë euro. Po mos të ishin shkurtimet buxhetore të pranuar prej 60 milionë eurove, arka nuk do ta kalonte 1.5% e GDP-së.

Në po këtë letër të Qeverisë, dërguar FMN-së para pak muajsh, theksohet në mënyrë të prerë: Privatizimi me kohë i PTK-së është shtylla bosht e strategjisë sonë financiare.

PTK nuk është privatizuar sivjet, siç ka qenë zotimi i Qeverisë së Kosovës. Kjo do të thotë se ka rënë poshtë shtylla bosht e strategjisë financiare të Qeverisë së Kosovës, nëse e parafrazojmë vetë Qeverinë.

Sipas këtij buxheti dhe sipas raporteve të fundit të FMN-së dhe të Bankës Botërore, zhvillimi ekonomik i Kosovës në vitin 2012 do të jetë diku në mes 4 deri në 5% ku së paku 2% të kësaj rritjeje janë investimi publik i parave të taksa-paguesve të Kosovës në autostradën Vërmicë-Prishtinë.

Edhe në vitin 2013 dhe 2014 nuk do të ketë zhvillim më të madh ekonomik. Në dokumentet e mëhershme të Qeverisë së Kosovës të këtij viti, të periudhës prill-korrik, përfshirë këtu edhe kornizën afatmesme të shpenzimeve, është paralajmëruar një rritje ekonomike prej 7 deri 8%, duke nisur prej vitit 2012 në kuadër të një strategjie të zhvillimit të madh ekonomik të Kosovës. Po del kështu, gjithnjë sipas dokumenteve të vetë Qeverisë së Kosovës, që ka rënë poshtë strategjia për zhvillimin ekonomik të Kosovës sepse 4 – 5%-shi është vetëm një mbijetesë dhe asgjë më tepër.

Janë të sakta krahasimet që ministri Hamza i bëri pak më parë, duke marrë parasysh raportin e fundit të Bankës Botërore sa i përket zhvillimit ekonomik në rajon, por po ashtu ministri Hamza e di që Banka Botërore ka thënë që për ta zënë trenin e Maqedonisë dhe Shqipërisë, Kosova duhet të ketë zhvillimi ekonomik prej dy shifrash në vitet e ardhshme.

Me investimet direkte nga jashtë, që në periudhën 2007 – 2010 kanë rënë për 59%, me paralajmërimin e qartë nga vetë Kosovës në letrën dërguar FMN-së më 20 qershor që së shpejti nuk do të nisë ndërtimi i autostradës 6, kah Shkupi, me këtë ngathtësi në procesin e privatizimit të PTK-së dhe të vendimmarrjes për “Kosovën e Re”, me këtë shkallë të rritjes së importit në vitin 2014, 2/3 e buxhetit të Kosovës do të varen nga doganat, nuk ke si t’i shmangesh konkludimit që kjo qeveri as që e ka ndërmend të merret me temën kyçe të ndërrimit rrënjësor të gjendjes ekonomike të Kosovës.

Sipas buxhetit të propozuar nga Qeveria e Kosovës dhe sipas shifrave që flasin për shkallën e rritjes ekonomike të Kosovës, mund të parashihet shtimi e jo ulja e papunësisë. Këtu duhet thënë se vetëm çdo i katërti qytetar i Kosovës i aftë për punë sot ka një punësim të rregullt, ndërsa na ishte premtuar zvogëlimi i papunësisë prej 10 deri 12% për çdo vjet.

Me këtë buxhet që na është prezantuar neve, nuk do të ketë rritje të rrogave dhe të ardhurave sociale në tri vitet e ardhshme. Kjo do të thotë që Qeveria e Kosovës nuk ka as strategji sociale për adresimin e çështjeve kyçe sociale në vitet e ardhshme.

Problemet sociale në fakt vetëm sa do të vijnë dhe do të rriten në vitet e ardhshme në bazë të obligimeve që Qeveria e Kosovës i ka marrë përballë FMN-së, gjithnjë duke shpresuar se do të ribëhet stand-by aranzhmani në vitin 2012, sepse pa të qysh tash mund të parashihet kërcënimi i madh për strategjinë e mbijetesës së kësaj qeverie. Ta zëmë, Qeveria e Kosovës do të rrisë tatimet në pronë për qytetarët e vet në gjithë Kosovë sipas

zotimeve të saja dhjetë herë apo 1.000%. Për shembull, nëse një qytetar i Prishtinës për banesën e tij të vjetër ka paguar 40 euro në vit, tash e tutje do të paguajë 400 euro në vit.

Qeveria e Kosovës po ashtu ka marrë detyrimin në stand-by aranzhmanin e nënshkruar me FMN-në, ta rrisë çmimin e rrymës, ashtu siç është shprehur vetë Qeveria në mënyrë thelbësore, po them gjithnjë që është citat nga marrëveshja e Qeverisë me FMN-në. Kjo nënkupton, sipas llogarive të fundit, që çmimi i rrymës mund të rritet deri në 30% në dy vitet e ardhshme. Po del se Qeveria e Kosovës nuk ka strategji të duhur për ta adresuar durimin në skadim e sipër të qytetarëve të Kosovës.

Qeveria e Kosovës, pra, sipas këtij buxheti të propozuar, do t'ua harxhojë paratë, kohën, durimin, qëndrueshmërinë qytetarëve të Kosovës në vitin 2012 dhe në vitet vijuese dhe do të krijojë më shumë të pa punë, më shumë probleme sociale dhe rrjedhimisht më shumë tensione politike dhe destabilizim të shoqërisë kosovare.

Në fund, vetëm një qëndrim të shkurtër rreth fjalës që kryetari apo shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së e tha në fillim, kur tha që buxheti është në fakt në shpërpjesëtim me nevojat e qytetarëve të Kosovës, por është në përpjesëtim me mundësitë reale që i ka Qeveria e Kosovës. Po krejt muhabeti, të nderuar kolegë, i një Qeverie është si t'i realizojë nevojat e qytetarëve apo si t'i bëj ato pjesë përbërëse të planit të saj. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Bedri! Ministri Bedri Hamza!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti Shala, është e vërtetë që disa shifra që i përmende, i përmende dhe i the mirë, por disa i ngatërrove dhe nuk i the drejt.

Sa i përket bilancit bankar, do të thotë, ka qenë 305 milionë, duke e përfshirë privatizimin e PTK-së. Kur të hiqet privatizimi i PTK-së, shuma prej parave që është pritur të vijë nga privatizimi i PTK-së, nuk është kriter 305 milionë.

Çështja tjetër, që iu referove, se nëse kemi rritje prej 5.3 rritje ekonomike, rritet papunësia. Nuk del matematikisht ashtu. Dhe i përmende dy gjëra, që do t'i përmendi shumë shkurt. Nuk qëndron fakti, nuk qëndron e dhëna që Qeveria e Kosovës ka marrë obligim për rritjen e tatimit në pronë për 300% ose 400%, ose sa thua. Tatimi në pronë në Kosovë është shumë, shumë i ulët. Ka laramani te aplikimi i shkallëve rreth tatimit në pronë nëpër komuna. Disa komuna e aplikojnë e disa kryetarë të komunave e aplikojnë normën e tatimit në pronë 0,07%. Disa tjerë e kanë 0,13%. Disa tjerë e kanë 0,15% dhe disa tjerë 0,20% dhe krejt qëllimi është që të bëhet një limit i poshtëm i normës sa tatimit në pronë, që mund të jetë aty rreth 0,15% jo 400%, por të bëhet një rregullim.

Dhe, çështja tjetër, është çështja e rrymës. Askund në marrëveshjen e institucioneve të Republikës së Kosovës, me Fondin Monetar Ndërkombëtar nuk figuron se do të rritet çmimi i energjisë elektrike për 30%. As nuk kemi asi obligimi, prandaj është e mirë që me thënë atë çka është. Unë i vlerësoj ato që thuhet reale, mirëpo nuk është mirë me thënë diçka çka s'është edhe çka s'qëndron. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Blerim Shala!

BLERIM SHALA: I nderuari ministër,

Unë po iu referohem dokumenteve, që Qeveria e Kosovës i ka nënshkruar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, në kuadër të stand by aranzhmanit dhe në këtë dokument, ju e dini fare mirë që jeni zotuar që do ta rritni në mënyre thelbësore çmimin e rrymës. Nuk e keni bërë në 2 vjetët e fundit dhe e dini fare mirë, e dini shumë mirë që do të detyroheni ta rritni për 30% në 2 vitet e ardhshme, e dini shumë mirë.

Për çështjen e rritjes së tatimit në pronë, prapë po i referohem dokumentit. E dini shumë mirë çka shkruan në dokument. Është 0.05% mesatarja e tatimit në pronë, ju e keni shkruar, jo unë, jo Fondi Monetar Ndërkombëtar. Keni thënë që do ta ... për 0.05%. 0.05% është 1000% në krahasim me 0.05%-shin.

Së treti, sa i përket shkallës së papunësisë. Vetë ju dhe të gjithë ekspertët ekonomikë në Kosovë kanë thënë që për të vendnumëruar, sa i përket shkallës së papunësisë, duhet së paku 6% të zhvillimit ekonomik. Ndërsa, për ta ulë papunësinë në dokumentin tuaj në kornizën e shpenzimeve afatmesme keni thënë që 7 - 8%-shi do të mundësojë uljen e papunësisë. Ju vetë keni thënë, që vitin e ardhshëm nuk do të ketë rritje më të madhe se 5%. Ky është versioni optimist, sepse e dini që janë dy versione, versioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar flet vetëm për 4%, versioni juaj dhe i Bankës Ndërkombëtare flet për 5%, por në asnjë variant 5%-shi nuk mundëson që të ulet papunësia, apo të mbahet papunësia e sotme, por do të shtohet papunësia.

Gjithnjë po i referohem dokumenteve, që ju si Qeveri i keni bërë dhe marrëveshjeve që ju si Qeveri i keni bërë me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Asnjë shifër s'është e imja.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!
Ministër, e ke fjalën për kundër replikë!

Le të përgatitet deputeti Liburn Aliu!

BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket normës së tatimit në pronë, është e rregulluar me Ligjin për tatimin në pronë. Ligjin, tek e fundit, edhe kur të vjen për amendamentim, e bënë Kuvendi. Unë po e them që është rekomandim i Fondit Monetar Ndërkombëtar që të shkohet kah ngritja e normës të tatimit në pronë. Nuk është kurrfarë obligimi, nuk kanë obligim institucionet e Kosovës që të shkojnë në rritjen e normës së tatimit në pronë në 0,5, është për t'u rregulluar, që të jetë një mesatare, diku është planifikuar që të jetë 0,15.

Ndërsa, sa i përket çmimit të energjisë elektrike, në asnjë dokument nuk kemi marrë obligim që ta ngrisim çmimin e energjisë elektrike për 30%. Dhe, po e përmbyllë, norma e rritjes ekonomike prej 5.3% nuk e lë të rritet norma e papunësisë. Për t'u zvogëluar norma e papunësisë aty ku dëshirojmë ne, është e vërtetë që kërkohet një rritje ekonomike prej 7 ose 8%.

KRYETARI: Para se t'ia jap fjalën deputetes Albulenë Fetoshi, ju njoftoj se shpërndarjen e bëj në grupe unë, por sipas grupeve, do të thotë kur i vjen radha e grupit, e përcjellë radhën e deputetëve që janë në rend të ditës. Këtë të jeni të sigurt!

(Ndërhyrje)

Realisht, ju kam tejkaluar më parë, tash jeni në radhë, do të thotë tash jeni ju!

ALBULENË FETOSHI: Faleminderit, kryetar!

Kjo Qeveri edhe në këtë buxhet na e ka bërë të qartë se nuk është e orientuar kah zhvillimi i ekonomisë së Kosovës, por mëton ta financojë rritjen e buxhetit me të hyra doganore, që në vetvete tregon orientim dhe qasje të gabuar. Pra, parashihet që të hyrat e përgjithshme në këtë buxhet të jenë 1.361.000.000 në vit, domethënë për vitin 2012, ku të hyrat nga doganat parashihet që të jenë 860.000.000, kurse të hyrat vendore pritet që të jenë 285.000.000.

Nëse i krahasojmë këto të hyra me vitin 2011, shihet që nuk ka ndonjë ndryshim shumë të madh. Pra, diferenca e të hyrave nga doganat për këto dy vite është 30.000.000, ndërsa diferenca e të hyrave vendore është për 24.000.000.

Nuk po vërehet ndonjë lëvizje shumë e madhe e të hyrave nga viti në vit, që do të thotë se kjo mënyrë e ndërtimit të buxhetit nuk po na sjellë ndonjë rritje ekonomike. Por, edhe sikur të ketë rritje ekonomike, e tha ministri këtu, që domethënë nga të hyrat për vitin 2011 rritja e të hyrave do të jetë diku rreth 18%. Kjo do të thotë se ne do të eksportojmë më shumë para.

Kur jemi te rritja e të hyrave doganore, na thuhet se do të ketë një rritje të të hyrave prej 9,5%, në raport me vitin paraprak, që do të thotë se Qeveria është optimiste se do të ketë rritje edhe më të lartë. Ku qëndron paradoksi këtu? Nëse thuhet se do të ketë rritje ekonomike vetëm 5% dhe se do të ketë një pako fiskale, që e lehtëson barrën fiskale të bizneseve, mirëpo nëse kemi ulje të çmimeve dhe të mallrave që importojmë. Nëse kemi ulje të remitencave dhe do të ketë më pak kredi për biznese dhe më pak para për të konsumuar, si mund të grumbullohen 9.5% më shumë tatime? Në rastin më optimist i bie që qytetarët do të kenë 5% më shumë para,...

KRYETARI: Unë ju kisha ftuar për pak qetësi, deputetë!

ALBULENË FETOSHI: ... para tatimi, por do të paguajnë 9.5% më shumë tatime dhe del se neto secili nga ne do të ketë më pak para se në vitin 2011. Këtu pra, nuk kemi rritje të mirëqenies shoqërore.

Pra, numrat në këtë buxhet flasin për një ekonomi të bazuar në të hyra doganore, e që i bie import i mallrave dhe eksport i parasë. Për më shumë duke importuar mallra, ne importojmë edhe inflacionin prej atyre shteteve dhe kjo do ta dëmtojë edhe më shumë ekonominë e Kosovës dhe konkretisht qytetarët e Kosovës, sepse duke pasur parasysh normën e inflacionit në Kosovë, jo vetëm për vitin 2012, por edhe për vitin 2013 dhe për

vitin 2014, ata që marrin paga prej buxhetit do të kenë mundësi të blejnë më pak, për shkak se rritja e pagave nuk është në vijë me inflacionin.

Kjo politikë e ndërtimit të buxhetit, përveç që nuk po sjellë rritje ekonomike, në mënyrë të tërthortë po e dëmton edhe xhepin e qytetarëve të Kosovës. Të hyrat për vitin 2012 pritet të rriten për vetëm 38.000.000, ndërsa që shpenzimet janë rritur për 100.000.000. Përderisa diferenca e rritjes së të hyrave me rritjen e shpenzimeve është për 62.000.000 këto zbrazëtira buxhetore ishte dashur që të financohen nga rritja ekonomike. Por, pasi që rritje ekonomike nuk ka atëherë kjo Qeveri e ka paraparë që këto zbrazëtira buxhetore t'i financojë nga borxhi i brendshëm që është 74.000.000, nga FMN-ja 92.000.000 e që ka gjasa që të mos i kemi, si dhe nga privatizimi i PTK-së 300.000.000 e që ne urojmë që të mos ndodhë.

Të gjitha këto bëjnë 430.000.000, ndërsa bilanci në fund të vitit është 407.000.000, që do të thotë se nëse nuk ndodhin këto, Qeveria ka parashikuar që në fund të vitit ne të dalim me minus, gjë që rrezikon edhe stabilitetin makrofiskal të shtetit të Kosovës.

Kur jemi te stabiliteti makroekonomik edhe Raporti i Progresit e thotë qartazi, që rritja ekonomike është e dobët dhe e thyeshme. Bile, potencohet ajo që lëvizja “Vetëvendosja” e ka thënë për një kohë të gjatë, në lidhje me mënyrën e rimëkëmbjes ekonomike, ku thuhet që disbalancet tregtare janë të mëdha dhe që investimet që rrisin kapacitetet prodhuese janë minimale ose nuk kanë lëvizur fare nga viti në vit.

Në buxhetin e vitit 2011, kemi thënë që Qeveria e ka rrezikuar buxhetin me tri të hyra të paraqitura për financim, e të cilat tani po shihet se nuk do t'i kemi. E njëjta gjë do të ndodhë edhe për vitin 2012, sepse gjithçka po vazhdon pothuajse me të njëjtin ritëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!
Fjalën e ka deputeti, Muhamet Mustafa!

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë deputetë dhe Kabinet qeveritar,
Projekti i buxhetit për vitin 2012 paraqet një vazhdim të politikave buxhetore të këtij viti e që është e kuptueshme, pasi që ndryshe edhe nuk ka mundur të jetë, sepse buxheti i këtij viti me goditjet e tija fiskale do të ketë ndikime të forta, të paktën gjatë kësaj periudhe afatmesme, që është para nesh.

Një rrethanë pozitive, e cila ka rëndësi, është se vazhdon rritja e të ardhurave buxhetore nga burimet vendore, nga doganat dhe Administrata Tatimore sipas parashikimeve, gjë që provon kapacitetet e Kosovës për të siguruar një qëndrueshmëri buxhetore.

Fatkeqësisht, kjo nuk vlen edhe për të ardhura tatimore në nivelin e komunave, të cilat kryesisht bazohen në tatimin në pronë. Këtu kemi një trend stagnimi dhe kjo praktikë duhet të ndryshojë. Nuk po shoh në këtë buxhet, 2-3 vite të buxhetit, e as në projeksionin

e kornizave afatmesme se projektohet një ndryshim. Unë mendoj se këtu kemi rezerva të mëdha për të rritë qëndrueshmërinë buxhetore.

Një çështje tjetër ka të bëjë edhe me prezantimin e një kategorie të të ardhurave, që përbën taksën për shfrytëzimin e burimeve natyrore ose tantumës që prezantohet bashkë me disa kategori tjera buxhetore, por për shkak të rëndësisë së kësaj dhe transparencës që ka kjo kategori, unë kam kërkuar edhe vjet dhe po e përsëris kërkesën edhe sivjet, që kjo të prezantohet qartë në buxhet.

Një çështje tjetër, që duhet të na preokupojë në debatin e sotëm, e që ka rëndësi fundamentale për stabilitetin makroekonomik për të cilin po flasim, është korniza makroekonomike, që e shoqëron buxhetin. Unë kam pritur që këtë buxhet do ta shoqërojë një analizë më serioze makroekonomike, sepse pa këtë ne nuk e dimë si do të jetë situata. Kjo analizë mendoj se duhet të rishikohet, dhe deri në fund, deri në aprovimin e buxhetit duhet të na vijë analiza më të besueshme makroekonomike, sidomos kur i kemi parasysh trendet më të reja në zonën e euros, në zonën euro pra, në disa vende që janë kapluar nga kriza, ne duhet t'i hetojmë më me kujdes dhe më mirë ndikimet që mund të kenë këto lëvizje në rritjen ekonomike të Kosovës, edhe në stabilitetin makroekonomik, sidomos në të ardhurat buxhetore. Unë po veçoj këto tri kategori makroekonomike, të cilat duhet të analizohen më mirë.

Së pari, inflacioni. Derisa inflacioni në Kosovë në vitin e kaluar ka qenë 7%, në vendet e rajonit ka qenë 3 – 4%. Sivjet parashikojmë një inflacion të ngjashëm me vendet e rajonit, 2.3% në Kosovë, kurse në rajon do të jetë 2-3,5% në Shqipëri. Dhe kjo, në dokumentin që e shoqëron buxhetin, i faturohet kryesisht importit. Domethënë, inflacioni në Kosovë arsyetohet se është më i madh për shkak të importit. Natyrisht, kjo është vetëm pjesërisht e vërtetë. Pra, duhet patjetër, unë jam befasuar që nuk janë analizuar më mirë burimet vendore të inflacionit, sepse me politikat ekonomike dhe fuqinë tonë ne nuk mund ta goditim inflacionin që importojmë, por mund ta analizojmë dhe të shohim athua kemi burime edhe brenda nesh, që e stimulon rritjen e inflacionit. Dhe, mu për këtë, mendoj se ky fenomen, fenomeni i inflacionit duhet të analizohet më mirë, sepse inflacioni direkt ka të bëjë me cilësinë e jetës dhe standardin e qytetarëve. Prandaj, në dokumentet që i bie Qeveria, kjo duhet të shikohet me një kujdes shumë më të madh.

Kategoria e dyte, që duhet të analizohet, ka të bëjë me investimet. Projektionet lidhur me investimet private, ma merr mendja se duhet të rishikohen seriozisht, jo pse janë tepër të mëdha, investimet private duhet të jenë edhe më të mëdha, por ky parashikim prej 1.000.000.000 eurosh investime private në kohën kur mjedisi biznesor, e sidomos politikatat tatimore ende nuk janë miqësore për investitorët privat, kur parashikojmë zvogëlim të remitancave dhe nuk parashikohet ndonjë zvogëlim i interesave për kredi në bankat vendore, kur kemi një trend të zvogëlimeve të investimeve të jashtme direkte, unë mendoj se duhet të brengosemi për mjedisin që duhet të na sigurojë këtë miliardë. Ajo duhet të na sigurojë edhe më shumë. Unë do të përkrahja Qeverinë nëse ajo krijon kushte që investimet private të rriten shumë më tepër.

Këtu u fol shumë për punësimin dhe, natyrisht, është mirë që flitet, por është për t'u habitur se në këtë dokument, kategoria e punësimit, indikator i punësimit si një nga shtyllat kryesore, çdo kund figuracioni makroekonomik mungon tërësisht. Prandaj, ne duhet në çdo tabelë makroekonomik, punësimi ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Jo vetëm pse e tangon cilësinë e 40% të popullatës aktive, që është e papunë, por për shkak se lëvizjet e punësimit ndikojnë në mënyrë qarkore edhe tek treguesit e tjerë. Unë pres që deri në aprovim të buxhetit kjo pjesa e analizës makroekonomike të korrigjohet edhe të vendoset këtu.

Ajo që do të duhej të ishte më mirë e thënë këtu, ka të bëjë me arsyetimin për politikat buxhetore. Ne e kemi një tekst, por arsyetimi nuk ka mjaft substancë për t'i vlerësuar politikat buxhetore se sa janë ato në harmoni me prioritetet zhvillimore. Struktura e shpenzimeve buxhetore nëpër sektorë dhe ministri e provon edhe një herë ajo që ne e shohim nga tabelat, se qeverisja ekonomike në Kosovë në të vërtetë bëhet pa një kornizë të qëndrueshme të shpenzimeve afatmesme. Është një fakt se më tepër ndikojnë buxhetet vjetore në kornizën e shpenzimeve afatmesme në vend, se të jetë e kundërta. Nëse shikoni në tabela dhe shikoni përqindjen e buxhetit të orientuar në vitin 2009 – 2012, për shembull në arsim do të shihni se derisa në vitin 2009 në arsim janë orientuar 8% të mjeteve buxhetore, sivjet orientohen 4%. Bile, edhe në shifra absolute 13.000.000 më pak.

Në shëndetësi, derisa në 2009-shin kemi pasur 12%, sivjet kemi 9%, edhe pse në pikëpamje absolute në shëndetësi shifra është më e madhe se atje.

Në mirëqenie sociale, prej 26%-ve, 21%. Këtu u përmend pak problemi i pensioneve. Pse ndodhë kjo? Kjo ndodhë për shkak të ndikimit të madh që ka autostrada, që është një projekt shumë me rëndësi, i cili duhet të realizohet, por këtë situatë ne nuk do ta kishim po të kishim pasur edhe burime tjera për financim të autostradës. Sot u përmend këtu autostrada e Ferizajt. Unë ju sugjeroj që të përgatitet kjo autostradë, por financimi i kësaj autostrade duhet të bëhet në mënyrë krejt tjetër prej financimit të autostradës Durrës-Prishtinë. Përndryshe, nëse vazhdon edhe një goditje fiskale e financimit, ne do të kemi strukturë të tillë të deformuar të shpenzimeve nëpër sektorë, që nuk janë askund, nuk e ke në rajon 4% arsimin në buxhet. E ne po pretendojmë që të kemi një cilësi më të madhe në arsim. Është mirë që kemi ndërtuar shkolla, por ato shkolla duhet të kenë edhe një mbështetje buxhetore, që të ngrisin cilësinë.

Një çështje tjetër ka të bëjë me projektimin e të ardhurave, ku rreth 472.000.000 bazohen në huazime të brendshme, financim të jashtëm dhe privatizim. Kjo pjesë e buxhetit, kjo pjesë e të ardhurave ka një siguri të ultë të realizimit. Të gjitha ngjashëm me vitin e kaluar, ka gjasa që mos të realizohen. Veçanërisht tek huazimet e brendshme duhet të jemi të kujdesshëm. E huazime të brendshme është borxhi publik, pra letrat me vlerë dhe paratë e fondit të pensioneve. Për të dy këto gjëra ligjet duhet të aprovohen, të operativizohen dhe duhet, sidomos te fondi i pensioneve, duhet të marrë vendim Bordi i Trustit të Pensioneve dhe Kuvendi nuk mundet t'i dirigjojë çka do të vendos, për arsye se ai bord është autonom dhe, fundi i fundit, ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm për përdorimin e këtyre mjeteve, sepse këto paraqesin investime të pensionistëve.

Së këndejmi, nga perspektiva ku ndodhemi, rezerva e parashikuar buxhetore duket bukur fiktive, por unë mendoj se projektimet mund të realizohen, pra edhe rezervat buxhetore në vend 400 e sa është aty në dokument, do të jetë sigurisht më e vogël, por sa do të jetë, sot s'mund të vlerësojmë.

Për të përfunduar, e tërë qeverisja makroekonomike, politikat fiskale dhe menaxhimi i buxhetit duan një rikonstruktivim dhe ristrukturim, në mënyrë që në vitet në vijim të mos hyjmë në kriza serioze makrofiskale.

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, z.Xhavit Haliti

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Goran Marinković!

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsjedavajući!

Poštovani kolege poslanici,

Po planu gospodina Marti Ahtisarija, decentralizovane srpske opštine imaju nadležnosti za obezbjeđivanje sekundarne zaštite, što uključuje i proširenu nadležnost nad sekundarnim zdravstvom i gradskom bolnicom. Opština Gračanica nema gradsku bolnicu. Ali, zato ima privremene objekte koje koristi kao alternativno rešenje i u tim objektima vrše se zdravstveni pregledi.

Moramo priznati da je to prava slika sekundarnog zdravstva u opštini Gračanica, sa kojom ne bismo trebali da se ponosimo. Prihvatanje zakona o proširenoj nadležnosti sekundarnog zdravstva, vlada se obavezala na izgradnju gradske bolnice u opštini Gračanica. U 2010. godini opština Gračanica je dobila poseban grant u iznosu od 300.000 eura za izgradnju bolnice i sa tim sredstvima počela je prva faza izgradnje bolnice, koja su se sredstva namenski potrošila.

Budžetom za 2011. godinu vlada nije planirala sredstva kako bi se radovi izvodili nekom planiranom dinamikom. Predlogom budžeta za 2012 godinu vlada ponovo nije planirala sredstva za nastavak gradnje bolnice.

Molimo vas da najozbiljnije uzmete u razmatranje i uvrstite u predlog budžeta izgradnju bolnice u Gračanici, kao i u Štrpcu, jer za normalno sekundarno zdravstvo u kojem normalno lečenje stanovništva u ovim bolnicama u srpskim sredinama je neophodna. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Fikrim Damka.

Deputetit Damka, fjalën!

FIKRIM DAMKA: Sayın Meclis Başkanı yardımcısı, Sayın Bakanlar ve Milletvekilleri Avrupada bu günlerde ekonomik bir kriz yaşanırken, Kosovaya ait 2012 yılı bütçe planlamasının gerçekçi rakamlara dayanarak hazırlandığını görmek bizleri memnun

etmektedir. Herşeye rağmen bir bütçe artışı ve yaklaşık olarak % 5-lık bir ekonomik büyümenin tahmin edilmesi herşeye rağmen sıkı bir mali politikanın izlenmesi gerekliliğini ortaya koymaktadır.

Fakat bu büyüme içerisinde harcamaların, gelirlerimizden daha yüksek olması ve bir seferliğe mahsus yaklaşık 300 milyon bir gelirin planlama içerisinde olması bir risk olarak görmekteyim, çünkü bu gelir telefon şirketinin satışından hesaplara katılması risk teşkil ettiğini ve planlamanın doğru ve zamanında yapılmaması, Kosova ekonomisini ciddi bir şekilde krize sokacaktır.

Dış ticaret açığı tahmininin 2 milyar yuro değerinde olması, ister istemez Kosovanın satan değil, satın alan bir ülke olduğunu ortaya koymaktadır. CEFTA işimize yaramadığının açık bir göstergesidir. Aynı zamanda üreten bir ülke değil, tüketen bir ülke olarak aynen bu yıl da devam etmekteyiz. Üretim açısından sevindirici olan Tarım bütçesinin bu yıl artış kaydetmesi ve gelecek yabancı bağışlar ile bu kesimin canlanmasına sebebiyet verecektir, bu da gerçek olarak Kosova ekonomisinin kalkınmasına olanak yaratacaktır.

Vergiler ile bütçenin ayakta tutulması doğrudur, ama gümrük vergilere bağlı kalmamız ekonomik olarak doğru değildir. Avrupada ekonomik krizini gözönünde bulundurarak, bu ülkelerde çalışan vatandaşlarımızın eskisi gibi Kosovaya para transferi gerçekleştirmeyeceklerini de dikkate almalıyız.

Emeklilere verilen yardımın bu yıl artış göstermesi az da olsa bütçede yer almasını sevindirici olarak görmekteyim.

Sağlık Bakanlığının bütçesinde de artışın görülmesine karşın yine de çok yetersiz olduğunu görmekteyiz. Sadece sağlık sektöründe çalışanlara 44 euronun bütçeye eklenmesi güzel bir lay olarak karşılanırsa da, yatırımlara ayrılan payın yüne az olduğunu görmekteyiz. Kosovada gerçekleşmeyen tedaviler için hastaların dış ülkelere gönderilmesi için ayrılan 2 milyon yuronun çok düşük olduğu ve yaklaşık olarak her yıl 500 kişiden fazla vatandaşın başvurduğu bu bütçe her yıl olduğu gibi bu yıl da yetersiz olacaktır. İlaç alımına ayrılan bütçenin yetersiz olduğu da açıktır. Bu yıl da hastalarımızın hastanelerde ilaç bulamayacakları görülmektedir.

Bütçede şahsen Türk toplumunu ilgilendiren bazı projelere yer verilmediğini veya ayrılan bütçelerden Türk toplumunun yeteri kadar yararlanmadığını görmekteyim

İçişleri Bakanlığında ayrılan biometrik kimliklerdeki softver projesinde umarım türkçe karakterlere ve yazısına da dikkat edilir.

İçişleri Bakanlığında evrak basımına ayrılan bütçeden, Prizren belediyesinde türkçe evrakların basımına öncelik verilmesini talep etmekteyim.

Mitroviçada geçen yıldan bu güne kadar talep ettiğimiz Türk Kültür Merkezinin bütçede yer almaması bizleri üzmektedir ve bunun düzeltilmesini istiyoruz.

Geri dönüş Bakanlığından bu gün Türk toplumun herhangi bir projeden faydalandığını görmedik, bu yüzden Türk toplumunun ihtiyaçlarının giderilmesi için 150 bin yuro değerinde bir bütçenin ayrılacağını belirtmesini talep etmekteyiz

Mamuşada yatırımların sadece 150 bin yuro olmasının yetersiz olduğunu ve domates üretiminde Kosovada birinci bölge olmasına rağmen tarım yatırımlarının sıfır olması kabul edilemezdir. Mamuşa tarımcıları geçen yıl maalesef hiçbir sera yatırımı almamıştır. Bunun bütçede dikkate alınmasını özellikle talep etmekteyim.

İki yıldır uyarmamıza rağmen yine Prizrende kültür değeri olan namazgahın bakımı için bütçenin ayrılmadığını görmekteyiz, orada çalışanların iki yıl maaş almadığını hatırlatmak isterim ve bu personelin maaşa bağlanmasını Kültür Bakanlığının listesinde görmek arzusundayım.

Kültür Müdürlüğünün derneklerimizin ayakta kalmaları için yeteri kadar bütçe ayırmadığı da ortada. Kültür Bakanlığı bunu kendi merkez bütçesinden karşılamalıdır.

Prizren belediyesinin sadece 1 milyon yuroyu transit yoluna ayırmasının yetersiz olduğunu, yapılan otoban bağlantılarının hızlı bir şekilde yapılması iyileştirilmesi şarttır.

Prizren deresinin düzeltilmesi için ayrılan 1 milyon yuronun az olduğunu ve Prizren su sisteminin hızlı bir şekilde rehabilitasyonun yapılması gerekmektedir. Bugün Prizren susuzluktan kıvrınmaktadır. Su idaresinin ve belediyenin su projeleri üzerinde durmasını uyarmak istiyorum.

Son olarak herşeye rağmen bütçede 2011 yılına nazaran % 7-lik bir artış, Hükümetin çok iyimser olduğunu göstermektedir. Umarım bu öngörülen rakamlar yerine gelir ve Kosova ekonomik krize yakalanmadan bu kriz dalgasını zarar görmeden atlatır. Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka Bekim Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kabinet Qeveritar, të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht dua t'u uroj të gjithë deputetëve, qytetarëve të Republikës së Kosovës për përfundimin e 38 kilometrave të para të autostradës Vërmicë – Merdare.

Projektbuxheti i vitit 2012, është një projektbuxhet i dizajnuar mirë, për çka lëvdatat i shkojnë hartuesit, i cili në vitin 2012 parasheh suksesshëm vazhdimin e investimeve në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, ndërtimin dhe rehabilitimin e objekteve shkollore, spitaleve, qendrave të mjekësisë familjare dhe shumë projekteve tjera me rëndësi vitale për shtetin dhe qytetarët tanë.

Kategoria e pagave dhe mëditjeve, po ashtu paraqet një pjesë të rëndësishme të këtij buxheti, duke pasur parasysh se në vitin 2011 u realizua vendimi i Qeverisë për rritjen e pagave të mësuesve, personelit shëndetësor, shërbyesve civilë, të gjithë policëve,

pjesëtarëve të FSK-së, doganierëve, inspektorëve tatimorë, zjarrfikësve dhe ngritjen dhe mbështetjen për paga për të gjithë invalidët e luftës të UÇK-së dhe familjeve të dëshmorëve. Dhe, jemi në shqyrtim dhe të ligjit për veteranë të luftës dhe seanca më parë, në fillim të këtij Parlamenti kam qenë ai, i cili kam kërkuar që ky ligj të futet sa më parë në Parlament, nga se nuk do ta ndjenim veten mirë pa miratimin e këtij ligji.

Është ky projektbuxheti projekteve konkrete, i rritjes së mirëqenies qytetare dhe mundësive reale. Ndërsa po analizoja projektbuxhetin e vitit 2012, iu ktheva pak transkriptit të seancës së 25 marsit 2011, kur po shqyrtonim projektbuxhetin për vitin 2011. Atëherë, vërejtja disa shqetësime të disa skeptikëve të atëhershëm të opozitës, që deklarorin se me planifikim të buxhetit për vitin 2011, Kosova do të bankrotojë. Atëherë parashihnin jostabilitet financiar dhe paralajmëruan krizë buxhetore deri në kolaps total. Këto analiza dolën të ishin vlerësime false dhe të pamatura e të pasakta. Atëherë këta ekspertë, bashkë me disa gjoja ekspertë ekonomik të pavarur, deklarorin atë kohë se Kosova nuk ka kapacitete të ndërtojë autostradë dhe rrugë të reja e të ndjekë investime në infrastrukturë dhe njëkohësisht të rritë edhe pagat. Asnjë supozim i tyre nuk doli i saktë. Nga këta që thonin se po e shesim PTK-në për të shpëtuar nga kriza. Ja që edhe PTK-nuk u shit dhe krizë nuk pati. Por, pati sukses! Bile, ekspertët ndërkombëtar, Kosovën sot e shohin larg krizës së eurozonës. Kosova ka borxhin publik më të voglin në rajon dhe rritjen më të madhe ekonomike prej 5.3%, sipas vlerësimeve të Bankës Botërore dhe FMN-së. Ne do të dëshironim dhe synojmë rritje ekonomike edhe më të madhe, por këto janë mundësitë tona duke vlerësuar edhe rezultatet, që u arritën deri më tani në ekonomi. Në veçanti në gjigantin “Trepça”, për herë të parë këtë vit doli me bilanc pozitiv pas 30 vjetësh. Ndërsa, disa veç e kishin shpallur “dinozaur” të vdekur, por ja që falë menaxhimit të suksesshëm dhe mbështetjes qeveritare, ky gjigant u ringjall. Ata që tentuan atëherë të fusin panik e pasiguri te qytetarët, se do të bankrotojmë e do të ketë krizë, duhet të turpërohen të gjithë ata defetistë dhe t’u kërkojnë falje qytetarëve për shqetësimet dhe zhurmën që u shkaktuan.

Të nderuar kolegë deputetë,

Buxheti i Kosovës për herë të parë e prek shifrën prej 1.500.000.000. Para se Partia Demokratike të vinte në pushtet, ju kujtoj se në vitin 2007, buxheti i Kosovës ishte 717.000.000. Edhe nëse do të mohojë ndokush këtë rritje më shumë se të dyfishtë të buxhetit të Kosovës, shifrat flasin vetë. Dhe, përveç këtyre shifrave, flasin projektet e realizuara, të cilat qytetarët për çdo ditë i prekin dhe i shohin. Vërtet duhet mbështetur Qeverinë për punën e bërë dhe prioritetet e caktuara zhvillimore, duke reflektuar rritje të buxhetit për bujqësi, shëndetësi, ambient, kulturë, rini dhe sport.

Në sport për herë të parë, prioritetet vendosen drejtë. Investimeve në futboll si sporti më masovik u jepet prioritet në raport me vitet e kaluara. Tani kemi investime në kulturë, rini dhe sport mbi 4.000.000 euro projekte të përbashkëta me IPO-n, ndërsa në të kaluarën ka qenë 160.000 euro. Duke pasur parasysh se edhe Ligji për sport veç ka kaluar në leximin e parë dhe gradualisht po ngriten edhe kapacitetet infrastrukturore dhe ligjore në këtë lëmi.

Të nderuar deputetë,

Miratimi i buxhetit është çështje më madhore dhe më themelore për shtetin dhe si i tillë duhet trajtuar në mënyrë reale dhe serioze. Andaj, të nderuar kolegë, nuk do të duhej të përdorej apo, thënë më mirë, të keqpërdorej foltorja e këtij Parlamenti për shpërndarjen e të pavërtetave, se gjoja Qeveria ka shpërndarë para për investime kapitale në komuna, që udhëheq PDK-ja, gjë që nuk është aspak e vërtetë. Bile, thënë të drejtën, pas një analize të mirëfilltë shihet qartë se komunat të cilat nuk i udhëheqë PDK-ja, në investime kapitale janë të favorizuara dhe po argumentoj me fakte një gjë të tillë. Duke krahasuar 5 komuna, që udhëhiqen nga PDK-ja, me 5 komuna që nuk udhëhiqen nga PDK-ja, të cilat për nga numri i banorëve janë përafërsisht të barabarta dhe krahasojmë: Skenderajn, Drenasin, Malishevën, Vushtrrinë dhe Mitrovicën, që janë komuna që udhëhiqen nga PDK-ja, me Besianën, Rahovecin, Suharekën, Pejën dhe Gjakovën. Për investime kapitale janë paraparë në Skenderaj 2.895.000 euro, në Drenas 2.373.000 euro, në Malishevë 2.887.000 euro, në Vushtri 3.823.000 euro, në Mitrovicë 4.774.000 euro, apo gjithsej në 5 komuna 16.754.000 euro. Ndërsa, për investime kapitale në komunat të cilat nuk udhëhiqen nga PDK-ja, në Besianë janë paraparë, 5.321.000 euro, në Rahovec 3.138.000 euro, në Suharekë 5.088.000 euro, në Pejë 5.161.000 euro, në Gjakovë 5.690.000 euro, apo gjithsej në pesë komunat 24.879.000 euro, apo 8.124.000 euro më shumë investime kapitale në komunat që nuk udhëhiqen nga PDK-ja. Të nderuar nëse kësaj shifre i shtojmë edhe 32.370.000 euro të planifikuara në investimet kapitale, në komunën e Prishtinës, që është për t'u përshëndetur, atëherë në 6 komuna që nuk udhëhiqen nga PDK-ja janë planifikuar investime kapitale prej 57.249.000 euro, nga gjithsej 124.000.000 të parapara për investime kapitale për komuna, që gjithsej i bie 46% e buxhetit të planifikuar për investime kapitale në komuna. Kjo analizë rrëzon të gjitha deklaratimet e deritanishme se buxheti është ndarë në baza politike.

Duke falënderuar hartuesin e këtij projektbuxheti dhe marrjen për bazë të shumë kërkesave dhe rekomandimeve të organizatave buxhetore, kam disa propozime t'ia bashkëngjes këtij projekti, të cilat më pas do t'ia dorëzoj Komisionit për Buxhet dhe Financa. Kërkoj që të merret parasysh dhe të përfshihet në buxhet:

1. Kërkoj në veçanti ndarjen e më shumë mjeteve për zhvillim dhe hulumtim shkencor dhe pasurimin e universitetit me më shumë tituj shkencor, literaturë universitare.
2. Kërkoj të ndahen mjete për mirëmbajtjen e kompleksit memorial "Adem Jashari" në Prekaz dhe trajnimin e stafit të këtij memoriali.
3. Janë nja dy mullinj mbi 200-vjeçar, njëri në Kopiliç e tjetri në Kuçicë, për të cilët nuk duhen shumë mjete që të restaurohen, bashkë me Akademinë e Parë Ushtarake të UÇK-së në Açarëvë.
4. Kërkoj, gjithashtu, të ndahen mjete edhe për ngritjen e shtatores së Isa Boletinit në Mitrovicë dhe Kullës së Shaban Mangjollit në Mikushnicë.

Besoj që këto propozime nuk do të prishin tabelat projektuese, por do të pasurojnë ato dhe do të jenë në kornizat e planifikimeve për vitin 2012.

Të nderuar, ftoj të gjithë deputetët që ta përkrahin këtë buxhet, ngase është zhvillimor, kreativ, më i konsoliduar dhe më i fuqishëm se të gjithë buxhetet që deri më tani ka votuar ky Parlament. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Sadriu!

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për ju!

Përshëndetje për Kabinetin Qeveritar dhe për kolegët deputetë,

Unë do të mundohem të jem sa më i shkurtër, se po e shoh listën e të lajmëruarve për diskutim dhe do të fokusohem në dy çështje.

Mendoj se këta kufij buxhetor janë të atillë që nuk sigurojnë ndonjë zhvillim çfarë ka nevojë Kosova. Kjo është një çështje që, parimisht besoj se e pranojmë që të gjithë. Unë nuk kam ndërmend ta akuzoj Ministrinë e Financave pse nga doganat nuk kemi shumë më shumë të hyra, sepse e shohim që dogana nuk është as polici e as ushtri. Kufiri është çelë dhe se kemi një burim të hyrash atje nga nuk i vjelim, e pamë në periudhën kur u vu reciprociteti. Ishte një kohë relativisht e shkurtër, por patëm përnjëherë ngritje. Mendoj se burim të hyrash tjera mund të kërkojmë ose të adresojmë edhe te tatimet.

Për tatimin në pronë u fol shumë. Unë kam rezervat e mia, sepse ai është tatim i kuvendeve komunale dhe ato dirigjojnë me to. Duhet ta shikojmë, se nuk është gjithkund i njëjtë, po mendoj i realizueshëm dhe i përcaktuar me norma, por duhet të kemi parasysh edhe shkallën e inkasimit të tij, që është shumë e ultë. Ti mund ta ngritësh, por nuk do të kesh të hyra, sepse s'do të paguajnë njerëzit, do t'i biesh në situatë njerëzit kur dalin jashtë ligjit.

Një burim tjetër te Administrata Tatimore, mendoj zoti ministër, që mund të jetë një rezervë me pragun e tatimit të TVSH-së, që të zbritet nga 50.000 në 30.000. Ky projektion, unë kam folur edhe në një rast tjetër, ka qenë i planifikuar që më 2004 janë pranuar njerëzit, janë trajnuar njerëzit dhe ajo përfshinë një gamë më të madhe të tatimpaguesve. Ju e dini që të gjithë ata që janë nën 50.000 euro, ata tatohen me tatim të paragjykuar, që nuk është një tatim matës dhe shumë herë mund t'i sjell edhe punëtorët tuaj në situata të pakëndshme, sepse shkon në një formë negocimi.

Do të thotë, orientimi im është që të shikojmë të gjitha burimet e mundshme, që të kemi të hyra më shumë, sepse vetë fakti që shpenzimet i kemi më të mëdha se të hyrat, është diçka që na imponohet të gjithëve.

Unë do të ndalem te një kategori, që nuk u përmend, ose që u përmend shkarazi vetëm si nocion. Fjalën e kam për pensionet. Kategoria e pensionistëve, që në momentin kur është aplikuar dhe kur zbatohet. Ne nuk kemi fond pensional. Flas për tatimin bazë, shtyllën e parë, jo për shtyllën e dytë. Ai është një solidaritet i gjeneratës për gjeneratën dhe ai është aplikuar si i tillë, si rezultat i asaj që Serbia e ka plaçkitur fondin e pensionistëve. Mendoj

se edhe në negociata, nuk është dashtë të hiqet ai pozicion dhe nuk guxon të hiqet në asnjë moment, sepse aty është djersa dhe munda, jeta e njerëzve që e kanë lënë.

Paralel me këtë dua ta cekim edhe kursimet e qytetarëve, që nuk i përmend askush. Janë dy pozicione që ndërkombëtarisht Qeveria del e fuqishme, sepse është e drejtë themelore njerëzore. Nëse flasim për një të drejtë, është kjo. Dhe, Qeveria jonë ka bërë mirë që megjithatë ka bërë një solidaritet të gjeneratës për gjeneratën. Por, unë po e shoh që në momentin kur është vendosur atëherë, bazë, kriter për përcaktimin e një pensioni bazik, që bazohet në moshën 65 vjeçare, ka qenë shporta e domosdoshme, të cilën e ka hartuar Banka Botërore dhe unë e kam këtu, ka 45 artikuj me sasinë dhe me kalorinë që shporta duhet të përmbajë minimum 2.100 kilokalori. Këto kalori janë diçka e domosdoshme për ta mbajtur në jetë personin. Dhe, nëse e marrim dhe bëjmë analizë, mua më kujtohet më 2003, kur është aplikuar kjo, ka qenë një debat i gjerë në mes ekspertëve lokal dhe ndërkombëtarë. Ka pasur dhe profesorë të Harvardit dhe kemi diskutuar, sepse të gjitha parametrat na e jepnin se shporta në Kosovë, për të siguruar ato kilokalori duhet të ketë dikund 39.7 euro dhe ishte një propozim, që të shkojmë në 40 euro për pensionin. Dominoi mendimi se edhe pse është një konsum, megjithatë në proceset makroekonomike ndikon pozitivisht. Unë i bëra një shikim kësaj përmes indeksimit nëpër vite dhe, për çudi, më dolën këto rezultate që unë do t'ua komunikoj tash.

Në vitin 2005, pensioni nuk është dashur të jetë 40 euro, por është dashur të jetë pensioni 64.3 euro.

Në vitin 2007, pensioni është dashur të jetë, nëse duam të themi se po e përmbajmë shportën, gjithëherë i referohem kësaj, 71.4 euro.

Në vitin 2008, ky pension është dashur të jetë 83,3 euro.

Në vitin 2011, sillet mbi 94 euro. Nëse ia shtojmë edhe inflacionin e pritshëm, atëherë ky pension për vitin 2012 duhet të jetë rreth 100 euro. Çdo veprim tjetër, ne nuk iu kemi përmbajtur dhe këtë nuk mund ta kontestojë as Fondi Monetar, as Banka Botërore, as askush. Janë kategoria më e lënë pas dore dhe unë mendoj se i kemi hak në këtë drejtim, të bëjmë gjithçka që edhe kjo kategori të merr fatin e të tjerëve, që aty-këtu është reflektuar me rritje dhe Qeveria mburret, e kam bërë këtë, e kam bërë këtë. Është në natyrë të çdo Qeverie që e bën atë, por unë mendoj se kjo kategori është momenti i fundit kur bashkërisht duhet të reflektojmë të gjithë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka Albulena Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Është e pamundur të kalojë të paktën një javë pa e dëgjuar kryeministrin apo ministrin e Drejtësisë, që trumbetojnë pacenueshmërinë e sistemit të drejtësisë na ana e Qeverisë, duke e propaganduar edhe përkushtimin e tyre për pavarësinë e këtij sistemi.

Fatkeqësisht, ashtu sikur edhe në Raportin e Progresit, edhe ky projektbuxhet na e përforcon argumentin që kjo Qeveri nuk e ka në interes të saj forcimin dhe, rrjedhimisht, pavarësimin e gjyqësorit, por me sa shihet, punon për të kundërtën.

Unë po ndalem në një pjesë të Projektbuxhetit për vitin 2012, që ka të bëjë me institucionet e drejtësisë.

Siç jemi në dijeni, Kuvendi i Kosovës deri më tani ka miratuar një numër ligjesh, që kanë për bazë reformimin e sistemit të drejtësisë. Këto ligje, ndër të tjera, konsistojnë edhe në funksionalizimin e plotë të institucioneve të drejtësisë dhe ky funksionalizim nënkupton shtimin e numrit të punëtorëve të administratës, shtimin e numrit të gjyqtarëve, prokurorëve, trajnimit të tyre, si dhe shpenzime të tjera, që hyjnë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, si dhe shpenzimet kapitale. Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, në buxhetin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, vërehet shkurtim i buxhetit nga ana e Qeverisë, për 180 pozita të reja, kryesisht administrative për gjykatat dhe sekretariatet që janë më të rëndësishme për mbështetjen dhe forcimin e këtij institucioni. Gjithashtu, mosaprovimi i 29 pozitave të reja për programet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës e bënë edhe më të rëndë dhe jofunksional punën në këtë institucion.

Problematikë e njëjtë, për sa i përket shkurtimit të stafit, është përcjellë edhe te prokuroria e shtetit, tek pjesa që ka të bëjë me plotësimin e vendit të punës të sekretariatit të prokurorit të shtetit dhe po i njëjti mentalitet refuzues është paraqitur edhe te institucioni gjyqësor i Kosovës. Ne e dimë përgjigjen retorike të kësaj Qeverie mbi numrin e lartë të punëtorëve, që paguhet nga buxheti i shtetit, por në fakt është po kjo Qeveri, që stërngarkuar me staf të panevojshëm, që ka ardhur si rezultat i pazareve politike, duke punësuar militantë partiak, kushërinj, familjarë, nëpër tërë strukturën e Qeverisë, përfshirë edhe institucionet tjera, në të cilat njerëzit e kësaj Qeverie kanë ndikim.

Andaj zgjidhja është fare e thjeshtë. Hiqni nga puna këta militantë e familjarë nga pozitat fantome që ua keni krijuar dhe kështu i krijoni hapësirë institucioneve tjera për t'i plotësuar pozitat e nevojshme dhe të domosdoshme për funksionimin normal të gjykatave, Këshillit Gjyqësor si dhe prokurorive. Se këto shkurtime bëhen pa kurrfarë analize paraprake dhe pa konsulta të mirëfillta në institucionet në fjalë, përveç fakteve që i përmenda tregojnë edhe faktet në vazhdim, ku në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të institutit gjyqësor i Kosovës, i janë hequr mbi 100.000 euro nga kategoria mallra dhe shërbime, të cilat ky institucion i paplanifikuar për përgatitjen paraprake të kuadrove, pra për trajnimit të gjyqtarëve, prokurorëve, të paraparë me ligjin e ri për gjykatat dhe prokurorinë e shtetit. Ajo që vërehet, jo vetëm te kjo mendësi e shkurtimeve ndaj këtij institucioni, por edhe institucioneve tjera, është fakti se qeveria, në vend se t'i inkurajojë, ajo i ndëshkon mu ato institucione, të cilat arrijnë ta ruajnë buxhetin e tyre, rrjedhimisht edhe paranë e qytetarëve të Kosovës, përmes sigurimit të donacioneve nga jashtë, në kategori të caktuara. Ky mentalitet pastaj, sjell dukurinë e harxhimit të parasë publike pa plan nga ana e institucioneve, që vërehet sidomos gjatë fund vitit, për ta shmangur suficitin e, rrjedhimisht cilësimin, si të paaftë për të shpenzuar.

Ajo që bie në sy tek shpenzimet kapitale tek institucioni i prokurorit të shtetit është kërkesa për blerjen e automjeteve për nevojat e prokurorëve dhe mosfutja në projektbuxhet e kësaj kërkesë. Për mua absurd është fakti, që ky institucion përdorë ende makina të vjetra si të tipit “Llada”, “Niva”, që janë blerë që nga koha e UNMIK-ut dhe ku secila prej tyre krijon shpenzime të mirëmbajtjes gjatë vitit më të mëdha se sa vlera e tyre. Mirëpo, kulmi i absurditetit qëndron në atë se gjersa në njërin anë kemi institucionin e prokurorit të shtetit, që ballafaqohen me këtë problem të kësaj natyre, në anën tjetër kemi Qeverinë, ministrat, zëvendësministrat, këshilltarët, zyrtarët e lartë, të cilët janë dorëshilirë në blerjen dhe shfrytëzimin e makinave luksoze. Dhe, këtu shtrohet pyetja se, a është më i rëndësishëm luksi i qeveritarëve, apo siguria e gjykatësve dhe prokurorëve. Shembull për keqardhje është refuzimi i planit buxhetor të prokurorisë, që ka të bëjë me blerjen e kompjuterëve, fotokopjeve dhe pajisjeve tjera. Mjafton që ti vizitoni zyrat e prokurorëve dhe ta vëreni se në çfarë kushtesh punojnë dhe me çfarë pajisjesh operojnë dhe atë ta krahasoni me luksin, që e keni ju.

Unë mendoj se shkurtime të buxhetore në këto institucione janë në kundërshtim me vetë ligjet e miratuara nga ky Kuvend, për gjykatat dhe prokurorinë, me anë të së cilave synohet pavarësia dhe funksionalizimi i sistemit të drejtësisë. Pra, kjo Qeveri po ia merr paratë institucioneve të drejtësisë dhe këto para, përmes tenderomanisë, po i orienton kah kompanitë, me të cilat ka lidhje klienteliste dhe të cilat do të duhej të ishin objekt hetimi nga këto organe të drejtësisë.

KRYESUESI: Faleminderit!
Ministri e ka fjalën!

BEDRI HAMZA: Deputete e nderuar,
Kam nevojë të ta përkujtoj që nëse i referohem projektbuxhetit aktual, dy institucione, që ti iu referove, nuk kanë shkurtime, por kanë rritje të buxhetit. Po flas për Prokurorinë e shtetit dhe ka rritje të buxhetit për 13% dhe po flas për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i cili ka rritje të buxhetit për 14% dhe nëse i referoheni raportit 9 mujor për ekzekutimin e buxhetit, del që jo që kanë mungesë këto dy institucione, por kanë para dhe nuk e di që a kanë për ta shpenzuar krejt buxhetin a jo. Prandaj, ju lutem, referohuni projektbuxhetit dhe bëni krahasimet e sakta dhe del kjo rritje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Kundër replikë, deputetja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!
Unë po flas me problematikën që e kanë këto dy institucione. Unë vetë kam qenë në takim me këto dy institucione. Jam takuar madje me drejtorë të financave dhe më kanë treguar për problemet që i kanë. Andaj, përballë meje i kam kërkesat edhe të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, edhe të Institutit Gjyqësor të Kosovës, po ashtu edhe të prokurorisë. Kështu që, unë nuk e di se për çfarë rritje flet ministri, mirëpo nuk është edhe aspak e vërtetë.

KRYESUESI: Zoti ministër!

BEDRI HAMZA: Më vjen mirë që paske folur me drejtorët financiar të këtyre dy institucioneve. Kam folur me kryeprokurorin dhe kam folur me kryetarin e Këshillit Gjyqësor, që janë në hierarki pak më të lartë. Por, edhe po të këshilloj, merre buxhetin, krahasojë me buxhetin e vitit 2011 dhe del që rritja për Prokurorinë e shtetit është 13% dhe rritja për Këshillin Gjyqësor të Kosovës është 14%. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Idriz Vehapi, e ka fjalën!

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh faktin se buxheti është njëri nga dokumentet më kapitale në jetën institucionale të shtetit, kjo duhet të na bëjë të përgjegjshëm të gjithë neve me rastin e shqyrtimit dhe diskutimit të tij.

Arsye kryesore që më shtyn të shpreh bindjen time të plotë se ky draft-ligj për buxhetin duhet miratuar është se draft-ligji për buxhetin e vitit 2012 është i përgatitur në nivel të kënaqshëm, qoftë si strukturë, por edhe si përmbajtje.

Këtë e them për arsye se në këtë draft-buxhet projeksionet e të hyrave dhe shpërndarjeve buxhetore bazohen në vlerësimet afatmesme të gjithë treguesve kryesorë ekonomikë, por duke përfshirë këtu edhe lëvizjet që kanë të bëjnë me nivelin e importit, çmimet si dhe në vlerësimet mbi rritjen e performancës së institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave siç janë doganat dhe administrata tatimore.

Sa u përket të hyrave të përgjithshme buxhetore, është planifikuar të jenë 1.361 milionë euro, në këto të hyra është llogaritur edhe dividendat prej 35 milionë euro nga PTK-ja, po ashtu pjesë e të hyrave është llogaritur edhe shuma prej 30 milionë euro si mbështetje direkte buxhetore nga Banka Botërore.

Po ashtu, me rëndësi të përmendet, është përmendur fakti se në këtë draft-buxhet përfshihet edhe rritja e të hyrave brenda vendit, me vlerë 285 milionë euro ose 9.5% më shumë, krahasuar me buxhetin paraprak.

Përlllogaritjet për ngritjen në këtë kategori të hyrave janë të bazuara në rritjen e aktivitetit afarist në vend, i cili vjen si rezultat i rritjes së përgjithshme ekonomike si dhe në angazhimet e vazhdueshme për ngritjen e efikasitetit përbrenda Administratës Tatimore të Kosovës.

Po ashtu edhe kategoria e të hyrave jo tatimore dhe të hyrat vetanake është paraparë të jenë në nivelin 168 milionë euro ose 6% më shumë se sa në vitin paraprak.

Ky trend pozitiv i rritjes së të hyrave tatimore në vlerën prej 6.1% është paraparë të ndodhë në periudhën kohore prej vitit 2012 deri në vitin 2014.

Të nderuar deputetë,

Edhe për sa i përket shpenzimeve, po ashtu është paraparë ngritje për 7.6% krahasuar me vitin paraprak. Kjo rritje e nivelit të shpenzimeve kryesisht vjen si rezultat i rritjes së shpenzimeve kapitale në vlerë prej 15%, krahasuar me vitin paraprak.

Rol kryesor në ngritjen e kësaj kategorie të shpenzimeve ka shtimi i intensitetit të punimeve në ndërtimin e autostradës, si dhe është rezultat i rritjes së shpenzimeve të tjera kapitale.

Burim tjetër i rritjes së shpenzimeve buxhetore është edhe rritja e kategorisë së pagave dhe mëditjeve, që kryesisht kjo ka të bëjë me implementimin e plotë të ngritjes së pagave, që është bërë në fillim të vitit 2011 dhe si rezultat i themelimit të institucioneve të reja, të parapara në kuadër të një numri të caktuar të ligjeve të cilat janë të aprovuara nga ky Kuvend.

E gjithë kjo është bërë me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të mirëqenies, të punësuarve si dhe për ngritjen e cilësisë së shërbimeve të afëruara për qytetarët.

Ky projektbuxhet tregon për trende pozitive edhe për sa i përket investimeve publike dhe atyre private.

Të nderuar deputetë,

Në këtë projektbuxhet janë përfshirë të gjitha prioritetet e Qeverisë, siç janë: investimet në infrastrukturë, në arsim, në shëndetësi, në bujqësi dhe në fusha të tjera.

Me këtë rast do të përkujtoja që duhet të vazhdohet të investohet në fushën e arsimit e këtu me theks të veçantë në fushën e hulumtimeve shkencore.

Dhe, në fund, të nderuar deputetë,

Ky projektbuxhet duhet të përkrahet, sepse është dokument shumë mirë i përgatitur, është në interes të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe si i tillë është në funksion të plotë të zhvillimit të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Buxheti i vitit 2012 është buxhet jo zhvillimor, është buxhet shpenzues dhe jo i harmonizuar me Kornizën afatmesme 2012 – 2014, i hartuar dhe i miratuar nga Qeveria gjatë vitit 2011.

Ky buxhet nuk është i strukturuar mirë dhe ka probleme të njëjta sikurse buxheti i vitit 2011.

Asnjë nga objektivat e parapara me plan të Qeverisë, do të thotë, te kornizës afatmesme, nuk parashohin implementimin e buxhetit të vitit 2012 dhe është jashtë planit qeveritar.

Unë do t'i referohem disa sektorëve, që janë në gjendje jo të mirë brenda këtij buxheti për vitin 2012.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në total të buxheti për vitin 2012, është 64 milionë e 80 mijë euro dhe po t'i shikojmë zërat buxhetor si në investimet kapitale, subvencione, mallra dhe shërbime si dhe paga e mëditje, buxheti për Ministrinë e Mjedisit është 7 milionë e 900 mijë. Do të thotë 56 milionë e 140 mijë janë vetëm për shpronësime. Pra, buxhet shpenzues dhe jo zhvillimor dhe po ashtu mashtues për Ministrinë e Mjedisit. Kjo po dëshmohej se me këtë buxhet, kërkesat dhe problemet nuk do të zgjidhen, por do të thellohen akoma më tepër, sepse kjo Qeveri nuk është e interesuar t'i zgjidhë problemet e ujit, ajrit dhe mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi, të cilat drejtpërsëdrejti po ndikojnë në shëndetin e njeriut.

Po t'i referohemi Raportit të Progresit për Kosovën, është theksuar qartë se buxheti i Ministrisë së Mjedisit është i pamjaftueshëm dhe i zvogëluar. Prandaj, në vend që të kemi ngritje për të përmirësuar këtë kërkesë nga Komisioni Evropian, Qeveria e Kosovës akoma më tepër zvogëlon buxhetin për Ministrinë e Mjedisit, për vitin 2012.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë po ashtu është me të njëjtin buxhet sikur gjatë vitit 2011, që do të thotë buxheti për vitin 2012 është 6 milionë e 899 mijë euro. E kur dihet që brenda kësaj ministrie ka edhe planin e implementimit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe strategjinë industriale, po t'i referohemi Raportit të Progresit, kërkon që të ndahet buxhet adekuat nga autoritetet përgjegjëse dhe të ngritet buxheti për këtë ministri.

Me zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, që është dashur të jenë prioritet i Qeverisë, ne mendojmë se me zhvillimin e këtij sektori, siç po e bëjnë vendet në tranzicion, vendet në zhvillim dhe vendet më të zhvilluara, do të ndikojë direkt në uljen e papunësisë, por me këtë buxhet nuk ka perspektivë për këtë sektor.

Një çështje tjetër e cila është shumë e rëndësishme dhe kapitale për Republikën e Kosovës, është rinia, e cila është anashkaluar me buxhetin e vitit 2012. Buxheti për këtë sektor për vitin 2011 ka qenë 730 mijë euro, ndërsa për vitin 2012 është 738 mijë euro, do të thotë kemi ngritje vetëm 8.000 euro.

Premtimet e dhëna gjatë fushatave elektorale se do të keni një buxhet më të mirë, se do të keni vende të reja të punës, se do të keni një të ardhme më të mirë, po mbesin vetëm premtime dhe me thënien: “rinia është vetëm e ardhmja jonë” dhe nuk është e tashmja.

Po ta llogarisim këtë buxhet të ndarë për rininë duke u bazuar në Ligjin për fuqizimin e rinisë që përcakton moshën e rinisë 14 deri 24, buxheti vjetor për kokë të një të riut, është më pak se 50 centë. Edhe këtë vit nuk do të ketë buxhet për investime kapitale për

rininë, qendrat rinore ekzistuese si dhe OJQ-të rinore edhe këtë vit do të kenë të njëjtin buxhet sikurse gjatë vitit 2011.

Me këtë buxhet nuk po harmonizohen zërat buxhetorë përbrenda institucioneve dhe sektorëve, kemi dyfishime dhe sisteme paralele buxhetore për të njëjtat projekte. Këtë e ka dëshmuar dhe buxheti si dhe implementimi i disa projekteve për vitin 2011.

Në Ministrinë e Kulturës është themeluar Zyra për botimin e librave dhe për vitin 2011 kanë qenë të planifikuara vetëm 30 mijë euro, që përfitues kanë qenë më tepër se sa 10 autorë.

Ndërsa, Ministria e Arsimit, vetëm për një autor ndan 200 mijë euro, do të thotë privilegjohet një autor dhe anashkalohen shumë autorë të tjerë apo nënçmohen, po me të njëjtën titull akademik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Unë do t'iu qasem dy problemeve. Problemi i parë ka të bëjë dhe që u diskutua edhe sot edhe për buxhetin e kaluar, është për ndarjet regjionale.

Është mirë që një herë e përgjithmonë t'i jepet pikë kësaj çështje, për arsye se duhet në radhë të parë ta ndryshojmë vetë Ligjin e financave lokale dhe t'i ndërrojmë edhe vetë kriteret nëpër komuna, kështu që një ndarje e tillë nuk do të diskutohet më dhe nuk do të kemi çështje regjionale se me të vërtetë është një çështje e ndjeshme.

Unë dua të them vetëm një përvojë nga Zvicra, ku komuna më e zhvilluar i ndihmonte komunës më të pazhvilluar. Do të thotë, një parim të tillë mund ta bëjmë edhe ne dhe t'i klasifikojmë komunat më pak të zhvilluar dhe ato më zhvilluara dhe të ketë një solidaritet edhe brenda vetë komunave, kështu që do t'i kishim hequr një herë e përgjithmonë nga rendi i ditës këto ndarje regjionale.

Një çështje tjetër është sa i përket projektimit të buxhetit. Pra edhe në këtë vit po hymë pa një strategji të mirëfilltë të zhvillimit ekonomik, pa një strategji e cila duhet të përpilohet nga ekspertë dhe që duhet çdo qeveri, por edhe qeveritë e tjera që do të vijnë, të kenë një plan të mirëfilltë se kah duhet të shkojnë edhe shteti edhe zhvillimi ekonomik.

The më parë që gjatë ekspozesë suaj, që Qeveria i ka prioritet ndërmarrjet e vogla, sektorin privat dhe sektori privat mund të zhvillohet me ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

Sa i përket sektorit të industrisë të ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për vitin që vjen nuk kemi ndonjë projekt të ri dhe më vjen keq që këtu nuk është ministria e Tregtisë dhe

Industrië, se gjatë fushatës e ka pas punësuar krejt Kosovën, bile edhe komunitetin egjiptian në Gjakovë, i ka marrë bukur do vota se do t'i punësojë, bile e kanë pas qitur edhe në këngë edhe po e shoh që në projektbuxhet nuk ka paraparë që t'i rritë dhe t'i zhvillojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, sepse ato janë bartëse të zhvillimit ekonomik.

Një problem tjetër që do të kisha thënë te planifikimi i të hyrave, unë jam shumë i sigurt që të hyrat do t'i realizojë dhe do t'i tejkalojë, për arsye se shumë me mençuri ke planifikuar ato çka mund t'i realizosh, dhe për atë do t'i tejkalosh edhe të hyrat.

Mirëpo, a ka rrugë tjera që të hyrat të rriten? Unë besoj që ka rrugë. Dhe atë që e përmendi ish ministri Sadriu, është shumë me rëndësi, gjithashtu edhe kontrolli në pikat 1 dhe 31, dhe luftimi i ekonomisë joformale do të ndikonin në të hyrat më të mëdha buxhetore.

Unë këtë dua ta shoh si gatishmëri të kësaj qeverie për arsye se zhvillimi ekonomik dhe punësimi janë në të mirën e gjithë qytetarëve të Kosovës.

Një diçka tjetër, pra një karakteristikë është bartja e projekteve të investimeve kapitale. Mund të këqyrni vetëm Ministrinë e Komunitetit dhe Kthimit, ku bartja e një projekti prej një milion euro është duke u përsëritur që 5 vjet me radhë, projekti një, projekti nesër, është që pesë vjet, një milionë euro duke u përsëritur dhe nuk di çka është duke ndodhur dhe po vlen ajo fjala e popullit që thotë: "lagu sot e të rruaj nesër". Do të thotë ato para kanë mbetur që 5 vjet, janë duke u bartur, ndërsa ne kemi njerëz të komuniteteve tjera, të komunitetit egjiptian dhe shumë komuniteteve të cilat janë duke jetuar në kushte shumë të vështira. Sidomos, ministrja e Integritetit Evropian, ballafaqohet me probleme të njerëzve të kthyer dhe ato para le të gjuhen bile në Ministrinë e Integritetit dhe mund t'iu ndihmojnë njerëzve të cilët kthehen dhe mos të rrinë të bllokuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Anton Quni.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,
Ministra, zëvendëskryeministra,
Të nderuar deputetë,

Pa ndonjë qasje të them kështu të thellë në çështjen e Projektligjit për buxhetin 2012, unë do të kaloj menjëherë në çështjet konkrete dhe të prekshme, për të cilat qytetarët shprehin shqetësime, kërkesa e të tjera dhe për të cilat unë mendoj që Qeveria duhet të ketë kujdes dhe deri në leximin e dytë t'i ketë parasysh këto çështje.

Planifikimi i mjeteve për ndërtimin e Qendrës memoriale "Beteja e Koshares" është inkurajues për protagonistët e kësaj beteje, familjet e dëshmorëve dhe të gjithë qytetarët e Kosovës.

Por, po ashtu shprehim shqetësimin që mjetet e parapara gjithsej 900 mijë euro për 3 vitet e ardhshëm nuk janë të mjaftueshme për ndërtimin e një qendre reprezentative që simbolizon “Betejën e Koshares”, në të gjitha dimensionet e saj.

Po ashtu, parcelizimi i mjeteve për 3 vitet e ardhshme imponon një dinamikë të ngadalshme të ndërtimit dhe është shumë dekurajuese për kompanitë serioze që do të konkurronin në ndërtimin e saj.

Kërkoj nga autoritetet e Qeverisë që të bëjnë të ditur koston totale të paraparë dhe vitin e përfundimit të ndërtimit të Qendrës Memoriale “Beteja e Koshares”.

Çështja e radhës ka lidhje me Ligjin për veteranët. Ligji për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili është ende në procedim, parasheh edhe krijimin e një komisioni për verifikimin e saktë të pjesëmarrësve në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Me Projektligjin e buxhetit 2012, por as në tri vjetët e ardhshëm nuk janë paraparë fondet për ngritjen dhe punën e këtij komisioni. Shpresoj se ky fakt do të merret parasysh dhe në leximin e dytë të zotohen mjetet edhe për këtë çështje.

Nga aksioni i 25 korrikut, ne mësuam se mekanizmat për mbrojtjen e informatave janë të brishtë. Posaçërisht jemi të ndejshëm në fushën e telekomunikimit dhe radio-komunikimit. Qeveria duhet të ndërmarrë masa që të ndërtojë rrjetin e sigurt të komunikimit brenda institucioneve, organizatave dhe agjencive, me të cilin do të garantojë suksese në zbatimet e strategjive, realizimit të operacioneve dhe në fund mbrojtjen e personelit që punojnë në fushat e ndryshme të sigurisë.

Çështja e radhës ka të bëjë me sigurinë e nxënësve në trafik. Nuk do të ishte e mjaftueshme nëse për nxënësit dhe studentët ofrojmë edukim dhe arsimim të mirëfilltë, nëse për të njëjtit nuk ekzistojnë edhe masat e sigurisë. Shumë nxënës kalojnë me kilometra rrugëtim pranë rrugëve të ngarkuara me automjete, çdo ditë kemi raste të aksidenteve ku nxënësit lëndohen rënd apo po ashtu edhe humbin jetën.

E tillë është edhe situata në Shkollën Fillore “Atë Gjergj Fishta” në Bishtazhin në komunën e Gjakovës, ku shumë nxënës nga fshatrat përreth shërbehen me rrugën e asfaltuar në aksin Gjakovë – Prizren. Deri tani janë të shënuara 17 raste të aksidentimit të nxënësve, shumica prej tyre me pasoja vdekjeprurëse.

Ndërtimi i trotuarit dhe i një nënkalimi në masë të madhe do të ngrejë sigurinë e nxënësve të kësaj ane. Shpresoj që Ministria e Infrastrukturës, ajo e Arsimit, Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me pushtetin lokal të Gjakovës, do t’i kenë parasysh këto fakte.

Fshati Zhegër, është një ndër fshatrat më të mëdha të Kosovës, me pretendime që në një të afërme të fitojë statusin e komunës. Përbëhet nga rreth 1000 shtëpi, me rreth 6.000 banorë. Ky fshat i mirëpriti të gjitha partitë politike gjatë të gjitha fushatave ku u dhanë premtime nga ato reale deri tek ato futuristike. Por, ky fshat ende përballet me nevojat

elementare të infrastrukturës siç janë: rruga Zhegër – Ferizaj, kanalizimi, ujësjellësi, trotualet e tjera.

Në buxhetin e vitit 2012 nuk është paraparë ndonjë projekt i natyrës së tillë, prandaj është momenti që edhe ky fshat, nga institucionet e Kosovës, të përfitojë për një jetë më të mirë bashkëkohore.

Fshatrat Jasiq dhe Gjocaj, të përbëra nga rreth 100 shtëpi, të vendosura në thellësi të Bjeshkëve të Junikut, dikur vende me ekonomi solide, për shkak të kushteve të mira për blegtori dhe bujqësi, në kohë lufte qendra dhe vatra të rezistencës dhe luftës së armatosu, gjatë së cilës u shkatërruan deri në themel nga forcat ushtarake serbe, sot janë të pabanuara, të shkreta, me shkolla të demoluara, pa ndonjë lidhje të mirë rrugore me pjesën tjetër të Kosovës dhe pa ndonjë përkujdesje institucionale.

Banorët e këtyre fshatrave kryesisht banojnë në lagjet Agim Ramadani, në veri të Junikut, me leje të përkohshme dhe janë peng të zhvillimeve për të ardhmen e tyre.

Dëshira e tyre është që të kthehen në vatrat e tyre, por janë të pafuqishëm, pa ndihmën dhe pa përkujdesjen e institucioneve të Kosovës.

Prandaj, ne të gjithë iu kemi borxh këtyre banorëve, të cilët më tërë potencialin e tyre ishin në shërbim për çlirimin e Kosovës.

Shpresoj që në buxhetin e vitit 2012 edhe kjo çështje do të merret në konsideratë.

I nderuar kryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Krejt në fund, shpresoj që të gjitha këto çështje të ngritura do të figurojnë për trajtim në Buxhetin e vitit 2012 dhe se në leximin e dytë do t'i kemi në përputhje nevojat më të mundshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje Kabinetit qeveritar!

Sot kur e ndrydha pullën këtu, ma kujtoi Agron Llakën, do të bëhem milioner, aq shumë luanin numrat këtu, për 60 diku mbërrini.

E falënderoj edhe Agronin që po na bënë nganjëherë milionerë atje.

Unë desha të flas më shkurt kështu, se këta ekonomistë i thanë të gjitha ato, i tha edhe ministri, kryeministri edhe deputetët e ekonomisë. Po i kemi, më duket janë përzier do fusha këtu. Unë do të flas vetëm për komisionin të cilin e kemi të Bujqësisë dhe të Ambientit, dhe buxheti për këto dy ministri derisa ne kërkojmë shëndetin, derisa kërkojmë ambientin, derisa kërkojmë ushqimin dhe prodhimet vendore, sidomos të “Vetëvendosjes”- “dua je tendën”, nuk po na mjafton buxheti për këto dy ministri që të

kemi një ambient më të pastër dhe një ajër më të pastër, prandaj, kërkesa jonë dhe një kërkesë në emër të Komisionit, ka shkuar te ministri dhe në kryeministri që të rritet buxheti, pikërisht për këto dy ministri, sepse janë bazë- ministri e zhvillimit tonë ekonomik dhe të shëndetit.

Prandaj, unë nuk do të zgjatem më shumë, nuk do ta shfrytëzoj kohën krejt, po do t'ia lë, se ka mundësi ministri të bëjë ndonjë replikë dhe kështu që i duhet koha jonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Ministri, si duket, nuk do replikë.
Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, kryesues!
Në fakt, duke u munduar të jem racional në kohë, edhe unë do të fokusohem vetëm në një aspekt shumë të ngushtë të këtij projektbuxheti, në atë se çfarë ka paraparë Qeveria të ndajë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në fakt, buxheti për FSK-në, i paraparë këtu, nuk ndryshon shumë prej vitit të kaluar, ndryshimet janë shumë të vogla dhe shumë simbolike. Pra, së paku, për shkak të situatës dhe nivelit të zhvillimit të FSK-së, do të duhej të parashiheshin më shumë mjete atje, sidomos në shpenzime kapitale të parapara për këtë Forcë të Sigurisë, si ushtri e ardhshme e Kosovës.

Pra, ndryshimet janë pothuaj se simbolike, kanë të bëjnë me tepër me çështje teknike dhe si i tillë ky buxhet më tepër është si buxhet i mbijetesës së brishtë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe nuk bëhet fjalë për një buxhet i cili do ta zhvillonte këtë forcë dhe po ashtu një buxhet i cili do të ndihmonte në arritjen e kapaciteteve të plota apo racionale si një ndër synimet që ka kjo Forcë e Sigurisë së Kosovës që ta përmbushë para vitit 2013.

Në të njëjtën kohë më lejoni të theksoj, që së paku do të duhej që kërkesa e Departamentit për Menaxhimin e Financave të plotësohej, sepse s'ka qenë ndonjë kërkesë shumë e madhe që të plotësohej me një kërkesë çfarë ata kanë bërë kërkesë shtesë për rritjen e këtij buxheti dhe kjo kërkesë nuk ka qenë më shumë se 4.3 dhe as kjo kërkesë në këtë rast jo shumë e dukshme nuk është plotësuar nga Qeveria dhe mendoj që do të jetë një hendikep për zhvillimin e kësaj force në të ardhmen. Pra, ky departament dhe Forca në tërësi ka pasur nevojë gjithsesi edhe për 4.3 milionë euro, e cila do të ndihmonte zhvillimin apo do ta ndihmonte një lloj vijueshmërie të zhvillimit të kësaj force.

E di që ndoshta ju do të thoni që në rishikimin e buxhetit do të parashihet një gjë e tillë që Forcës së Sigurisë së Kosovës t'i zëvendësohen këto mjete, por, unë mendoj që do të duhej tani për shkak se kjo forcë qysh tani e bën planifikimin e zhvillimit dhe kjo forcë do të jetë e detyruar që ta planifikojë zhvillimin e saj me këtë masë të buxhetit, pra me buxhetin çfarë është paraparë në këtë vit prej 35.8 milionë eurosh.

Duke paraparë që të arrihen kapacitetet e plota personale, mendoj që Forcës së Sigurisë së Kosovës, i është pamundësuar një gjë e tillë sa i përket buxhetit dhe mendoj që FSK-ja ka pasur shumë nevojë kësaj radhe për një rritje aq sa ka kërkuar për mbështetje, pra FSK-ja ka nevojë për mbështetje. Me që kërkesat kanë qenë shumë racionale dhe kanë qenë më tepër për investime zhvillimore, që ka të bëjnë atje me automjetet e caktuara taktike, pastaj ka pasur edhe disa automjete tjera dhe pajisje tjera operacione për të cilat ka nevojë në përputhje me planin që ka zhvillimor, mendoj që ka pasur mundësi shumë reale që Forcës së Sigurisë së Kosovës, t'i plotësohet së paku edhe kjo kërkesë prej 4.3 milionë eurosh, që do ta arrinte në 40.1, më duket kështu ka qenë, është shuma totale, për të cilën ka qenë një kërkesë për buxhet shtesë për këtë Forcë të Sigurisë.

Ne duhet ta kemi parasysh se Forca e Sigurisë së Kosovës aspiron, me të drejtë, zhvillimin e saj për t'u bërë ushtria e Kosovës dhe mendoj me këso përkrahjesh do ta ketë shumë të vështirë, të mos them të pamundur, që t'i arrijë kapacitetet e veta të plota operacionale dhe që të kthehet vërtet në një ushtri të mirëfilltë çfarë ka nevojë Kosova.

Sidoqoftë, përqindja e përcaktuar e buxhetit të Kosovës, pra e buxhetit total të Kosovës, në këtë shkallë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, nuk është, jo vetëm respekt, po nuk është përkrahje për këtë Forcë dhe si e tillë Forcës së Sigurisë së Kosovës i keni siguruar vetëm një mbijetesë të brishtë, gjë që kam frikë që do të jetë e pamjaftueshme për FSK-n. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!
Unë do të ngutem për dy çështje.

Një, ngase tani kur po diskutojmë Projektbuxhetin për vitin 2012, edhe tash Qeveria e Kosovës po bën shpenzime pa nevojë, përderisa ne jemi duke diskutuar në sallë, veturat e kryeministrit dhe të ministrave ende janë ndezur, terë kohën po rrinë ndezur, me qëllim që mos të ftohen, të jenë të nxehta kur këta të kthehen.

Kështu që do të ndalem në dy çështje, thashë, shumë shkurt!
Një, në projektbuxhetin që është paraparë pikërisht për Ministrinë e Arsimit, që konsideroj që është një buxhet shumë i mangët, duke pasur parasysh që është momenti i fundit që kjo Qeveri të mendojë mirë se pa investuar në arsim e sidomos në cilësinë e arsimit, pra duhet të hartohen edhe politika shumë të drejta e shumë të sakta, investimi në arsim do të thotë, të investosh në një shoqëri të shëndoshë edhe në një shoqëri të pa korruptuar.

Më duhet t'ju them të nderuar qeveritarë, se nuk duhet të ndiheni komod kur thoni se kemi investuar në shkolla, sepse fatkeqësisht që nga 2009 s'kanë filluar shumë shkolla nga ish-ministri, i cili ia ka lënë një barrë të rëndë ministrit aktual për t'i përfunduar ato shkolla dhe në pamundësi për t'u përfunduar unë konsideroj se Kosova do të humbë edhe shumë e shumë euro të tjera, ngase edhe gjatë kësaj kohe ajo punë që është bërë po

dëmtohet. Tash e dimë që është edhe koha e dimrit dhe gjithçka mund të shkatërrohet derisa ne t'i gjejmë të hollat për t'i përfunduar ato.

Megjithatë edhe një çështje tjetër që duhet ta përmend, edhe Gjakova është Kosovë. Dhe, në Gjakovë nuk është bërë një gjë e mirë falë Qeverisë, por është bërë një gjë e mirë falë menaxhimit të drejtë të qeverisë lokale. Unë e falënderoj këtu, pikërisht ministrin e Financave, i cili ka bërë, këtë vit, ka dërguar në fakt një vlerë prej 300 mijë euro, një projekt shumë madhor, të cilin nuk do të mund ta përfundonte qeveria lokale, por ajo vlerë është shumë minimale. Unë besoj në vitin tjetër për ta përfunduar, megjithatë ka pas zëra po nga kjo Qeveri që e ka kundërshtuar këtë edhe mund të them lirisht ata që vijnë po nga Gjakova.

Prandaj, edhe një herë ju them, ka shumë projekte të Gjakovës, duhet t'i drejtoni sytë e shihni drejt Gjakova meriton shumë më shumë, Gjakova ka treguar që meriton shumë më shumë, prandaj janë shumë projekte sikurse tri hyrjet- daljet e qytetit të Gjakovës, projekte të cilat nuk kanë gjetur përgjigje sot e kësaj dite. Prandaj, unë i gëzohem çdo investimi kudo, në cilindo komunë të Kosovës, por më duhet të ju them edhe Projektbuxheti edhe buxheti i vitit 2009, edhe 2010 edhe ky projektbuxhet e ka një ndarje jo proporcionale. Pra, me keqardhje e them, më duhet ta bëjë një krahasim po ashtu me komunën e Skenderajt, ku për kokë të banorit është ndarë, do të thotë një me 17 është ndarja buxhetore. Them edhe një herë, çdo investim kudo që të bëhet është shumë i drejtë, por duhet të shikohet shumë më drejtë dhe shumë më shpejtë me urgjencë se zhvillimi ekonomik në komunën e Gjakovës nuk është në atë pikë, falë qeverisjes lokale, por falë kësaj qeverie. Prandaj, shikoni e mendoni drejt dhe shikoni edhe në Gjakovë duhet të bëni shumë më shumë për të zhvilluar ekonominë, sepse Gjakova meriton më shumë se shumë kund.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Fadil Demaku e ka fjalën.

FADIL DEMAKU: I nderuar nënkryetar,

I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektbuxheti i propozuar nga ana e Qeverisë është buxhet për zhvillimin ekonomik dhe është në harmoni të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Do të ishte me rëndësi që të mos paragjykojnë projektet nga ndikimet që mund të shfaqen nga tendencat e ndryshme të grupimeve politike, por të vazhdohet duke marrë në konsideratë nevojat e mëdha të qytetarëve, duke u bazuar në një trajtim të barabartë të tyre nga institucionet.

Nëse në një region nuk është investuar po thuaj se asgjë për vite të tëra e nëse tani kemi një rrugë e një shkollë më shumë, nuk bëhet fjalë për asnjë lloj privilegji, por vetëm për përgjegjësi institucionale ndaj kërkesave emergjente të qytetarëve të vendit për një trajtim të barabartë të tyre kudo, në cilin cep të vendit ndodhin ata.

Këtu duhet pasur parasysh mos zhvillimin e vazhduar të rajoneve të caktuara në vitet e shkuara dhe arsyet janë të njohura për të gjithë ne këtu.

Të nderuar deputetë,

Rritja e buxhetit për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është për t'u përshëndetur, sepse në këtë mënyrë stimulon sektorët më profitabil që nxitin rritjen e prodhimit vendor. Inkurajojmë Qeverinë në vazhdimin e rritjes së buxhetit për Ministrinë e Shëndetësisë, si sektori më i ndjeshëm i shoqërisë sonë. Rritja e buxhetit për Ministrinë e Arsimit, do jetë në shërbim të rritjes së cilësisë dhe performancës në avancimin e vazhduar të plan-programeve dhe përshtatjen e tyre me nevojat e tregut. Kjo është domosdoshmëri për të nxjerr kuadro që përballen suksesshëm me sfidat e së ardhmes.

Vazhdimi i projekteve në Ministrinë e Infrastrukturës, janë vazhdimësi për zhvillimin dhe hapjen në tregun e lirë dhe të gjithë të jenë të barabartë në raport me mundësitë e një shoqërie të hapur demokratike në atë treg.

Ndarja e buxhetit për Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, duke i plotësuar të gjitha kërkesat buxhetore ndaj këtij institucioni, është për t'u përshëndetur pasi që Qeveria ka vlerësuar me seriozitetin më të lartë punën dhe rolin e këtij institucioni për sigurinë e vendit, si parakusht i domosdoshëm për forcimin e shtetit dhe zhvillimin e tij ekonomik. Por, a është kjo e mjaftueshme, a është ky buxheti që i plotëson nevojat qytetare? Të gjithë do të dëshironim më tepër duke pasur parasysh kërkesat e mëdha dhe mundësitë e kufizuara.

Shikuar nga aspekti retrospektiv, Qeveria vazhdimisht është duke ndërtuar infrastrukturën legislative, administrative juridike, përafrimin e një ambienti optimal dhe atraktiv për biznese të huaja dhe vendore dhe, gjithë parametrat janë inkurajuese rreth këtyre çështjeve.

Projektbuxheti i propozuar këtu nga Qeveria, përcjell një mesazh të qartë tek të gjithë qytetarët e vendit pa asnjë lloj dallimi, se Qeveria është e përkushtuar dhe garanton zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social për vendin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Ju kisha lutur për pak qetësi, se po hidhërohet tani pjesa tjetër.

Sot po shqyrtojmë Projektbuxhetin për vitin 2012, do të ishte me rëndësi të veçantë që ky buxhet të kishte karakter të zhvillimit ekonomik, por edhe për një mirëqenie më të mirë sociale për qytetarët e vendit.

Shumicën e thanë edhe kolegët e mi deputetë, unë do ta trajtoj vetëm një çështje. Në vitin 2008, konkretisht po thuaj se i njëjti kabinet qeveritar, kur ka ardhur në pushtet me premtimet elektorale, por edhe vetë kryeministri i vendit është zotuar se do të ketë shkurtime buxhetore në aspektin e shpenzimeve të Kabinetit qeveritar.

Fatkeqësisht, edhe për vitin 2012, tani katër vite më vonë, kemi një stërngarkim të buxhetit të shpenzimeve, duke marrë parasysh se kjo Qeveri ka 19 ministra, 6 zëvendëskryeministra, 33 zëvendësministra dhe po thuaj se një kabinet qeveritar, pa llogaritur pjesën e këshilltarëve politikë, shoferëve dhe të gjitha këto shpenzime. Pse po e them këtë? Është e vërtetë se po të llogariten të gjitha shpenzimet të cilat jo me të drejtë e bëjnë një barasvlerësim me shpenzimet në aspektin social duke marrë parasysh se 335 mijë familje...domethënë janë në asistencë sociale, llogariten që 150 familje janë të papunë dhe me të gjitha këto shpenzime edhe për vitin 2012, nuk e karakterizon me premtime të cilat janë dhënë nga Qeveria se do të ketë shkurtime në këtë dikaster.

E dyta, shpenzimet e komunikimit të mallrave dhe shërbimeve dhe të gjitha këto po të llogariten bashkë, do të thotë që prekin direkt në jetën e qytetarit.

Zoti Kryeministër,

Kjo është një ndër temat më preokupuese ndoshta të cilat duhet me të drejtë të shqyrtohen, jo pse nuk është mundësia, por përkujdesja mungon në këtë drejtim, sepse ne kemi problem me hartimin e ligjeve që janë shumë rëndësi, që kemi edhe Ligjin e pensioneve, Ligjin e sigurimeve shëndetësore, Ligjin për kategoritë të dala na lufta e të tjerë.

Këto janë disa vërejtje parimore që duhet të shqyrtohen me kujdes dhe jo të jenë apo të bien në ndikim të interesave grupore apo partiake të partive politike të cilat janë në koalicionin qeverisës. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektbuxheti i vitit 2012, vlerësoj se është përgatitur në mënyrë shumë profesionale, si në aspektin profesional, ashtu edhe në atë teknik dhe propozon në mënyrë të qartë të hyrat dhe shpenzimet për kornizën afatmesme.

Doganat dhe Administrata Tatimore janë dy institucione kryesore në mbushjen e buxhetit. Këto dy institucione në vazhdimësi po tregojnë performancë shumë të mirë në realizimin e të hyrave. Ky rezultat tregon se ka pasur menaxhim efikas në këto organizata buxhetore.

Nëse i bëjmë një analizë buxhetit në përqindje, shihet që 40% është dedikuar për investime kapitale, 27% paga mëditje, 11.60% mallra dhe shërbime, 1.5% shpenzime komunale, 18.75% subvencione dhe transfere, dhe rreth 24% e buxhetit është ndarë për komunat.

Vazhdimi i financimit të projektit të autostradës për 240 milionë euro për vitin 2012 është në të mirë të gjithë qytetarëve të vendit. Kjo është vërtetuar me lëshimin në qarkullim të 38 kilometrave të parë të kësaj autostrade. Dhe, rrugëtimi nëpër ato kilometra të autostradës me të vërtet na bënë të ndihemi se edhe ne jemi pjesë e Evropës së zhvilluar dhe kush nga ne këtu nuk e përkrah financimin e këtij projekti, me të vërtetë është larg realitetit që po ndodhë në Kosovë.

Është treguar qartë se Qeveria di të menaxhojë mirë me buxhetin dhe atë edhe me projektet madhështore zhvilluese, siç është autostrada, rritja e buxhetit në sektorin e bujqësisë, rritja e pagave që për shumë kënd ka qenë e pa paramenduara dhe i ka nxitur për prononcime dashakëqija të stilit se Kosova do të pësojë kolaps ekonomik dhe financiar e tjera e tjera. Por, të gjitha këto u demantuan fuqishëm dhe po shihen qartë se planifikimi dhe menaxhimi i mirë i buxhetit nga Qeveria e Kosovës bëri që Kosova të jetë stabile në aspektin makroekonomik dhe financiar.

Krejt këto fakte që i përmenda, janë të paraqitura në raportin e Bankës Botërore nga vetë përfaqësuesi i kësaj banke, i cili deklaroi se Kosova është stabile në aspektin makroekonomik dhe financiar.

Edhe buxheti për vitin 2012 është i strukturuar mirë dhe i bazuar në burimet e qëndrueshme financiare, që garantojnë se edhe viti 2012 do të jetë një vit i suksesshëm dhe me të arriturat e reja të Kosovës, të cilat dita-ditës po ofrojnë Kosovën drejt qëllimit tonë të përbashkët, integritit në Bashkimin Evropian.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, ju ftoj që ta votojmë këtë buxhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Poštovani predsjedavajući,
Predstavnići vlade,
Kolege poslanici,
Uvaženi građani,

Želim da se u ime Bošnjačke zajednice zahvalim Vladi Kosova i rukovodstvu opštine Prizren na budžetu za 2011. godine, odnosno za sva finansijska ulaganja u Bošnjačkim sredinama za sve kapitalne investicije, odnosno infrastrukturne projekte, izgradnja lokalnih puteva, rekonstrukcija vodovodne i kanalizacione mreže, obnova električne mreže, izgradnja kulturno - sportskih sala i terena, tako da u potpunosti podržavamo budžet Vlade Kosova za 2012. godinu, kao i ekonomski rast naše zemlje od 5%.

Koristim priliku da se za ovom govornicom zahvalim ministru za infrastrukturu, gospodinu Mujoti, koji je za 2012. godinu izdvojio finansijska ulaganja za lokalni put Prizren - Jablanica, koga stanovništvo tog kraja čeka već 40. godina, kao i ministru za rad i socijalna pitanja, gospodinu Rašiću koji realizuje projekte koji su od prioritetne važnosti za Bošnjačku zajednicu. Naravno, sve ovo ne bi bilo dobro bez dobrog menažiranja ministra za financije.

Pozivamo ministra za poljoprivredu da 2012. godine uloži u poljoprivredne projekte na ograncima Šar-planine, da aktivira proces ruralnog razvoja gde to područje ispunjava i zadovoljava sve prirodne i privredne potencijale koji utiču na rast i ekonomski razvoj naše zemlje. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues,
Të nderuar Kabinet qeveritar,
Kryeministër,
Të nderuar kolegë,

Me qenë se zgjati shumë edhe nuk jemi duke parë ndonjë analizë shumë të thukët, unë nuk do t'ju marrë shumë kohë lidhur me buxhetin, sepse mungojnë kritikën reale që të anashkalohet ose të mos votohet ky buxhet dhe mendoj që duhet të kalohet dhe mendoj që, buxheti që është ky që është, janë arritur rezultate të mjaftueshme, të prekshme, të matshme, të kapshme, të cilat janë për t'u vlerësuar edhe nga qytetarët e Republikës së Kosovës, me të gjitha dobësitë përcjellëse të tij dhe, megjithatë, pretendimet të cilat paraqiten për buxhetin e vitit 2012, në shumë fusha nga dëshira dhe nevoja që ka, është e vërtetë që nuk mund të arrihen ato që ne kishim pasur dëshirë të jemi edhe me standarde të bashkimit Evropian, si shtet që aspirojmë të jemi në familjen e tyre.

Mendoj që nëse shtrohet pyetja se cili është raporti i Republikës së Kosovës me këtë buxhet në institucionet ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar, janë premtues relacionet përkundër koketimeve të cilat janë thirrur se ky shtet do të jetë i falimentuar, kjo qeveri do të jetë e bankrotuar, megjithatë është duke ruajtur parametrat financiar stabil dhe të kontrollueshëm, pavarësisht situatës së përgjithshme globale të krizës së sotme ekonomike e cila ka përfshirë tanimë edhe shtetet në fqinjësinë tonë siç janë Greqia e Italia, por nuk reflektojnë në situatën tonë financiare.

Duke u nisur nga Raporti i Progresit i cili paraqet për buxhetin, jep instruksione të qarta për mekanizmat mbrojtës për të cilët duhet të jetë e kujdesshme, Qeveria e Republikës së Kosovës, duke filluar nga evazioni fiskal, pastrimi i parasë dhe kontrolli më i mirë i menaxhimit të parasë publike. Këto janë sfida të cilat Qeverinë, në vitin 2012, do ta përcjellin Qeverinë dhe të cilat sigurisht do të evidentojnë si rezultate.

Mendoj në fund fare që Republika e Kosovës ka vendosur shumë mirë orientimin që bujqësisë është duke i përkushtuar një vëmendje të veçantë, janë disa sfida të radhës që i kanosen sot njerëzimit, por edhe Kosova nuk mund të jetë i imonizuar nga kjo, ushqimi i

cili është shumë i shtrenjtë dhe energjia e cila është një sfidë globale sot në tërë rruzullin tokësor.

Prandaj, në bujqësi mendoj që nëse analizohen më shumë investimet, do të jetë shumë më mirë, sepse do të rriten edhe vendet e punës, dhe do të jetë prodhimi i brendshëm më i mirë për të mos lejuar që paraja jonë të kalojë në shtetet tjera vetëm për ushqim.

Unë dëgjova shumë pjesë, pa dashur t'i vlerësoj edhe për kontestimin e ndërtimit të shkollave, mirëpo unë u habita për shkollat, ndërtimet që janë bërë në Kosovë edhe disa nuk i vlerësuan që kjo është një arritje edhe nga aspekti ekonomik është një arritje, sepse një fëmijë i cili shkollohet në një institucion të pastër, të ngrohtë, ai nuk do të jetë i sëmurë, nesër në ambientet në çfarë ka shkuar dhe automatikisht ose në mënyrë indirekte shteti do të harxhojë për shëndetin e tij nga ky buxhet që është i varfër.

Prandaj, dekurajimi që mundohet t'iu bëhet investimeve që ka vendosur Qeveria e Republikës së Kosovës, me këtë 3 -vjeçar të kaluar edhe në këtë gjysmë buxhet, sepse buxheti i vitit 2011 është miratuar para 6 muajsh këtu në këtë Parlament, ku ka pasur edhe kundërshtime fizike për t'u aprovuar ky buxhet, megjithatë sot është krijuar një stabilitet i cili neve na jep siguri dhe të jemi të kujdesshëm që ta afirmojmë dhe ta ndërtojmë së bashku nga aspekti i pjesës që i takon legjislativit dhe monitorimin t'ia bëjmë sa më mirë ekzekutivit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Lirije Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit!

Përsëritës punët e mira që janë munduar të bëhen me përpilimin e këtij buxheti, fundja e kemi një obligim si institucione të shtetit, por nuk mundem pa filluar nga fjalët e para të kryeministrit, që deklaroi se është buxhet i premtimeve të mbajtura.

Nëse flasim për buxhet dhe bëjmë krahasime, gjithëherë duhet pasur parasysh totalin e buxhetit e jo të krahasohemi me vitet paraprake, kur as nuk kemi qenë shtet.

Një përkujtim, i nderuar, se nëse është buxheti i premtimeve të mbajtura, shifrat thonë diçka ndryshe. Nga 100 milionë euro të premtuara, në Gjilan janë ndarë 1 milion e 349 mijë euro dhe ju keni folur të vërtetën vetëm 1.3%, zoti kryeministër, e vërteta në fjalën e juaj është 1.3% nga shifrat, shifrat e thonë këtë.

Shqetësimi është edhe më i madh kur nuk shihet përparim as në vitet në vazhdim. I kemi parë edhe vitet vijuese, nuk ka rritje, ka një përqindje shumë të vogël që nuk ia vlen të theksohet.

Duke nxjerrë shifrat nga totali i shpenzimeve, po ju përmend se Gjilani shfrytëzon vetëm 0.58% të buxhetit, ndërsa përqindja e popullatës në nivel shteti është 5%, shtuar kësaj shifre edhe vijën kufitare me Serbinë dhe Maqedoninë, ku shqiptarët nuk trajtohen si duhet, por sidomos shqiptarët e mbetur në kufijtë administrativ të Serbisë. Përndryshe, sa

herë që e përmendni Preshevën, Bujanovcin e të tjerë, tingëllon si një demagogji e kulluar.

Edhe disa mahi të këtij buxheti janë 2 – 3 kategori që do t'i përmendi shkurtazi. Fondi për përkrahjen e botimeve në Ministrinë e kulturës, që e përmendi Hamiti, është qesharak. Nëse trashëgimia kulturore na është e politizuar dhe nëse ajo ka qenë pjesë e obligimeve për statusin, askush nuk e ndal Qeverinë të investojë në argumentimin shkencor të trashëgimisë kulturore. Përkrahja e botimeve në këtë drejtim, kish për t'i ndejtur përballë politikës, e cila e përvetëson trashëgiminë nga Serbia.

Po ashtu, buxheti për Akademinë Shkencave dhe Arteve, me shifrën 704.000 euro, po ashtu është shumë nënçmues për institucionin prestigjioz siç është Akademia, dhe Agjencioni i Inteligjencës të Kosovës në këtë buxhet mbështet për këtë vit 1.300.000. Nuk është çudi që kur nxjerrim shifra, shohim se këtu operojnë shumë më mirë shërbime të huaja se tonat, nga se investojnë në këtë drejtim. Veç për krahasim, në Serbi e ke ndarjen buxhetore 40 milionë, ndërkohë që me 1 milion mund ta shohim sa mund t'iu rrimë karshi operimeve të shërbimeve tjera. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Kuleta e ka fjalën.

AGIM KULETA: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!
Duke pasur parasysh që shumë gjëra u thanë, unë do të përpiqem të jem më i shkurtër. Ajo që vazhdon të mbetet brengë kryesore dhe e përhershme rreth të gjitha projektbuxheteve që paraqiten në këtë Kuvend, është raporti i pafavorshëm midis të hyrave doganore dhe atyre vendore.

E keqe është se as në këtë Projektbuxhet nuk vërehet ndonjë tendencë për ndryshim të qasjes në këtë drejtim. Me gjithë faktin që sipas Projektbuxhetit për vitin 2012 vërehet, për shembull, një rritje e shpenzimeve të parapara për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në krahasim me vitin e kaluar, një dikaster që mbulon një ndër sektorët që ndikon në rritjen e të hyrave vendore, megjithatë kjo rritje më tepër si rezultat i ndonjë vendimi eventual për kthesë në politikat ekonomike të Qeverisë, është rezultat i rritjes së përgjithshme që ka pësuar buxheti i vitit të ardhshëm, që ne e kemi tani për tani si projekt të propozuar. Pra, në fakt, nuk kemi të bëjmë me ndonjë ndërhyrje substanciale pozitive në orientimin e deritashëm të politikave ekonomike të vendit. Sa i përket pasqyrës tabelore në të cilën paraqiten të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme të Qeverisë, si dhe shpjegimeve që jepen në brendi të tekstit të këtij projektligji, mund të konstatohen mangësi të shumta që kanë të bëjnë me specifikimin e të hyrave, qoftë të atyre doganore apo të atyre vendore. Pra, në këtë dokument kemi të dhëna vetëm se të hyrat doganore pritet të jenë 860 milionë, ndërkohë që nuk specifikon se sa prej tyre do të jenë në formë të tarifave doganore, sa në formë të akcizës dhe sa në formë të TVSH-së.

Ndërsa, sa iu përket të hyrave vendore, hasim shifrën 285 milionë, por nuk është specifikuar se sa prej tyre do të jenë të hyra nga TVSH-ja, sa nga tatimi mbi të ardhurat personale, tatimeve nga bizneset dhe kështu me radhë.

Specifikimi i këtyre të dhënave është me rëndësi të madhe sepse do të kthjellonte pasqyrën reale të zhvillimit ekonomik. Për shembull, nëse marrim parasysh të hyrat vendore të vitit të kaluar, që vlerësohet të jenë 261 milion euro, një përqindje shumë e madhe e këtyre të hyrave sipas ekspertëve buron nga dënimet, pra gjobat që u vihen subjekteve. Kjo mund të duket tërheqëse për arsye se ndikon në mbushjen e shpejtë të arkës të Qeverisë, por në plan afatgjatë vazhdimi me këtë logjikë do të ndikojë në dobësimin çdo ditë e më tepër të kapaciteteve të këtyre subjekteve ekonomike për ta zhvilluar biznesin e tyre. Rrjedhimisht, do të ndikojnë edhe negativisht në zhvillimin e ekonomisë së vendit në përgjithësi. Në këtë rast ideja nuk është që këto subjekte ekonomike të lejohen të bëjnë shkelje e të mos dënohen, por që të eliminohen shkaqet që i shtyjnë këto subjekte t'i bëjnë këto shkelje, për të cilat pastaj detyrohen të paguajnë gjoba.

Sa i përket diferencës midis të hyrave vendore të vitit 2011, që vlerësohen 261 milionë euro, dhe atyre që planifikohen të mblidhen në vitin 2012, e që kapin shifrën 285 milionë, konsiderojmë se një rritje prej 24 milion euro, që pritet të jetë si rezultat i rritjes së aktivitetit afarist, zgjerimit të bazës tatimore dhe uljes së evazionit fiskal, nuk paraqet një lajm edhe aq të mirë. Ajo që na frenon t'i gëzohemi këtij lajmi, është përveç nivelit të ulët të rritjes së aktivitetit afarist, po ashtu edhe mungesat e efikasitetit të luftimit të evazionit fiskal.

Sipas FMN-së dhe Bankës Botërore, evazoni fiskal në Kosovë, llogaritet të jetë midis 38 e 42%, që përbën një përqindje shumë alarmante kur kemi parasysh që në shtetet anëtare të OISD-së ky evazion vlerësohet të jetë 7.5 deri në 8.1%.

Përfundimisht, Lëvizja për Bashkim, duke pasur parasysh këto dhe shumë vërejtje tjera që u përmendën, këtë projektbuxhet nuk e konsideron projektbuxhet të zhvillimit ekonomik të Kosovës, por projektbuxhet të mbijetesës sociale të qytetarëve të saj. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Ju faleminderit!
Vjollca Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Gjatë këtij legjislacioni është diskutuar nganjëherë për një nga brengat e shoqërisë sonë, konkretisht rininë, e në veçanti sportin. Andaj, edhe do të doja të them se pse ky segment kaq vital nuk ka trajtim më serioz dhe më fundamental, kur e dimë se në Kosovë frekuenton një numër i madh impozant aktivistësh.

Të nderuar kolegë,

Getoizimi i sportit kosovar është plotësisht i paarsyeshëm nga ndërkombëtarët, por shumë herë edhe nga ne vet, sepse vet kemi bërë që sporti të jetë i marginalizuar dhe shumë i varfër. Kemi një rritje të vogël të buxhetit, sigurisht do të jetë një shtyllë dhe shpresë për të gjithë ata që marrin pjesën në organizimin dhe zhvillimin e sportit, por jo të gjithë mund t'i shijojnë të mirat nga ky buxhet.

Të nderuar kolegë,

Jam koshiente për vështirësitë financiare, çështje që preokupon secilin prej nesh, por më duhet të them se sporti, si një hallkë e rëndësishme e zinxhirit të kësaj bote, meriton më shumë mjete, por meriton edhe më shumë vëmendje. Jam e vetëdijshme se ndoshta asnjë shtet nuk e ka prioritet sportin, por asnjë shtet nuk e ka lënë në mëshirë të qytetarëve, të njerëzve të vullnetshëm, gjë që edhe numri i tyre po bie dita më ditë, sepse janë shterur xhepat familjar për të mbajtur gjallë këtë segment. Ashtu sikurse në vitin e kaluar, në këto tabela financiare kemi disa halla sportive në disa komuna, por Kosova nuk e ka asnjë stadium i cili do të plotësonte kriteret ndërkombëtare, nëse do të pranohet ky sport na UEF-a dhe FIF-a. Pse nuk rregullohet stadiumi i futbollit të Prishtinës, në mënyrë që kryeqendra ta ketë një stadium të kompletuar. Pse salla “1 tetori” ka mbetur e pa shfrytëzuar dhe i tërë fluksi i klubeve është i orientuar drejt Pallatit të Rinisë, pallat ky që e ka vetëm një sallë funksionale.

Qeveritarët dhe politikanët këtë sallë e shohin një herë në 4 vite, atëherë kur kemi fushata parazgjedhore. Në këtë Parlament kemi miratuar në lexim të parë Ligjin për sport, por as këto ndryshime dhe plotësime të vogla nuk ndryshojnë asgjë në aspektin financiar. Ligji për sponzorizim po vonohet, gjë që është njëra nga format e ndihmës së nevojshme që mund t'i ofrohet sportit.

Para disa ditësh diskutuam për Raportin e Progresit, i pamë sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohemi. Kosova zë vend në këtë raport, si vend i trafikimit të narkotikëve, por edhe i konsumimit të drogës. Në mënyrë që rinia jonë, e cila e përbën pjesën më të madhe të shoqërisë, të jetë sa më lartë këtyre dukurive, duhet të merremi më tepër, t'i kushtojmë vëmendje dhe seriozitet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ramë Vataj e ka fjalën.

RAMË VATAJ: Ju, faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Tani kur po diskutojmë miratimin e buxhetit për vitin 2012, nuk mund të mohojmë rritjen e dukshme të buxhetit për disa ministri, që është për ta përshëndetur

E përgëzoj ministrin e Financave, zotin Hamza që ka paraqitur Projektbuxhetin për vitin 2012 në mënyrë të argumentuar me shifra dhe që ishte shumë real në diskutim, ndërsa më gëzon fakti që edhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka një rritje të

buxhetit në krahasim me vitin 2011, për afër 18%. Megjithatë, unë mendoj se duhet edhe më shumë buxhet për shkencë dhe arsim të lartë, tash që kemi edhe universitetin e dytë shtetëror.

Unë kam një kërkesë që njëherësh është edhe kërkesë e dëshirë e profesorëve dhe e studentëve tanë për ndarjen e një buxheti shtesë prej 3 milionëve për Ministrinë e Arsimit që për shkaqe, besoj, të arsyeshme nuk kanë mundur ta fusin me kohë në buxhetin e planifikuar. Është fjala për blerjen e disa librave shkencore dhe profesionale të nivelit universitar nga një shtëpi botuese e Maqedonisë “Tabernakul”, ku janë të përkthyer në gjuhën shqipe 150 tituj të librave, të cilat përdoren në 10 universitetet më të njohura të botës, sipas listës së Shangait. Vlen të theksohet se përkthimi është bërë nga profesionistët e fushave të veçanta nga Republika e Shqipërisë dhe kualiteti i letrës dhe i ilustrimeve është i njëjtë me ata origjinal.

Kosova paguan vetëm punët teknike dhe letrën, ndërsa nuk paguan të drejtën e autorit as përkthimin, që i bie se këto libra janë gati falas, në krahasim me vlerën reale që e kanë ose mund ta kenë botimet në origjinal. Prandaj, prej 150 titujve nga 1000 ekzemplarë në vlerë prej 3 milionë euro, që i bie mesatarisht nga 20 euro për libër, ia vlen të investohet, duke marrë parasysh se kemi mungesë të literaturës nga autor botëror dhe mungesë të njohjes së gjuhës angleze nga studentë dhe një pjesë e stafit akademik. Besoj se kjo kërkesë do të amendamentohet deri në leximin e dytë të Projektligjit për buxhetin.

Të nderuar kolegë deputetë dhe anëtarët të Kabinetit qeveritar,
Votimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, e mbështes fuqishëm dhe kërkoj edhe nga kolegët tjerë deputetë të japin kontributin e tyre me propozime për përkrahjen e projekteve të përbashkëta që kalojnë kufijtë e lagjeve dhe fshatrave apo qyteteve prej nga vijnë. Besoj se do t’i tejkalojmë edhe interesat personale dhe inatet personale dhe partiake, në mënyrë që Kosova të vazhdojë të zhvillohet krahas vendeve tjera të rajonit dhe të integrohet më shpejt në Bashkësinë Evropiane. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit! Unë po e shoh që pak a shumë e keni humbur durimin për debat.

(Ndërhyrje)

Jo, ne po e kryejmë sot, por ju a po i shkurton fjalët? Unë po mendoj se është mirë që disa t’i reduktojnë fjalët, janë edhe 19 deputetë të paraqitur, disa le t’i shkurtojnë edhe ta përfundojmë sonte. Nesër kemi edhe takime, kështu që ne po vazhdojmë, edhe komisionet i kanë punët e tyre, kështu që ne po vazhdojmë, por keni kujdes. Ndonjë le të tërhiqet, për shembull ata që i kanë me shkrim, le t’i dorëzojnë. Mirë, ju faleminderit, deputeti Hashim Dëshishku po e dorëzon fjalën e vet.

(Reagime nga salla)

Po, e tha fjalën tash! Ndokush prej pozitës, kush po e dorëzon fjalën?
Hasimja po e dorëzon fjalën e shkruar. Mirë, ju faleminderit!

Dikush tjetër? Alma, ti?

Vesimir Saviq po e dorëzon fjalën edhe ai,

Arsim Barjami po e dorëzon fjalën e vet.

Edhe Brati po më duket se po e dorëzon fjalën.

Hashim Deshishku dhe Hamza Bale po e dorëzojnë. Regjia, le t'i regjistrojë emrat që i thashë. Ata që u lajmëruar për t'i dorëzuar fjalët, edhe Bahri Thaqi, Lutfi Haziri dhe Rita Hajzeraj. Ju faleminderit shumë!

Atëherë, po ia japim fjalën Glauk Konjuvcës, le të përgatitet Vjosa Osmani. Regjia, fjalën deputetit Glauk Konjufca!

GLAUK KONJUFCA: Ju faleminderit!

Deputetë të Kuvendit të Kuvendit të Kosovës,

Mirë menaxhimi dhe mirë përdorimi i buxhetit publik është parakusht i një pushtetit demokratik, sepse buxheti publik është para e popullit. Detyra e një Qeverie të përgjegjshme është planifikimi i këtyre parave të taksapaguesve të Republikës së Kosovës për t'i dedikuar dhe shpërndarë ato në mënyrë sa më të mirë të mundshme, me ç'rast kriter themelor do të jenë nevojat e qytetarëve dhe zhvillimi i vendit. Vetëm në këtë kuptim, shteti e merr domethënien e tij të vërtetë, si mekanizëm të cilin njeriu e krijon për ta gëzuar lirinë, sigurinë, mirëqenien dhe zhvillimin, me fjalë të tjera për një jetë më të mirë.

Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2012, nuk është projektuar mbi këto parime dhe themele. Njëri prej kriterëve thelbësorë të një buxheti të mirë të planifikuar është dedikimi sa më racional i mbështetjes financiare sipas nevojave, duke pasur parasysh sidomos barazinë dhe mos diskriminimin e qytetarëve, komunave dhe rajoneve. Shikuar nga ky prizëm, buxheti i projektuar për vitin 2012, përmban diskriminim sektorial dhe gjeografik, Qeveria është përkujdesur që t'i favorizojë padrejtësisht me mbështetje më të madhe financiare ato komuna në të cilat udhëheq partia kryesore në pushtet, në kuptimin që përqindja e kontributit të granteve qeveritare në buxhetin përkatës komunal është më e lartë nëpër komunat ku pushtetin lokal e ka partia që e ka edhe pushtetin qendror dhe këtu mund të ketë justifikime që ndodhë kjo për arsye se ku ka përqindje më të vogël të granteve qeveritare, ajo përputhet me të hyrat më të mëdha të komunave, mirëpo kjo, për mendimin tim, nuk është arsye e mjaftueshme. Ky korrelacion tregon se shpërndarja gjeografike e buxhetit është ndikuar nga përkatësia partiake e pushteteve komunale e jo nga nevojat e vërteta të qytetarëve.

Kur një pushtet politik të mirat publike të cilat qytetarëve u takojnë me ligj, i trajton sipas përkatësisë së tyre partiake, ky është fundi i një pushteti demokratik.

Ndonëse diferencat rajonale nuk janë shumë të ashpra për arsye se po të ishin të tilla, do të vëreheshin nga vetë shifrat, diferencat janë zhvendosur si më të thella në nivelin e mikro menaxhimit lokal, pra në praktikat diskriminuese brenda komunale. Ka dhjetëra

raste nëpër fshatrat e Kosovës të cilat diskriminohen apo favorizohen në përfitimin apo mospërfitimin e mbështetjes financiare komunale për projekte infra-strukturore, varësisht orientimeve të tyre partiake, madje ka fshatra brenda të cilave rrugët shtrohen deri nëpër lagje të cilat kanë votuar për partinë në pushtet, dhe ndërpriten aty ku fillon ndonjë lagje e cila masivisht dihet se nuk ka votuar për partinë në pushtet.

Çka tregon kjo? Kjo tregon se ky pushtet politik, që aktualisht qeverisë me Kosovën, ka arritur që buxhetin publik, si një të mirë të përgjithshme e cila u takon të gjithëve, ta shndërrojë në instrument të ndikimit dhe kushtëzimit partiak, të shpërblimit apo ndëshkimit për bindjet politike. Kjo po ashtu është tipar i pushteteve jodemokratike, pra atëherë kur një të mirë publike që të takon me ligj, pushteti ta ofron vetëm në shkëmbim të lojalitetit dhe dëgjueshmërisë partiake.

Kjo është shenjë që tregon se ky pushtet buxhetin publik e ka uzurpuar dhe po e trajton si të ishte fond privat dhe prej këtu rrjedh edhe mendësia e këtij pushteti, i cili kur e kryen detyrën edhe obligimin e vet për të investuar aty ku duhet, pret që qytetarët të duartrokasnin, t'i falënderohen, bile, bile edhe t'i përgjërohen e t'ia japin votën edhe përkundër manipulimeve e korrupsionit të madh. Ndërkaq, edhe me këtë buxhet po vazhdon avazi i vjetër në raport me tri komunat veriore të Kosovës, të cilat nuk e njohin Republikën e Kosovës, kurse buxhetit tonë i marrin miliona. Te këto komuna ekziston një shpërputhje e pa tolerueshme mes kontributit të këtyre komunave në buxhet, përmes të hyrave si dhe shumës që buxheti i Republikës ua dedikon këtyre komunave.

Leposaviqit, për shembull, i ndahen 3 milionë buxhet, kurse kjo komunë kontribuon 10.000 euro. Raporti është 1 me 300. Zubin Potoku me 2 milionë euro, kurse të hyrat 10.000, raporti 1 me 200. Zveçani me buxhet 1.8 milion euro dhe kontribut prej 5200 euro, po ashtu tregon shpërputhje shumë drastike. Kjo tregon se sa më të padëgjueshme komunat e Kosovës dhe sa më shumë ato nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, aq më të shpërblyera janë ato. Ky mendoj se është një mesazh shumë i keq.

Ndonëse disa projekte infrastrukturore, siç janë rrugë të cilat lidhin fshatrat shqiptare atje, janë të domosdoshme, Qeveria nuk e di se sa nga këto para të buxhetit të Republikës së Kosovës, shfrytëzohen nga kuvendet e paligjshme komunale të këtyre tri komunave, të cilat nuk e njohin shtetin e Kosovës, për financimin e strukturave paralele, sidomos në fushat e arsimit dhe të shëndetësisë.

Në këtë mënyrë, Qeveria po shpenzon para të taksapaguesve, të cilat shfrytëzohen për strukturat kriminale dhe të paligjshme të ë Beogradit, të cilat e luftojnë pavarësinë e Republikës tonë dhe kjo është politikë ekonomike antishtetërore dhe nuk është në rregull. Është shumë e qartë që nëse analizohet po ashtu buxheti i ndarë nëpër komuna në krahasim me numrin e banorëve të komunave, vërehet edhe një qasje diskriminuese mbi baza etnike. Për shembull, mesatarja për kokë të banorit në komunën e Vitisë është 131 euro në vit, kurse në komunën e re të serbëve të Klllokotit, që është ndarë prej Vitisë, sipas planit të Ahtisarit, kemi buxhet 335 euro për kokë banori, në Graçanicë 412 euro, si dhe në Partesh 507 euro. Po ashtu, disa shuma simbolike të ndara për

komuna të mëdha, sa i përket fushave me rëndësi jetike, janë tejet jo serioze, në ndërkohë që Qeveria po ndanë 240 milionë euro në vit vetëm për një projekt, e kjo do të thotë 120 euro për kokë banori në vit, kur dihet që shumë më e mirë do të ishte një shpërndarje më racionale. Për shembull, vetëm ta marrim komunën e Gjilanit. Sa i përket shëndetësisë primare, në këtë komunë janë ndarë 22.000 euro ose 22 euro cent për kokë banori gjatë një viti. Kjo do të thotë, asgjë më shumë se nga një paracetamol kur të na dhemb koka nga propaganda e Qeverisë.

Për bujqësi, blegtori dhe pylltari në këtë komunë janë dhënë 83.000 euro ose 84 cent për kokë banori gjatë tërë vitit. Pastaj, pothuaj se në çdo komunë, zyrat e kryetarëve, vetëm zyrat, po e theksoj, kanë më shumë mbështetje financiare se sa drejtoritë për bujqësi, si dhe ato për kulturë, rini dhe sport. Këto mendoj se janë disa raporte shumë skandaloze të këtij buxheti, për çka mendoj që si të tilla nuk ia vlen të përkrahen. Ju faleminderit!

KRYTEARI: Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Meqenëse shumica e çështjeve që kisha ndërmend t'i përmend sot para jush, u thanë nga deputetët e LDK-së dhe si propozime konkrete u arsyetuan shumë mirë, në veçanti në fillim të kësaj seance. Unë do të ndalem vetëm në një aspekt dhe kjo ka të bëjë më shumë me këtë buxhet në kontekst të imazhit ndërkombëtar për Kosovën dhe do të lidhem, natyrisht, me ato u që thanë në Raportin e Progresit për vitin 2011, apo siç u quajt nga gazeta "The Economist" - raport i stagnimit për Kosovën. Ky raport ndër të tjera thotë se nevojitet dizajnim dhe implementim i një strategjie ekonomike koherente dhe kredibile për zhvillim ekonomik dhe të bëhet ndërlidhje e politikave prioritare, reformave strukturore dhe shpenzimeve publike.

Pa ashtu, përmend se ka një rritje ekonomike të dobët dhe të brishtë dhe një disbalanc të jashtëm të lartë, në veçanti në tregtinë e mallrave, prandaj edhe sugjerojmë që të merren masa për reduktimin e deficitit të lartë buxhetor dhe të rritet transparenca buxhetore.

Besoj se prezantimet e deputetëve të LDK-së në fillim të kësaj seance dëshmuar se as ky buxhet për vitin 2012 nuk ka marrë parasysh këta parametra të përmendur në Raportin e Progresit. Ju e dini se ne kemi thënë kur është diskutuar buxheti për vitin 2011, se Qeveria nuk do të marrë fondet prej 167 milionë euro për vitin 2011 nga FMN-ja, Banka Botërore dhe Komisioni Evropian, dhe donatorët e tjerë, si dhe nuk do të vijnë as 300 milionët nga shitja e PTK-së. Të gjitha vërejtjet tona u jetësuan gjatë këtij viti, pra edhe Qeveria nuk mori aspak mësim, fatkeqësisht, kjo po dëshmohet edhe me këtë projektbuxhet, sepse prishja e marrëveshjes me FMN-në tregon se kjo Qeveri nuk di t'i mbajë premtimet dhe nuk di t'i respektojë kontratat. Fatkeqësisht, kjo po e dëmton Kosovën ndërkombëtarisht dhe po minimizon çdo ditë e më shumë shanset e saj për t'u anëtarësuar në organizmat e tjerë ndërkombëtarë, në veçanti ata financiar.

Kosova, më specifkisht Qeveria ka vazhduar të neglizhojë procesin e anëtarësimit në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim edhe këtë vit, si dhe ka neglizhuar mundësinë për përfitimin e projekteve nga institucionet e tjera bankare. Përveç që ka ulur mundësitë për anëtarësime të tilla, këto sjellje të papërgjegjshme kanë për pasojë edhe dëmtimin e raporteve bilaterale me shtetet e tjera, që janë donatorë potencial që do ta ndihmonin zhvillimin e Kosovës në aspektin ekonomik. Për shkak të veprimeve të Qeverisë, tani Kosova shihet si partner jo serioz me të cilin nuk mund të zhvillohen dhe përforcohen raporte ekonomike. Si shembull konkret, SHBA-të kanë qenë shteti kyç që ka lobuar për Kosovën për anëtarësim në FMN dhe Bankë Botërore dhe një përkrahje e tillë i duhet Kosovës edhe për anëtarësime të tjera. Megjithatë, neglizhenca e Qeverisë ka bërë që shtetet mike tani të hezitojnë të marrin përsipër barrën e të lobuarit për Kosovën, meqë dihet se kjo Qeveri nuk i respekton obligimet ndërkombëtare.

Jostabiliteti ekonomik është një ndër arsyt kryesore për mungesë të investimeve të huaja direkte. Sipas të gjithë indikatorëve dhe raporteve ndërkombëtare në Kosovë, gjatë këtij viti ka pasur rënie të investimeve të huaja direkte në Kosovë. Të gjithë ata që merren me këtë fushë e dinë se fare mirë se një ndër arsyt kryesore për mungesë investimesh të huaja në një vend është, krahas sundimit të ligjit, edhe jo stabiliteti buxhetor dhe makro-financiar. Kjo është konfirmuar, po e them prapë, edhe në Raportin e Progresit, i cili po ashtu konfirmon se Qeveria nuk është e aftë të thitë donacione të huaja.

Të nderuar deputetë,

Edhe gjatë prezantimit të buxhetit të vitit 2011, kryeministri kishte thënë se buxheti është hartuar bashkë me miqtë tanë ndërkombëtarë, duke potencuar madje edhe pajtimin e FMN-së me atë projektbuxhet. Derisa Qeveria thoshte kështu, FMN-ja dhe Komisioni Evropian në zyrat tjera deklarorin pikërisht të kundërtën. Natyrisht që kjo u dëshmuar kur pak kohë pasi u miratua ai buxhet nga kjo Qeveri e pakicës, Fondi Monetar Ndërkombëtar prishi marrëveshjen stand-bay dhe transformoi atë në një marrëveshje për monitorim stafi, nga e cila Kosova nuk përfitoi asnjë cent gjatë këtij viti.

Sot Qeveria thotë po të njëjtën që pati thënë për buxhetin 2011, por na takon neve të vendosim nëse kemi marrë mësim. Sot Qeveria po ashtu thotë se Kosova është anëtare e barabartë dhe e përgjegjshme institucioneve ndërkombëtare, mirëpo ata që nuk respektojnë marrëveshjen ndërkombëtare dhe premtimet e dhëna nga anëtarësimet në institucione ndërkombëtare financiare, janë në fakt anëtarët më të papërgjegjshëm të komunitetit ndërkombëtar.

Së fundi, jemi të njoftuar të gjithë se në Raportin e Progresit është propozuar që të ndërtohet një plan gjithë përfshirës për veriun. Në sqarimet që, besoj, shumica prej nesh i kemi kërkuar nga Komisioni Evropian, na është thënë se kjo nënkupton një plan shumë më aktiv ekonomik për veriun e Kosovës. Fatkeqësisht, ky projektbuxhet nuk ka përfshirë projekte që do ta arsyetonin këtë kërkesë për zhvillim ekonomik të veriut të Kosovës, në veçanti të pjesës veriore të Mitrovicës, duke i lënë kështu hapësirë Serbisë që të investojë një pjesë të madhe të buxhetit të saj në veri të vendit tonë.

Shtrirja e sovranitetit, të nderuar deputetë, nuk bëhet me fjalime dhe prononcime, ajo bëhet pikërisht përmes një investimi e stimulimi ekonomik në atë pjesë.

Të nderuar deputetë,

Kjo Qeveri që ka dëmtuar imazhin e Kosovës në botë, po vazhdon që me çdo veprim të saj, përfshirë edhe me këtë projektbuxhet të propozuar që po e shqyrtojmë sot, t'i tregojë botës se nuk është Qeveri e aftë të udhëheqë me shtetin në këtë periudhë të rëndësishme për vendin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Do ta kisha tërhequr edhe unë fjalën, po të mos ishin dy arsye. Një, që kam për të thënë diçka që ende nuk e tha askush dhe, e detyra, tri herë e kam shtypur, dy herë ma ka fikur dikush, e nuk po di se çka po ndodhë. Sido që të jetë, zonja e zotërinj deputetë, ju përsëndes dhe e përsëndes këtë debat!

E përsëndes edhe Propozim-buxhetin e sjellë në Kuvend. Mendoj që do konstatuar fakti se është një buxhet i përgatitur mirë dhe i hartuar mirë dhe më vjen mirë që kësaj radhe nuk kemi probleme me vetë ligjin. Kemi disa dilema me shifrat, herën tjetër kishim edhe me ligjin.

Unë e përsëndes edhe rritjen e konstatuar në buxhet. Më gëzon sinqerisht dhe besoj që e gëzon secilin. Urojmë që të ketë edhe më shumë, megjithatë nuk do të isha i sinqertë po të mos them se i druaj pak kësaj euforisë tonë dhe prirjes që në njëfarë mënyre me noshalancë edhe të rrëshqasim në futje në borxhe. Nuk kemi paralajmërime, por as vendet që kanë pasur një ekonomi stabile nuk kanë pasur paralajmërime për pasojat që shumë shpejt pastaj u bënë pa rrugëdalje. Mund edhe të bëhet ndonjë vërejtje në projektligjin, besoj që megjithatë do të ishte më mirë sikur në ligj të ishin radhitur më mirë komunat, se po kemi telashe t'i gjejmë, as nuk ka kriter alfabeti, as nuk ka ndonjë kriter tjetër, madje as ministrinë.

Po ashtu, më bën përshtypje një fenomen që ka qenë i pranishëm edhe në propozim - buxhetet e mëparshme - shifrat e rrumbullakuara. Hiq disa raste kur kjo justifikohet me përmbajtjen e tyre, në të tjerat më del se janë paushalle dhe më del se procesi i ndërtimit të buxhetit është problematik. Nuk mund të jetë gjithkund 1 milion, 2 milionë, 3 milionë e tjera, sidomos për komunat, për një ministri ose për zërat të veçantë buxhetor. Dyshoj se aty jo vetëm që nuk është ndërtuar mirë buxheti, po krijohet hapësirë edhe për abuzime.

Megjithatë, unë dua të vë theksin posaçërisht te një çështje që mendoj se do të duhej të gjente më shumë shprehje në ligj. Obligimet që ka Qeveria nga ligjet e miratuara në Kuvend, pa injoruar problemet e shumta sociale, siç janë pensionet e tjera, të cilat duhet të gjejnë një zgjidhje. Megjithatë, më lejoni që të theksoj veçanërisht çështjen e Ligjit për të burgosurit politikë, që ky Kuvend e ka miratuar para një viti dhe që e ka obliguar Qeverinë që të marrë masat e nevojshme përgatitore për vënie në jetë të këtij ligji.

Përsëritësish deklarimet, gatishmërinë e deklaruar të Qeverisë dhe të ministrave për vënien në jetë të këtij ligji por, për fat të keq, në projekt-propozim-ligj nuk shohim të jetë bërë ndonjë hap konkret.

Kemi marrë në konsideratë faktin se Qeveria është konstituuar dhe konsoliduar me vonesë, prandaj një vonesë edhe e kemi gëlltitur, por megjithatë mendoj që perioda që ka mbetur, duhet të shfrytëzohet për të kryer obligimet që Qeveria ka në raport me këtë ligj dhe me këtë kategori.

Tërheq vërejtjen, zonja dhe zotërinj, se fjala është për një kategori veçanërisht të dëmtuar, nuk po e përmend atë pjesën sa jemi borxh ndaj saj dhe kam parasysh veçanërisht gjeneratën e vjetër të saj, të cilët çdo ditë vdesin pa pasur mundësi të shohin asnjë të mirë konkrete, hiq të atyre të përgjithshme, për privacionet që kanë pasur. Faktet dëshmojnë, po ashtu, se është problem shumë më i lehtë edhe më i zgjidhshëm se sa që është menduar në fillim dhe mendoj se përvoja do ta dëshmojë këtë. Qasja që është përvijuar në ligj, ka qenë racionale, e menduar mirë dhe graduale. Është kërkuar kurrëgjë më shumë, madje as sa kanë të tjerët në vende tjera, por është krijuar një minimum i një zgjidhjeje që do të mund të konsiderohej meritore. Presim mirëkuptimin e të gjithëve në këtë drejtim.

Dhe, një çështje tjetër, me lejen tuaj, mendoj se imponohet pa lejuar që të rrëshqasim në pozita regjionale e provinciale. Megjithatë, edhe ky buxhet vuan nga një mungesë proporcioni midis pjesëve të ndryshme të Kosovës.

Zonja e zotërinj,

Është konstatim i përgjithshëm në pjesën lindore të Kosovës, do të thotë gjysmën e Kosovës, se kjo pjesë po lihet anash dhe, e vërteta, faktet e dëshmojnë këtë në shumë parametra. Bëni krahasimet dhe do të gjeni vetë konstatimet. Edhe në investimet kapitale, edhe në ato sektoriale, madje edhe ndërtimin e infrastrukturës. Unë mbështes të gjitha ato përpjekje që janë bërë që Kosova të jetë si gjithë bota, si gjithë Evropa, por shtrohet puna - e pse u dashka vetëm gjysma e Kosovës të përfitojë nga këto dhe jo gjysma tjetër, që është më shumë se kaq, sepse është edhe një pjesë përtej kufijve që është, po ashtu, e jona dhe duhet të kenë kujdes edhe për ta. Nëse flasim për Evropën pa kufi, le të shikojnë pra edhe në raport me Preshevën, Bujanovcin dhe gjithë Luginën.

Është, po ashtu, për ta realizuar edhe një fakt, që nga autostradat që po ndërtojmë ne, përfitojmë vetëm ne apo përfitojnë edhe të tjerët. Autostrada si këto tonat janë financuar nga burime kryesisht evropiane e ndërkombëtare. Nuk mund ta arsyetoj lehtë kur njerëzit ma bëjnë pyetjen - pse vetëm Kosova u dashka të bëjë autostrada, të cilat do t'i shfrytëzojnë të tjerët më shumë se ne, me dhjamin tonë të munguar, të paktë. Është mirë t'i tiganisim me dhjamin tonë, por kur kemi diçka. Nuk kemi aq sa ne të bëjmë autostrada edhe për të tjerët, siç po pretendohet. Por, nëse duhet të bëhet, le të shikojmë atëherë edhe përfshirjen e të gjitha pjesëve të Kosovës.

Shtrohet pyetja: nëse ishte e justifikuar që autostrada Prishtinë-Morinë ose Morinë – Merdare, si ju pëlqen të thonë, të devijohet për arsye edhe ekonomike e tjera, pse të mos analizohet edhe nevoja e devijimit të autostradës ose projektit të autostradës Prishtinë-Shkup në linjën që bashkon më mirë edhe Anamoravën dhe që me çdo kriter do të ishte më pak e kushtueshme, do të kursente pastaj edhe mjete edhe për shpronësimet e tjera, do ta ruante rrugën e vjetër dhe do të shërbente si bay-pas dhe ekspertët thonë se është zgjidhje shumë më racionale dhe më me nikoqirllëk.

Përveç tjerash, edhe rruga që po ashtu e lidhë Kosovën me korridorin e tetë, me Bujanovcin dhe Preshevën, do të duhej të kishte së paku në vokabularin tonë trajtimin që e kanë disa drejtime të tjera për shkak të lidhjes së veçantë, jo vetëm me këtë korridor, por edhe me Preshevën, Bujanovicin, Medvegjën e tjerat.

Besoj që në shqyrtimin e mëtejshëm do të merren në konsideratë këto sugjerime, si dhe sugjerimet tjera dhe do të bëjmë një projektligj që do të ishte më afër kërkesave të qytetarëve të të gjithë Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputeti Emin Gërbeshi e ka fjalën. Nuk është këtu. Mirë, deputeti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Qeveria e Kosovës ka përsëritur në vazhdimësi se vendi nuk ballafaqohet me krizë buxhetore. Ajo thoshte se të gjitha prognizat e dashakëqijve se do ketë krizë, janë treguar të pavërteta. Në të njëjtën kohë, sa herë që flitet për projekte të caktuara nëpër ministri, Qeveria arsyetohet se projektet nuk janë realizuar për shkak të vështirësive buxhetore. Kjo i bie se vendi megjithatë paska një krizë të tillë buxhetore.

Me buxhetin për vitin 2012, sipas propozimit të Qeverisë, kriza vetëm sa thellohet. Në kohërat e mungesës së zhvillimit ekonomik përgjatë këtyre viteve të pasluftës, Kosova ka mundur të lavdërohet vetëm për një gjë: që nuk ka borxhe. Natyrisht, nëse përjashtohen këtu borxhet e Serbisë, të cilat Plani i Ahtisarit ia barti Kosovës. Mirëpo, prej vitit të ardhshëm, pikërisht me këtë lloj buxheti Kosova e nis kredhjen e saj në borxhe. Suficitet e dikurshme buxhetore shndërroheshin në akuza për paaftësi qeveritare. Tash e tutje, do të kalojmë te borxhet gjithnjë e më të mëdha për shkak të aftësive qeveritare për gabime, keqpërdorime e manipulime.

Buxheti i Kosovës është buxheti i popullit që ka varfërinë dhe papunësinë më të madhe në Evropë dhe që i ka qeveritarët më të pasur në Evropë, krahasuar me gjendjen e popullsisë. Kjo pakicë super të pasurish kanë vendosur se çka të bëhet me paratë e shumicës dërrmuese që janë të varfër e në kurriz të të cilëve edhe janë pasuruar. Pra, ky propozim për buxhetin 2012 është propozim i qeveritarëve të pasur për neve përfaqësuesit e qytetarëve që janë përgjithësisht të varfër në Kosovë. Buxheti 2012 na e sjell edhe njëherë në skenë këtë konflikt themelor të interesit.

Ky buxhet na njofton që mjetet për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe për Ministrinë e Shëndetësisë bëjnë sa gjysma e mjeteve për autostradën Morinë-Merdar, kurse mjetet për Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik bëjnë sa çereku i mjeteve të ndara për këtë autostradë në vitin 2012. Kjo tregon që Qeveria e Kosovës nuk është as Qeveri e zhvillimit ekonomik, as Qeveri e mirëqenies qytetare dhe as qeveri e sundimit të ligjit.

Të hyrat doganore planifikohen të jenë sa trefishi i të hyrave vendore tatimore dhe mbështetja e këtillë në import e demaskon çfarëdo zotimi qeveritar për kinse zhvillimin ekonomik. Kjo Qeveri është Qeveri e asfaltit, Qeveri e asfaltit të importuar, Qeveri e asfaltit për import, Qeveri që shtron asfalt për kamionët e mallrave të huaja e posaçërisht për ato të Serbisë. Nuk mund të na thotë kjo Qeveri që po e shtron rrugën për hir të kombit, kur lejon që kombi të vërshohet nga mallrat e Serbisë.

Prandaj, mendoj që nuk ka kuptim që opozita t'i dalë përballë Qeverisë me buxhet alternativ. Askund në botë kjo nuk ndodh. Ka logjikë që Qeverisë t'i kritikohet planifikimi buxhetor dhe mandej t'i kundërvihemi asaj me vizion tjetër ekonomik, por jo me buxhet tjetër. Njëherë kur pajtohesh me vizionin ekonomik të qeverisë, vetëm atëherë mund ta sjellësh një buxhet alternativ. Pra, është e logjikshme që buxheti alternativ të sillet prej një partie tjetër përbrenda koalicionit qeverisës, por jo nga një parti opozitare.

Ne nuk mund t'i zgjidhim problemet duke i kapur ato për bishti. Buxheti ndryshe duhet të vije nga vizioni ekonomik ndryshe. Përndryshe, kemi të bëjmë me një vizion ekonomik që thelbësisht nuk është ndryshe dhe alternativat janë vetëm pretendime për korrigjime të kufizuara buxhetore.

Kjo është arsyeja pse në propozimin e kolegëve opozitarë nga LDK-ja për buxhet alternativ nuk shoh dallim konceptual prej Qeverisë në fushën e politikave ekonomike. Pra, i thuhet PO autostradës që ka trefishin e çmimit të tregut dhe përmes së cilës po bëhet vjedhja më e madhe qeveritare në kohën e pasluftës, por thuhet që kjo të shtyhet për një vit. I thuhet PO shitjes së PTK-së, ndërmarrjes më profitabile në Kosovën e pasluftës, por thuhet që kjo të shtyhet për një vit. Shtyrja e shitjes së PTK-së është leje dhe inkurajim për këtë Qeveri shitjen e PTK-së si të tillë.

Kjo nuk është strategji tjetër ekonomike, por taktikë brenda së njëjtës strategji. Strategjia ka të bëjë me hapësirën, kurse pikërisht taktika ka të bëjë me kohën, pra me të njëjtat gjëra duke ndryshuar paksa vetëm momentin e tyre kohor.

Ne inkurajojmë deputetët e LDK-së që kurrësi të mos i thonë PO privatizimit të PTK-së. Po ashtu, duhet ta kuptojnë që nuk bën thjeshtë të shtyhet ndërtimi i autostradës, sepse asisoj do t'i paguanim penaltit në bazë të kësaj kontrate, por duhet ta bëjmë një kontratë krejtësisht tjetër. Kjo është një ndër arsyet e shumta pse të gjithë bashkërisht, e posaçërisht deputetët dhe subjektet e opozitës duhet ta kërkojmë dorëheqjen e kësaj Qeverie.

Kosova lëngon dëshpërueshëm për zhvillim ekonomik. Mirëpo, nuk mund të ketë zhvillim ekonomik pa strategji afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Doktrina ekonomike në Kosovën e pasluftës është ajo e “ndërtimit të tregut funksional”, gjë që na ka lënë pa zhvillim. Sepse, në vend se ta kemi tregun në funksion të ekonomisë dhe ekonominë në funksion të shoqërisë, në Kosovë e kemi saktësisht të kundërtën: shoqërinë në funksion të ekonomisë dhe ekonominë në funksion të tregut. Për pasojë, çdo gjë në Kosovë po shndërrohet në mall, madje edhe njerëzit.

Deficiti i tmerrshëm tregtar në Kosovë i ka përmasat e vetë buxhetit të Kosovës. Importi i mallrave nga Serbia i ka përmasat e remitancave të të gjithë bashkatdhetarëve tanë, marrë së bashku. Kjo assesi nuk paraqet kurrfarë fatkeqësie natyrore. Ajo është pasojë e kësaj dogme të fundamentalistëve të tregut, përbrenda së cilës ndodhet Qeveria aktuale e Kosovës. Mu këta qeveritarët kosovarë janë vënë në shërbim të krijimit të kushteve për tregun me iluzionin se ai do ta mundësojë zhvillimin pa e përcaktuar apo orientuar fare këtë të fundit. Këta fundamentalistë të tregut të lirë kanë sjellë liri për mallrat e huaja e jo edhe për njerëzit tonë.

Ne as që mund të flasim për zhvillim ekonomik të Kosovës pa strategji afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimit ekonomik. Një strategji afatmesme dhe afatgjatë do t’i përzgjidhte sektorët ku Kosova synon të zhvillohet në periudhën afatmesme 5 deri në 10 vjeçare dhe ato ku do të synohej zhvillimi në periudhën afatgjatë, për shembull pas 15 deri 20 vjet.

Në këtë kontekst, minimalisht do ishte i nevojshëm financimi i një studimi me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë rreth mundësive të ekonomisë së Kosovës në raport me tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Në mungesë të një studimi të tillë, që do shërbente edhe për formësimin e një strategjie zhvillimore afatgjatë, qeverisja nuk mund të jetë veçse kaotike dhe e çorientuar. Në fakt, ky duket se është modeli qeverisës i qeverise aktuale që nuk ka një vizion konkret zhvillimor për Kosovën. E keqja e planit Banskó nuk është se ai është një plan i keq, por para së gjithash që ai nuk është plan fare. Një këso Qeverie, si kjo e jona, ekonomikisht do t’ia shohin hairin shtetet e tjera, por jo edhe shteti ynë.

Bota sot ndodhet në krizë globale financiare dhe ekonomike që po bëhet edhe krizë sociale. Investitorët e huaj janë tërhequr nga periferitë (ku përfshihen edhe vende si Greqia) drejt qendrave financiare. Qasja që ende bazohet te investimet e huaja, ndërkohë që ne shpenzojmë paratë e buxhetit në mënyrë që të krijojmë kushte që investitorët e huaj në të ardhmen të shpenzojnë paratë e tyre për të investuar në Kosovë, është shumë iluzore. Sepse, autostradat që po ndërtohen në Kosovë po bëhen duke shpresuar që kjo i tërheq investitorët e huaj. Ne po investojmë qindra miliona, që ata t’i investojnë miliardat, apo jo? Ne nuk e filluam me fabrika, por me autostrada. Fabrikat po presim që t’i ndërtojnë investitorët e huaj, apo jo? E po, kjo është gabim i madh dhe rrezik edhe më i madh. Kjo nuk do të thotë se duhet të jemi kundër investimeve të huaja. Sigurisht që jo. Mirëpo, kjo do të thotë që investitorët e huaj, të cilëve ua kemi shtruar asfaltin, mund të mos vijnë fare. Tash kur në skenën globale mungojnë kapitalet dhe investuesit janë bërë shumë alergjik ndaj rrezikut, çfarë duhet të bëjë Kosova? Thjesht, të presë derisa të ndryshojë atmosfera e investimeve globale? Po nëse diçka e tillë vazhdon për vite me

radhë, sikur që duket nga shenjat e tregjeve globale, çka dot bëjmë atëherë? Pra, ne duhet të kemi një plan B, dhe jo një buxhet B.

Plani B është zhvillimi i prodhimit vendas, duke përfshirë mbështetje për prodhuesit vendas. Për mirëqenie duhen para, e paratë vijnë nga puna, kurse vendet e punës vijnë nga prodhimi. Ajo që e shpjegon më së miri pse Gjermania nuk e pësoi si shumë shtete anembanë globit nga kriza financiare e shtatorit të 2008-ës, është fakti që gjysma e bruto produktit vendor të Gjermanisë në atë vit vinte nga eksporti. Pra, Gjermania nuk ishte kufizuar në, le të themi, domenin disi virtual të ekonomisë, financat dhe shërbimet, por ajo kishte prodhim të madh dhe rrjedhimisht edhe eksport të madh.

Prandaj, përveç një strategjie afatmesme dhe afatgjatë, Kosova duhet t'i kthehet prodhimit. Vetëm asisoj do ta transformonim ekonominë drejt zhvillimit të saj. Zhvillimi që vjen prej prodhimit përputhet me parimin që zhvillimi buron nga brenda. Pa dyshim që ai mund të ndihmohet dhe duhet të ndihmohet nga jashtë, por ai duhet të nisët nga brenda. 90% të investimeve nga jashtë në botë nuk shkojnë në vendet në zhvillim ose të pazhvilluara, por në vendet tashmë të zhvilluara. Pikërisht nëse i duam investimet nga jashtë, ne duhet që njëherë të zhvillohemi ca përbrenda.

Fondi Pensional mund të ishte një rast konkret se si kursimet e qytetarëve kosovarë mund të përdoren për zhvillimin e Kosovës, në vend që Kosova të futet në borxhe duke kërkuar kapitale nga jashtë. Aq më tepër, po të kihet parasysh pra se ky fond mund të zgjerohet edhe më tej përmes një reformimi të tërësishëm. Në të njëjtën linjë, do ishte edhe rasti i PTK-së, si burim afatgjatë i të ardhurave për Kosovën, financimi i zhvillimit lokal nga sistemi bankar, duke përfshirë edhe kreditë për biznesin e vogël, si dhe krijimi i fondeve apo bankave për zhvillimin bujqësor dhe industrial. Ju faleminderit!

KRYETARI: Replikë, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Me të vërtetë nuk do të dëshiroja të replikoja, por me të vërtetë habitem se si e merr të drejtën dikush tjetër të na shpjegojë neve dhe të na tregojë se çka ne ofrojmë, çka ne rekomandojmë, çfarë alternativash ofrojmë. Sot është në shqyrtimi buxheti ose Projektligji i buxhetit të Kosovë dhe ne si Grup Parlamentar e kemi thënë qartë, pasa analizave shumë të hollësishme, qëndrimet tona shumë të qarta përmbajtësore por jo vetëm fjalë. Kemi dorëzuar edhe me shkrim se çfarë ne mendojmë dhe unë mendoj që duhet të mësohen edhe të tjerët të njëjtën gjë ta bëjnë, sepse ne si LDK e konsiderojmë që nuk është e mjaftueshme veç të kritikohet, por edhe të ofrohen alternativa për projekte të caktuara. Se çka mendojmë ne për autostradën, për privatizimin, është punë e LDK-së, nuk është punë e të tjerëve. Prandaj, është mirë ta ruajmë veten, të mos e marrim atë ngarkesë për t'i mësuar edhe të tjerët se çfarë duhet të bëjnë.

Ne jemi në Parlament, jemi opozitë, por i kemi subjektivitetet e ndara dhe për çështje të caktuara mund të mendojmë ndryshe, që është e drejtë e jona plotësisht legjitime, por edhe t'i japim alternativat dhe sugjerimet tona. Kjo është punë e jona këtu si deputetë, si

grup parlamentar dhe jo ta mësojmë tjetrin se çfarë duhet thënë ose çfarë duhet bërë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Kundër replikë, deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Gjithsesi duhet të kemi alternativa, por alternativat duhet të jenë vizion, strategji për zhvillim ekonomik, para se të jenë, në vend se të jenë alternativa për buxhet. Pra, ky buxhet që na është propozuar sot për vitin 2012 nga Qeveria e Kosovës, është i padrejtë dhe i dëmshëm për shkak se vizioni ekonomik i kësaj Qeverie është i padrejtë dhe i dëmshëm. Pra, është pasoja me të cilën ne sot po merremi dhe jo shkak. Dhe, së fundi, dua ta vë theksin, prandaj e bëra këtë kritike më herët, tek botëkuptimi ekonomik, e jo tek buxheti sepse, nëse nisim nga buxheti, atëherë do të kemi pikëpamje statike për ekonominë, që buxheti na qenka një tortë dhe ne tash duhet të bëjmë gara se si e ndajmë atë tortë. Në fakt, ne do të duhej të diskutojmë para së gjithash e mbi të gjitha për programet zhvillimore...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Projektbuxheti që e paraqiti Qeveria sot para Kuvendit është një fakt i dhimbshëm se nuk ka përmirësim të cilësisë së jetës së qytetarit të Kosovës.

Qeveria ka rritur shpenzimet, pra për veten. Ky projektbuxhet tregon se Qeveria ka dështuar të ballafaqohet me problemet e qytetarëve dhe t'i zgjidh ato. Kjo do të thotë se ende do të vazhdojë papunësia, varfëria, mungesa e rrymës, edukimit cilësor, shëndetësia e cila është ende e sëmurë dhe gjyqësia shumë e dobët. Prandaj, Qeveria ka treguar jo efikasitet dhe keq menaxhim.

Pra, më lejoni që këto që i thashë t'i paraqes me shifra. Nga kjo se si është projektuar ky projektbuxhet, del se investimet kapitale janë rreth 600 000 000 euro. Nëse i shihni në detale, do të shini se 300 000 000 euro janë shpenzime vetëm për autostradën, gjysma tjetër për investimet tjera të cilat fare nuk kanë të bëjnë me zhvillim ekonomik. Deficiti buxhetor do të jetë 3.5% e GDP-së, e që është mbi nivelin e lejuar sipas normave evropiane. Sa u përket të hyrave, 34% të këtij buxheti janë bazuar në burimet e supozuara, të cilat nuk janë realizuar as në këtë vit. Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime nuk është në harmoni me investimet kapitale. Shumë projekte janë të bartura nga viti që po e lëmë pas. Pra, buxheti është peng i politikave dhe premtimeve elektorale e jo buxhet i zhvillimit ekonomik.

Sipas këtij buxheti, Korniza afatmesme e shpenzimeve 2012-2014 është dokument i pa vlerë. Plani i Bullgarisë u hodh poshtë nga vetë përpiluesit, pra asnjë nga objektivat e atij plani nuk janë në këtë buxhet dhe kjo tregon se Qeveria në Bullgari ishte për skijim e jo për hartim të ndonjë plani. Kjo Qeveri në vend se të hartojë politika të zhvillimit

ekonomik, ku çdo ditë e më shumë mungon stimulimi i prodhimit vendor, stimulimi i bizneseve të vogla dhe të mesme, ku ende mungojnë shumë ligje bazike e që edhe Raporti i Progresit i ka cekur, pra Ligji për sigurimin shëndetësor dhe ai për kryeqytetin.

Kjo Qeveri kreket çdo ditë e më shumë se po punon në të mirë për jetën e qytetarit. Kjo është shumë lehtë nëse dilni dhe i shihni brengat dhe hallet e qytetarëve. Nëse e shihni me vëmendje hartimin e këtij projektbuxheti me deficit rreth 159 000 000 euro, duke u bazuar pra në hipoteza, gjithmonë duke shpresuar në marrjen e një kredie nga Fondi Monetar Ndërkombëtar e që llogarit Qeveria rreth 92 000 000 euro, e që nuk është e sigurt. Pastaj, tërheqjen e 74 000 000 nga Fondi i Kursimeve Pensionale që administrohet nga Trusti, e që nuk mund t'i tërheq këto para sepse ende nuk është bërë ndryshimi i këtyre ligjeve.

Po ashtu, Qeveria me hipotezë, prapë, tenton që ta shesë PTK-në apo do ta shesë PTK-në për 300 000 000 euro, e që as kjo nuk është e sigurt. Pra, siç po shihni, hartimi i projektbuxhetit në këtë mënyrë, si dokumenti më i rëndësishëm për zhvillimin e një shteti, mund të ndikojë shumë negativisht në stabilitetin ekonomik dhe mund të ketë pasoja jashtëzakonisht të mëdha për vitet në vazhdim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Ganimete Mulsiu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolege dhe ju të nderuar kolegë deputetë,

E përshëndes fillimisht ministrin Bedri Hamzaj, i cili ka bërë një punë të shkëlqyeshme sa i përket përpilimit të projektbuxhetit për vitin 2012 dhe mendoj që ka dhënë fjalën e fundit të profesionalizmit në këtë lëmi.

Dua të ngrejë një çështje ose të mbështes propozimin që u dha sot për botimin e 150 titujve shkencorë, të cilën kërkesë e bëri deputeti Ramë Vataj, sepse një kërkesë e tillë i është drejtuar me shkrim nga Rektori i Universitetit, zotit Rugova, iu është drejtuar edhe Grupit Parlamentar të deputetëve të rinj, prandaj shfrytëzoj rastin që në emër të deputetëve të rinj të këtij Kuvendi t'i japim mbështetje kësaj kërkesë, sepse mendojmë që është një kërkesë shumë e arsyeshme dhe e nevojshme, sepse pasurimi i bibliotekave shtetërore dhe universitare me këta titujt do të thotë pasuri e madhe për gjithë vendin.

U fol sot shumë këtu për buxhetin në të gjitha fushat, por megjithatë mbase ajo çka më bëri përshtypje shumë, e pamë që Skenderaji me të vërtetë ka shumë dashamirë në këtë sallë dhe unë meqë vij nga ajo zonë, po e shfrytëzoj rastin ta kem një kërkesë konkrete sa i përket buxhetit për vitin 2012, të cilën e adresoj tek organet kompetente që grantet Qeveritare për bujqësi në komunën e Skenderajit të rriten, sepse janë vetëm 72 000 euro dhe kur e kemi parasysh që 90% e popullatës në Skenderaj jetojnë në zona rurale, ky grant është i ulët dhe nuk i mbulon kërkesat. Prandaj, shfrytëzoj rastin që edhe njëherë të shqyrtohet kjo ndarje dhe të shtohet, do të thotë kjo shumë e granteve qeveritare për bujqësi në Skenderaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Albulenë Haxhiu, e ke harxhuar fjalën ti, më duket. E, në rregull! Atëherë, kemi edhe 5 deputetë. Këta kryesisht janë të Lidhjes Demokratike. Unë po shkoj sipas një liste që e kam këtu. Fjalën e ka deputetja Afërditë Berisha.

AFËRDITË BERISHA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Diskutimi im do të fokusohet për buxhetin në sektorin e bujqësisë. Buxheti i vitit 2012, i ndarë nga Qeveria e Kosovës për Ministrinë e Bujqësisë është i ulët. Edhe pse ka një rritje në krahasim me vitin e kaluar, prapë gjendja në këtë sektor nuk është aspak e lakmueshme. Ky buxhet është më i ulët në rajon. Kosova, pra ndan 21 409 230 euro të buxhetit përgjithshëm për bujqësinë, ndërsa ndarjet buxhetore për këtë sektor në vendet e rajonit sillen 5 deri në 8%.

Për t'u bazuar me vendet e rajonit, gjë që është edhe intenca jonë, buxheti për bujqësinë e Kosovës do të duhej të ishte rreth 100 000 000 euro, këtë e thonë ekspertët e bujqësisë. Subvencionet nga ministria e Bujqësisë edhe për këtë vit janë 8 400 000, që është pak për të siguruar një rritje të prodhimit bujqësor. Shprehur në përqindje është 0.55% e shpenzimeve totale të Qeverisë. Kjo tregon kujdesin për mbi gjysmën e popullsisë që jeton në zona rurale.

Qeveria në të ardhmen duhet t'i caktojë 2 deri në 3 prioritete, mendoj në këtë sektorë, pastaj ... në mënyrë që të kemi një zhvillim të këtij sektori. Pavarësisht planit të Qeverisë për të rritur buxhetin për Ministrinë e Bujqësisë deri në 3% të buxhetit total, kjo prapë nuk është arritur dhe, për më tepër, forma e mbështetjes së këtij sektori nuk po tregon efekte.

E përsëris edhe njëherë, buxheti për sektorin e bujqësisë edhe për këtë vit është i ulët. Ky buxhet tërësisht limiton arritjen e synimeve në këtë sektorë. Gjithashtu, implementimi i kornizës legjislative është sfidë për institucionet. Siç kam theksuar, Agjencioni i Veterinar dhe i Ushqimit të Kosovës ende mbetet në zyrën e kryeministrit, gjë që paraqet një anomali të veçantë në organizimin e institucioneve. Kryeministria, përveç tjerash, do të duhet të merret edhe me kontrollimin e mishit të importuar.

Në përgjithësi, Kosova ka bërë përparim të kufizuar në fushën e bujqësisë, prandaj mendoj se një sektor i cili gjeneron vende të reja pune, së bashku me përkrahjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duhet të jenë në prioritet nga Qeveria dhe mjetet të cilat i ndajnë të jenë, nëse jo sa rajoni, bile t'i afrohen atij.

Lidhja Demokratike e Kosovës, për një zhvillim më të mirë të këtij sektori në buxhetin alternativ, të cilin e prezantuan kolegët e mi, mendon që sektorit të bujqësisë, buxhetit aktual, t'i shtohen edhe 20 000 000 euro të tjera, mjete të cilat do të shkonin në projekte

zhvillimore, projekte në të cilat bujqit dhe agrobizneset do të mund të përfitonin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Sali Asllanaj e ka fjalën, nuk është! Deputeti Lutfi Haziri, nuk është. Erdhi rendi te deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Të nderuar kolegë deputetë,
Mbas shumë fjalimeve që dëgjuam këtu, ka edhe shumëçka për t'u thënë, për të thënë në kuptimin e asaj se si shihet ky buxhet dhe çka pritet nga ky buxhet? Nga ky buxhet në aspektin strukturor pritet të ndodh ajo çka ka ndodhur vitin e kaluar. Po jap dy shembuj se çka ka ndodhur dhe çka pritet të ndodhë.

Kompetencat ekskluzive që janë komunale, vazhdojnë të jenë, për arsye abuzimi dhe përfitimi personal dhe grupor të njerëzve, që normalisht janë mbrapa shpinës sime, vazhdojnë të jenë në nivel qendror. Pse duhet Ministria e Arsimit të ndërtojë shkolla? Ministria e Arsimit duhet të ndërtojë arsim, ndërsa kompetencë ekskluzive e ndërtimit të shkollave dhe mirëmbajtjes të tyre është kompetencë e komunave, mirëpo Ministria e Arsimit nuk merr parasysh se duhet të delokohen këto fonde dhe të shkojnë në nivel komunal dhe komuna t'i menaxhojë objektet dhe t'i ndërtojë ato.

Për arsye përfitimi dhe vjedhjeje, vazhdojnë të jenë në Ministrinë e Arsimit, por e njëjta gjë ndodh me Ministrinë e Infrastrukturës. Objektet rrugore të nivelit rural dhe të brendshme komunale vazhdojnë të jenë në Ministrinë e Infrastrukturës. Pse këto objekte duhet të jenë aty?! Pra, të njëjtat arsye, përfitimi. Prandaj, vazhdon e njëjta logjikë e abuzimit.

Këtu u tha se ky projektbuxhet është një projekt zhvillimor. Çka ka koncepti i zhvillimit këtu, si shihet zhvillimi, ky është problemi kryesor. A quhet zhvillim ndërtimi i infrastrukturës? Normalisht që quhet, por a është bartësi kryesor i zhvillimit ndërtimi i infrastrukturës, absolutisht nuk është. Çfarë lloj zhvillimi po i ofrojmë vendit? Po i ofrojmë vendit një ndërtim të përkohshëm, i cili realisht nuk po jep premisa të zhvillimit të qëndrueshëm.

Çka ka nevojë, Kosova është për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik vjen nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Këto janë baza e zhvillimit ekonomik, aty gjenerohet punësimi. Mirëpo, ky koncept i zhvillimit ekonomik nuk ekziston në këtë Qeveri, sepse në qoftë se e shihni buxhetin për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, absolutisht asnjë projekt i cili ka për qëllim krijimin e kapaciteteve për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nuk ekziston, bile as me bashkëfinancim. Ju e dini se shumë projekte realizohen sot në Kosovë për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, projekte të financuara nga USAID-i, Swiss Contact-i dhe të gjitha organizatat tjera të rëndësishme ndërkombëtare, ndërsa në realitet Qeveria jonë nuk ka ndarë asnjë buxhet dhe si duhet ne të përmirësojmë kualitetin e jetës së qytetarëve të Kosovës.

Këtu u tha se autostrada ka punësuar 3700 vetë. Kryeministri duhet ta dijë se ata 3700 vetë sot janë të papunë dhe Bechtel-Enka ju ka thënë, zotërinj, ju keni qenë të punësuar sezonal dhe kjo nuk është zhvillim i qëndrueshëm. Ky është një punësim i përkohshëm. Punësimi sezonal nuk garanton zhvillim, prandaj ne duhet të shohim dhe të japim alternativën, cila është alternativa?

Alternativa që këtu u kritikua sot, alternativa e LDK-së është të krijohen kapacitete për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, i cili do të ketë edhe pasoja në zhvillimin e qëndrueshëm social. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik arrihet nëpërmjet krijimit të kapaciteteve buxhetore, të cilat do të krijojnë mundësi subvencionimi dhe përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Cilat janë ato ndërmarrje të vogla dhe të mesme që përkrahen? Cili është interesi strategjik i zhvillimit të këtyre ndërmarrjeve? Ku duhet të zhvillohen këto ndërmarrje? A duhet të shohim modelet që janë zhvilluar? Cilat modele ka përdorur Sllovenia? Sllovenia ka përdorur sistemin Vaucher të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, se nëpërmjet buxhetit ka garantuar kapacitetet financiare për projekte të zhvillimit të biznesit familjar. Qeveria nuk e ka asnjë projekt të vetëm. Ka delokuar për secilën komunë në Slloveni të paktën 2 000 000 euro që të jepet mundësi që të zhvillohet, të krijohen këto kapacitete për financimin e biznesit. Ka krijuar mundësinë që bizneset familjare të kenë mundësinë, qasje më të lehtë në kredi marrje dhe përveç qasjes më të lehtë, të kenë edhe norma të interesit më të ulëta.

Kjo Qeveri nuk e ka fare këtë koncept, prandaj ne duhet të mendojmë. Alternativa jonë është që të mendojmë se cila është perspektiva e zhvillimit ekonomik të këtij vendi dhe jo punësimi i 3000 vetëve, të cilët sot janë të papunë. Ne duhet të punësojmë njerëz të cilët në mënyrë sistematike vazhdojnë të punojnë në vend dhe të krijojnë vende të reja punës. Prandaj, unë them se përveç objektivit primar, abuzimit me fondet publike nëpërmjet centralizimit të kapaciteteve buxhetore, këtu nuk ka asnjë koncept zhvillimor, prandaj këto dy çështje nuk u diskutuan dhe pata dëshirë që t'i diskutoj.

E para, vazhdimi i mentalitetit të abuzimit me fondet publike nëpërmjet centralizimit tyre dhe shfrytëzimit nga ministritë e linjës për qëllime personale dhe të grupeve që shpeshherë janë edhe kriminale dhe, tjetra, mungesa e një vizioni të zhvillimit ekonomik nëpërmjet zhvillimit të ndërmarrësisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, ministër! Ministri Bedri Hamza e ka fjalën.

BEDRI HAMZA: Zoti Gashi, nuk mund të thuash që nuk është buxhet i cili ndikon në zhvillimin ekonomik, se nëse buxheti ndikon në konsum, rritje të konsumit, konsumi ndikon në zhvillimin ekonomik. Dhe, nuk ndodh zhvillimi ekonomik vetëm në sektorin publik, qëllimi jonë është që ne të krijojmë parakushte për zhvillimin e sektorit privat dhe sektori privat të jetë bartës i zhvillimit ekonomik.

Mirëpo, fondet të cilat janë të investuara në projektet kapitale, nuk do të thotë që është punësim sezonal, sepse gjithmonë me këto fonde ka mundësi që të jetë një numër i konsiderueshëm i punëtorëve i angazhuar. Sa i përket koncentrimin të fondeve, sipas asaj

logjikës që ju po e thoni, ministritë s'po dashka të ekzistojnë fare, po u dashka të ekzistojnë veç komunat, t'u barten përgjegjësitë veç komunave, nuk ka ndodh kurrfarë ndryshimi, duhet ndërruar ligjet që të thuhet Ministria e Arsimit nuk e ka këtë përgjegjësi, Ministria e Infrastrukturës nuk e ka këtë përgjegjësi dhe krejt çka ke fol, ke fol me paragjykimet. Unë e di që duhet folur dhe është mirë të flitet, po s'ke dhënë fakte, jo koncentrimi, jo keqpërdorimi, ato i lëmë paragjykimet dhe zhvillimi ekonomik ndodh edhe përmes rritjes së konsumit, edhe përmes rritjes së investimeve.

KRYETARI: Replikë, 1 minutë!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Pikërisht ministri e konfirmoi atë çka e thashë unë, se qëllimi kryesor i kësaj Qeverie është për të konsumuar dhe jo për t'i rritur kapacitetet për të pasur zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social. Këto janë koncepte që përplasen. Ne po flasim për konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik edhe social nëpërmjet të garantimit të investimeve në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si promotorë të gjenerimit të zhvillimit që kanë ndodhur në të gjitha vendet në tranzicion dhe ky është koncepti që ne e bartim mbas vetes dhe jo koncepti të cilin e promovon këtu ministri, se ne po konsumojmë dhe përdërisa po hamë, jemi mirë.

Ideja është që të ndërtojmë një shtet me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe me zhvillim të qëndrueshëm edhe social nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve ligjore dhe infrastrukturore. Po koncepti i konsumit është një koncept i cili këta e kanë në krye, të konsumojmë ne, sa më shumë që të konsumojmë, mirë e kemi punën, por ideja është që të krijojmë këto kapacitete dhe të kemi zhvillim. Këta zotërinj këtu e dinë shumë mirë se për t'i përmirësuar këta numra, kanë bërë edhe shkelje shumë të rënda, kanë shti investimin në autostradën si investim...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kundër replikë, ministri Hamza!

BEDRI HAMZA: Jo, ministri e tha pikërisht atë të kundërtën çka po e thoni ju, se nëse e shikon strukturën e buxhetit, del që një pjesë është për mallra e shërbime, një pjesë është për tansfere sociale, ndërsa pjesa kryesore rreth 40% e buxhetit është për investime kapitale. Prandaj, dallohem shumë konceptualisht.

KRYETARI: Ju lutem! Jo, Bekim Haxhiu, Arben Gashi dhe Zenun Pajaziti nuk kanë fjalë. Ne i kemi edhe 3 deputetë që kanë qenë të lajmëruar dhe vetëm edhe 3 deputetë, të tjerët e kanë harxhuar. Edhe Qeveria mund ta marrë fjalën. Kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Është fare e lehtë të pretendohet, të akuzosh pa asnjë argument, e në veçanti të thirrësh në standarde, parime dhe në aspekte profesionale të cilat dikush mund t'i ketë mësuar edhe si vjershë apo të paraqitet si ekonomist dhe që nuk je i tillë, por natyrisht se njeriu mëson. Por, së paku para se të akuzosh të tjerët dhe

Qeverinë, është mirë për t'iu drejtuar edhe vetë partisë tënde, në profesionin tuaj, edhe pse të kanë larguar nga puna.

KRYETARI: Replikë, Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Shoku Hashim, po më duket që i ke ngatërruar konceptet dhe me konceptin e shokut vazhdon të jesh dhe duhet të kuptosh se në kapacitetet politike ne jemi këtu për të dhënë variantet tona politike. Përgatitjet e mia profesionale dhe përvojën time të punës, shoku Hashim nuk mund ta mbërrish kurrë, mund ta ëndërrosh. Sa i përket zhvillimit dhe karrierës time, lirisht mund të diskutojmë dhe i ballafaqojmë të miat dhe tuat.

Sa i përket mundësive të zhvillimit ekonomik dhe konceptit që ju prezantoni këtu, është një koncept i cili nuk garanton zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të këtij vendi dhe jam i bindur se i tillë do të mbetet. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri, kundër replikë!

HASHIM THAÇI: Unë e di, po tregoji partisë suaj, nëse nuk e di.

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë, unë kisha bërë lutje që deputetë që kanë mbetur e që janë të Lidhjes Demokratike, në fakt, sipas një liste që e kemi marrë, ata s'kanë qenë në listë, por megjithatë janë lajmëruar si deputetë. Por, ju kisha lutur që t'i shkurtojnë fjalët, se nuk kanë çka shumë, se i thanë këta tjerët dhe e keni dorëzuar dokumentin e partisë. Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Në fillim dua të theksoj se në parim nuk do të përkrahu aprovimin e këtij projektbuxheti. Arsyet konkrete qëndrojnë në faktin se jam i bindur se nuk mund të zbatohet në mënyrë të kënaqshme projektbuxheti i një Qeverie, e cila gjatë vitit 2011 nuk ia ka dalë të realizojë afro 30%, respektivisht mbi 450 000 000 euro të hyrave të planifikuara apo më mirë thënë, gabimisht të planifikuara, qoftë për shkak të mosmarrëveshjes me FMN-në, diku mbi 100 000 000 euro, qoftë për shkak të mos privatizimit të PTK-së apo afro 300 000 000 euro.

Po ashtu, vlerësoj se edhe në Projektbuxhetin e vitit 2012 nuk planifikuar si duhet shpenzimet reale të vendit tonë, fakt që do të ndikojë që ky projektbuxhet të konsiderohet si një buxhet i futjes në borxhe të shtetit, i cili do ta ketë vështirë t'i paguajë borxhet e tilla, për arsye se kjo Qeveri tanimë ka shitur çdo gjë që mund të shitet e në të njëjtën kohë ka shpenzuar edhe bilancin bankar.

Më tutje, Projektbuxheti i vitit 2012 parasheh shpenzime më të mëdha se sa që do të ketë të hyra. Vërtet, keq planifikimet e këtilla në njëfarë mënyre tanimë janë bërë praktikë dhe mënyrë e veprimit të kësaj Qeverie shpenzuese, e cila gjatë mandatit të saj ka shpenzuar

afro 400 000 000 të kursyera nga Qeveria paraprake, pastaj ka shpenzuar të hyrat e realizuara nga shitja e ndërmarrjeve publike, si dhe me këtë projektbuxhet planifikon që gjatë vitit 2012 të marrë borxh të brendshëm.

Një vërejtje tjetër tejet serioze për këtë projektbuxhet, që në njëfarë mënyre u përmend edhe nga shumë parafolës, përfshirë këtu edhe parafolësit nga Partia Demokratike, ka të bëjë me mënyrën jo të drejtë të shpërndarjes së buxhetit për komunat e Kosovës, sepse analizat e këtij dokumenti tregojnë se shpërndarja e buxhetit për komunat e Kosovës është bërë mbi baza partiake dhe regjionale e jo mbi baza të kriterëve racionale dhe të mirëfillta, siç mund të jenë popullata, respektivisht territori i një komune.

Konkludimin e mësipërm do ta ilustroj me krahasimin e të dhënave të ndryshme për 4 komunat të Kosovës. Konkretisht do të theksoj që dhënat mbi territorin, pastaj mbi numrin e banorëve, të hyrat buxhetore dhe investimet kapitale të planifikuara për komunat e Kamenicës dhe të Gjilanit, në njërën anë, dhe të Drenasit dhe Skënderaj, në anën tjetër, të cilat janë të njohura edhe si bastione të partisë në pushtet, pra të PDK-së.

Kështu, sipas këtij projektbuxheti, kjo Qeveri për komunën e Kamenicës, e cila qeveriset nga LDK-ja, për vitin 2012 ka planifikuar 6 300 000 euro, prej tyre vetëm 636 000 euro investime kapitale, e cila komunë ka një territor prej 523 km² dhe një popullatë prej mbi 60 000 banorëve. Ndërsa, po sipas këtij projektbuxheti, Qeveria e Kosovës për komunën e Skenderajt, e cila në krahasim me Kamenicën ka një territor dukshëm më të vogël, respektivisht 378 km² dhe një popullatë prej mbi 70 000 banorë, ka planifikuar një buxhet prej 8 700 000 euro, ndërsa për investime kapitale ka paraparë shumën prej 1 900 000 eurove, e cila shumë është për 300% më e lartë se sa shuma e investimeve kapitale për komunën e Kamenicës.

Mënyra jo e drejtë e shpërndarjes së buxhetit është edhe më e theksuar te rasti i komunës së Gjilanit, e cila ka një sipërfaqe prej 515 km² dhe një popullatë prej 130 000 banorëve, që e llogaritet të jetë komuna e 5-të për nga numri i banorëve në Kosovë. Ndërsa, sipas këtij projektbuxheti për komunën e Gjilanit është paraparë për investime kapitale shuma në lartësi prej 1 470 000 euro, që është shumë më e vogël se ajo e paraparë për Skënderaj, që ishte 1 900 000, por edhe më e vogël se ajo e Drenasit, për të cilën janë planifikuar 1 800 000 euro investime kapitale.

Kurse, komuna e Drenasit duhet theksuar se ka një territor edhe më të vogël se Skenderaj, respektivisht 290 km² dhe një popullatë prej 70 000 banorëve. Dihet mirë se planifikimi jo i drejtë i investimeve kapitale drejtpërdrejtë ndikon në zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e përgjithshëm të një komune apo regjioni, respektivisht ngecjen ekonomike të regjionit tjetër. Një fakt i këtillë mund të konstatohet edhe nga tabela 4.2. mbi financimin vjetor të investimeve kapitale për komunën e Drenasit, respektivisht Glllogocit, ku shihet se për vitin 2012 për këtë komunë janë planifikuar 25 projekte të asfaltimit të rrugëve, ndërsa në tabelën e komunës së Skenderajt po ashtu për vitin 2012 shihet se janë planifikuar 27 projekte të asfaltimit të rrugëve.

Në anën tjetër, nga tabela mbi investimet kapitale në komunën e Kamenicës dhe të Gjilanit shihet se ekziston vetëm një pozicion për asfaltimin e rrugëve me pjesëmarrjen e qytetarëve në komunën e Kamenicës dhe një pozicion për participimin në projektet e bashkë financuara nga donatorët, në të cilin mund të ketë edhe ndonjë projekt për asfaltimin e ndonjë rruge të komunës së Gjilanit. Mendoj se me shpërndarjen jo të drejtë të mjeteve financiare për investimet kapitale të komunave, përpiluesit e këtij projektbuxheti favorizojnë dhe stimulojnë zhvillimin ekonomik të komunave të caktuara, e në të njëjtën kohë neglizhojnë zhvillimin ekonomik të komunave tjera, duke cenuar në këtë mënyrë interesat vitale të popullatës së këtyre komunave që ndërlidhen me infrastrukturën rrugore, pastaj ndërtimin e objekteve shëndetësore, shkollore, fushave sportive, sistemeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit dhe në këtë mënyrë shkelin premtimet e tyre të bëra gjatë fushatës elektorale në rastin konkret para qytetarëve të këtyre dy komunave të apostrofuara.

Pasur parasysh trajtimin jo të drejtë që hartuesit e buxhetit ua bëjnë përfituesve të buxhetit, sidomos atyre të nivelit komunal, si dhe lëshimet e shumta të cilat e përcjellin të njëjtin, kërkoj që i njëjti mos të aprovet pa u bërë ndryshimet dhe plotësimet konkrete në të. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryetar!

I nderuari deputet Demolli, në fjalimin e juaj fillimisht thatë se “nuk u shit posta”, që është e vërtetë që s’është kryer ai proces i privatizimit. Pak më vonë thatë se “keni shitur gjithçka”, s’po shkojnë bashkë.

E dyta, u ngrit një çështje jo vetëm nga ju, por edhe nga të tjerët, çështja e borxhit publik. Dua të sqaroj që borxhi publik nuk është borxh të cilin e ka marrë kjo Qeveri, është borxh i trashëguar në raport ndaj Bankës Botërore, të cilën marrëveshje e ka ratifikuar Kuvendi, nuk ka hyrë Qeveria borxh. Ndërsa, sa i përket planifikimit për borxhet e reja, që është rreth 74 000 000, kjo është më pak se 2% e GDP-së. Të jemi të qartë. Te çështja e tretë, që e ngritët, duhet kuptuar drejt edhe bukur mirë mënyrën e funksionimit të buxhetit dhe të ndërtimit të buxhetit edhe të granteve.

Grantet nga niveli qendror për nivelin lokal ndahen në bazë të formulave. Regjistrimi i popullsisë do t’i bëjë disa korrigjime, mirëpo sa i përket totalit të investimeve nëpër komuna, nuk është ai vetëm nga grantet, por është edhe nga të hyrat vetanake të komunave. Ka disa komuna që kanë burime më të fuqishme të hyrave vetanake, i menaxhojnë më mirë të hyrat vetanake, i mbledhin ma mirë të hyrat vetanake dhe e rritin buxhetin për investime kapitale. Nëse, komuna e Skenderajt ka burime më të mëdha se sa komuna e Dardanës, nëse komuna e Skenderajt i ka mbledhur më shumë tatimet se sa komuna e Dardanës, sigurisht që ka më shumë buxhet për investimet kapitale.

Prandaj, nuk ekziston, nuk qëndron deklarimi se ka shpërndarje të padrejtë të granteve, grantet janë të ndara në bazë të formulave edhe kështu është dhe kështu duhet të interpretohet. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: As e imja nuk është replikë, më tepër është sqarim, si zakonisht. Unë edhe paradite kam diskutuar për çështjen e edhe të rrugëve, edhe të autostradave, njerëzit mund t'i shohin edhe si veç asfalt, është vlerësim i tyre personal.

Por, më mirë që po kemi mundësi dhe po kemi guxim, edhe po kemi ... për të ndërtuar asfalt, se sa ta mbajmë Kosovën në baltë, siç e kemi gjetur. Ndërsa, ata deputetë që ju kanë bashkangjitur pjesës së dytë të Kuvendit, pasdite, pasi që i kanë kryer obligimet tjera dhe e kanë Parlamentin vetëm si punë sekondare kështu, dëshiroj të them se sa iu përket investimeve nëpër rajone, nuk ka diskriminim, përkundrazi, ka afirmim dhe investime të fuqishme në çdo komunë. Për secilën komunë mund të bëjmë krahasime prej vitit 2007 deri më tani, bile kësaj radhe ka edhe më tepër se sa herëve tjera.

Vetëm, e theksova edhe paradite, ne jemi në fazën finale të përfundimit, mund të them lirisht, të shqyrtimit të mundësisë më të mirë të financimit të autostradës Prishtinë-Ferizaj-Kaçanik-Hani i Elezit. Ndërsa, duke iu bashkangjitur diskutimit të zotit Hyseni, e theksoj se gjithashtu kemi filluar të punojmë seriozisht edhe për vazhdimin e ndërtimit të autostradës nga Ferizaji, Pozhoran, në drejtim të Gjilanit dhe pastaj duhet të merremi vesh të gjithë në drejtim të Bujanovcit apo Preshevës.

Gjithashtu, jemi duke punuar shumë seriozisht dhe falënderoj edhe kryetarët edhe të Deçanit, edhe të Pejës, që do të fillojmë së shpejti edhe projektin jo të autostradës, por të rrugës së standardit modern prej Deçanit në drejtim të Plavës dhe Gucisë. Mua më vjen keq për armiqësinë tuaj ndaj dy komunave Skenderaj dhe Drenicë, por me këtë qasje, si profesor, më vjen keq prej atyre studentëve që u ligjëroni, i nderuari ish-ministër, s'ke për të fituar kurrë votë!

KRYETARI: Replikë, deputeti Haki Demolli!

HAKI DEMOLLI: Unë, vërtet dua publikisht të them se kurrfarë armiqësie nuk kam ndaj asnjë komune, ndaj asnjë territori, ndaj asnjë katundi të Kosovës, mirëpo këtu para jush dhe para këtij Kuvendi paraqita vetëm dy lloj faktesh. Nën një, paraqita faktet të cilat janë në këtë dokument dhe të cilën e kemi të gjithë para veti, ku figurojnë grantet qeveritare, se i shoh që më poshtë janë të hyrat vetanake dhe, ju lutem, të gjithë që e kanë dokumentin mund ta analizojnë, te shohin te komuna e Kamenicës figuron: grantet qeveritare për investimet kapitale, të cilat janë në vlerë prej 636 952 euro për vitin 2012, që i ka paraparë kjo Qeveri e jona.

Po ashtu, i theksova edhe grantet qeveritare të komunave të tjera, siç është Skenderaj, për investime kapitale parashihen 1 900 000. Në anën tjetër, mora shembull, ju e morët kriter numrin e qytetarëve, komuna e Gjilanit sipas të dhënave ka 130 000 banorë edhe po e them tjetrën, unë kam hyrë në ueb faqe të komunave dhe kam parë territorin e tyre të cilin e prezantova para jush dhe numrin e popullatës të cilën ata e kanë prezantuar.

Por, të njëjtën kohë kam siguruar edhe të dhënat e regjistrimit më të ri, ku prapë figuron se komuna e Gjilanit është komunë ma e madhe se sa këto 3 komuna tjera. Ky ishte sqarimi im, se nuk kam vërtetë kurrfarë armiqësie, por thjeshtë edhe unë, edhe zoti Hydajet, edhe kushdo që është i anës së Kamenicës, dëshiron që të trajtojë komunat e këtyre anëve në mënyrë të barabartë kjo Qeveri.

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Në fakt, nuk paraqite kurrgjë, përpos një urrejtje ndaj një regjioni të Drenicës, që është marre, po ta them drejt, mirëpo unë të them me përgjegjësinë më të lartë shtetërore se në çdo komunë ka investime edhe më të fuqishme se sa në kohën kur edhe partia juaj e ka udhëhequr qeverisjen, e në kuadër të kësaj edhe për Kamenicën tonë të dashur.

KRYETARI: Deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, shumë!

Zoti kryetar, kryeministër, Kabinet qeveritar,

Meqenëse u bë shumë vonë, e kam paraqitur edhe më herët fjalën, sa për informatë. Propozimet e mia do t'i paraqes me shkrim dhe do të pretendoj që edhe me ndonjë amemndament, sidomos te buxheti që ka të bëjë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit dhe asaj të Infrastrukturës.

Unë shumë shkurt, vetëm po e dëshiroj ta falënderoj ministrin e Financave që ka bërë një punë shumë të madhe dhe ka pasur durimin që këto ditë të jetë me ne në çdo pyetje të mundshme edhe me grupet parlamentare dhe dëshiroj t'i jap një propozim, meqenëse ka pasur sfida dhe ky buxhet i këtij viti ka qenë me risk jashtëzakonisht të madh në çdo aspekt, mendoj që është sivjet rasti më i mirë që ministri i Financave të mendojë që ta bëjë tradicional një festë të fund vitit për punën e buxhetit. Mendoj kur të bëhet aprovimi final, ministër, të kesh parasysh që t'i ftosh të gjithë grupet parlamentare dhe shoqërinë civile që ta kemi një festë të buxhetit. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit!

I nderuari kryetar,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të fokusohem ngushtë në dy çështje që mendoj që është me interes derisa po e diskutojmë Ligjin për buxhetin. Duke parë tabelën numër 1 dhe të hyrat, unë kam pritur që të hyrat sidomos nga planifikimi i luftës kundër ekonomisë informale, pra pengimi i saj dhe minimizimi, do të jetë një burim i mirë i cili do të mundet, nëse edhe tash nuk është projektuar, së paku do të na gëzojë të gjithëve fakti nëse në fund vitit konstatojmë se si produkt i bashkërenditjes të të gjithë faktorëve edhe luftës së ekonomisë së fshehtë, ne do të rrisim të hyrat në buxhetin e Republikës së Kosovës, sepse ajo përveç që do t'i rritë të hyrat, do të krijojë edhe efekte anësore pozitive, siç është konkurrenca lokale në

treg, si dhe krijimi i një ambienti biznesor dhe krijimi i një ambienti më të favorshëm për investorët e jashtëm.

Ndërsa, çështja e dytë që dua të diskutoj, është për mua edhe një çudi, odisejada e Ligjit për Prishtinën, që 2 vjet e gjysmë akoma po sillet nëpër zyre, edhe pse është një ligj thuajse i përfunduar, një ligj që ka kaluar njëherë nëpër Kabinetin qeveritar, ka kaluar nëpër leximin e parë, ndërsa edhe këtë vit ai nuk është proceduar dhe tani në buxhet ne nuk kemi paraparë mjete që parashikohen sipas projektligjit, çka do të thotë se Ligji për Prishtinën nuk do të funksionalizohet as vitin e ardhshëm në mbështetjen financiare, që do të thotë se edhe njëherë, pra gati thuaja edhe një vit ne do të mjaftohemi që të mos kemi Ligjin për kryeqytetin.

Ndërsa, si çështje të fundit, e vërteta është ajo që nganjëherë edhe mund të krijohet një ngatërrim në mes të investimeve që ndodhin nga garanti i rregullt, që është ... e rregullt dhe nuk mund t'i bëhet askujt padrejtësi në formulën e grantit të përgjithshëm dhe atyre specifike. Pra, 89, 6, 3, 2, siç është e paraparë, mirëpo ajo çka krijon pakënaqësinë më të madhe, janë tek ministritë e linjave.

Buxhetet që janë nëpër ministritë e linjave dhe investimet që ndodhin dhe p.sh. ne të gjithë sot kemi të drejtë ta krijojmë një dilemë se sikur të kishim pas një plan pune të ministrive sot këtu dhe të shohim se të gjitha ato mjete nëpër ministri të linjave si janë të parapara për t'u shpenzuar? A do të jenë në pjesën primare të ministrive apo ato do të ruhen që pastaj do të bëhet ajo mbështetja jo proporcionale nëpër komuna.

Prandaj, unë mendoj se këto janë tri momente që kishin për ta begatuar Ligjin për buxhetin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe e kemi diskutuesin e fundit, deputeten Kimete Bytyqi. Po, para se ta marrësh deputete fjalën, unë dua të them se fjalën ose radhën për dhënien e fjalëve të deputetëve të grupeve parlamentare e kam bërë sipas kërkesave të kryetarëve të grupeve parlamentare.

KIMETE BYTYQI: I nderuari kryetar i Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po debatojmë për një çështje të rëndësishme, Projektbuxhetin e vitit 2012. Duke qenë kështu, shtroj pyetjen, a është në të vërtetë ky buxhet ai i cili duhet të jetë dhe a garanton ecjen në binarë të sigurimit të zhvillimit ekonomik të vendit tonë?

Unë mendoj që jo, sepse ky buxhet është i ndërtuar mbi premisat e njëjta sikurse buxheti i vitit 2011, i cili u vërtetua se nuk ka qenë buxhet i zhvillimit ekonomik dhe përmirësimit të gjendjes sociale në vend, por buxhet që ka thelluar krizën në vendit tonë. Ky buxhet nuk garanton zhvillimin ekonomik për vendin. Ka rritje të buxhetit në kategorinë mallrat dhe shërbime që nuk është në linjën e kategorinë e investimeve kapitale, pra kjo Qeveri është Qeveri e shpenzimeve enorme dhe jo Qeveri që i interesohet të ulë shpenzimet në

mallra e shërbime dhe të ngritë investimet kapitale sipas parametrave të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Çka është më e keqe, shumë nga këto projekte, investime kapitale nuk janë të qëndrueshme dhe të analizuara me kujdes se sado të ndikojnë në zhvillimin e vendit dhe duke qenë kështu, konstatimi im i bazuar është se ky buxhet është i hartuar për interesa individuale, politike, partiake të partive në pushtet dhe si e tillë është i papranueshëm.

Ky buxhet, si i tillë është në kundërshtim me vizionin tonë si shtet në integrimin në Bashkimin Evropian. Me këtë buxhet nuk garantohet reformë në administratën publike të Republikës së Kosovës, nuk garantohen ndërtime me mirëmbajtje të shkollave, shtëpive të shëndetit, infrastrukturës rrugore, çerdheve, sallave sportive, stadumeve etj.

Ky buxhet nuk subvencionon bujqësinë as në tretmanin minimal. Duke ditur faktin se bujqësia është degë kryesore e zhvillimit ekonomik të vendit tonë, është dashur të ketë prioritet më të lartë, bujqit do të mbesin pa subvencione të duhura dhe si pasojë të kësaj, shumë toka do të mbesin të pa punuara, në këtë mënyrë vendi ynë do të jetë i obliguar të importojë produkte nga vendet tjera.

Pastaj, artistët nuk do të kenë mbështetjen e duhur për ta afirmuar talentin dhe kreativitetin e tyre për të afirmuar vlerat tona kulturore e artistike. Ky buxhet si i tillë nuk do të hap vende pune për të rinjtë, të cilët edhe pse investojnë në vendin e tyre duke kryer me sukses studimet diplomike dhe post diplomime, mbesin pa punë dhe kjo gjithashtu është pengesë në procesin e krijimit të familjeve të reja, çka do të thotë se kjo Qeveri nuk ka politika zhvillimore për të rinjtë dhe për krijimet e familjeve, kur dihet mirëfilli se familja është celulë e shoqërisë dhe e shtetit.

Sa i përket sportit, me mburrje them se federatat e sportit janë duke punuar me përkushtim në integrimin e sporteve tona në kuadër të federatave ndërkombëtare. Ama, Qeveria e vendit tonë ende nuk ka ndërtuar as edhe një stadium të vetëm, i cili përmbush kriteret për zhvillimin e ndeshjeve sportive të karakterit ndërkombëtar. Kjo është vetëm një shembull dhe atë vetëm një sektorë të Qeverisë, që tregon se ky buxhet nuk është buxheti i zhvillimit ekonomik, por është buxhet i tekeve elektorale të individëve të partisë në pushtet.

Trashëgimia kulturore do të mbetet në mëshirë të kohës. Shumë monumente do të shkatërrohen, sepse kjo Qeveri nuk është duke ndarë buxhete të mjaftueshëm për këtë sektorë shumë të rëndësishëm që pasqyron qytetërimin tonë autoktonë në këtë pjesë të Evropës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Pensionistët janë duke na dëgjuar me “vesh në krah” se çka do t’ju ofrojë ky buxhet, se ky buxhet nuk do t’i ofrojë asgjë më shumë se deri më tani, e kjo Qeveri nuk është duke u interesuar për këtë kategori, e cila ka kontribuar me jetën e tyre për ndërtimin e vendit tonë.

Ata janë prindërit tonë dhe ata meritojnë të kenë një pleqëri të qetë dhe të begatë, mirëpo ky buxhet dhe kjo Qeveri nuk ua siguron këtë. Atëherë, si anëtare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut mund të them se ky buxhet ka edhe elemente të shkeljes së të drejtave të njeriut, sepse në komunat që qeverisë Lidhja Demokratike e Kosovës, siç është Prishtina, Fushë Kosova, Podujeva, Istogu, Obiliqi, Novobërda, të cilat kanë rreth 40% të popullsisë së Kosovës, marrin vetëm 19% të buxhetit për ndërtimin e shkollave.

Kjo shihet qartë se qytetarët e këtyre komunave, edhe pse janë tatim pagues të njëjtë sikurse qytetarët e komunave tjera, nuk kanë hise të njëjtë në ndarje të buxhetit, vetëm e vetëm se këto komuna nuk udhëhiqen nga partitë në pushtet.

Si përfundim, mund të them lirisht se ky buxhet thëllon krizën në vend. Duke mos dashur që të jem pjesë e këtij thellimi të krizës në vend, unë jam “kundër” këtij buxheti, sepse ky buxhet nuk garanton zhvillimin dhe mirëqenien për qytetarët e vendit tonë. Faleminderit!

Diskutime të dorëzuara me shkrim

LATIF GASHI: I nderuari kryetar,
I nderuari kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po shqyrtojmë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, i cili është projektuar të jetë 1 miliard e 520 milion euro, e që sipas hartuesve, pra Qeverisë së Kosovës, ky projektbuxhet është në harmoni të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Bazuar në rishikimin e marrëveshjes të bërë nga 2 nëntori deri më 11 nëntor nga një staf i ekspertëve të FMN-së, kryesuesi i të cilit e ka lëshuar një deklaratë për media në të cilën konstatohet se “Qeveria e Kosovës ka hartuar politika të qëndrueshme fiskale dhe ka krijuar menaxhim të fortë në ekzekutimin e buxhetit për këtë vit që mund të hap rrugën për ndihmë financiare nga FMN-ja për vitin 2012”, vazhdon deklarata e kryesuesit të FMN-së “politika makroekonomike dhe financiare janë në rrugën e duhur, deri në fund të shtatorit janë plotësuar standardet mbi bilancin e përgjithshëm bankar të Qeverisë, bilancin primar dhe shpenzimet primare që ishin pikë referimi sipas marrëveshjes së monitorimit”, thuhet në deklaratën e kryesuesit të këtij misioni. Gjithashtu, stafi i FMN-së ka arritur marrëveshje me autoritetet kosovare që për vitin 2012 deficiti të mos jetë më i lartë se 3.2%, çka do të thotë se kemi qëndrueshmëri buxhetore, përkundër investimeve të mëdha kapitale dhe rritjes së mirëqenies sociale. Pra, ky buxhet është i bazuar në projekte realiste të të hyrave dhe shpenzimeve të cilat garantojnë jo vetëm plotësimin e nevojave të qytetarëve tanë, por njëkohësisht garanton edhe rritje në zhvillimin ekonomik.

Të hyrat e rregullta buxhetore janë parashikuar të jenë 1 miliard e 361 milionë euro apo rreth 4.0% më të larta se sa të hyrat e rregullta, për vitin 2011. Nga këto të hyra doganat e Kosovës pritet t'i grumbullojnë 860 milionë euro, ndërsa të hyrat nga tatimet vendore

pritet të arrijnë vlerën prej 285 milionë eurove. Përpos këtyre të hyrave të rregullta dhe të burimeve tjera të të hyrave, pritet që të trashëgojmë edhe një bilanc pozitiv bankar prej mbi 120 milionë euro nga buxheti i këtij viti, që do të jetë burim shtesë i financimit.

Buxheti i rregullt për vitin 2012 është në vlerë prej 1 miliard e 520 milionë eurove, që paraqet një rritje prej 7.6% krahasuar me buxhetin e projektuar në vitin 2011. Sikurse edhe vitet e kaluara, edhe Draft-buxheti për vitin 2012 ruan nivelin e lartë të shpenzimeve kapitale me pjesëmarrje prej 40.5% në buxhetin e tërësishëm, ku mund të themi se kemi nivelin më të lartë të pjesëmarrjes krahasuar me vendet e regjionit, ku kjo pjesëmarrje sillet rreth 15%.

Pra, shpenzimet kapitale janë paraparë të jenë 616 milionë euro, shifër e cila përfaqëson një ngritje prej afro 15% në krahasim me vitin 2011. Kjo ngritje e theksuar në kategori të shpenzimeve reflekton vazhdimin e projektit të autostradës, e cila përfshin shumën prej 296 milion euro apo rreth 50% të kësaj kategorie. Për projekte tjera janë paraparë 320 milion, që janë 11% më tepër krahasuar me vitin 2011.

Ngjashëm me vitet tjera, pjesë e shpenzimeve të përgjithshme të Qeverisë janë edhe pagesa e interesit për huamarrje në vlerë prej 13 milionë euro, si dhe kredia e planifikuar për ndërmarrje publike në vlerë prej 15 milionë euro, duke e rritur vlerën e shpenzimeve të Qeverisë për vitin 2012 në 1 miliardë 533 milionë euro.

Një buxhet i tillë i ofron Kosovës një stimulim shtesë që do të rezultojë me një rritje të parashikuar ekonomike prej rreth 5.0% në vitin 2012. Sa u përket shpenzimeve tjera, për paga dhe mëditje janë 407 milionë euro, shifër kjo që paraqet një ngritje prej 5.4% në krahasim me vitin 2011, shpenzime për subvencione dhe transfero 284 milionë euro, shpenzime për mallra dhe shërbime janë paraparë të jenë 198 milionë euro.

Sipas hartuesve të buxhetit, të gjitha kalkulimet janë në harmoni të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, e cila marrëveshje obligon ruajtjen e rezervës fiskale në rast të ballafaqimit me kriza eventuale, duke e ditur që Kosova është një vend i hapur dhe nuk ka instrumente të politikës monetare që t'i përgjigjet çfarëdo tronditje të mundshme.

Komisioni Evropian ka kërkuar për këtë vit që rezerva buxhetore të jetë 60 milionë euro. Sigurimi i kësaj rezerve është vendimtar për të garantuar stabilitet buxhetor. Qeveria ka miratuar propozim vendimin e alokimit të mjeteve në shumën prej 60 milionë eurove. Nuk pritet që kriza e borxheve do të afektojë vendin tonë, për arsye se ka një stabilitet të konsiderueshëm financiar, bankar.

Kosova mbase është vendi i cili ka më së paku borxhe në Evropë. Sektorët që më së shumti do të përfitojnë nga ky buxhet për vitin e ardhshëm janë: Ministria e Bujqësisë, e cila do të ketë rritje 56%, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Arsimit, Ministria e Kulturës me rritje 18%, Ministria e Punëve të Brendshme 7%, Universiteti i Prishtinës, Prokuroria e shtetit 13%, Këshilli Gjyqësor i Kosovës 14%.

Ndarja e buxhetit për investime kapitale nëpër komuna është bërë në përputhje me projektet prioritare të kuvendeve komunale dhe mundësive buxhetore.

Duke pasur parasysh faktin se Kosova ka dalë nga lufta me një ekonomi krejtësisht të shkatërruar, si dhe deri në vitin 2008 është investuar shumë pak në projektet kapitale, siç janë: infrastruktura në objektet qeveritare dhe vendosja e institucioneve nga objektet private në ato shtetërore, ndërtimi i objekteve shkollore në të gjitha komunat e vendit tonë, që deri në vitin 2008 shumë nxënës i kishim në tende, investime të mëdha në infrastrukturën rrugore dhe së fundi në autostradën Morinë-Merdar.

Përkundër kësaj, Kosova sot në kohën kur shumë vende të rajonit i ka kapluar kriza ekonomike, vendi ynë po arrin stabilitet ekonomik të qëndrueshëm, me një rritje të theksuar të zhvillimit ekonomik, si dhe ngritje të mirëqenies sociale të qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

BAHRI THAÇI: I nderuari kryetar i Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Meqenëse sot para nesh kemi në rend të ditës diskutimin e buxhetit të Kosovës për vitin e ardhshëm, konsideroj që është e nevojshme të diskutojmë me qëllim më të mirë që ky buxhet të finalizohet në formën më të mirë të mundshme.

Gjithashtu, meqenëse nëpërmjet këtij buxheti bëhet edhe shpërndarja e të ardhurave të Kosovës, atëherë duhet të kemi kujdes që kjo shpërndarje të jetë sa më e drejtë dhe sa më gjithëpërfshirëse. Për të shkuar në përmbajtjen e dokumentit, për neve si deputet është më se e nevojshme të dimë se shifrat të cilat na janë prezantuar, sa janë shifra realiste dhe si të tilla sa pritet të realizohen.

Pa dashur të hyj shumë në detaje, unë kisha dashur që të potencoj vetëm disa nga pikat kyçe:

- Projektionet e të hyrave buxhetore, sa këto të hyra marrin për bazë ambientin ekonomik në Kosovë, si dhe zhvillimet e pritshme në tregun global, e për të qenë më konkret, sa ato janë realiste dhe të pritshme të realizohen?

- Një nga zërat e të hyrave për vitin 2012 është llogaritur edhe mbështetja nga donatorët prej 30 milionë euro, e cila vështirë se mund të materializohen për faktin që fillimisht kjo Qeveri duhet të hyjë në program të ri me FMN-në.

- Gjithashtu, një burim tjetër shtesë duket të jetë edhe një dividendë nga PTK-ja në vlerë prej 35 milionë euro, që prapë na vë në dyshim se diçka në këtë rast nuk po shkon. Në të njëjtën kohë merren vendime për privatizimin e kësaj kompanie dhe në të njëjtën kohë presim dividendë shtesë. Sipas një kalkulimi të thjeshtë, nëse do marrim dividendën, atëherë pritjet për vlerën e mjeteve nga privatizimi i kësaj kompanie duhet zvogëluar.

- Në pjesën e shpenzimeve, struktura pothuaj mbetet e njëjtë me vitin e kaluar në të gjitha kategoritë. Pagat dhe mëditjet duket të jenë rritur në terma nominal për 21 milionë euro dhe kjo kryesisht si rezultat i rritjes së administratës dhe posteve politike, përderisa në terma real askush nga pagat e tyre nuk mund të pres rritje, edhe pse sipas të dhënave aktuale niveli i inflacionit në vitin 2011 pritet të jetë rreth 8%.

- Shpenzimet kapitale duket të jenë rritur për rreth 81 milionë euro, krahasuar me vitin 2011, por kjo rritje më shumë lidhet me faktin që në vitin 2011 këto shpenzime janë shkurtuar në raport me buxhetin fillestar dhe ky shkurtim ka ndodhur në mungesë të fondeve dhe shtrëngimeve nga FMN-ja, sepse buxheti fillestar i vitit 2011 për shpenzimet kapitale ka qenë i madh.

- Në të njëjtën kohë, pjesa më e madhe e këtyre mjeteve janë orientuar në autostradë (projekt ky të cilin të gjithë ne e çmojmë), por shtrohet një pyetje, çka të bëhet me projektet tjera nëpër komuna? Qytetarëve të shumë lokaliteteve vështirë se do t'ju vijë radha të shijojnë autostradën për faktin që nuk kanë as infrastrukturë bazike në vendbanimet e tyre dhe në të njëjtën kohë nuk kanë as makinë.

- Në pjesën e financimit, shifrat e prezantuara tregojnë që vendi ynë duhet të fillojë të marrë borxh, për të ruajtur nivelin e pranueshëm të bilancit bankar. Kjo duhet potencuar se tanimë keni filluar ta fusni vendin në borxhe, të cilat duhet paguar nga gjeneratat e ardhshme.

- Bilanci bankar në fund të vitit 2012 në këtë tabelë është paraqitur të jetë 411 milionë euro, por kjo shifër duket se është lidhur ngushtë me një varg të panjohurash:

- a). A do të ketë marrëveshje me FMN-në dhe a do marrim fonde prej tyre?
- b). Fondet nga Banka Botërore janë të lidhura me marrëveshjen me FMN,
- c). Privatizimi i aseteve publike edhe më i pasigurt
- d). Borxhi i brendshëm publik, nuk kemi ndonjë informatë se si do të ndodh.

Të gjitha këto na japin të kuptojmë që jemi duke ndërtuar një buxhet mbi disa projeksione të cilat janë mjaftë të pasigurta dhe të cilat nuk varen nga ne.

Për të vazhduar më tutje, ku profesioni im si mjek dhe si anëtarë i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale detyrimisht më obligon të vlerësoj shpërndarjen e këtij buxheti për këtë sektor.

Shëndetësia, duket se nuk është prioritet i kësaj Qeverie. Si duket, kemi harruar që shëndeti është primar për secilën shoqëri. Buxheti për shëndetësi i paraparë për vitin 2012 duket të jetë i njëjtë me atë të vitit 2011, ndoshta kjo Qeveri po konsideron që shërbimet shëndetësore janë të mira, por e vërteta në këtë është krejt ndryshe.

Tanimë janë dhënë shumë premtime që së shpejti Qeveria do të procedojë në Parlament Ligjin për shëndetësi dhe Ligjin për sigurime shëndetësore, por si duket edhe viti 2012 Kosovën do ta shoqërojë pa këto ligje, edhe pse jemi vendi i vetëm në Evropë pa Ligjin për sigurim shëndetësor. Buxheti për shëndetësi është 88 milionë euro, ku gati gjysma prej tyre janë paga dhe mëditje, përdërisa shpenzimet kapitale dhe buxheti për barnat esenciale mbeten mjaft të ultë.

Një kategori tjetër në këtë buxhet janë transferet sociale, ku të dhënat që janë prezantuar nuk tregojnë që këtu kemi rritje të buxhetit. Kjo dëshmon se pensionistëve ende ju mbetet vetëm të shpresojnë që pensionet do t'ju rriten. Pensionet bazike për rreth 110 mijë veta ende mbesin me 45 euro në muaj, ku rritja e fundit për këtë kategori ka qenë në vitin 2009. Me ligj Qeveria është e obliguar që këto pensione dhe asistencën sociale duhet ta indeksojë në fund të çdo viti, varësisht nga niveli i inflacionit. Gjithashtu, edhe numri i familjeve në asistencë sociale është rreth 35 mijë, ku përfitimet e tyre ka vite që nuk janë rritur.

Të dhënat nga Enti i Statistikave të Kosovës flasin që përgjatë periudhës kur këto pensione nuk janë rritur, inflacioni për produktet ushqimore ka qenë rreth 30%. Kjo nënkupton se këto pensione duhet rritur në harmoni me këtë inflacion.

Mendoj se ky buxhet nuk prezanton prioritetet reale të shoqërisë, por më shumë ka adresuar nevojat dhe interesat e caktuara të një grupi.

HASHIM DESHISHKU: I nderuari kryetar i Parlamentit,

I nderuari kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Këtë projektligj që sot e kemi për shqyrtim, përcakton të gjithë parametrat e zhvillimit ekonomik e social për vitin 2012. Prandaj, ai ka rëndësi të veçantë dhe hartuesi i tij duhet të jetë i vëmendshëm për mënyrën e sigurimit të parasë publike dhe shpërndarjen e saj sipas nevojave. Do të thotë, të mbulojë të gjitha kërkesat sociale, të nxisë zhvillimin ekonomik dhe punësimin, kurse vendin të mos e fusë në situata të paqarta, në deficite, apo në borxhe.

Për fat të keq, ky projektligj i ka pikërisht këto mangësi. Por, më të theksuarat janë:

1. Ai nuk premtonte zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, meqenëse paratë nuk shkojnë për mbulimin e nevojave më të mëdha.
2. Krahasuar me vitin 2011, në 2012 të hyrat buxhetore parashihen të rriten 3,7%, kurse shpenzimet 7,5%. Kjo shpërputhje e rritjes është paralajmërim i keq për qëndrueshmërinë e buxhetit dhe për stabilitetin makro-fiskal në përgjithësi.
3. Kalkulimet tabelore më shumë janë produkt i dëshirës së autorit, se sa i mundësive aktuale për sigurimin e parasë. Së paku shumë gjëra deri më sot janë të padukshme.

4. Buxhetit që gjendet para nesh realisht i mungojnë më shumë se 450 milionë euro. Ato janë kalkuluar për të mbuluar deficitin, përkatësisht për të nxjerrë një bilanc pozitiv prej 411 milionë eurosh. Por, këto para nuk janë të prekshme. Ja ilustrimet konkrete:

- a) Parashihet që si financim i jashtëm të arrijnë 90 milionë euro, para që janë shumë ngushtë të lidhura me nivelin e raportin e Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Ministri me optimizëm flet për këto raporte, por kjo është vetëm njëra anë e medaljes. FMN ende nuk e ka thënë fjalën e vet, kurse përmes shtypit janë transmetuar vërejtjet që ia adreson Qeverisë.
- b) Përmes huazimeve të brendshme thuhet se sigurohen 74 milionë euro. Kjo nënkupton emetimin e letrave me vlerë. Ndërkaq, e vërteta është se ky proces është në fazën e përgatitjes dhe nuk dihet saktësisht se a mund të sjellë aq para për nevojat e Qeverisë.
- c) Sërish figurojnë të hyrat e mëhershme në të njëjtën shumë sikur edhe në buxhetin e vitit 2011, pra 300 milionë që vijnë pas shitjes së aksioneve në PTK. Ndërkaq, kjo para ende mbetet në pikëpyetje. Një tentativë, dështoi, kurse e dyta nuk dihet kur do të fillojë?

Edhe nëse mendohet se i tërë procesi do të përfundojë brenda vitit, enigmë edhe më e madhe janë blerësit dhe ofertat e tyre. A do të ofrojnë 300 milionë euro, apo Qeveria do të jetë e shtrënguar që pasurinë që ka mundësi që secilin vit t'ia sjell 30 – 40 milionë euro ta shes me nguti dhe për çfarëdo çmimi. Rrethanat në të cilat ajo do të gjendet në mot, flasin se kështu edhe do të veprojë.

Pra, tabelat buxhetore përmbajnë shumë paqartësi, kurse në disa vende shifrat më shumë janë të imagjinuara se sa reale.

Kur flasim për zhvillimin e kufizuar ekonomik, kryesisht kam parasysh shpenzimet kapitale, strukturën e tyre dhe synimet. Se do të mungojë ky zhvillim, ka përplot fakte:

1. Është e vërtetë se shpenzimet kapitale prej 616 milionë eurosh do të kenë rritje të dukshme 15,1%. Por, gati gjysma e tyre shkojnë në një projekt-financim të autostradës. Ndërkaq, ky projekt në mot mban “të bllokuara” mbi 90% të parasë për investime kapitale që ka paraparë Ministria e Infrastrukturës.

2. Gjendja është edhe më e rëndë kur merret parasysh se nga 490 milionë euro, sa parashihen të jenë investime kapitale në nivelin qendror, për projekte të reja shkojnë vetëm 23,5% të tyre. Kjo Qeverisë ia ka imponuar që të shkurtojë projektet e reja. Ose, në njërin prej prioriteteve të proklamuar – bujqësinë, për insertime kapitale të ndajë 7,9 milionë euro, ku mbi 76% të tyre janë për projektet e filluara më herët. Ndërkaq, në sferën e arsimit në mot nis ndërtimi i vetëm pesë objekteve të reja, kurse për veturat e Ministrisë do të shpenzohen 200 mijë euro.

3. Ose, rasti edhe më eklatant. Në mot përmes financimit nga niveli qendror nis ndërtimi i vetëm një rruge në Jabllanicë dhe ndërtimi i unazës së jashtme – pjesa perëndimore në Prishtinë. Në bashkëfinancim me komunat parashihen vetëm pesë rrugë të reja. Po ashtu, nga tabelat vërehet se parashihet vazhdimi i rrugës në lokalitetin e Kamenicës në fshatrat Shuipovnic e Epërme, Destivojc, Tërstenik, ku janë ndarë vetëm pesë mijë euro. Shtroj pyetjen - çka mund të ndërtohet me 5 mijë euro?

Ka s'përputhje të mëdha edhe kur analizohet mënyra e financimit të komunave, për të cilat në mot do të ndahen 301 milionë euro. Këtyre duhet shtuar edhe 60 milionë euro nga të hyrat vetjake dhe kjo është e tëra që kanë komunat për paga, investime dhe për qëllime të tjera. Por, ka anomali për mënyrën e ndarjes së këtyre mjeteve, që në fakt tregon për trajtimin jo të barabartë që iu bëhet komunave. Kjo lë për të dyshuar se paraja ndahet varësisht se cila parti e ka pushtetin. Ja shembujt:

1. Për nga vlerat absolute del se Prishtina, nga niveli qendror merr më shumë krahasuar me komunat e tjera. Mirëpo, pjesëmarrja e grantit qeveritar në strukturën e të hyrave buxhetore është më e ulëta krahasuar me komunat e tjera. Në këtë strukturë granti qeveritar merr pjesë 64.7%, ndërkaq në Skenderaj, Kaçanik e Viti nga 89%, në Gjilan 80%, Prizren 83% dhe Gjakovë 85%. Për hartuesit e buxhetit nuk ka pasur rëndësi se Prishtina ka numër të banorëve dukshëm më të madh se secila komunë, madje edhe sipas regjistrimit të fundit. Por, as fakti se nga 60 milionë euro sa është totali i të hyrave vetjake të të gjitha komunave, vetëm Prishtina grumbullon 21.7 milionë euro, ose 36% të tyre.

2. Apo, sa për ilustrim po përmendi se komuna e Artanës nga niveli qendrorë merr pak më shumë se 2.2 milionë euro, që është gati përgjysmë më pak se ajo që merr komuna e Graçanicës, dhe përafërsisht e njëjta me të Shtërpçës.

3. Anomali të ngjashme ka edhe kur analizohen përfitimet e komunave për investime kapitale. Në komunën e Prishtinës përmes grantit qeveritar ato mbulohen vetëm 38.7%. Kjo është pjesëmarrja më e ulët krahasuar me komunat e tjera, kurse barabartë me Gjilanin. Në Skenderaj qeveria mbulon 66% të shpenzimeve kapitale, në Viti 75% në Vushtrri e në Kaçanik 55%, kurse në Gjakovë 62%. Ndërkaq, në komunat e banuara me popullatë serbe kjo pjesëmarrje sillet nga 72% në Graçanicë, deri në 90% në Ranillug.

Nga kjo del qartë se buxheti si i tillë ka përplot çrregullime dhe ndarje jo të barabarta. Por, më e rrezikshme është ajo se vendi po ecë drejt një krize të rëndë buxhetore. Prandaj, ky projektligj nuk duhet të pranohet përderisa ai nuk përmban zëra real. Ju faleminderit!

JETON SFIRCA: Të nderuar deputetë,

Sot jemi duke e diskutuar në lexim të parë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Parashikimit të Qeverisë dhe konstatimit të saj për rritje ekonomike mbi 50%, besojmë dhe mirëpresim rritjen, rritje të mirëpritur nga të gjithë qytetarët e vendit, duke qenë

koshient se rruga jonë drejt zhvillimit ekonomik dhe arritjes së standardeve të jetesës evropiane nuk është e lehtë.

Interesimi ynë për një zhvillim ekonomik që do t'iu mundësojë qytetarëve të Kosovës të ardhura dhe jetë të njëjtë me atë të qytetarëve të shteteve të zhvilluara, konsideroj se ne duhet të vëmë prioritete në ndarjen buxhetore.

Andaj, në drejtim të kësaj konsiderojë se duhet rritur buxhetin për Ministrinë e Shëndetësisë së paku edhe 10 milionë, për arsye të lehtësimit të implementimit më të efektshëm të dy projektligjeve të Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat do të na vijnë së shpejti në Kuvend, për miratim.

Gjithashtu, shtimi i më shumë se 1 milionë euro për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, konkretisht për Universitetin e Prishtinës për botimin e një numri të konsideruar të titujve shkencorë të cilët janë shumë të nevojshëm.

Gjithashtu, kërkojmë fond shtesë për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, konkretisht për ndërtimin e një palestre sportive në lagjen Kodra e Trimave në Prishtinë. Kjo lagje është e lënë anash nga investimet, e këtë duhet ta ketë parasysh niveli qendror. Ju faleminderit, për mirëkuptim!

HASIME KRASNIQI: I nderuari kryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Hartimi i buxhetit paraqet një ndër punët më sfiduese për Qeverinë e Kosovës, dhe një gjë e tillë është e kuptueshme për faktin se nevojat e qytetarëve dhe dëshirat për të bërë më shumë për vendin janë më të mëdha se sa mundësitë dhe potenciali që ka Republika e Kosovës. Por, unë e përgëzoj Qeverinë e Republikës së Kosovës, për punën që kanë bërë gjatë planifikimit të projektbuxhetit për vitin 2012, në kuadër të mundësive buxhetore për adresimin e nevojave për të gjithë qytetarët e vendit dhe në harmonizim me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Ky projektbuxhet ka për synim krijimin e kushteve për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe për përmirësimin e mirëqenies socialo-ekonomike për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Të dhënat aktuale të ofruara me këtë projektbuxhet dëshmojnë se ekonomia e vendit, edhe përkundër tronditjeve në tregjet ndërkombëtare ka arritur të gjenerojë një rritje reale ekonomike prej 5.3% për vitin 2011, rritje kjo e cila parashihet edhe për vitin 2012 - 2014.

Projektbuxheti i vitit 2012 ka për synim ruajtjen e qëndrueshmërisë makrofiscale të vendit, duke siguruar të hyra buxhetore në vlerë prej një miliard e treqind e gjashtëdhjetë e një milion euro, të hyra këto për 4% më të larta se të hyrat e planifikuara për vitin 2011.

Prej këtyre të hyrave edhe në vitin 2012:

- Të hyrat tatimore – (ATK-ja) arrijnë vlerën prej një miliard e njëqind e njëzet e tre milionë euro,
- Të hyrat nga kufiri (doganat) 860 milionë euro ose 3.7% më të larta, krahasuar me planifikimin e vitit 2011,
- Të hyrat vendore janë më të larta për 9.5%, dhe
- Të hyrat jo tatimore dhe të hyrat vetanake shënojnë një ngritje për 6% më të larta, krahasuar me planifikimin për vitin 2011.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2012 janë planifikuar të jenë 1 miliard e 520 milionë euro, apo rreth 7% më të larta se shpenzimet, e që priten të realizohen gjatë vitit 2011, që është rezultat i rritjes së investimeve kapitale, rritjes së pagave, bartjes së përgjegjësisë nga institucionet ndërkombëtare, themelimin e institucioneve të reja në bazë të ligjeve të aprovuara dhe të hyrave në fuqi.

Shpenzimet buxhetore sipas kategorive ekonomike edhe në vitin 2012, dominohen nga investimet kapitale të cilat kanë pjesëmarrje prej 41%. Paga dhe mëditje 27%, mallra dhe shërbime 13% dhe subvencionet dhe transferet 19% në shpenzimet e përgjithshme.

Në fund, mendoj se projektbuxheti për vitin 2012 është një projekt profesional dhe vizionar i Qeverisë së Republikës së Kosovës, që do të bëhet edhe projekt i qytetarit dhe do të ndikojë në përmirësimin e jetës së tyre. Ju faleminderit!

HAMZA BALJE: Hvala, gospodine predsedniče!

Gospodine premijeru, ministri,

Kolege zastupnici,

Kratko ću napraviti jedan osvrt o budžetu za 2012. godinu.

Globalna ekonomska kriza, koja je bila prisutna krajem 2008. i tokom 2009. godine, je imala značajan uticaj na ekonomiju Republike Kosova. Ovaj uticaj se ogleda u sužavanju privrednih aktivnosti, izraženo u procentima koji su konstantno padali tokom 2009. godine. Napokon u 2010. godini je počeo ekonomski oporavak u euro-zoni, tako i u našoj zemlji, tako da u 2010. i 2011. godini dominiraju pozitivna očekivanja ekonomskog i privrednog razvoja Republike Kosova. Što se tiče ekonomskog i privrednog razvoja, Kosovo vodi na listi sa povećanjem od 5.30% respektivnih 5%, a zatim slede ostale zemlje u regionu, kao što je Makedonija sa 3% i tako dalje.

Za 2012. godinu budžet u svojoj makro-ekonomskoj projekciji pokazuje rast bruto društvenog proizvoda od 5%, i on je baziran na osnovu povećanja potrošnje, izvoza i investicija. Privatne investicije se očekuju da rastu po prosečnoj stopi od oko 8.70%, a kao važan doprinos BDP je povlačenje javnih investicija koje se očekuje da budu čak i do 11.90%.

Projekcije budžetskih prihoda za 2012. godine su zasnovane na srednjoročnim procenama vodećih ekonomskih pokazatelja, uključujući i kretanja na nivo uvoza, cijena, kao i rasta performansi institucija za prikupljanje prihoda, a to su carina, poreska administracija itd.

To je značajan pokazatelj za stabilan budžet koji se bazira na stabilnoj i naprednoj fiskalnoj politici unutar zemlje, gdje će se od svakog ministarstva odvojiti po 5% i za manjine na Kosovu (posebno naglašavam tu ravnopravnu raspodelu za Bošnjačku i Goransku zajednicu).

Očekuje se da će ukupni budžetski prihodi za 2012.godinu, dostignu iznos od 1.361.000 što je očevidan rast u odnosu na prethodne godine.

Budžetski rashodi će u 2012. godini postići vrednost od 1.520.000 ili oko 7,6% visine od rashoda koja će biti razlikovana tokom 2011.godine. Ovo se planira zbog rasta kapitalnih investicija za oko 15%. Glavnu ulogu u podizanju ove kategorije rashoda će imati nastavak izgradnje auto-puta Morina – Merdare.

S obzirom na ovakav razvoj, MMF je revidirao globalni privredni rast za 2011 sa 4% na 4,50%. Iako se ovo povećanje može smatrati zadovoljavajućom, hoću da napomenem da ovo povećanje nije izbalansirano kako treba unutar zemlje, gde se zapaža povećan privredni rast i razvoj naročito u investicijama u pojedinim delovima Kosova, dok se u drugim, kao što je primer u naj južnijoj opštini na Kosovu – Dragaš, očigledno je da je pomak veoma mali, opštini koja ima možda najveće resurse što se tiče razvoja poljoprivrede i turizma.

Mislim ad će se ovi mali propusti izbalansirati u toku rada Komisije za budžet i financije i dati jednu izbalansiranu sliku budžeta na celoj teritoriji Kosova u toku drugog čitanja budžeta.

Mi ćemo naravno podržati ovaj Nacrt budžeta i glasiti za njega. Zahvaljujem!

ENIS KERVAN: 2012 yılı Bütçe Tasarısıyla ilgili kimi öneri ve uyarılarımızı sizlerle paylaşmak istiyorum. Öncellikle sözkonusu Türk topluluğu ve onların beklentileri konusuna odaklanmak istiyorum. Sözkonusu Türk topluluğunun yasal haklarını konuşursak, bu haklarımızın yürürlükte olabilmesi için kimi kurumlardaki bütçe miktarının artması gerekmektedir.

Topluluklar ve Geri dönüş Bakanlığındaki 7 milyon 179 bin euroluk bütçe, Kosovada yaşayan tüm toplulukları gözönünde bulundurursak yeterli değildir.

Geri dönüş sürecinde Kosovalı Türkleri diğer topluluklarla kıyaslamamız elbette doğru olmaz. Bü yüzden Türk topluluğunun güncel yaşama şartları doğrultusundaki beklentilerine yönelik ayrı bir bütçe oluşturulup, belediyelerle koordineli çalışılmalıdır.

Mitroviçanın kuzeyinde yaşayan Türk ailelerinin hemen hepsi ya Mitroviçanın güneyine, ya Priştineye, ya Türkiye'ye ya da Avrupa ülkelerine yerleşmiştir. Öyle ki güneye yerleşen bu aileler için yerleşim konutlarının oluşturulması için Topluluklar Bakanlığına ek bütçe gerekmektedir. Hastaların Türkiye'ye Sağlık Bakanlığınca daha fazla gönderilebilmesi için bu bakanlığa da bu konuda ek bütçe gerekmektedir.

Türkçenin resmi dil ve resmi kullanımda dil olduğu Prizren, Mamuşa, Priştine, Gilan, Mitroviça ve Vıçitırın belediyelerinde yasal hak Türkçenin eğitimde, belediye kurumlarında ve meclislerinde kullanılması için ve bu sistemin yerine oturması için bu belediyelerde Türk toplumuna yönelik ek bütçe gerekmektedir.

Kültür, Gençlik ve Spor Bakanlığında, Başbakanlığa bağlı topluluklar ofisinde ve diğer kurumlarda, Türk kültür, eğitim, esnaf, gençlik, spor, kadın v.b. derneklerin temel beklentilerini karşılamak maksadıyla bütçenin ayrılması gerekmektedir. Mitroviça olmak üzere, Prizren v.b. belediyelerde Türk kültür merkezlerinin oluşması için hiçbir bütçe ayrılmazken, mesela Leposaviçe başka bir topluluk enstitüsü için bütçe ayrılmıştır.

Prizren belediyesinde ek ilkokul ve ortaokul binalarının inşaatı için yine bütçe gerekmektedir. Bugün Prizren belediyesinde Türk topluluğunun yaşadığı semtlerde asfaltlama olayları hala tamamlanmamıştır, bu yüzden belediyeye bu konuda ek bütçe dahil edilmesi gerekmektedir.

Yasal hak olan kimlik belgeleri halen Türk dilinde basılmamıştır. Bu yüzden 2012 bütçesiyle öngörülen biometrik kimliklerde Türkçenin de eklenmesi için bütçenin tamamlanması gerekmektedir.

Kosova Türk medyalarının ayakta durabilmesi ve güçlenmesi için yine var olan yasal haklar çerçevesinde bütçenin artırılması şarttır. Son olarak emeklilerimizin beklentilerini gözardı etmememiz gerektiğini, öğretmenler ve sağlıkta çalışanlar ile polisimizin beklentilerine çare bulmamız gereğini vurgulamak istiyorum.

KRYETARI: Ju faleminderit! Të lajmëruar të tjerë nuk kemi për diskutim. Fjalën ia kisha dhënë ministrit për Ekonomi dhe Financa, zotit Bedri Hamza.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari kryeministër, ministra,

Deputetë të nderuar,

Sinqerisht më lejoni t'ju falënderoj për diskutimet e juaja shumë profesionale, përmbytjesore dhe korrekte. Më lejoni t'ju falënderohem shumë për alternativat e juaja, më lejoni t'ju falënderoj shumë edhe për kritikën e juaja qëllimmira!

Ne, të gjitha propozimet e juaja do t'i marrim në konsideratë dhe brenda mundësive reale gjatë punës tonë në komisione do t'i akomodojmë dhe do t'i bëjmë pjesë të buxhetit.

Edhe njëherë më lejoni t'ju falënderoj dhe ta shfrytëzoj rastin që t'ju lus që ta votoni Projektbuxhetin për vitin 2012.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim, kërkoj deklarami me votim për miratimin në parim të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash! Prezentë janë 102 deputetë.

Konstatohet se me 58 vota “për”, 35 vota “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012.

(Reagime)

Pa kartelë?! Ne kemi thënë që pa kartelë nuk është mirë të jeni. Do të thotë, 2 vota “për” pa kartelë, që gjithsej bëjnë 60 vota “për”, 35 “kundër” dhe 2 abstenime.

Faleminderit! konstatohet se Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012.

I kemi edhe dy pika të shkurtra, ju lutem!

Pika 5 e rendit të ditës:

**5. Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim
Hapësinor për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin
për mbeturinat**

Me një ngritje formale të dorës, kush është “për”? Faleminderit! Për 30 ditë është fjala.

Dhe, njoftimi tjetër, pika 6e rendit të ditës:

**6. Propozimi i Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje” për
zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare**

Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” ka propozuar deputetin Liburn Aliu për anëtarë të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në vend të deputetes Aurora Bakalli. Ndërsa, deputeti Glauk Konjufca propozohet anëtarë në Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në vend të deputetit Agim Kuleta.

Kërkoj nga deputetët që me ngritje dore të deklarohejmë për propozimin e Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”. Kush është “për”? Faleminderit! “Kundër”, s’ka! Mirupafshim, në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës